

**ARTI MUZIKOR**

**për vitin II**

Arsimi i gjimnazit

## **ARTI MUZIKOR**

ПËР VITIN II (dytë)

Arsimi i gjimnazit

Miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të Vendimit nr. 26-748/1, datë 16.6.2026.

### **Titulli origjinal**

**МУЗИЧКА УМЕТНОСТ ЗА II ГОДИНА гимназиско образование**

### **Botues**

Litera Group, Shkup, 2026

### **Autorë**

Simona Zafirovska

Lejla Alimi Lumani

### **Kryeredaktore**

Ajnure Selmani

### **Redaktore**

Blerta Islami

### **Redaktimi profesional**

Teuta Alimi Selmani

### **Komisioni recensues nga MASH**

Prof. dr. Nevenka Dukovska

Prof. mr. Sasho Popovski

Jovan Vasilevski

### **Përktheu nga maqedonishtja në shqip**

Teuta Alimi Selmani

### **Redaktimi gjuhësor**

Fexhide Zeqiri

### **Dizajni**

Litera Group - Arbana Dehari

### **Redaktimi grafik dhe teknik**

Litera Group - Rina Adili

### **Shtypi**

Polyesterday - Shkup

### **Tirazhi**

2000

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.5.016:78(075.3)

ZAFIROVSKA, Simona

Arti muzikor : për vitin II të gjimnazëve / Simona Zafirovska, Lejla Alimi Lumani ; përktheu nga maqedonishtja në shqip Teuta Alimi Selmani.

- Shkup : Litera Group, 2026. - 176 стр. : илустр. ; 24 см

Превод на делото: МУЗИЧКА УМЕТНОСТ ЗА II (втора) ГОДИНА гимназиско образование. - Библиографија: стр. 174-175

ISBN 978-608-4855-92-7

1. Alimi Lumani, Lejla [автор]

COBISS.MK-ID 69276165

# PËRMBAJTJA

Hyrje

5

## ARTI MUZIKOR NËPËR KOHË

8

### PARAKLASICIZMI

8

Kristof Vilibald Gluk

10

Xhovani Batista Pergolezi

13

### KLASICIZMI VIENEZ

16

Franc Jozef Hajdn

19

Volfgang Amadeus Mocart

21

Ludvig Van Betoven

25

### ROMANTIZMI MUZIKOR

29

Franc Shubert

31

Feliks Mendelson

34

Robert Shuman

36

Johanes Brams

38

Hektor Berlioz

40

Franc List

42

### OPERA NË ROMANTIZËM

44

Opera në Itali në shekullin XIX

45

Xhoakino Rosini

46

Xhuzepe Verdi

47

Opera në Gjermani

50

Rikard Wagner

51

Opera në Francë

53

Zhorzh Bize

53

### ROMANTIZMI NË VENDET SLLAVE

55

Frederik Shopen

56

Mihail Ivanoviç Glinka

58

Petar Iliç Çajkovski

61

Bedzhih Smetana

63

Antonin Dvorzhak

66

## MUZIKA NË SHEKULLIN XX

68

Impresionizmi

68

Klod Debysi

69

Moris Ravel

70

Ekspresionizmi

72

Arnold Shënberg

72

Neofolklorizmi

74

Bela Bartok

74

Neoklasicizmi

75

Igor Stravinski

75

Karl Orf

77

Muzika elektronike

78

## SHKOLLA KOMPOZICIONALE

### MAQEDONASE

79

Kompozitorët maqedonas –  
themeluesit

80

Grupi i dytë i kompozitorëve maqedonas  
– afirmimi dhe modernizmi

82

Grupi i tretë i kompozitorëve maqedonas  
– shprehje bashkëkohore

84

Kompozitorët e muzikës së popullarizuar  
dhe xhazit – linjë paralele

86

## ZHANRE TË MUZIKËS SË

### POPULLARIZUAR

88

Muzika e filmit, muzika për filmat  
e animuar, videolojërat dhe reklamat  
Produksioni muzikor dhe studioja për  
inçizim të tingullit

92

93

Festivale dhe koncerte të muzikës së  
popullarizuar

94

## DËGJIM I UDHËZUAR

96

## **TEORIA E MUZIKËS NËPËRMJET PRAKTIKËS 98**

|                                                       |     |
|-------------------------------------------------------|-----|
| SHKALLËT, INTERVAL ET DHE<br>AKORDET                  | 98  |
| D – dur                                               | 99  |
| h – mol                                               | 100 |
| B – dur                                               | 103 |
| g – mol                                               | 104 |
| Akordi                                                | 107 |
| RITMI, METRI DHE TAKTI                                | 109 |
| Sinkopa                                               | 109 |
| Paratakti                                             | 110 |
| Ritmi i punktuar                                      | 110 |
| Triola                                                | 111 |
| ELEMENTET E FORMËS MUZIKORE DHE<br>ZHVILLIMIT MUZIKOR | 113 |
| Motivi                                                | 115 |
| Fraza (Dytaktëshi)                                    | 115 |
| Fjala                                                 | 116 |
| Periudha                                              | 116 |
| Forma dypjesore                                       | 119 |
| Forma tripjesore                                      | 120 |
| Forma tripjesore e përbërë                            | 122 |
| Tema me variacione                                    | 127 |
| Rondoja                                               | 129 |
| Forma e sonatës                                       | 132 |
| APLIKACIONE PËR SHKRIMIN E<br>NOTAVE                  | 136 |

## **INTERPRETIMI MUZIKOR DHE SHPREHJA KREATIVE 140**

|                                                                                            |     |
|--------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| INTERPRETIMI VOKAL DHE LUAJTJA<br>NË INSTRUMENTE                                           | 141 |
| SINKRETIZMI – MUZIKA DHE<br>ARTET TJERA                                                    | 146 |
| PUNË ME FRAGMENTE TË<br>SHKURTRA MUZIKORE PËRMES<br>APLIKACIONEVE PËR SHKRIMIN E<br>NOTAVE | 150 |


## **TRASHËGIMIA KULTURORE MUZIKORE 154**

|                                                                                                                                |     |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| MUZIKA NË ZAKONET DHE TRADITAT<br>E POPULLIT MAQEDONAS<br>DHE TË POPUJVE QË JETOJNË NË<br>REPUBLIKËN E<br>MAQEDONISË SË VERIUT | 154 |
| Tradita përmes zakoneve dhe<br>riteve                                                                                          | 154 |
| Këngët dhe vallet e lidhura me ritet<br>dhe traditat                                                                           | 155 |
| Këngët dhe vallet e dasmave në<br>Maqedoninë e Veriut                                                                          | 157 |
| TRASHËGIMIA KULTURORE<br>MUZIKORE NË RAJON, EVROPË<br>DHE BOTË                                                                 | 161 |
| Trashëgimia kulturore muzikore në<br>rajon                                                                                     | 161 |
| Trashëgimia kulturore muzikore në<br>Evropë                                                                                    | 165 |
| Trashëgimia kulturore muzikore në<br>botë                                                                                      | 170 |
| Literatura e shfrytëzuar                                                                                                       | 174 |

## Hyrje

Muzika është një art që i tejkalon kufijtë kohorë, gjuhësorë dhe kulturorë. Ajo është një proces i gjallë, në të cilin krijimi, interpretimi dhe dëgjimi ndërthuren, ndërsa zhvillimi i saj gjatë historisë tregon se si njeriu ka ndryshuar shpirtërisht dhe kulturalisht. Ky tekst mësimor ka për qëllim t'ju afrojë muzikën si njohuri, aftësi dhe përvojë personale, duke ju ofruar mundësinë ta hulumtoni, kuptoni dhe krijoni atë. Përmes dëgjimit të kujdesshëm dhe analizës do të njiheni me stilet muzikore nga paraklasicismi deri te muzika bashkëkohore dhe do t'i ndiqni ndryshimet në format muzikore, mjetet shprehëse dhe gjuhën muzikore. Do ta mësoni teorinë përmes shkallëve, intervaleve, figurave ritmike dhe formave kryesore muzikore, edhe atë nëpërmjet këndimit, interpretimit dhe analizës së shembujve muzikorë. Njëkohësisht, do të zhvilloni teknikën tuaj interpretuese, të të shprehurit, dëgjimin dhe kreativitetin përmes interpretimeve individuale dhe grupore, krijimit të frazave muzikore, aranzhimeve dhe projekteve digjitale, në mënyrë që muzika të bëhet një hapësirë për shprehje personale dhe komunikim bashkëkohor. Teksti mësimor do t'ju njohë edhe me pasurinë e këngëve dhe valleve tradicionale të folklorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si edhe me zakonet dhe traditat muzikore që kultivohen në vendin tonë, në Ballkan dhe në botë, duke ju ndihmuar ta kuptoni rolin shoqëror dhe ritual të muzikës dhe ta vlerësoni rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore. Në këtë mënyrë, muzika do të bëhet jo vetëm një lëndë mësimore, por edhe një hapësirë për hulumtim, kreativitet dhe përjetim personal.

Le t'ju frymëzojë ky udhëtim nëpër botën e muzikës që ta hulumtoni, dëgjoni dhe ta krijoni atë me gëzim dhe kureshtje.





**ARTI MUZIKOR**  
**NËPËR KOHË**



## Kuriozitete

### Stili galant ka qenë në modë në tërë Evropën

Përveç muzikës, në shekullin XVIII “galante” u bënë edhe veshja, sjellja, piktura dhe arkitektura. Njerëzit dëshironin që gjithçka të dukej elegante, e hijshme dhe e rregullt.



Zhan-Onore Fragonar  
– *Luhatësja* – një nga  
veprat më të njohura  
të stilit rokoko



Sallë madhështore  
në stilin rokoko

Salla e paraqitur në fotografi është një shembull tipik i stilit rokoko, i cili dallohet për elegancën, madhështinë dhe larminë e elementeve dekorative. Ajo është e mbushur me dritë dhe shkëlqim, ndërsa çdo element është punuar me kujdes për të krijuar një ndjenjë luksu.

### Kompozitorët kanë filluar të shkruajnë muzikë, e cila është “e lehtë për ta dëgjuar”

Pas stilit të gjatë dhe të ndërlikuar të barokut, njerëzit donin një muzikë më të këndshme, më melodioze dhe më të lehtë për t’u mbajtur mend. Prandaj, stili galant në muzikë shpesh përshkruhet si “muzikë për kënaqësi” ose “muzikë për aristokracinë”.



Skenë muzikore rokoko nga Antonio Zopi

## ARTI MUZIKOR NËPËR KOHË

Muzika është një gjuhë universale dhe një vlerë e qëndrueshme shpirtërore, që i lidh njerëzit përtej kohërave, hapësirave dhe kulturave të ndryshme. Ajo është kujtesa kolektive e qytetërimit njerëzor dhe pasqyrë e zhvillimit të tij. Si pjesë e trashëgimisë kulturore jomateriale, muzika paraqet një dëshmi të krijimtarisë njerëzore dhe të përpjekjes për kuptim, bukuri dhe bashkim, duke e bërë qytetërimin më njerëzor dhe më të lidhur ndërmjet veti. Zhvillimi dhe shndërrimi artistik i saj mund të ndiqen qartë përmes studimit të të gjitha periudhave, që nga zanafilla e njerëzimit e deri në ditët e sotme.

Në temën *Arti muzikor nëpër kohë* trajtohen periudhat historike: paraklasicismi, klasicizmi vienez, romantizmi muzikor dhe opera në romantizëm, si edhe romantizmi në vendet sllave, muzika e shekullit XX, shkolla kompozicionale maqedonase dhe zhanret e muzikës së popullarizuar. Në këtë temë ndiqet zhvillimi i stileve, formave dhe mjeteve shprehëse muzikore.

Kjo temë jep udhëzime për dëgjim të kujdesshëm dhe të kuptuarin e muzikës, si edhe për njohjen e veçorive specifike të çdo periudhe historike, gjë që ndihmon në vlerësimin më të thellë të artit muzikor dhe në zhvillimin e ndjeshmërisë personale muzikore.

## PARAKLASICIZMI

Në vitet e 30-ta të shekullit XVIII, në vendet e Evropës Perëndimore u shënuan ndryshime të rëndësishme shoqërore dhe ekonomike, duke forcuar pozitën e qyteteve të pasura edhe me zhvillim të lartë kulturor. Këto qytete e rritën ndikimin e tyre në muzikë dhe në artet e tjera, ndërsa në këto rrethana u shfaqën elementet e një stili të ri, të quajtur rokoko.

Rokokoja, e njohur edhe si stili galant ose paraklasicismi, nuk përbën një periudhë plotësisht të mëvetësishme, por një fazë kalimtare ndërmjet barokut të vonshëm dhe klasicizmit të hershëm (rreth viteve 1725–1775). Në muzikë ende ndihen tiparet e stilit barok, veçanërisht polifonia instrumentale, por njëkohësisht zhvillohet edhe faktura homofonike, me një melodi të spikatur qartë, e cila shpesh është e zbukuruar me ornamente të pasura.

Ashtu si në veshjen, mobiliën, arkitekturën dhe pikturën e asaj periudhe, edhe në muzikën e rokokos mbizotërojnë gracioziteti, eleganca, sentimentaliteti dhe dekorativiteti, me prirje drejt një shkëlqimi të rremë dhe një emocionaliteti sipërfaqësor.



Shoqëri rokoko me violinist dhe  
çembalist, e nënshkruar me  
pseudonimin F. Marceglia

Muzika e paraklasicismit dallohet për qartësinë e saj, prandaj shpesh përshkruhet si “galante”, term që nënkupton fisnikëri, mirësjellje dhe rregullsi. Në vend të kontrapunktit të ndërlikuar, mbizotëron faktura homofonike, ku melodia kryesore ka rolin udhëheqës, ndërsa shoqërimi e mbështet atë, duke krijuar një ekuilibër të qartë muzikor. Meloditë përbëhen nga fraza të shkurtra dhe simetrike, të cilat i përgjigjen njëra-tjetrës, ndërsa përdorimi i ornamenteve u jep atyre një karakter dekorativ. Në paraklasicism, tingëllimi orkestral bëhet më i qartë, më i ndritshëm dhe më i ekuilibruar, me orkestra më të vogla dhe me ndryshime graduale të dinamikës. Përmes veprimtarisë së kompozitorëve të Shkollës së Manhajmit, në paraklasicism zhvillohen edhe forma të reja muzikore, si forma e sonatës, simfonia, kuarteti harkor dhe tema me variacione. Gjithashtu, futet edhe nuancimi i qartë dinamik – kreshendo (crescendo) dhe dekreshendo (decrescendo).

Kompozitorë të njohur të periudhës së paraklasicismit janë: Kristof Vilibald Gluk, Xhovani Batista Pergolezi, Karl Filip Emanuel Bah, Johan Kristian Bah, Domeniko Skarlatti, etj.

### Zgjeroni njohuritë

#### Eleganca rokoko në Sonatën në E-dur, K. 380 të Skarlatit

Domeniko Skarlatti ishte kompozitor italian dhe virtuoz i çembalos, i njohur si autor i më shumë se pesëqind sonatave për çembalo, të cilat sot interpretohen shpesh edhe në piano. Një nga sonatat e tij më të njohura është Sonata në E-dur.

Kjo sonatë përbëhet nga dy pjesë, gjë që është karakteristike për stilin e Skarlatit. Kjo formë quhet forma e sonatës së Skarlatit dhe përbën bazën për zhvillimin e formës klasike të sonatës.

Gjatë dëgjimit të sonatës, kushtoni vëmendje pasazheve të shpejta, energjisë së gjallë dhe fakturës së qartë homofonike, që krijon një tingull të lehtë dhe të kthjellët. Vëreni edhe zbukurimet me ornamente të shkurtra e të shpejta, të cilat i japin veprës elegancën karakteristike të kësaj periudhe. Karakteri galant pasqyrohet në meloditë e ndritshme, kontrastet e buta dhe vijën e rregullt e të rafinuar melodike, duke lënë përshtypjen e një bukurie të thjeshtë, por fisnike.



Domeniko Skarlatti



### Aktivitete

#### 1. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme

- Cilat janë karakteristikat kryesore të paraklasicismit?
- Cilat janë arsyet e shfaqjes së stilit galant në muzikë?
- Cilat forma muzikore fillojnë të zhvillohen në paraklasicism?



Shtëpia ku jetoi dhe vdiq kompozitori  
Kristof Vilibald Gluk në Vjenë

## Kristof Vilibald Gluk (1714 – 1787)

Kristof Vilibald Gluk (gjerm.: *Christoph Willibald Gluck*) është një nga kompozitorët më të shquar të shekullit XVIII dhe krijuesi që kontribuoi në reformën e artit operistik në atë periudhë. Lindi më 2 korrik të vitit 1714 në Erasbah, Bavari (Gjermani), por talenti dhe ambicia e tij e çuan drejt qendrave më të rëndësishme muzikore të Evropës. Shkollimin e hershëm e mori në Çeki dhe Austri, ndërsa më vonë shkoi në Milano, ku u njoh me traditën e operës italiane. Në Londër u njoh me oratoriumet e famshme të Hendelit. Kjo përvojë ndikoi fuqishëm në krijimtarinë e tij dhe e orientoi drejt reformës së stilit të operës që në atë kohë mbizotëronte në teatrot evropiane. Gjatë jetës së tij, Gluku veproi në Vjenë dhe në Paris, ku gëzonte një vlerësim të jashtëzakonshëm për origjinalitetin e tij dhe për synimin e qartë për ta bërë operën më dramatike dhe më pranë ndjenjave njerëzore. Vdiq më 15 prill të vitit 1787.

Ndër veprat më të rëndësishme të Glukut janë operat *Orfeu dhe Euridije*, *Alçesta*, *Ifigjenia në Aulidë*, *Ifigjenia në Tauridë*, *Armida*, etj.

## Kuriozitet

### Interpretuese femra të roleve mashkullore (trouser roles) në opera

Luiz Homer (Louise Homer, 1871–1947), kontraalto amerikane dhe Johana Gadski (Johanna Gadschi, 1872–1936), soprano gjermane, ishin këngëtare të njohura operistike të fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX. Në kohën e Kristof Vilibald Glukut, roli i Orfeut ishte i shkruar për kastrat – këngëtar mashkull që në fëmijëri i ishte nënshtruar kastrimit, me qëllim që ta ruante zërin e tij të lartë (soprano ose mecosoprano). Në periudhën e operës serioze, zëra të tillë vlerësoheshin veçanërisht, sepse rolet kryesore mashkullore kërkonin linja melodike virtuozë, në regjistr të lartë dhe të pasura me ornamente, të cilat zërat e zakonshëm mashkullorë nuk mund t'i interpretonin. Sot, meqenëse kastratët nuk ekzistojnë më, roli i Orfeut interpretohet më së shpeshti nga këngëtare me zë mecosoprano. Edhe pse rolin e interpreton një grua, personazhi i Orfeut mbetet mashkull. Kjo praktikë interpretuese njihet si “interpretim femëror i një roli mashkullor” (trouser role). Këngëtarja vishet me kostum mashkullor dhe në skenë sillet si personazh mashkullor, ndërsa, falë mundësive të saj vokale, interpreton tonet e larta të shkruara për kastrat. Me këtë përshtatje bashkëkohore, opera e ruan qartësinë e saj dramatike dhe forcën emocionale, ndërsa publiku pa vështirësi e njeh Orfeun si personazh mashkullor.



Luiz Homer dhe Johana Gadski në rolet e  
Orfeut dhe Euridijes

## Zgjeroni njohuritë

### Orfeu dhe Euridice – përmbajtja e operës

Opera *Orfeu dhe Euridice* (Orfeo ed Euridice) konsiderohet simbol i reformës së Glukut dhe përfaqëson një ndërthurje të qartësisë dramatike me emocionalitetin e thellë. Ajo trajton rrëfimin mitologjik për Orfeun dhe të dashurën e tij, Euridicën. Personazhet kryesore janë: Orfeu - rol i shkruar për kastrat (sot interpretohet më së shpeshti nga një zë femëror mecosoprano ose përshtatet për zë mashkullor tenor), dhe Euridice – soprano (zë femëror). Rolet e tjera më të vogla dhe kori mbështesin zhvillimin dramatik të veprës. Përmbajtja e operës është marrë nga mitologjia greke. Subjekti flet për fuqinë magjike të muzikës dhe për rolin e saj në jetën e njeriut. Në fund triumfon dashuria e sinqertë. Me ndihmën e muzikës dhe të lirës së tij, Orfeu arrin ta rikthejë në jetë të dashurën e tij, Euridicën.



Dorëshkrimi i operës  
*Orfeu dhe Euridice*



Eduard Pointet: *Orfeu dhe Euridice*

### Opera serioze (opera seria)

Gjatë shekullit XVIII, opera vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes si një nga format më të dashura të artit, si për kompozitorët, ashtu edhe për publikun. Shumica e operave të këtij shekulli i përkasin operës serioze, përmbajtja e së cilës mbështetet në mitologji, legjenda dhe histori. Opera e kësaj periudhe përjetoi një rënie të vërtetë, e cila në historinë e operës njihet si periudha e dekadencës së saj. Elementet dekadente u shfaqën nëpërmjet: virtuositetit të tepruar të këngëtarëve, libreteve të ndërlikuara dhe të paqarta, formës monotone të arieve, rolit të kufizuar të korit dhe orkestrës, si edhe ndikimit të tepruar të yjeve të operës mbi muzikën, gjë që çoi në humbjen e qartësisë dramatike dhe të ekuilibrit artistik.

Një nga ngjarjet më të rëndësishme në zhvillimin e operës është reforma e ndërmarrë nga Kristof Vilibald Gluku. Kjo reformë u shfaq pikërisht në kohën kur kjo formë e rëndësishme muzikore po kalonte një periudhë të vështirë. Ai iu kundërvu prirjes që opera të ishte vetëm një spektakël i stolisur, në të cilin këngëtarët shfaqnin virtuositetin e tyre. Ai besonte se muzika duhej t'i shërbente dramës dhe ta zhvillonte rrjedhën e ngjarjeve, e jo vetëm ta zbukuronte atë. Prandaj synonte që struktura e skenave të ishte e qartë, ndërsa kori dhe orkestra të merrnin pjesë aktive në veprimin dramatik. Reforma e tij nënkuptonte se opera duhej të ishte një vepër dramatike e plotë, ku të gjitha elementet muzikore dhe skenike janë në harmoni me njëra-tjetrën dhe së bashku krijojnë një efekt të fuqishëm emocional.

Kontributi i tij përbën një pikë kthese në historinë e muzikës dhe shërbeu si bazë për zhvillimin e operës klasike në fund të shekullit XVIII.

## Aktivitetet

### 1. Pyetje për diskutim

- Çfarë mendoni, çfarë e shtyu Kristof Vilibald Glukun t'i kundërvihet zhanrit të njohur të operës serioze?
- Cilat janë elementet e reformës së Glukut?
- Cilat janë veprat më të njohura të Glukut?

### 2. Dëgjim i udhëzuar

- *Che farò senza Euridice* (Çfarë do të bëj pa Euridicën) nga Kristof Vilibald Gluk
- Dëgjojeni arien e Orfeut dhe kushtojini vëmendje zërit të lartë e shprehës, si edhe mënyrës se si orkestra e ndjek zhvillimin dramatik dhe e mbështet atmosferën emocionale
- Vëreni stilin galant - meloditë elegante dhe të lehta, ornamentet (notat zbukuruese), teksturën e qartë homofonike, si edhe kontrastet në dinamikë dhe tempo

Përgjigjuni pyetjeve

- Si do ta përshkruanit karakterin e aries *Che farò senza Euridice* - të trishtuar, të qetë, dramatik apo të butë?
- Si e ndjek dhe e mbështet orkestra emocionin e zërit të Orfeut?
- Cilat veçori të stilit galant mund t'i dalloni në këtë arie (melodi e lehtë, ornamente, teksturë e qartë)?



Gluku duke interpretuar partiturën e *Armidës* - pikturë nga Ezhen Delakroa

## Xhovani Batista Pergolezi (1710 – 1736)

Xhovani Batista Pergolezi (ital.: *Giovanni Battista Pergolesi*) është njëri nga përfaqësuesit më të spikatur të shkollës muzikore napolitane dhe krijues që ka lënë gjurmë të thella në zhvillimin e operës komike. Lindi më 4 janar të vitit 1710 në qytetin e Jesit, studioi në Napoli, i cili në shekullin XVIII ishte një nga qendrat më të rëndësishme të artit operistik. Pergolezi që në fëmijëri shfaqti një talent të jashtëzakonshëm muzikor, ndërsa shkollimi i tij në konservatorët e njohur napolitanë i mundësoi të zhvillonte një stil të pasur melodik dhe një ndjenjë të thellë për dramaturgjë. Edhe pse jeta e tij ishte e shkurtër (vdiq më 17 mars të vitit 1736, në moshën vetëm njëzet e gjashtë vjeçare), krijimtaria që la pas pati ndikim të jashtëzakonshëm në muzikën evropiane.

Vepra më e njohur e Xhovani Batista Pergolezit është opera komike *Shërbëtorja zonjë*, e cila konsiderohet si një nga veprat e para plotësisht të formësuara të zhanrit të operës komike. Në këtë operë, Pergolezi bashkon të gjitha tiparet themelore të operës komike. Personazhet janë të afërt me publikun -shërbëtorë, tregtarë ose të rinj të zakonshëm - gjë që përbënte një risi të madhe në një kohë kur skena ishte e mbushur me heronj dhe perëndi. Pergolezi arriti të krijojë muzikë që pasqyron humorin, dinamikën dhe ritmin e shpejtë të situatave komike, tërheqëse për një publik të gjerë dhe në frymën e muzikës popullore. Krahas operave komike, Pergolezi njihet edhe për operat serioze. Ai kompozoi gjithashtu vepra të zhanreve të ndryshme muzikore, si sonata, kantata, etj.



Teatri Pergolezi në Jesi, Itali

### Kuriozitet

#### Përshtatja e muzikës për oborrin perandorak

Kompozitori italian Xhovani Paiziolo (1740–1816) e përshtati operën *Shërbëtorja zonjë* të Xhovani Batista Pergolezit për oborrin e perandoreshës ruse Katerina e Madhe. Ai jo vetëm që e interpretonte muzikën e Pergolezit, por edhe e përshtatte atë sipas shijes së publikut të oborrit perandorak rus. Këtë e arriti duke e ndryshuar formacionin instrumental, duke shtuar arie të reja dhe duke e përshtatur tempin dhe dinamikën, në mënyrë që opera të ishte më e përshtatshme për sallë të madhe dhe për publikun aristokrat. Qëllimi i tij ishte ta impresionojë dhe argëtojë elitën e oborrit perandorak, sepse në atë kohë muzika nuk ishte vetëm art, por edhe një mjet prestigji dhe ndikimi. Në këtë mënyrë, Paiziolo e ngriti operën komike italiane në një spektakël të popullarizuar skenik të oborrit perandorak, duke bërë që *Shërbëtorja zonjë* të bëhej e njohur edhe jashtë Italisë. Ky është një shembull se përshtatja muzikore nuk shërben vetëm për argëtim, por edhe si mjet për krijimin e ndikimit shoqëror e politik në oborr - Paiziolo e "përktheu" muzikën në mënyrë që ajo t'i përshtatej kontekstit të ri kulturor dhe shoqëror.



*No: Battista Pergolesi*

### Zgjeroni njohuritë

#### Përmbledhje e shkurtër e operës komike *Shërbëtorja zonjë*

Në përmbajtjen e operës *Shërbëtorja zonjë* paraqiten gjithsej tre personazhe. Libreti e paraqet historinë komike të Serpinës, një shërbëtoreshë e zgjuar dhe plot vetëbesim, e cila dalëngadalë merr kontrollin në shtëpinë e zotërisë së saj, Ubertos. I pakënaqur me sjelljen e saj, Uberto vendos të martohet, por Serpina, me ndihmën e shërbëtorit memec Vespone, organizon një mashtrim me një dhëndër të rremë. Në fund, pas një sërë situatash humoristike, Uberto i pranon ndjenjat e tij dhe martohet me Serpinën, e cila nga shërbëtoreshë bëhet zonjë e shtëpisë.



Paiziolo duke interpretuar operën *Shërbëtorja zonjë* para Katerinës II - vepër artistike e Anibale Gatit, 1872–1873

## Opera komike (opera buffa)

Opera komike (opera buffa) u shfaq për herë të parë në Napoli dhe Venedik në fillim të shekullit XVIII. Ky zhanër, i krijuar nga Xh. B. Pergolezi, nuk ndryshon nga opera serioze vetëm për nga tematika, por edhe për nga gjuha muzikore dhe qasja dramaturgjike. Në vend të subjekteve mitologjike ose historike, ajo i kushtohet jetës së përditshme dhe njerëzve të zakonshëm, duke paraqitur situata humoristike dhe ironike, të shoqëruara shpesh edhe me kritikë shoqërore. Muzika e operës komike karakterizohet nga lehtësia, gjallëria dhe melodioziteti, si dhe nga prania e ansambleve të shumta, finaleve dhe dialogëve të gjallë skenikë. Ky zhanër fitoi shpejt pëlqimin e publikut, pasi paraqiste realitetin në mënyrë të gjallë e argëtuese, ndërsa në të njëjtën kohë, nëpërmjet humorit dhe satirës, vinte në pah dhe kritikonte dobësitë e shoqërisë. Për këtë arsye, tiparet themelore të operës komike janë: fabula e thjeshtë dhe plot humor, dialogët e natyrshëm e të gjallë, personazhet e marrë nga jeta e përditshme, si dhe muzika e karakterizuar nga melodioziteti, freskia dhe natyrshmëria.

### Dallimet ndërmjet operës serioze dhe operës komike

| Lloji i operës          | Opera serioze (Opera seria)                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | Opera komike (Opera buffa)                                                                                                                                                                                                                                                        |
|-------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Tematika dhe përmbajtja | <ul style="list-style-type: none"> <li>- subjekte mitologjike;</li> <li>- ngjarje historike;</li> <li>- rrëfime nga bota antike.</li> </ul>                                                                                                                                                                                          | <ul style="list-style-type: none"> <li>- histori nga jeta e përditshme me situata humoristike dhe komike.</li> </ul>                                                                                                                                                              |
| Personazhet             | <ul style="list-style-type: none"> <li>- mbretër;</li> <li>- perëndi;</li> <li>- heronj, si simbole të vlerave morale dhe shpirtërore.</li> </ul>                                                                                                                                                                                    | <ul style="list-style-type: none"> <li>- njerëz të zakonshëm të jetës së përditshme: shërbëtorë, tregtarë dhe të rinj të dashuruar.</li> </ul>                                                                                                                                    |
| Veçoritë muzikore       | <ul style="list-style-type: none"> <li>- dominojnë ariet da cappel në formën ABA;</li> <li>- teknika vokale dhe virtuozyteti janë në plan të parë;</li> <li>- drama ndërtohet mbi recitativët (që zhvillojnë veprimin) dhe ariet (që shprehin emocionet);</li> <li>- orkestra është e pranishme, por nuk ka rol dominues.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- muzikë e lehtë, e gjallë dhe melodioze;</li> <li>- ansamble, duete dhe finale të shumta;</li> <li>- dialogë natyrorë, të afërt me gjuhën e folur;</li> <li>- muzika ndjek dinamikën e humorit dhe të zhvillimit të ngjarjeve.</li> </ul> |
| Qëllimi i zhanrit       | <ul style="list-style-type: none"> <li>- të shprehë fisnikëri, madhështi dhe seriozitet dramatik.</li> </ul>                                                                                                                                                                                                                         | <ul style="list-style-type: none"> <li>- të argëtojnë publikun;</li> <li>- t'i kritikojë dukuritë shoqërore përmes satirës.</li> </ul>                                                                                                                                            |

## Aktivitete

### 1. Pyetje për diskutim

- Pse Xhovani Batista Pergolezi konsiderohet një kompozitor i rëndësishëm në historinë e muzikës?
- Cila është vepra më e njohur e Pergolezit dhe cilit zhanër i përket ajo?
- Cilat janë karakteristikat kryesore të operës komike?
- Cilat janë dallimet ndërmjet operës serioze dhe operës komike?

### 2. Hulumtim

Ndahuni në dy grupe:

Grupi I - përgatitni një detyrë projektuese me temë: Kristof Vilibald Gluk

Grupi II - përgatitni një detyrë projektuese me temë: Xhovani Batista Pergolezi

Secili grup hulumton në tekste mësimore, enciklopedi dhe faqe të besueshme në internet, ndërsa më pas për kompozitorin e caktuar përgatit:

- të dhëna të shkurtra për jetën;
- titujt e veprave më të njohura;
- karakteristikat themelore stilistike të krijimtarisë së tij;
- një shembull të shkurtër muzikor (1–2 minuta).

Prezantimi

- Gjatë orës së mësimi, secili grup prezanton shkurt projektin e përgatitur dhe dëgjon një shembull muzikor.

### 3. Dëgjim i udhëzuar

- *Stizzoso mio stizzoso (I zemëruari im, i zemëruar)* nga Xhovani Batista Pergolezi
- Dëgjojeni arien dhe kushtojuni vëmendje aspekteve të mëposhtme:

- si zhvillohet melodia – a është e lehtë, me kërcime melodike dhe përsëritje që krijojnë ndjesinë e humorit;
- si është tempoja dhe si ndikon ajo në krijimin e efektit komik;
- a ka ndryshime të menjëhershme dinamike dhe a i theksojnë ato emocionet e personazheve;
- si e mbështet orkestra zhvillimin e skenës dhe a e vë në pah karakterin humoristik;
- si i përcjell vokali emocionet dhe karakterin e personazheve.



Pyetje për diskutim pas dëgjimit

- Cilat elemente muzikore e theksojnë më së shumti karakterin komik të skenës?
- Si krijohet ndjesia e lojës dhe e humorit përmes ndërthurjes së melodisë, tempos dhe ritmit?
- Pse muzika e Pergolezit e bën këtë operë argëtuese dhe lehtësisht të kuptueshme për publikun?

## KLASICIZMI VIENEZ

Pamje panoramike e  
Vjenës (shek. XVIII)




Klasicizmi në muzikë përfshin gjysmën e dytë të shekullit XVIII dhe fillimin e shekullit XIX, një periudhë e karakterizuar nga ndryshime të rëndësishme politike, shoqërore dhe kulturore në Evropë. Revolucioni Francez i vitit 1789 tronditi strukturën shoqërore të deriatëhershme dhe shënoi fundin e vlerave absolutiste, ndërsa ngritja e Napoleon Bonapartit u bë simbol i rendit të ri dhe i ndryshimeve të vullshme në skenën evropiane. Në këto rrethana, klasa qytetare u forcua gradualisht, duke ushtruar një ndikim të madh në zhvillimin e artit dhe të muzikës.

Muzika gjatë periudhës së klasicizmit muzikor kishte një rol të rëndësishëm shoqëror dhe kulturor. Ajo u bë më e qasshme për publikun e gjerë dhe nuk ishte më e destinuar vetëm për aristokracinë dhe oborret mbretërore. Koncertet, operat dhe muzika e dhomës njohën një zhvillim të madh, duke kontribuar në krijimin e një jete të gjallë muzikore publike. Njëkohësisht, muzika shërbeu si mjet edukimi, kultivimi të shijes artistike dhe forcimi të identitetit kulturor të qyteteve evropiane, veçanërisht të Vjenës. Muzika e kësaj periudhe karakterizohet nga melodi elegante, të qarta dhe të balancuara, në të cilat çdo frazë ka një fillim dhe një përfundim të përcaktuar qartë dhe përvetësohet lehtë nga dëgjuesi. Format muzikore janë të ndërtuara me saktësi dhe simetri, siç janë sonata, simfonia dhe koncerti për solist dhe orkestër, ndërsa orkestra është e balancuar me kujdes, duke krijuar një tingëllim të pasur, por njëkohësisht të kthjellët dhe transparent. Harmonia është e pastër, logjike dhe e qartë, ndërsa muzika synon bukurinë dhe kënaqësinë, duke pasqyruar racionalitetin dhe idealet estetike të kohës.

Meritën më të madhe për formësimin e stilit klasik e kanë Jozef Hajdn, Wolfgang Amadeus Mocart dhe Ludvig van Betoven, të cilët jetuan dhe krijuan në Vjenë. Për shkak të rëndësisë së tyre dhe mjedisit të përbashkët krijues, e gjithë kjo periudhë në historinë e muzikës njihet me emrin “klasicizmi vienez”.

**Orkestra simfonike** gjatë periudhës së klasicizmit vienez u zhvillua në një formacion muzikor të qëndrueshëm dhe të përcaktuar qartë. Kjo periudhë solli ndryshime të rëndësishme në përbërjen, tingëllimin dhe mënyrën e funksionimit të orkestrës.

Në klasicizmin e hershëm, orkestra ishte modeste, e përbërë kryesisht nga instrumente harkore. Me kalimin e kohës, ajo u zgjerua dhe u bë më e pasur e më e larmishme.



## Orkestra në klasicizëm

## Zgjeroni njohuritë

## Risitë në tingëllimin dhe stilin e orkestrës

Në përputhje me frymën e klasicizmit, orkestra bëhet shembull i simetrisë, balancës dhe organizimit logjik. Muzika është e rregullt, transparente dhe e përshtatur për sallonet, pallatet dhe hapësirat koncertale të Vjenës - qendrës së kulturës muzikore evropiane.

Kjo periudhë sjell disa risi të rëndësishme:

## Klarineta si instrument i ri

Klarineta shfaqet si një instrument i ri, që krijon një ngjyrë krejtësisht të re në orkestrë. Mozarti ishte ndër të parët që e integroi atë me shumë dashuri dhe kujdes.

## Balancë më e mirë dhe rol më i rëndësishëm i instrumenteve frymore

Instrumentet frymore të dyfishuara gradualisht fitojnë linja të veta melodike, në vend që vetëm t'i shqërojnë violinat.

## Ndarje e qartë e roleve

Instrumentet harkore mbajnë rrjedhën kryesore melodike dhe ritmike, ndërsa instrumentet frymore shtojnë ngjyrë, kontrast dhe funksione të reja harmonike.

## Zhvillimi i shkrimit orkestral

Hajdn dhe Mocart vendosën bazat e orkestracionit bashkëkohor, ku çdo instrument fiton një rol logjik dhe të vecantë.

**Format ciklike** janë vepra muzikore të ndërlikuara, të përbëra nga disa kohë, të cilat së bashku formojnë një tërësi të vetme. Gjatë periudhës së klasicizmit muzikor, ato përfaqësohen nga sonata, simfonia, kuarteti harkor dhe koncerti për solist dhe orkestër.

**Sonata** është vepër instrumentale e shkruar për instrument solo, më së shpeshti për piano ose për një instrument të shoqëruar me piano. Zakonisht përbëhet nga tri ose katër kohë: koha e parë është e shpejtë (më së shpeshti e ndërtuar në formën e sonatës), koha e dytë ka karakter të ngadaltë dhe lirik, koha e tretë mund të jetë menuet ose skerco, ndërsa koha përmblylëse zakonisht është e shpejtë dhe dinamike. Gjatë periudhës së klasicizmit muzikor, sonata përbënte një lloj laborator të ideve muzikore, ku kompozitorët zhvillonin formën, përpunimin tematik dhe harmoninë.

**Simfonia** është formë orkestrale dhe zakonisht përbëhet nga katër kohë. Koha e parë është zakonisht e shpejtë (në formën e sonatës), pas saj vjen një kohë e ngadaltë me karakter lirik, koha e tretë është menuet ose skerco, ndërsa koha përmbyllëse zakonisht është sërish e shpejtë dhe dinamike. Simfonia vë në pah fuqinë dhe pasurinë e paletës tingëllimore të orkestrës simfonike.

**Kuarteti harkor** është formë ciklike e muzikës së dhomës, e shkruar për dy violina, violë dhe violonçel dhe konsiderohet si një nga format më të rafinuara të klasicizmit muzikor. Zakonisht përbëhet nga katër kohë, struktura e të cilave është e ngjashme me atë të simfonisë, por me një dialog më intim dhe më të barabartë ndërmjet instrumenteve.

**Koncerti** për solist dhe orkestër është formë muzikore në të cilën solisti dhe orkestra janë në dialog dhe kontrast të vazhdueshëm. Gjatë periudhës së klasicizmit muzikor, koncerti zakonisht përbëhet nga tri kohë: koha e parë dhe e tretë janë të shpejta, ndërsa koha e dytë është e ngadaltë dhe lirike.

## Kuriozitet

### Muzikë me porosi – vepra të mëdhaja

Në Vjenë, kompozitorë si Hajdn, Mocarti dhe Betoven, shpesh krijojnë muzikë me porosi për raste ose festime të veçanta, si ditëlindje, ceremoni apo shërbesa kishtarë. Është interesante se pikërisht këto porosi i frymëzuan ata të eksperimentonin me forma të reja dhe efekte të reja tingëllimore, prandaj shumë nga veprat e tyre më të njohura lindën pikërisht për raste të tilla të porositura.

## Zgjeroni njohuritë

**Kadencia** është një pjesë e shkurtër e koncertit, në të cilën solisti interpreton vetë, pa shoqërimin e orkestrës, me qëllim që të vërë në pah virtuozyzetin, aftësinë teknike dhe kreativitetin muzikor. Zakonisht shfaqet në fund të kohës së parë dhe tingëllon si një improvizim muzikor brilant. Fillimisht, kadencia improvizohet nga vetë solisti, ndërsa më vonë kompozitorët filluan ta shkruanin atë në partiturë, duke ofruar ndonjëherë edhe disa variante të mundshme.

### Dallimi ndërmjet formës së sonatës dhe sonatës si vepër muzikore

Forma e sonatës është mënyra e organizimit të ideve muzikore brenda një vepre muzikore. Ajo paraqet strukturën e brendshme të veprës, renditjen dhe zhvillimin e temave, tonaliteteve dhe karaktereve, por nuk përbën një vepër muzikore më vete.

Sonata është vepër muzikore e plotë, e cila mund të ketë tri ose katër kohë dhe zakonisht e përdor formën e sonatës, veçanërisht në kohën e parë. Ajo është një vepër konkrete, e cila kompozohet dhe interpretohet.

Me fjalë të tjera, forma e sonatës është struktura (plani) mbi të cilën ndërtohet vepra, ndërsa sonata është vetë vepra muzikore e ndërtuar sipas asaj strukture.

## Aktivitete

### 1. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme

- Gjatë cilës periudhë u zhvillua klasicizmi vienez në muzikë dhe pse e gjithë kjo epokë quhet klasicizëm vienez?
- Cilët janë tre kompozitorët më të rëndësishëm të klasicizmit vienez?
- Cilat janë veçoritë me të cilat karakterizohet muzika në klasicizëm?
- Cilat forma muzikore u përdorën më së shumti gjatë klasicizmit vienez?

## Franc Jozef Hajdn (1732 – 1809)

Franc Jozef Hajdn (gjerm.: *Franz Joseph Haydn*) lindi më 31 mars të vitit 1732 në fshatin Rohrau të Austrisë, në një familje zejtarësh. Që në moshë të hershme shfaqti interes dhe talent për muzikën, duke filluar të mësonte çembalon, violinën dhe këndimin. Më vonë u vendos në Vjenë, ku punoi fillimisht si korist, e më pas si violinist në orkestra të ndryshme.

Në moshën njëzetetrevjeçare kompozoi kuartetin e tij të parë harkor, ndërsa pak më vonë edhe simfoninë e parë. Pjesën më të madhe të krijimtarisë së tij e zhvilloi gjatë shërbimit në orkestrën e oborrit të princit hungarez Esterhazi, ku punoi për rreth tridhjetë vjet. Pas vdekjes së princit Esterhazi, Hajdn udhëtoi për në Londër, ku u përball me një mjedis të ri muzikor dhe me një publik më të gjerë. Pikërisht atje ai e përsosi stilin e tij simfonik. Vitet e fundit të jetës i kaloi në Vjenë, tashmë si një kompozitor me famë të gjerë. Vdiq më 31 maj të vitit 1809.

Me krijimtarinë e tij të gjerë dhe të larmishme, Franc Jozef Hajdn dha një kontribut të jashtëzakonshëm në formësimin dhe përcaktimin e stilit klasik në muzikë. Ai konsiderohet si një nga themeluesit e formës së sonatës, të kuartetit harkor dhe të simfonisë klasike, si edhe një mjeshtër i shquar i muzikës instrumentale. Megjithatë krijimtaria e tij ishte e përqendruar kryesisht në muzikën instrumentale, ai kompozoi edhe një numër të madh veprash vokalo-instrumentale, ndër të cilat opera, oratorio dhe kantata. Me qasjen e tij krijuese, Hajdn e largoi muzikën nga misticizmi fetar dhe e afroi atë me jetën e përditshme dhe me ndjenjat e njerëzve. Muzika e tij karakterizohet nga forma e qartë, mendimi muzikor logjik dhe ekuilibri ndërmjet melodisë dhe harmonisë. Ai përdori shpesh kontraste, humor dhe elemente të muzikës popullore, duke i bërë veprat e tij të kuptueshme dhe të afërta për publikun.

Veçanërisht të rëndësishëm janë kuartetet e tij harkore op. 20 nr. 2 në C - dur, op. 64 nr. 5 në D - dur dhe op. 76 nr. 2 në d - mol. Po aq të rëndësishme janë edhe *Simfonitë parisiene*, me të cilat Hajdn fitoi famë mbarëevropiane, si dhe *12 Simfonitë londineze*, të cilat përfaqësojnë kulmin e stilit simfonik klasik. Ndër to veçohen Simfonia nr. 103 në Es - dur dhe Simfonia nr. 104 në D - dur. Në periudhën e fundit të jetës së tij, Hajdn krijoi dy oratore të mëdha – *Krijimi i botës* dhe *Stinët e vitit*, të cilat konsiderohen ndër arritjet më të larta të muzikës vokalo-instrumentale të epokës së klasicizmit. Me krijimtarinë e tij, Hajdn ushtroi një ndikim të fuqishëm në zhvillimin e muzikës klasike edhe te kompozitorët e mëvonshëm, veçanërisht te Wolfgang Amadeus Mozart dhe Ludwig van Beethoven. Roli i tij në formësimin e formave muzikore klasike i siguroi një vend të përhershëm në historinë e muzikës evropiane.



*Haydn*



Rruga Jozef Hajdn në Ajzenshtad

## Kuriozitet

### Historia e pazakontë e kafkës së Hajdn

Një kuriozitet që lidhet me jetën e Franc Jozef Hajdn është ngjarja që ndodhi pas vdekjes së tij, në vitin 1809. Për shkak të interesimit për frenologjinë – një teori pseudoshkencore e kohës, e cila përpigjej të shpjegonte karakterin e njeriut nëpërmjet formës së kafkës – kafka e tij u vodh.

Gjatë dekadave në vijim, kafka e Hajdn kaloi në duart e personave të ndryshëm dhe mbeti e ndarë nga trupi i tij për plot 145 vjet. Tek në vitin 1954 ajo u ribashkua me mbetjet e tjera mortore dhe u vendos në varrin e tij.



Kafka e Hajdn



Dorëshkrimi i Hajdn

## Aktivitetet

### 1. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme

- Cilat janë karakteristikat e muzikës së Hajdn?
- Në cilat forma muzikore Jozef Hajdn konsiderohet themelues dhe mjeshtër i shquar?
- Cilat janë veprat simfonike më të njohura të Hajdn?

### 2. Dëgjim i udhëzuar

*Sonata për piano nr. 50 në D – dur* – Koha I, nga Franc Jozef Hajdn



*Simfonia nr. 101 Ora* – Koha I, nga Franc Jozef Hajdn



Bëni përzgjedhjen e njërës prej kompozimeve të propozuara, duke përdorur linqe.

Për kompozimin e zgjedhur kushtoni vëmendje këtyre elementeve: dinamikës, tempos dhe karakterit.

Analizoni dhe zbuloni

- Në cilën formë muzikore është shkruar kompozimi i zgjedhur?
- Për cilin instrument/orkestër/zë është shkruar kompozimi?
- Zbuloni tempon, dinamikën dhe karakterin e kompozimit.

## Volfgang Amadeus Mozart (1756 – 1791)

Volfgang Amadeus Mozart (gjerm. *Wolfgang Amadeus Mozart*) lindi më 27 janar të vitit 1756 në qytetin austriak Salzburg dhe konsiderohet si një nga kompozitorët më të mëdhenj në historinë e muzikës.

Mocarti vinte nga një familje muzikantësh, ndërsa babai i tij, Leopold Mozart, (violinist i njohur, kompozitor dhe pedagog muzikor), e vuri re shumë herët talentin e jashtëzakonshëm muzikor të të birit. Nën drejtimin e tij, Mocarti filloi të mësonte çembalon, violinën dhe bazat e kompozimit. Që në moshën trevjeçare shfaqte aftësi të jashtëzakonshme muzikore, ndërsa në moshën pesëvjeçare veçmë kompozonte dhe interpretonte publikisht. Për shkak të kësaj dhuntie të rrallë, ai njihet si “fëmijë mrekulli”. Së bashku me motrën e tij, Nanerl, interpretoi në turne të shumta koncertale nëpër Evropë – në Gjermani, Francë, Angli dhe Itali – ku i mahniste oborret mbretërore dhe rrethet muzikore me virtuozytetin dhe muzikalitetin e tij. Këto udhëtime patën rëndësi të madhe për zhvillimin e tij muzikor. Përmes tyre, Mocarti pati mundësi të njëjhej me stile të ndryshme muzikore kombëtare, të dëgjonte dhe të studionte veprat e kompozitorëve kryesorë të kohës së tij, si dhe të fitonte një formim të gjerë muzikor, i cili ndikoi fuqishëm në pjekurinë e shprehjes së tij krijuese. Në periudhën e mëvonshme të jetës punoi në qytete të ndryshme evropiane, ndërsa më gjatë qëndroi në Vjenë. Edhe pse fitoi famë të madhe që në rini, jeta e tij ishte e mbushur me sfida të shumta, ndër të cilat edhe vështirësitë financiare dhe mungesa e mbështetjes së mjaftueshme nga shoqëria. Mocarti vdiq para kohe, në moshën 35-vjeçare, në Vjenë, më 5 dhjetor të vitit 1791. Pavarësisht jetës së shkurtër, ai la pas një trashëgimi muzikore jashtëzakonisht të pasur dhe të çmuar, e cila edhe sot ka rëndësi dhe ndikim të madh në kulturën muzikore botërore.

Krijimtaria e Volfgang Amadeus Mozartit është jashtëzakonisht e pasur dhe e larmishme. Gjatë jetës së tij të shkurtër ai krijoi më shumë se gjashtëqind vepra. Muzika e tij karakterizohet nga lehtësia në krijim, forma e qartë, ekuilibri ndërmjet pjesëve dhe tërësisë, si dhe nga pasuria melodike dhe bukuri shprehëse.

Operat zënë një vend shumë të rëndësishëm në krijimtarinë e tij. Ai kompozoi shtatëmbëdhjetë opera dhe falë udhëtimeve të shumta si edhe njohjes së thellë të karaktereve njerëzore, krijoi në to një galeri të pasur personazhesh, të paraqitur me një thellësi të madhe psikologjike. Pjesa më e madhe e operave të tij janë shkruar në gjuhën italiane, ndërsa opera e tij e fundit, *Flauti magjik*, është shkruar në gjuhën gjermane.

Ndër operat e tij më të njohura janë: *Idomeneo*, *Rrëmbimi nga saraji*, *Martesa e Figaros*, *Don Xhovani*, *Kështu bëjnë të gjithë* dhe *Flauti magjik*.



*Wolfgang Amadeus Mozart*



Leopold Mozart dhe fëmijët e tij, Volfgang dhe Maria Ana (Nanerl)



Dizajni i skenës për operën *Flauti magjik* të Mocartit nga Karl Fridrih Shinkel

## Zgjeroni njohuritë



Portret i Konstanca Mocart nga Jozef Lange

Pas vdekjes së Mocartit, kujdesin për dorëshkrimet dhe për të gjithë trashëgiminë e tij e mori bashkëshortja, Konstanca (Mocart-Weber). Në këtë punë e ndihmoi edhe bashkëshorti i saj i dytë, Georg Nikolas von Nisen, një admirues i madh i artit të Mocartit. Me ndihmën e tij, në vitin 1828 Konstanca botoi biografinë e parë të plotë të kompozitorit. Në të njëjtën kohë filloi edhe botimi sistematik i veprave të Mocartit, pasi pjesa më e madhe e tyre ishte ruajtur me dorëshkrim. Po ashtu, u hartua edhe katalogu i parë kronologjik-tematik i veprave të Mocartit nga Ludvig Kehel, i cili e botoi atë në vitin 1862. Ky katalog mori emërtimin KV (Köchel-Verzeichnis – Katalogu i Kehelit) dhe që prej asaj kohe çdo vepër e Mocartit identifikohet me shenjën KV, të ndjekur nga numri përkatës.

Mocarti shkroi rreth pesëdhjetë simfoni, në të cilat mund të ndiqet zhvillimi i tij krijues, nga format e thjeshta deri te strukturat e ndërlikuara me ide të pasura muzikore. Kulmin e krijimtarisë së tij simfonike e përfaqësojnë tri simfonitë e fundit – në Es - dur, g - mol dhe C - dur *Jupiter*.

Në fushën e muzikës së dhomës, Mocarti krijoi një numër të madh kuartetesh harkore dhe kuartetesh për piano, trio për piano, kuintete harkore, serenata dhe divertimente. Veçanërisht e njohur është serenata *Muzikë e vogël e natës*.

Ai kompozoi sonata për piano, sonata për violinë dhe piano, si edhe sonata për flaut dhe piano, në të cilat pasqyrohet e gjithë pasuria e invencionit të tij melodik, mjeshtëria në formësimin e kohëve të ndara, si dhe baza harmonike e larmishme dhe interesante.

Mozarti shkroi një numër të madh koncertesh për instrument solistik dhe orkestër, duke përfshirë pothuajse të gjitha instrumentet që ishin në përdorim në kohën e tij (flautin, klarinetën, kornon, fagotin dhe harpën), ndërsa numrin më të madh e përbëjnë koncertet për piano dhe violinë. Ndër më të njohurit janë koncertet për piano në D - dur (*Koncerti i kurorëzimit*), në A - dur, c - mol dhe d - mol, si dhe koncertet për violinë në G - dur, D - dur dhe A - dur. Ai krijoi gjithashtu një numër të konsiderueshëm veprash të muzikës kishtare, ndër të cilat veçohen *Mesha e kurorëzimit* dhe vepra e tij e fundit, e papërfunduar – *Rekuiem*, e cila konsiderohet një nga veprat më mbresëlënëse në historinë e muzikës kishtare.

## Kuriozitete

Kompozimi *Miserere* i Gregorio Allegrit ruhej me kujdes të madh në Vatikan dhe askujt nuk i lejohej të merrte partiturën e tij. Mocart, i cili në atë kohë ishte vetëm 14 vjeç, e dëgjoi një herë këtë vepër në Kapelën Sistine dhe po atë ditë e shkroi të plotë – notë për notë – vetëm me mbajtje në mend. Vepra është jashtëzakonisht e ndërlikuar dhe në vend që të ndëshkohej, Vatikani e njohu dhuntinë e tij të jashtëzakonshme muzikore dhe i shprehu nderim e vlerësim të veçantë.

Mocarti kompozonte sipas bindjeve dhe shijes së tij artistike, por kryepeshkvi i Salzburgut nuk hiqte dorë nga kërkesat dhe tekat e oborrit. Ai mendonte se Mocarti duhej ta vinte muzikën në shërbim të oborrit. Kjo ishte e papranueshme për të, prandaj Mocarti kërkoi të largohej. Në ditarin e tij shkroi se muzika e oborrit ishte “vulgare, e dobët dhe e çrregullt” dhe se në Salzburg nuk kishte interes për muzikën. Ai u largua nga Salzburgu dhe u vendos në Vjenë. Atje punoi me përkushtim, por nuk arriti t'i siguronte vetes mirëqenie materiale.

Dhjetë vitet e fundit të jetës Mocarti i kaloi në varfëri. Kur vdiq, për shkak se ishte i varfër dhe nuk kishte një mbrojtës që të kujdesej për varrimin e tij, trupi i tij u vendos në një varr të përbashkët për të varfrit. Në këtë ceremoni nuk morën pjesë as familja e tij dhe as aristokracia, ndërsa vendndodhja e varrit mbeti e panjohur.

## Shembull për dëgjim të udhëzuar dhe analizë

*Simfonia nr. 40 në g - mol, KV 550 – Koha I, nga Wolfgang Amadeus Mozart*



Allegro molto.

Fragment nga faqja e parë e simfonisë

Simfonia nr. 40 në g - mol, KV 550, Koha I, e Mozart, është shkruar në formën e sonatës. Ajo përbëhet nga këto pjesë:

### Ekspozicioni

- Në ekspozicion paraqiten dy tema kryesore, të cilat krijojnë kontrastin dramatik, karakteristik për formën e sonatës. Tema e parë është në g - mol, ndërsa pas saj vijon një kalim modulues drejt temës së dytë, e cila është në B - dur. Ekspozicioni mbyllet me grupin përfundimtar.

### Pjesa zhvilluese

- Në pjesën zhvilluese përpunohet materiali tematik i ekspozicionit përmes veprimeve të ndryshme harmonike dhe motivore.

### Repriza

- Në reprizë rikthehet materiali i ekspozicionit, por i përpunuar në mënyrë të tillë që të dyja temat shfaqen në tonalitetin kryesor, g - mol, ashtu siç e kërkon forma klasike e sonatës.



## Aktivitete

### 1. Pyetje për diskutim

- Si do ta përshkruanit jetën e Wolfgang Amadeus Mocart?
- Cili është qëndrimi juaj ndaj krijimtarisë së Mocartit?
- Cila formë nga krijimtaria e Mocartit ju tërheq më shumë vëmendjen dhe ju nxit dëshirën për ta dëgjuar?

### 2. Dëgjim i udhëzuar

*Sonata në C - dur Facile KV 545 – Koha I (Allegro), nga Wolfgang Amadeus Mocart*

*Kuinteti harkor Muzikë e vogël e natës, nga Wolfgang Amadeus Mocart*

*Lakrimosa (Lacrimosa) – Rekuem, nga Wolfgang Amadeus Mocart*



Motive nga fillimi i *Lakrimosës* nga Rekuemi i Mocartit

*Aria Mbretëresha e natës nga opera Flauti magjik, e Wolfgang Amadeus Mocart*

*Marshi turk (Rondo alla Turca) nga Wolfgang Amadeus Mocart*

- Bëni përzgjedhjen nga linqet e dhëna.
- Dëgjojeni me vëmendje veprën.
- Përcaktoni për cilin aparat interpretues është shkruar kompozimi.
- Zbuloni tempon, dinamikën dhe karakterin e kompozimit.



Mocarti në një koncert  
oborrtar

## Ludvig van Betoven (1770 – 1827)

Ludvig van Betoven (gjerm. *Ludwig van Beethoven*) lindi në dhjetor të vitit 1770 në Bon të Gjermanisë. Ai vinte nga një familje muzikantësh dhe që në moshë të hershme shfaqti një talent të jashtëzakonshëm muzikor, duke filluar një arsimim intensiv në muzikë. Në vitin 1792 u vendos në Vjenë, e cila mbeti vendbanimi i tij i përhershëm deri në fund të jetës.

Betoveni u dallua shpejt si pianist dhe muzikant i jashtëzakonshëm, i njohur për forcën shprehëse, dramtizmin dhe origjinalitetin e tij. Jeta e tij u shënua nga vështirësi të shumta personale dhe shëndetësore. Ai njihej për temperamentin e tij të vrullshëm dhe impulsiv, por edhe për ndjeshmërinë e thellë dhe bindjet humaniste. Vështirësia më e madhe për të ishte humbja graduale e dëgjimit. Pavarësisht kësaj gjendjeje, ai vazhdoi të punonte dhe të krijonte aktivisht, duke u tërhequr gjithnjë e më shumë nga jeta publike.

Jeta private e Betovenit ishte e mbushur me trazira emocionale dhe pasiguri financiare. Megjithatë, ai gëzonte mbështetjen e aristokratëve dhe mecenëve që e vlerësonin artin e tij. Ai vdiq më 26 mars të vitit 1827, duke lënë një gjurmë të thellë në historinë e muzikës dhe duke u konsideruar si figura kyçe që lidh epokën e klasicizmit muzikor me romantizmin.

Përvojat e tij jetësore, betejat personale dhe synimet artistike pasqyrohen drejtpërdrejt në krijimtarinë e tij të pasur dhe të larmishme. Ai ka një rëndësi kyçe në zhvillimin e formës dhe ciklit të sonatës, kurse krijimtaria e tij dallohet qartë në tri faza zhvillimore. Në fazën e hershme, ai mbështetet në modelin klasik të J. Hajdnit dhe V. A. Mocartit, duke respektuar planin tradicional modulues dhe ndërtimin e qartë strukturor të formës së sonatës. Në fazën e mesme, të ashtuquajturën “fazë heroike”, Betoveni zgjeron gradualisht kornizat formale, e pasuron pjesën zhvilluese, rrit dramtizmin dhe e trajton me më shumë liri planin modulues, duke i dhënë formës së sonatës një dimension të ri shprehës dhe dramatik.

Në fazën e vonshme, ai i rishqyrton me vetëdije dhe pjesërisht i thyen skemat formale klasike, duke sjellë marrëdhënie të papritura tonale, organizim strukturor të ndryshueshëm dhe një gjuhë muzikore thellësisht individuale. Në këtë mënyrë, ai i hodhi themelet e romantizmit dhe mundësoi zhvillimin e mëtejshëm të ciklit të sonatës si një formë e lirë dhe ekspresive.

Krijimtaria muzikore e Betovenit përfshin: simfoni, koncerte, muzikë dhome, vepra për piano dhe vepra vokalo-instrumentale.

Nëntë simfonitë e Ludvig van Betovenit përfaqësojnë kulmin e zhvillimit të muzikës simfonike dhe krijojnë urën lidhëse ndërmjet klasicizmit dhe romantizmit. Veçanërisht të rëndësishme janë: Simfonia e tretë *Eroica* – simbol i luftës dhe lirisë; Simfonia e pestë – e njohur për “motivin e fatit”; dhe Simfonia e nëntë – revolucionare, ku në finalen e saj përfshihen kori dhe solistët.



*Ludwig van Beethoven*



Zvogëlim fotografik i njërës prej letrave të Betovenit, të zbuluara në vitin 1908



Pamje e një pjese të partiturës së Simfonisë së nëntë

## Zgjeroni njohuritë

Në tabelë janë të paraqitura të gjitha simfonitë e Beethovenit me të dhënat kryesore për kohët, tempot dhe format e tyre.

### Pasqyrë e simfonive të Ludvig van Beethovenit

| Simfonia                     | Tonaliteti | Opusi   | Koha I                                                  | Koha II                                                   | Koha III                                 | Koha IV                                                                     | Koha V                    |
|------------------------------|------------|---------|---------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------|---------------------------|
| Simfonia nr. 1               | C - dur    | Op. 21  | Adagio molto – Allegro con brio – formë sonate me hyrje | Andante cantabile – formë sonate                          | Menuetto: Allegro – menuet               | Adagio – Allegro molto e vivace – formë sonate                              |                           |
| Simfonia nr. 2               | D - dur    | Op. 36  | Adagio molto – Allegro con brio – formë sonate me hyrje | Larghetto – formë sonate                                  | Scherzo: Allegro – skerco                | Allegro molto – formë sonate me elemente të rondo sonatës                   |                           |
| Simfonia nr. 3<br>"Heroike"  | Es - dur   | Op. 55  | Allegro con brio – formë sonate                         | Marcia funebre: Adagio assai – marsh                      | Scherzo: Allegro vivace – skerco         | Finale: Allegro molto – variazione me dy tema                               |                           |
| Simfonia nr. 4               | B - dur    | Op. 60  | Adagio – Allegro vivace – formë sonate me hyrje         | Adagio – formë sonate pa pjesë zhvilluese                 | Allegro vivace – skerco                  | Allegro ma non troppo – formë sonate                                        |                           |
| Simfonia nr. 5               | c - mol    | Op. 67  | Allegro con brio – formë sonate                         | Andante con moto – variazione me dy tema                  | Allegro – skerco                         | Allegro – formë sonate                                                      |                           |
| Simfonia nr.6<br>"Pastorale" | F - dur    | Op. 68  | Allegro ma non troppo – formë sonate                    | Andante molto mosso – formë sonate                        | Allegro – skerco                         | Allegro – formë e lirë                                                      | Allegretto – rondo-sonatë |
| Simfonia nr. 7               | A - dur    | Op. 92  | Poco sostenuto – Vivace – formë sonate me hyrje         | Allegretto – kombinim i formës tripjesore dhe variacionit | Presto – skerco                          | Allegro con brio – formë sonate                                             |                           |
| Simfonia nr. 8               | F - dur    | Op. 93  | Allegro vivace – formë sonate                           | Allegretto scherzando – formë sonate pa pjesë zhvilluese  | Tempo di menuetto – menuet               | Allegro vivace – formë sonate me rondo                                      |                           |
| Simfonia nr. 9 (me kor)      | d - mol    | Op. 125 | Allegro ma non troppo, un poco maestoso – formë sonate  | Molto vivace – Presto - skerco                            | Adagio – Andante – variazione me dy tema | Finale: Presto – Allegro assai, Recitativo, Allegro assai – formë e përzier |                           |

## Kuriozitet

Simfonia e nëntë e Betovenit konsiderohet inovatore dhe revolucionare, sepse në kohën e katërt (finale) përfshin korin dhe solistët, gjë që nuk ishte karakteristike për simfonitë e asaj kohe. Teksti është marrë nga poema *Oda e gëzimit* e Fridrih Shiler, e cila e lartëson lirinë dhe vëllazërinë midis njerëzve. Një nga vargjet më të njohura është: “Të gjithë njerëzit bëhen vëllezër” (Alle Menschen werden Brüder). Finalja e kësaj simfonie shpreh me një forcë të jashtëzakonshme gëzimin dhe unitetin mes njerëzve, prandaj tema e saj muzikore u zgjodh më vonë si himni i Bashkimit Evropian.



Pjesë nga melodia e  
*Odës së gëzimit*

Muzika për piano e Betovenit dallohet për emocionet e fuqishme, melodiozitetin dhe ndërlikueshmërinë teknike. Ndër tridhjetë e dy sonatat e tij për piano, (secila një dramë muzikore më vete), veçohen *Sonata e Hënës*, *Valdshtejn*, *Patetike*, *Apasionata* dhe të tjera.

Betoveni krijoi edhe koncerte të rëndësishme për instrumente të ndryshme dhe orkestër. Ai shkroi pesë koncerte për piano dhe orkestër, ndër të cilët më i interpretuari është Koncerti nr. 5 në Es - dur, i njohur si *Koncerti perandorak*, si edhe Koncerti për violinë dhe orkestër në D – dur.

Ai gjithashtu kompozoi vepra të muzikës së dhomës dhe vepra vokalo-instrumentale, prej të cilave vetëm një është operë - *Fidelio*, ndërsa më shpesh interpretohen tri versionet e uverturës së saj *Leonora*. Një nga kryeveprat e tij vokalo-instrumentale është vepra madhështore *Missa solemnis* në D - dur.

## Kuriozitete


### Si krijonte muzikë Betoveni pas humbjes së dëgjimit

Edhe pse Betoveni filloi ta humbiste dëgjimin rreth moshës 28-vjeçare, ai vazhdoi të kompozonte disa nga veprat e tij më të njohura, përfshirë edhe Simfoninë e nëntë, duke u mbështetur në njohuritë e tij të brendshme muzikore dhe duke “e dëgjuar” muzikën në mendjen e tij. Shpesh ai shkruante me kujdes nota dhe skica për të kontrolluar tingujt që nuk mund t'i dëgjonte më, duke përdorur një lloj “dëgjimi imagjativ” për t'i ndjerë harmonitë dhe ritmet brenda tij. Në të vërtetë, gjatë disa koncerteve ai nuk mund t'i dëgjonte duartrokitjet e publikut, por arrinte t'i kuptonte reagimet duke vëzhguar fytyrat e njerëzve.

### E dashura e pavdekshme

“O Zot, pse njeriu duhet të ndahet nga ai që e do kaq shumë? E megjithatë, jeta ime në Vjenë tani është një jetë e mjerë. Dashuria jote më bën njëkohësisht njeriun më të lumtur dhe më të palumtur. Në moshën time kam nevojë për një jetë të qetë e të qëndrueshme – a mund të ekzistojë një gjë e tillë në marrëdhënien tonë?”

E dashura e pavdekshme (Immortal Beloved) është një nga misteret romantike më të njohura të jetës së Betovenit. Ky emërtim vjen nga një letër e gjatë dashurie që Betoveni e shkroi më 6 korrik të vitit 1812, por nuk e dërgoi kurrë. Letra i drejtohet një gruaje, të cilën ai e quan E dashura e pavdekshme dhe në të shpreh dashurinë e thellë, pasionin, dhimbjen dhe vuajtjen e shkaktuar nga ndarja.



Pjesë nga letra origjinale  
e Betovenit drejtuar *Të*  
dashurës së pavdekshme

## Aktivitetet

### 1. Pyetje për diskutim

- Pse Ludvig van Betoven konsiderohet kompozitori që lidh klasicizmin me romantizmin?
- Cilat gjini muzikore dallohen më shumë në krijimtarinë e Betovenit?
- Sa simfoni shkroi Betoveni dhe në çfarë dallohen ato nga simfonitë e kompozitorëve paraardhës?
- Çfarë e bën të veçantë Simfoninë e nëntë?

### 2. Aktivitet individual – punë hulumtuese

Ndahuni në tri grupe:

- Grupi I – përgatitni një detyrë projektuese me temë: Jozef Hajdn
- Grupi II – përgatitni një detyrë projektuese me temë: Wolfgang Amadeus Mocart
- Grupi III – përgatitni një detyrë projektuese me temë: Ludvig van Betoven

Secili grup hulumton në tekste shkollore, enciklopedi dhe faqe të besueshme interneti, ndërsa më pas për kompozitorin të cilin e zgjedh përgatit:

- të dhëna të shkurtra për jetën;
- titujt e veprave më të njohura;
- veçoritë kryesore stilistike të krijimtarisë dhe
- një shembull të shkurtër muzikor (1–2 minuta).

Në orën e mësimi, secili grup prezanton shkurt përmbajtjen e projektit dhe e prezanton shembullin muzikor.

### 3. Dëgjim i udhëzuar

*Simfonia nr. 5 në c - mol, Op. 67 – Koha I, nga L. van Betoven*

*Simfonia nr. 9 në d - mol, Op. 125 – Koha IV (Finalja), nga L. van Betoven*

*Simfonia nr. 7 në A - dur, Op. 92 – Koha II, nga L. van Betoven*

*Sonata e hënës (Mondscheinsonate), Sonata nr. 14 në cis - mol – Koha I, nga L. van Betoven*

*Për Elizën (Für Elise) WoO 59 në a - mol, nga L. van Betoven*

Bëni përzgjedhjen nga kompozimet e dhëna duke i përdorur linqet.

Për kompozimin e përzgjedhur përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

- Cilës gjini i përket kompozimi i përzgjedhur?
- Cila është forma e kompozimit?
- Për cilin instrument/orkestër/zë është shkruar kompozimi?
- Përcaktoni tempon, dinamikën dhe karakterin e kompozimit.



## ROMANTIZMI MUZIKOR

Shekulli XIX në muzikën evropiane u karakterizua nga romantizmi – një stil dhe lëvizje artistike që lindi si pasqyrim i ndryshimeve të thella shoqërore dhe politike pas Revolucionit Francez. Kushtet e reja historike, lëvizjet çlirimtare dhe fuqizimi i shtresës qytetare ushtruan ndikim të madh në jetën shpirtërore e kulturore dhe, rrjedhimisht, edhe në krijimtarinë muzikore.

Ndryshe nga klasicizmi, i cili vinte në pah arsyen, ekuilibrin dhe formën e qartë, romantizmi vendos në plan të parë shprehjen individuale dhe fantazinë. Kompozitorët tregojnë një interes të shtuar për botën e brendshme të njeriut, emocionet, ëndrrat dhe gjendjet e tij psikologjike. Tema të shpeshta në krijimtarinë muzikore bëhen dashuria, natyra, e kaluara dhe tradita popullore.

Romantikët marrin frymëzim nga folklori, poezia popullore dhe historia kombëtare. Në veprat e tyre ndihen prirjet drejt lirisë dhe kundërshtimi ndaj padrejtësive shoqërore.

Në gjuhën muzikore shfaqen ndryshime të rëndësishme: harmonia bëhet më e pasur, përdoret më shumë kromatika, ndërsa orkestra zgjerohet me ngjyra të reja tingëllimore. Zhvillohet edhe virtuozyzimi, veçanërisht në muzikën për piano.



*Liria e udhëheq popullin,*  
nga Ezhen Delakroa

Gjatë romantizmit u zhvilluan edhe dy lloje kryesore të shprehjes muzikore:

- muzika absolute dhe
- muzika programatike.

Muzika absolute mbështetet në forma muzikore të pastra, pa një përmbajtje konkrete të jashtme dhe realizohet përmes simfonive, sonatave, koncerteve, muzikës së dhomës dhe miniaturave për piano. Krahas saj u zhvillua edhe muzika programatike, e cila, përmes tingullit, paraqet një tregim, ide ose gjendje shpirtërore të caktuar. Karakteristike për të janë pikturimi tingullor dhe koloriti i pasur orkestral.

Përfaqësuesit e romantizmit muzikor të Evropës Perëndimore sollën zhvillime të reja edhe në format muzikore. Veçanërisht u dallua kënga solo (Lied) për zë dhe piano, në të cilën muzika ishte e lidhur ngushtë me tekstin poetik. Një vend të rëndësishëm zuri edhe miniatura për piano, si formë e shkurtër, e përshtatshme për një shprehje intime dhe të drejtpërdrejtë. Në muzikën orkestrale u zhvillua poema simfonike – një vepër programatike njëkohëshe me ndërtim të lirë. U shfaq edhe simfonia programatike, në të cilën muzika ndjek një tregim, ide ose ngjarje të paramenduar, me ndihmën e të ashtuquajturës ide fikse (idée fixe).

Në fushën e muzikës skenike, romantizmi solli arritje të rëndësishme në operë dhe balet. U zhvillua e ashtuquajtura operë heroike me tematikë kombëtare, e frymëzuar nga folklori, si edhe drama muzikore (opera dramë), në të cilën lajtmotivi u jep jetë personazheve, ngjarjeve dhe ideve, duke u përsëritur dhe zhvilluar gjatë gjithë veprës operistike.

Periodha e romantizmit muzikor la një trashëgimi të pasur kulturore përmes krijimtarisë së një plejade kompozitorësh, shumë prej të cilëve ishin njëkohësisht interpretues dhe virtuozy të shquar.

### Aktivitete

#### 1. Pyetje për diskutim

- Cilat janë karakteristikat kryesore të muzikës së romantizmit?
- Cilat ishin burimet e frymëzimit për kompozitorët e periudhës së romantizmit?
- Cili është dallimi ndërmjet muzikës absolute dhe muzikës programatike?
- Cilat forma muzikore u dalluan në krijimtarinë e kompozitorëve të Evropës Perëndimore?

## Franc Shubert (1797 – 1828)

Franc Shubert (gjerm.: *Franz Schubert*) lindi më 31 janar të vitit 1797, afër Vjenës. Njohuritë e para muzikore i mori nga i ati, ndërsa më vonë studioi në shkollën e qytetit, ku mësoi piano, violinë dhe kompozim. Që në moshë të re filloi të kompozonte këngë, fantazi për piano, uvertura dhe kuartete.

Për shkak të kushteve të vështira ekonomike, i ati e orientoi drejt profesionit të mësuesit, por Shuberti nuk ishte i kënaqur me atë punë dhe iu përkushtua plotësisht muzikës. Ai jetoi në varfëri dhe në kushte të vështira, gjë që u pasqyrua fuqishëm në krijimtarinë e tij. Vdiq më 19 nëntor të vitit 1828, në moshën 32-vjeçare.

Krijimtaria e Franc Shubertit zë një vend të rëndësishëm në romantizmin muzikor dhe përbën një urë lidhëse ndërmjet klasicizmit dhe romantizmit. Në veprat e tij ai krijoi një shprehje të re muzikore, më të thellë dhe më emocionale, në qendër të së cilës qëndron bota e brendshme e njeriut.

Kënga solo zë vend kryesor në krijimtarinë e Shubertit. Ai është krijuesi i këngës artistike (Lied), në të cilën muzika është e lidhur ngushtë me poezinë. Shuberti shkroi rreth gjashtëqind këngë. Melodia është mjeti kryesor i shprehjes muzikore në kompozimet e tij, të cilat dallohen për linja melodike të këndshme me karakter deklamativ. Sipas ndërtimit, këngët janë strofike ose variaciono-strofike. Shoqërimi në piano nuk është vetëm mbështetje, por aktivisht merr pjesë në shprehjen dhe thellimin e përmbajtjes muzikore. Ai shërben edhe si komentues i veprimit dramatik të muzikës. Për këngët e tij, Shuberti përdori shpesh tekste nga Gete dhe Hajne. Ciklet më të rëndësishme të këngëve janë: *Mullixhesha e bukur* dhe *Rrugë dimri*. Shuberti krijoi edhe një numër të madh veprash për piano: sonata, fantazi, impromptu dhe momente muzikore, si edhe vepra për ansamble dhome, muzikë skenike, opera, opereta etj. Ai shkroi gjithashtu nëntë simfoni, ndër të cilat më të njohurat janë: *Simfonia në h - mol (E pambaruar) D 759*, dhe *Simfonia në C - dur, D 944*.




Fragment nga *Simfonia e pambaruar* në h – mol

### Kuriozitet

Simfoninë nr. 8 të Shubertit e quajnë *Të pambaruar*, sepse ka vetëm dy kohë. Megjithatë, në thelb, ajo konsiderohet muzikalisht e plotë dhe e përfunduar si shprehje e konceptit të tij artistik.

## Zgjeroni njohuritë

**Mullixhesha e bukur** është një cikël prej njëzet këngësh, i kompozuar mbi vargjet e poetit Myler. Në to rrëfëhet dashuria e një djali të ri, i cili, pas një endjeje të gjatë, punësohet në një mulli dhe dashurohet me vajzën e mullixhiut. Mirëpo, dashuria e tij nuk gjen përgjigje. I trishtuar, çiraku mendon të hidhet në ujërat e përroit. Cikli ndahet në dy pjesë me nga dhjetë këngë. Pjesa e parë ka karakter optimist, ndërsa në pjesën e dytë shprehet pafuqia dhe dëshpërimi i të riut, të cilat e çojnë deri te dëshira për t'i dhënë fund jetës. Nga pikëpamja muzikore, këngët e këtij cikli dallohen për melodinë, ritmin dhe harmoninë, të cilat janë të afërta me thjeshtësinë dhe bukurinë e këngës popullore.

**Rrugë dimri** është gjithashtu një cikël prej njëzet e katër këngësh, në të cilin Shuberti paraqet edhe më thellë gjendjen e tij të rëndë shpirtërore, duke e ruajtur karakterin popullor. Bëhet fjalë për një shtegtar të braktisur, të vetmuar dhe pa shpresë, përmes të cilit kompozitori shpreh në mënyrë simbolike fatin e tij.

**Trofta** është këngë e pavarur e Shubertit, e kompozuar për zë dhe piano, e cila rrëfen për një troftë që noton e lumtur në një përrua të pastër, derisa një peshkatar dinak e turbullon ujin për ta kapur dhe për ta vlarë. Muzika e paraqet gjallërinë e peshkut të vogël dhe lëvizjen e ujit, ku ndihet gëzimi dhe loja e natyrës, ndërsa çasti kur peshkatari e kap peshkun, shton befasi dhe dramatizëm. Përveç karakterit narativ, kënga ka edhe kuptim simbolik – si alegori e pafajësisë rinore, e cila mund të rrezikohet nga mashtrimi dhe dinakëria, por edhe si paralajmërim për vajzat e reja ndaj burrave grabitqarë. Në këtë mënyrë, kënga i lidh pamjet e drejtpërdrejta muzikore me një mesazh më të thellë moral.

**Serenata** është një vepër muzikore, një kompozim melodioz dhe i qetë, i destinuar shpesh për interpretim në mbrëmje ose si dedikim dashurie.

**Momenti muzikor** është një kompozim i shkurtër instrumental, që krijohet si një tablo momentale lirike ose pikturale muzikore.



*Mullixhesha e bukur* – versioni francez nga Moris Shasan



Dorëshkrim i këngës *Trofta* (Die Forelle) të Franc Shubertit, botuar në vitin 1817



*Der Leiermann* nga *Rrugë dimri*

## Aktivitete

### 1. Pyetje për diskutim

- Si ndikuan vështirësitë e jetës dhe varfëria në karakterin emocional të muzikës së Shubertit?
- Cilat janë veprat më të njohura të Shubertit?
- Pse kënga (lied) zë vend qendror në krijimtarinë e Shubertit?

### 2. Dëgjim i udhëzuar

*Trofta* nga Franc Shubert

Dëgjojeni këngën.

- tregoni se çfarë ndjenje ose gjendjeje shpirtërore krijon kompozimi;
- dëgjoni shoqërimin në piano dhe shpjegoni se si ai e përshkruan ujin, lëvizjen e troftës dhe dramën e skenës;
- shkruani një përshkrim të shkurtër se si muzika e gjallëron tregimin;
- mendoni nëse kjo këngë mund të konsiderohet shembull i muzikës absolute apo i muzikës programatike. Pse?

### 3. Vlerësim estetik i veprave të Franc Shubertit

Bëni një hulumtim të shkurtër për kompozimin e përzgjedhur, me ndihmën e TIK-ut.

*Simfonia nr. 8 E pambaruar në h - mol, D 759 – Koha I*

*Serenata*

*Momenti muzikor nr. 3*

*Kënga solo Mbreti i pyllit*

Udhëzime për dëgjim

Dëgjoni me vëmendje kompozimin e përzgjedhur dhe kushtoni rëndësi këtyre elementeve: tempos dhe dinamikës, karakterit, aparatit interpretues (instrumenteve, vokaleve) dhe faktit nëse kompozimi i përket muzikës programatike apo muzikës absolute;

Mendoni dhe paraqitni vlerësime të argumentuara për çështjet e mëposhtme:

- cilat pjesë ju duken veçanërisht mbresëlënëse dhe pse;
- përshtypja juaj personale dhe reagimi emocional;
- ndani vëzhgimet tuaja me nxënësit tjerë;
- nxirrni përfundime të përbashkëta për veçoritë estetike dhe interpretuese.





*Felix Mendelssohn Bartholdy*

## Feliks Mendelson (1809 – 1847)

Feliks Mendelson Bartoldi (gjerm.: *Felix Mendelssohn Bartholdy*) lindi më 3 shkurt të vitit 1809 në Hamburg, në një familje të pasur dhe të shkolluar.

Që në moshë shumë të hershme shfaqti një talent të jashtëzakonshëm muzikor, prandaj shpesh krahasohet me Mocartin si një “fëmijë mrekulli”. Familja i siguroi një shkollim të shkëlqyer; ai mësoi piano, violinë, kompozim dhe teori të muzikës. Krahas muzikës, studioi edhe gjuhë, filozofi, letërsi, histori dhe art figurativ. Mendelsoni ishte gjithashtu një piktor i talentuar, gjë që ndikoi në mendimin e tij muzikor figurativ dhe të qartë. Rëndësi të madhe për zhvillimin artistik dhe frymëzimin e Mendelsonit patën udhëtimet e tij nëpër Evropë – Itali, Francë, Angli, Irlandë dhe Skoci. Ai nuk ishte vetëm kompozitor, por edhe dirigjent dhe pedagog i shquar. Vdiq shumë i ri, në moshën 38-vjeçare, më 4 nëntor të vitit 1847, si pasojë e problemeve shëndetësore dhe rraskapitjes psikike.

### Kuriozitet



*Gewandhaus në Lajpcig – akuarel nga Feliks Mendelson*

#### Kur muzika shndërrohet në pikturë

Edhe pse njihet para së gjithash si kompozitor dhe dirigjent, Feliks Mendelson ishte edhe një artist figurativ i talentuar. Gjatë udhëtimeve të tij nëpër Evropë, ai realizoi vizatime dhe akuarele, ndër të cilat edhe pikturën *Sheshi Groënmarkt* në Hagë.

Ai e pikturoi gjithashtu edhe sallën e koncerteve *Gevandhaus* (Gewandhaus) në Lajpcig, Gjermani, ku interpretonte dhe dirigjonte. Sot, kjo sallë është një nga qendrat simfonike më prestigjioze në Evropë.



*Sheshi Groënmarkt në Hagë nga Feliks Mendelson*

### Zgjeroni njohuritë

**Marshi** është një formë muzikore me ritëm të qartë, zakonisht në masën 4/4, e cila krijon ndjesinë e ecjes me hap të rregullt. Përdoret në parada, procesione ushtarake, ceremoni solemne dhe ceremoni martesore.

Krijimtaria e Mendelsonit përfshin: vepra simfonike, vepra koncertale, muzikë për ansamble, kompozime për piano – miniatura, si edhe vepra për organo. Veçori e çdo kompozimi të tij është melodia e bukur dhe e rrjedhshme. Me ciklin prej dyzet e tetë kompozimeve për piano, *Këngë pa fjalë*, ai krijoi gjininë e miniaturave pianistike karakteristike, ku instrumenti “këndon” pa tekst. Mendelsoni kompozoi pesë simfoni, ndër të cilat më të rëndësishmet janë: Simfonia në a - mol, e quajtur *Simfonia skoceze* dhe Simfonia në A - dur, e quajtur *Simfonia italiane*. Një vend të veçantë në krijimtarinë e tij zënë uverturat programore, të cilat nuk janë hyrje në operë, por vepra instrumentale të pavarura me karakter simfonik. E tillë është uvertura *Ëndrra e një nate vere*, në të cilën pjesa më mbresëlënëse është *Marshi i martesës*. Ai kompozoi gjithashtu edhe uverturat *Shpella e Fingalit*, *Meluzina e bukur*, *Qetësia e detit*, etj. Nga veprat e tjera instrumentale të Mendelsonit veçohet edhe *Koncerti për violinë dhe orkestër në e - mol*.

## Aktivitete

### 1. Pyetje për diskutim

- Si ndikoi shkollimi familjar në zhvillimin muzikor të Mendelsonit?
- Çfarë roli patën udhëtimet nëpër Evropë në frymëzimin dhe krijimtarinë e Mendelsonit?
- Pse uverturat e Mendelsonit, si *Ëndrra e një nate vere*, janë të rëndësishme dhe me çfarë dallohen nga uverturat operistike?

### 2. Dëgjim i udhëzuar

*Marshi i martesës nga Ëndrra e një nate vere*



Dëgjoni kompozimin *Marshi i martesës* dhe kushtoni vëmendje ritmit, melodisë dhe instrumenteve që e bartin materialin motivor.

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

- A tingëllon muzika e gëzueshme, solemne apo e qetë? Pse?
- Cila pjesë e muzikës mendoni se e pasqyron më së miri atmosferën e martesës?
- Në çfarë dallon marshi nga llojet e tjera të muzikës që keni dëgjuar?

*Koncerti për violinë dhe orkestër në e – mol*



Dëgjoni koncertin me vëmendje dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme hulumtuese:

- Sa kohë ka koncerti?
- A ndryshon tempoja brenda kohës?
- Çfarë karakteri kanë kohët: romantik, dramatik, i gëzueshëm apo i trishtuar?
- Çfarë ndjenjash ju zgjon muzika gjatë dëgjimit të koncertit?

## Kuriozitete

### Marshi i martesës – muzika që kremton çastin

Edhe pse e gjithë uvertura *Ëndrra e një nate vere* është frymëzuar nga komedia e Shekspirit, *Marshi i martesës* është pjesa që interpretohet më shpesh si vepër e pavarur. E kompozoi atë si një tablo muzikore të gëzimit dhe kremtimit të bashkësisë martesore, por nuk e kishte menduar se do të shndërrohej në një “hit dasmash” dy shekuj më vonë.



Fragment nga *Marshi i martesës*

### Rilindja e J. S. Bah

Në vitin 1829, Mendelsoni luajti një rol kyç në ringjalljen e muzikës së Johan Sebastian Bahut, kur, pothuajse një shekull pas krijimit të saj, e vuri në skenë dhe e dirigjoi Pasionin sipas Shën Mateut. Me këtë interpretim historik filloi e ashtuquajtura “Rilindja e Bahut”, e cila e riktheu këtë kompozitor në qendër të jetës muzikore evropiane.



*Robert Schumann*



Klara dhe Robert Shuman –  
fotografi e vitit 1850

## Robert Shuman (1810 – 1856)

Robert Shuman (gjerm.: *Robert Schumann*) lindi më 8 qershor të vitit 1810 në Cvikau, Gjermani. Që në fëmijëri shfaqti interes për muzikën dhe letërsinë. Mësoi piano dhe filloi herët të kompozonte, por njëkohësisht ishte thellësisht i interesuar edhe për të shkruar, për të lexuar dhe për të analizuar vepra letrare. Ai i nisi studimet për drejtësi, por pasioni i tij i vërtetë ishte muzika. Shumani ishte një personalitet jashtëzakonisht i ndjeshëm, me një botë të pasur shpirtërore. Gjatë jetës u përball shpesh me kriza psikike, depresion dhe luhajtje emocionale. Megjithatë, ai ishte edhe një intelektual me nevojë të fortë për të reflektuar mbi muzikën, për ta analizuar dhe për të shkruar për të. Në vitin 1834 themeloi revistën muzikore *Revista e re muzikore* (Neue Zeitschrift für Musik), përmes së cilës mbështeti në mënyrë aktive muzikën e re romantike dhe talentet e rinj. Në jetën dhe krijimtarinë e tij vend të rëndësishëm zë dashuria për Clara Wieck, pianiste e shquar, e cila më vonë u bë bashkëshortja e tij. Në vitet e fundit të jetës, gjendja e tij mendore u përkeqësua rëndë, ndërsa në vitin 1854 përjetoi një krizë të rëndë psikike dhe u shtrua në një institucion psikiatrik. Vdiq më 29 korrik të vitit 1856, në moshën 46-vjeçare. Edhe pse jeta e tij ishte e mbushur me përballje dhe vuajtje të brendshme, ai mbetet një nga personalitetet më të thella dhe më të ndjeshme të romantizmit, simbol i artistit që jeton mes realitetit dhe botës së emocioneve të brendshme.

Në krijimtarinë e Shumanit pasqyrohet bota e thellë shpirtërore e njeriut. Muzika e tij mbështetet edhe në elemente kombëtare. Në të gjitha veprat e tij, nga miniaturat pianistike deri te simfonitë, pasqyrohen fryma poetike, ndjenjat e pastra, dashuria për natyrën dhe humori i singertë, të cilat janë karakteristike për artin popullor.

Në kompozimet për piano ai zbatoi parimin e ciklit. Të tilla janë ciklet me karakter programatik *Karnavali*, *Kreisleriana*, *Skena fëmijërore* dhe *Pjesë fantastike*, në të cilat secila pjesë ka një titull që e shpjegon përmbajtjen e saj. Ndër veprat e tjera për piano veçohen *Etydet simfonike*, *Sonata në g - mol*, *Fantazia në C - dur*, *Sonata në fis - mol* dhe *Koncerti për piano dhe orkestër në a - mol*, op. 54.

Shumani shkroi rreth dyqind e pesëdhjetë këngë solo, ku shoqërimi në piano nuk është vetëm mbështetje e linjës vokale, por edhe bartës aktiv dhe i barabartë i shprehjes muzikore. Ciklet më të njohura të këngëve të tij janë: *Dashuria dhe jeta e gruas*, *Dashuria e poetit*, etj.

Në krijimtarinë e tij orkestrale bëjnë pjesë uverturat simfonike, si *Manfredi dhe Fausti*, si edhe katër simfonitë: *Simfonia e Pranverës* (B - dur), *Simfonia në C - dur*, *Simfonia e Rinit* (Es - dur) dhe *Simfonia në d - mol*.

## Aktivitete

### 1. Mendo dhe diskuto

- Romantizmi vë në pah emocionin individual dhe botën e brendshme të njeriut. Në ç'mënyrë muzika e Robert Shumanit e shpreh këtë ideal?
- Shumani ishte njëkohësisht kompozitor dhe kritik muzikor. A mendon se është e rëndësishme që një artist të jetë edhe teoricien dhe mendimtar? Arsyejo qëndrimin tënd.
- Në cikle si *Skena fëmijërore* dhe *Karnavali*, secila pjesë ka një titull. A e kufizon apo e nxit titulli imagjinatën tënde si dëgjues?
- Në këngët solo të Shumanit, shoqërimi në piano ka një rol të barabartë me linjën vokale. Si e pasuron kjo përmbajtjen muzikore?
- A mund të jetë vuajtja e artistit burim krijimtari? Mendo dhe lidhe përgjigjen tënde me jetën dhe veprën e Shumanit.

### 2. Analizë programatike dhe emocionale

*Skena fëmijërore* (nr. 1 dhe nr. 7) nga Robert Shuman

Nr. 1 *Nga vende dhe njerëz të huaj* (Von fremden Ländern und Menschen)

Nr. 7 *Ëndërrim* (Träumerei)



Udhëzime për analizë dhe pyetje për diskutim:

- Çfarë ju sugjeron titulli i pjesës?
- A e pasqyron muzika përmbajtjen e titullit?
- Çfarë “skene fëmijërore” mund të përfytyroni gjatë dëgjimit?
- A tingëllon muzika më shumë si këndvështrimi i një fëmije apo si një kujtim i një të rrituri?

### 3. Dëgjim i udhëzuar


*Simfonia nr. 4 (Koha III – Skerco)* nga Robert Shuman

*Koncerti për piano dhe orkestër në a - mol (Koha I)* nga Robert Shuman



Diskutim pas dëgjimit të kompozimeve:

- Në cilën vepër ka më shumë dramacitet? Pse?
- Cili është dallimi ndërmjet simfonisë dhe koncertit?
- Ku shprehet më shumë individualiteti: në simfoni apo në koncert?
- Si manifestohet stili romantik në të dyja veprat?
- Cila vepër ju duket më intensive nga ana emocionale dhe pse?



Faqja e parë e partiturës në Skercos nga Shuman

## Kuriozitete

### Viti i këngëve


Gjatë vetëm një viti, në vitin 1840, i frymëzuar nga dashuria për Klarën, Robert Shuman kompozoi më shumë se njëqind e tridhjetë këngë solo (lied). Në muzikologji, ky vit njihet si *Viti i këngëve të Shumanit*.

### Klara – pianiste me famë botërore dhe përkrahëse deri në fund

Klara ishte një nga pianistet më të mëdhaja të shekullit XIX. Pas sëmundjes psikike të Robertit dhe shtrimit të tij në sanatorium, ajo u kujdes vetë për fëmijët e tyre, ndërsa njëkohësisht mbante koncerte në mbarë Evropën, duke përhapur muzikën e tij dhe duke e ruajtur krijimtarinë e tij nga harresa.

### Zgjeroni njohuritë

**Skercoja** është një formë muzikore që mund të paraqitet si kompozim i pavarur ose si pjesë e ciklit të sonatës. Zakonisht ka karakter të shpejtë, të gjallë, lozonjar dhe humoristik, me kontraste ritmike dhe dinamike, duke krijuar një ndjenjë loje dhe energjie brenda simfonisë.



*Johannes Brahms*



Bramsi në banesën e tij në Vjenë

## Johanes Brams (1833 – 1897)

Johanes Brams (gjerm.: *Johannes Brahms*) është kompozitor gjerman, i lindur më 7 maj të vitit 1833 në Hamburg, Gjermani, në një familje modeste, por muzikalisht e orientuar. Që në fëmijëri shfaq talent të theksuar muzikor. Mësoi piano dhe violinë, ndërsa që në vitet e adoleshencës interpretonte si pianist dhe shoqërues në piano. Më vonë, falë veprimtarisë së tij muzikore, u njoh me Robert Shumanin, i cili e dalloj si një talent të jashtëzakonshëm dhe e ndihmoi të niste rrugën e tij profesionale si kompozitor. Bramsi iu përkushtua me zell kompozimit, por edhe veprimtarisë pedagogjike dhe dirigjuese. Vdiq më 3 prill të vitit 1897 në Vjenë. Megjithëse jetoi në një periudhë ndryshimesh të mëdha muzikore, ai mbetet simbol i ndërthurjes së përkryer midis formës klasike dhe emocionit romantik, si kompozitor që kultivoi traditën e thellë muzikore dhe kulturën e lartë muzikore.

Krijimtaria e Johanes Brams përfshin pothuajse të gjitha gjinitë muzikore, me përjashtim të muzikës skenike. Ndër veprat e tij më të rëndësishme për piano veçohen Sonatat për piano (op. 1, 2 dhe 5), *Baladat* op. 10, variacionet dhe fugat – *Variacione me temë të Hendelit*, op. 24 dhe *Variacione me temë të Paganinit*, op. 35, intermecot, kapriçot, rapsoditë, etj., si edhe *Koncerti për piano dhe orkestër nr. 1 në d - mol, op. 15* dhe *Koncerti për piano dhe orkestër nr. 2 në B - dur, op. 83*.

Muzika orkestrale e Brahmsit përfshin edhe katër simfonitë: Simfonia nr. 1 në c - mol op. 68, Simfonia nr. 2 në D - dur op. 73, Simfonia nr. 3 në F - dur op. 90, Simfonia nr. 4 në e - mol op. 98; uverturat – *Uvertura tragjike* op. 81 dhe *Uvertura solemne akademike* op. 80. Ai gjithashtu kompozoi muzikë dhome, si edhe një numër të madh kompozimesh vokale – këngë solo (lied), duete dhe ansamble për zë dhe piano, si edhe muzikë korale (me ose pa shoqërim instrumental). Kulmin e krijimtarisë së tij vokalo-simfonike e arriti me *Rekuiemin gjerman* op. 45 (për kor, solistë dhe orkestër). Ndër veprat më të njohura të Bramsit, që interpretohen shpesh në koncerte anembanë botës, janë *Vallet hungareze*, të frymëzuara nga muzika popullore hungareze. Fillimisht ato u shkruan për piano me katër duar, ndërsa më vonë, për shkak të popullaritetit të tyre të madh, u orkestruan.

### Kuriozitet

#### Miqësia dhe frymëzimi muzikor – Bramsi dhe Klara Shuman

Bramsi dhe Klara Shuman kishin një miqësi shumë të ngushtë dhe të ngrohtë. Edhe pse nuk ishin partnerë romantikë, ata shkëmbenin letra të mbushura me emocione, respekt dhe frymëzim muzikor. Klara i jepte shpesh këshilla për kompozimet e tij, ndërsa Bramsi e konsideronte atë një burim të madh frymëzimi dhe një mbështetëse të besuar në sfidat muzikore dhe personale.

### Kuriozitet

#### Ninulla e Johanes Bramsit

*Ninulla* e Johanes Bramsit është një nga ninullat më të njohura në botë. Ajo u kompozua në vitin 1868 dhe karakterizohet nga një melodi e butë dhe qetësuese, e cila krijon ndjenjë ngrohtësie dhe sigurie. Edhe pse është e thjeshtë, kjo këngë dëshmon mjeshtërinë e Bramsit për të shprehur dashurinë dhe butësinë përmes muzikës. Interesant është fakti se kjo vepër nuk interpretohet vetëm për fëmijë – ajo interpretohet edhe në koncerte, si shembull i ndërthurjes së përkryer të thjeshtësisë muzikore me thellësinë e shprehjes.



## Aktivitete

### 1. Hulumtim mbi jetën dhe krijimtarinë e Johanes Bramsit

- Hulumtoni jetën dhe krijimtarinë e Johanes Bramsit duke përdorur enciklopedi online, libra ose burime të tjera të besueshme.
- Mblidhni të dhëna themelore për jetën e këtij kompozitori (vendin dhe kohën e lindjes, shkollimin, si edhe personalitetet që kanë patur rëndësi në jetën e tij).
- Hulumtoni fushat kryesore të krijimtarisë së tij (simfonitë, koncertet, muzika e dhomës dhe këngët).
- Veçoni disa nga veprat më të rëndësishme të Bramsit dhe shpjegoni pse janë të rëndësishme.



### 2. Dëgjimi i kompozimeve të Johanes Bramsit

*Valle hungareze nr. 2*

*Valle hungareze nr. 4*

*Valle hungareze nr. 5*

Udhëzime për dëgjim

- dëgjojeni me vëmendje *Vallet hungareze nr. 2, nr. 4 dhe nr. 5*. Gjatë dëgjimit, kushtoni vëmendje: tempos, ritmit dhe karakterit të valles, dinamikës, melodisë dhe karakterit të saj, frymës popullore (hungareze) në muzikë dhe
- në fund, paraqitni përfundimet tuaja para klasës.



### 3. Simfonia në pikturë

*Simfonia nr. 3 (Koha III)* nga Johanes Brams

*Poco Allegretto*

Fillimi i temës nga Simfonia nr. 3 (Koha III)



Udhëzime për aktivitetin

- dëgjoni me vëmendje melodinë;
- kushtoni vëmendje tempos dhe dinamikës;
- dalloni përsëritjet dhe kontrastet dhe
- përqendrohuni te karakteri i kësaj kohe.

Interpretim vizual

- Gjatë dëgjimit të muzikës, vizatoni një figurë, skicë ose grafikë të frymëzuar nga muzika që dëgjoni.
- Përpiquni të shprehni energjinë, ritmin ose atmosferën e muzikës përmes vizatimit tuaj.



*H. Berlioz*

## Hektor Berlioz (1803 – 1869)

Hektor Berlioz (frëngj.: *Hector Berlioz*) është kompozitor, dirigjent dhe kritik muzikor, i lindur më 11 dhjetor të vitit 1803 në afërsi të Lionit, Francë. Babai i tij ishte mjek, ndërsa nëna kishte interes për muzikën dhe letërsinë, gjë që i mundësoi që në moshë të hershme të njihej me artet. Me dëshirën e familjes filloi studimet për mjekësi, por shumë shpejt kuptoi se pasioni i tij i vërtetë ishte muzika. Në vitin 1826 u regjistrua në Konservatorin e Parisit, ku studioi harmoni, kontrapunkt dhe orkestracion.

Ai promovoi konceptin romantik të muzikës si shprehje të emocioneve dhe ndjenjave të thella personale. Vepra e tij më e njohur është *Simfonia fantastike* (*Symphonie fantastique*), e frymëzuar nga dashuria e tij për aktoren Harriet Smithson. Në këtë vepër ai përdor konceptin e idesë fikse (*idée fixe*) – një motiv muzikor që simbolizon një person ose një ndjenjë të caktuar dhe përsëritet gjatë gjithë veprës. Berlioz i udhëtoi nëpër Evropë dhe ushtroi ndikim të madh si dirigjent dhe pedagog. Edhe pse veprat e tij shpesh konsideroheshin kontroverse për shkak të harmonive të pazakonta dhe përdorimit të një orkestre me përmasa të mëdha, sot ai vlerësohet si pionier i orkestracionit romantik dhe një nga kompozitorët më novatorë të shekullit XIX. Vdiq më 8 mars të vitit 1869 në Paris.

Krijimtaria e Berliozit u zhvillua në tri fusha kryesore: muzika simfonike, oratoriumet dhe operat. Origjinaliteti i tij shfaqet veçanërisht në muzikën simfonike, ku ai krijoi ciklin simfonik romantik me program (duke shpjeguar temat përmes një teksti programatik, gjë që e bën simfoninë më të qartë dhe më të lehtë për t'u kuptuar nga dëgjuesi). Risitë në simfonitë e tij qëndrojnë në formën, orkestracionin, përdorimin e mjeteve shprehëse muzikore dhe në përdorimin e idesë fikse (*idée fixe*), elemente që dallohen nga normat e simfonisë klasike. Në këtë grup bëjnë pjesë: *Simfonia fantastike*, *Haroldi në Itali*, *Romeo dhe Zhulieta* (që përfshin tekst dhe vokal), *Karnavali romak* dhe *Simfonia funebre - triumfale*. Ndër veprat e tij më të njohura janë edhe operat *Benvenuto Celini* dhe *Trojanët*, oratoriumi *Dënimi i Faustit* dhe *Rekuemi*.

### Kuriozitet

#### Berlioz dhe Festivali i madh i industrisë

*Festivali i madh i industrisë* (Grand Festival de l'Industrie) ishte një ngjarje publike në Francë, e organizuar gjatë shekullit XIX, kushtuar industrisë, teknologjisë dhe zhvillimit kulturor. Në këto festivale prezantoheshin arritjet më të reja industriale, makineritë dhe produktet, si edhe organizoheshin shfaqje artistike – muzikë, kore dhe orkestra – për të dëshmuar lidhjen midis përparimit teknik dhe jetës kulturore.

Më 1 gusht 1844, Berlioz drejtoi një koncert me më shumë se një mijë interpretues, duke dëshmuar madhësinë dhe rëndësinë e këtij festivali si një ngjarje kulturore dhe muzikore.



Berlioz si dirigjent në koncertin e mbajtur te "Festivali i madh i industrisë"



Ideja fikse – temë  
nga Berlioz (Simfonia  
fantastike)

## Aktivitetet

### 1. Pyetje për diskutim

- Pse Hektor Berlioz konsiderohet novator në muzikën e romantizmit?
- Në cilat tri fusha kryesore u zhvillua krijimtaria e Hektor Berliozit dhe në cilën prej tyre shprehet më fuqishëm origjinaliteti i tij?
- Çfarë është cikli simfonik romantik me program dhe si e largon përdorimi i idesë fikse krijimtarinë e tij simfonike nga normat e simfonisë klasike?

### 2. Dëgjojmë muzikë nga Hektor Berlioz

*Simfonia fantastike (Koha I – Endërrime dhe pasione)*

*Simfonia fantastike (Koha IV – Kortezi për në ekzekutim)*

*Simfonia fantastike (Koha V – Endërra e natës së shtrigave)*

*Dënimi i Faustit (Marshi Rakoci)*

Udhëzime për aktivitetin

- Pas dëgjimit të fragmenteve, zgjidhni një kompozim që ju pëlqen më shumë dhe vazhdoni ta dëgjoni individualisht me kufje.
- Përqëndrohuni te mjetet shprehëse muzikore: melodia, harmonia, karakteri, kontrasti dhe orkestracioni.
- Shkruani vërejtjet dhe përshtypjet tuaja për kompozimin.
- Hapni një diskutim në klasë rreth këtyre pyetjeve: Çfarë keni vërejtur? Si jeni ndjerë gjatë dëgjimit? Si i përdor Berlioz mjetet muzikore për të krijuar një rrëfim ose një emocion?





*Liszt*

## Franc List (1811 – 1886)

Franc List (gjerm.: *Franz Liszt*) ishte një kompozitor dhe pianist i shquar, i njohur për virtuositetin, risitë dhe ekspresivitetin e tij. Lindi më 22 tetor të vitit 1811 në Rajding, Austri. Babai i tij ishte një adhurues i muzikës dhe e nxiti Francin që në moshë të vogël t'i përkushtohej muzikës. Interpretimin e tij të parë publik e dha kur ishte vetëm nëntë vjeç, ndërsa suksesi i koncerteve në Presburg dhe në oborrin e princit Nikolaus Esterhazy i mundësoi të siguronte mbështetje financiare për studimet muzikore në Vjenë. Në vitet 1830, Listi filloi turnetë e tij nëpër Evropë, duke u bërë i famshëm për virtuositetin e jashtëzakonshëm. Në këtë periudhë lindi edhe fenomeni i njohur si "Listomania", i cili e dëshmoi popullaritetin e tij të jashtëzakonshëm. Në vitin 1847 u vendos në Vajmar, ku u tërhoq nga karriera koncertale për t'iu kushtuar kompozimit. Atje u shqua si promovues i muzikës bashkëkohore dhe krijoi bërthamën e të ashtuquajturës "shkollë e re gjermane". Periudhën e mëvonshme të jetës e kaloi duke udhëtuar midis Romës, Vajmarit dhe Budapestit, ku dha mësim dhe themeloi një akademi muzike, e cila më vonë mori emrin e tij. Vdiq më 31 korrik të vitit 1886 në Bajrot, Gjermani.

### Kuriozitet

#### Listomania – fenomeni i euforisë muzikore

Një nga dukuritë më interesante në historinë e muzikës është e ashtuquajtura "Listomania" – një fenomen që u shfaq gjatë viteve 1840, në kohën e turneve koncertale të Franc Listit. Publiku nuk reagoonte ndaj Listit thjesht si ndaj një kompozitori apo pianisti, por si ndaj një ylli të vërtetë: dëgjuesit përjetonin një entuziazëm të jashtëzakonshëm, duartrokisnin në mënyrë të pakontrolluar, mblidhnin suvenire nga koncertet e tij, madje ruanin edhe telat e këputur të pianos si kujtim. Termin "Listomania" e përdori për herë të parë poeti gjerman Hajnrih Hajne, duke e përshkruar këtë entuziazëm masiv si një lloj "histerie muzikore". Ky fenomen konsiderohet si një nga shembujt e parë të kultit të një personaliteti të famshëm në muzikën klasike, shumë kohë përpara shfaqjes së yjeve të muzikës pop dhe tregon qartë ndikimin e jashtëzakonshëm dhe karizmën që Franc Listi ushtronte mbi publikun e epokës romantike.



Listi në sallën koncertale Teodor Hozeman  
(Theodor Hosemann)

Krijimtaria e Franc Listit është e gjerë dhe e larmishme, por mund të organizohet në disa drejtime kryesore: vepra për piano, poema simfonike, vepra vokale dhe kompozime orkestrale. Muzika e tij është një nga shenjat dalluese të romantizmit dhe karakterizohet nga ekspresiviteti i fuqishëm, virtuositeti dhe dimensionimi programatik.

Ndër veprat e tij më të njohura për piano veçohen *Rapsoditë hungareze* – një cikël prej nëntëmbëdhjetë rapsodish të frymëzuara nga muzika popullore hungareze, si edhe nga ritmet dhe meloditë e muzikës rome; *Sonata në h - mol*; *La Campanella*; *Etydet transcendente* – një cikël prej dymbëdhjetë etydesh; si edhe *Ëndrrat e dashurisë* – një cikël prej tre nokturnesh.

Listi e zhvilloi formën e poemës simfonike (një vepër orkestrale instrumentale me një kohë, e cila mbështetet në një vepër letrare, dramatike ose pikturale dhe rrëfen një histori, përshkruan një pamje ose shpreh një ndjenjë pa përdorur fjalë). Ndër trembëdhjetë poemat e tij simfonike, më të njohura janë *Mazeppa*, *Les Préludes*, *Fausti*, *Dante*, etj.

## Aktivitete

### 1. Përgjigjuni pyetjeve

- Çfarë paraqet fenomeni “Listomania” dhe çfarë tregon ai për popullaritetin e Franc Listit?
- Cilat janë karakteristikat kryesore të stilit muzikor të Franc Listit?
- Çfarë është poema simfonike dhe cili është roli i Franc Listit në zhvillimin e saj?

### 2. Dëgjojmë muzikë dhe krahasojmë

*Rapsodia hungareze nr. 2* nga Franc List - versioni për piano

*Rapsodia hungareze nr. 2* nga Franc List - versioni orkestral



Udhëzime për diskutim:

- kushtoni vëmendje nëse melodia është e njëjtë në të dyja versionet;
- mendoni se çfarë kanë të përbashkët të dyja versionet dhe çfarë i dallon ato. Si ndikon kjo në përjetimin tuaj të kompozimit?
- shpjegoni pse të dyja versionet janë të rëndësishme dhe si e ndryshojnë instrumentet përjetimin e muzikës.

### 3. Dëgjim i udhëzuar

*La Campanella* nga Paganini/List

Dëgjoni kompozimin.

Udhëzime për diskutim:

- Ku përsëritet motivi i “ziles së vogël”?
- A ndryshon ai në pjesë të ndryshme të kompozimit?
- Cilat pjesë janë më të shpejta dhe cilat më të ngadalta?
- Ku “vrapon” pianoja papritur lart ose poshtë nëpër tastierë?
- Si ndikon ndryshimi i dinamikës në dramatin e veprës?

### 4. Punimi i një eseje pas dëgjimit të kompozimit

*Ëndrra e dashurisë nr. 3* nga Franc List

- Shkruani një ese të shkurtër, në të cilën do të përshkruani ndjenjat, atmosferën dhe mendimet që ju ngjalli dëgjimi i kompozimit *Ëndrra e dashurisë* nga Franc List.



### 5. Tinguj romantikë – klasifikimi i veprave sipas gjinisë

- Krijoni një listë me vepra të njohura muzikore të romantizmit muzikor të Evropës Perëndimore, të organizuara sipas gjinisë.

## Zgjeroni njohuritë

Rapsoditë hungareze fillimisht u shkruan për piano solo. Franc Listi i kompozoi nëntëmbëdhjetë rapsoditë kryesisht gjatë periudhës 1846–1853, i frymëzuar nga muzika popullore hungareze, nga stilet verbunkos (valle ushtarake hungareze) dhe czardas (valle popullore hungareze dhe rome, me pjesë të ngadaltë dhe të shpejtë), si edhe nga muzika që e dëgjonte nga ansamblet rome.

Një pjesë e Rapsodive hungareze më vonë u orkestruan, domethënë u përshtatën për orkestër. Disa orkestrime i bëri vetë Franc Listi, ndërsa disa të tjera i realizuan nxënësit dhe bashkëpunëtorët e tij, më shpesh Franc Dopler, nën mbikëqyrjen ose me miratimin e Listit.

## Kuriozitet

### Sekretet e La Campanella

*La Campanella* (Zilja e vogël) është një nga kompozimet pianistike më të njohura dhe më virtuozet të Franc Listit. Vepra është frymëzuar nga koha e katërt (finalja) e Koncertit për violinë nr. 2 në h - mol, op. 7, të kompozitorit dhe violinistit italian Nikolo Paganini, i njohur për pasazhet e tij solistike jashtëzakonisht të ndërlikuara dhe teknikisht sfiduese, si edhe për efektin e ziles, i cili dëgjohej si në partin solistik, ashtu edhe në atë orkestral.

Është interesante se *La Campanella* nuk përbën vetëm një sfidë teknike për interpretuesin, por është edhe një vepër me efekt të fuqishëm muzikor dhe lehtësisht e dallueshme, gjë që e ka bërë si një nga kompozimet pianistike më të njohura të romantizmit dhe simbol të virtuositetit pianistik të Franc Listit.



## OPERA NË ROMANTIZËM



Teatri i operës *La skala* në Milano

Në shekullin XIX, opera bëhet forma qendrore muzikore-skenike, e cila e bashkon muzikën, letërsinë dhe teatrin. Ajo jo vetëm që argëton, por edhe shpreh klimën shpirtërore, kombëtare dhe emocionale të kohës.

Kjo periudhë karakterizohet nga ekspresiviteti i fuqishëm, emocionet e theksuara, konfliktet dramatike dhe interesi për historinë, natyrën dhe identitetin kombëtar. Ndryshe nga opera klasike e shekullit XVIII, ku në plan të parë ishin ekuilibri dhe qartësia formale, opera romantike synon një trajtim më të thellë psikologjik të personazheve dhe një shprehje muzikore më intensive.

Në gjysmën e parë të shekullit, ndikim të rëndësishëm patën veprat e Xhoakino Rosinit, Vinçenzo Belinit dhe Gaetano Donizetit, të cilët e zhvilluan stilin “belkanto”.

Në gjysmën e dytë të shekullit shfaqet një qasje e re ndaj operës. Xhuzepe Verdi sjell një ngarkesë të fuqishme dramatike, personazhe realiste dhe muzikë që shpreh drejtpërdrejt emocionet.

Paralelisht me traditën italiane, në Gjermani zhvillohet një koncept i ndryshëm i dramës muzikore përmes veprave të Rikard Vagnerit, ndërsa në Francë zhvillohet e ashtuquajtura “opera e madhe” (grand opéra), e karakterizuar nga skena madhështore, kore masive dhe tema historike. Nga fundi i shekullit, në Itali shfaqet verizmi – një drejtim që paraqet histori reale, shpesh të ashpra, nga jeta e përditshme.

Në këtë periudhë zhvillohen edhe shkollat nacionale të operës. Në Rusi dhe në Çeki krijohen opera të frymëzuara nga muzika popullore dhe e kaluara historike, me elemente folklorike dhe me një frymë të theksuar kombëtare.

### Zgjeroni njohuritë

Teatri i Operës *La Scala* në Milano është një nga teatrot operistike më të rëndësishme në Evropë dhe ka luajtur një rol të madh në zhvillimin e operës gjatë romantizmit. Ky teatër ishte skena e premierave të shumë operave të rëndësishme romantike dhe u dha mundësi kompozitorëve dhe solistëve t’i interpretonin veprat e tyre përpara një publiku të gjerë dhe me ndikim. *La Scala*, si edhe teatro të tjera të mëdha, si *Bayerische Staatsoper* në Mynih, *Vienna State Opera* dhe *Paris Opéra*, kontribuan në zhvillimin e operës si një art dramatik dhe me shprehje të fuqishme emocionale. Ato mundësuan përdorimin e orkestrave të mëdha, skenografive madhështore dhe produksioneve komplekse, duke nxitur karakterin romantik të muzikës, ekspresivitetin e solistëve dhe dramaticitetin e rrëfimeve.



Pllakata nga operat e romantizmit në *La Scala*

## Opera në Itali në shekullin XIX

Në gjysmën e parë të shekullit XIX, Italia mbetet qendra kryesore e artit operistik evropian. Pas krizës së operës serioze në fund të shekullit XVIII dhe nën ndikimin e ideve të Revolucionit Francez, si edhe të lëvizjeve nacionalçlirimtare kundër sundimit austriak, lindi nevoja për ripërtëritjen e artit operistik dhe për krijimin e veprave më të afërta me ndjenjat dhe aspiratat e popullit. Kështu, opera u orientua gradualisht drejt një shprehjeje më të fuqishme dramatike dhe theksimit të elementit kombëtar. Në këto rrethana, opera italiane e gjysmës së parë të shekullit XIX u zhvillua si një formë artistike ku vendin qendror e zinte zëri i njeriut. Rëndësi të veçantë mori stili belkanto. Orkestra kishte, në shumicën e rasteve, rol shoqërues, ndërsa këngëtarët ishin bartësit kryesorë të dramës dhe të emocionit. Në këtë frymë krijuan kompozitorë si Xhoakino Rosini, Vinçenco Belini, Gaetano Donizeti dhe, më vonë, Xhuzepe Verdi, të cilët kontribuan në formësimin e fizionomisë së re të operës romantike italiane.

Belkanto (“këndim i bukur”) është një stil muzikor italian që u zhvillua në operën italiane nga mesi i shekullit XVIII deri në fillim të shekullit XIX. Karakterizohet nga linja të gjata dhe shprehëse vokale, të cilat vënë në pah bukurinë, pastërtinë, fleksibilitetin dhe virtuozeitetin teknik të zërit, saktësinë e frazimit dhe ekspresivitetin e interpretimit, ndërsa këngëtari bëhet bartësi kryesor i dramës. Parimet e stilit belkanto vazhdojnë të ndikojnë edhe sot në zhvillimin e teknikës vokale.



Teatri i operës *La Fenice* në Venedik



*G. Rossini*

## Xhoakino Rosini (1792 – 1868)

Xhoakino Rosini (ital.: *Gioachino Rossini*) lindi më 29 shkurt të vitit 1792 në Pezaro, Itali. Që në fëmijëri tregoi talent të jashtëzakonshëm muzikor. Studioi në Bolonjë, ku zhvilloi stilin e tij kompozicional dhe filloi të ndërtonte karrierën si kompozitor operash.

Jeta e tij u karakterizua nga suksese dhe vlerësime të mëdha, veçanërisht në fushën e operës komike, por edhe nga sfida personale që ndikuan në krijimtarinë e tij. Ai kompozoi në pothuajse të gjitha gjinitë muzikore, por arritjen më të madhe e shënoi në artin operistik. Vdiq më 13 nëntor të vitit 1868 në Paris.

Krijimtaria operistike e Rosinit përfshin rreth dyzet opera. Ai e ngriti operën komike në një nivel më të lartë artistik dhe iu kundërvu karakterit dekadent të operës serioze. Me ariet e tij zhvilloi stilin e këndimit belkanto, duke u dhënë këngëtarëve mundësinë të shfaqnin virtuositetin teknik dhe ekspresivitetin interpretues. Në këtë mënyrë, ai solli freski dhe humor në operat e tij përmes arieve dhe ansambleve dinamike dhe i pasuroi skenat dramatike me një orkestracion madhështor dhe emocione të fuqishme, duke krijuar një urë lidhëse midis traditës operistike klasike dhe asaj romantike. Operat më të njohura të Rosinit janë: *Berberi i Seviljes*, *Semiramida*, *Viliam Tel*, *Hirushja*, *Otello*, *Italiania në Algjeri*, etj.

### Kuriozitet

Një nga anekdotat më të njohura për Rosinin tregon njëkohësisht dembelizmin dhe zgjuarsinë e tij: ndërsa ishte shtrirë në shtrat, një faqe e partiturës i ra në dyshe. Meqë nuk donte të përkulej për ta marrë, në vend të kësaj shkroi menjëherë një arie të re. Kjo tregon se talenti i tij ishte aq i madh, sa edhe "dembelizmin" arrinte ta shndërronte në një kryevepër muzikore.

### Zgjeroni njohuritë

*Berberi i Seviljes* është një nga operat më të njohura të Xhoakino Rosinit dhe një shembull klasik i operës komike. E kompozuar në vitin 1816, ajo tërhoqi menjëherë vëmendjen e publikut me gjallërinë dhe humorin e saj. Libreti bazohet në komedinë e Pjer Bomarshe dhe paraqet zgjuarsinë dhe guximin e shërbëtorit Figaro. Rosini përdori arie dinamike, ansamble dhe skena ritmike argëtuese, të cilat krijojnë një atmosferë të lehtë dhe lozonjare. Gjuha muzikore e operës vë në pah elegancën e stilit belkanto, duke u dhënë këngëtarëve mundësinë të shfaqin aftësitë e tyre vokale. Përmes situatave komike dhe melodive plot gjallëri, ai solli freski dhe humor. Sot, opera *Berberi i Seviljes* është vazhdimisht e pranishme në repertorin e teatrove më të njohura të operës në botë dhe konsiderohet një kryevepër e operës komike.

Opera serioze *Viliam Tel* (1829) u kompozua mbi libretin e frymëzuar nga drama e Fridrih Shilerit. Në këtë vepër, personazhi kryesor është populli dhe jo heroi aristokrat, siç ishte zakoni në operat e kohës. Drama paraqet luftën e zviceranëve për liri dhe guximin e personazhit kryesor, Viliam Telit. Rosini e pasuroi muzikën me një orkestracion madhështor, emocione të fuqishme dhe skena me tension dramatik. Ariet dhe pjesët korale u japin këngëtarëve mundësinë të shfaqin virtuositetin teknik dhe ekspresivitetin, karakteristik për stilin e këndimit belkanto. Orkestra dhe kori jo vetëm që mbështesin dramën, por e bëjnë muzikën të fuqishme dhe mbresëlënëse. Kjo operë pati një rol të rëndësishëm në zhvillimin e operës heroike italiane.




Skenë nga opera *Berberi i Seviljes*



Kostume të krijuara nga Euzhen Du Fazhe për premierën e operës *Viliam Tel* të Rosinit

## Xhuzepe Verdi (1813 – 1901)

Xhuzepe Verdi (ital.: *Giuseppe Verdi*) lindi më 10 tetor të vitit 1813 në fshatin Roncole, Itali. Ai është një nga kompozitorët më të mëdhenj italianë operistik të shekullit XIX. Që në moshë të re tregoi talent të jashtëzakonshëm muzikor. Mësoi pianon, ndërsa më vonë studioi kompozicion në Milano. Tragjeditë e tij personale, si vdekja e bashkëshortes dhe e fëmijëve, ndikuan thellësisht në karakterin emocional dhe dramatik të muzikës së tij. Verdi jetoi në një kohë kur Italia ishte e ndarë në shtete të vogla, ndërsa lufta nacionale për bashkim (“risorxhimento”) e frymëzoi ndërgjegjen e tij artistike dhe patriotike. Krijimtaria e tij operistike karakterizohet nga muzika dramatike, personazhet e forta, trajtimi i psikologjisë njerëzore dhe i konflikteve midis jetës personale dhe rrethanave shoqërore, melodi të spikatura dhe përdorimi i fuqishëm i korit. Ai e përdori muzikën si një mjet të fuqishëm shprehës emocional dhe kombëtar. Të tilla janë operat *Nabuko*, *Rigoletto*, *Trubaduri*, *Traviata*, *Aida*, *Falstaf*, *Otello*, *Ernani*, etj. Verdi vdiq më 27 janar të vitit 1901 në Milano.




Ilustrim i Roberto Fokosit për botimin e parë alternativ të partiturës vokale të operës *Rigoletto*



*Traviata* – partitura për zë dhe piano



Xhuzepe Verdi si dirigjent në premierën e operës *Aida* në Operën e Parisit

### Zgjeroni njohuritë

Në zhvillimin e operës italiane dhanë një kontribut të rëndësishëm edhe Gaetano Donizeti dhe Vinçenco Belini, të cilët, së bashku me Xhoakino Rosinin dhe Xhuzepe Verdin, e formësuan operën italiane të shekullit XIX, duke sjellë ide të reja dramatike dhe muzikore.

- Gaetano Donizeti (1797–1848) kompozoi opera lirike dhe komike, të karakterizuara nga melodi të qarta dhe personazhe të gjalla. Ndër operat e tij më të njohura janë: *Eliksiri i dashurisë*, *Don Paskal* dhe *Lukrecia Borxhia*.
- Vinçenco Belini (1801–1835) njihet për operat e tij lirike, të karakterizuara nga linjat melodike të gjata e të rrjedhshme dhe nga ekspresiviteti dramatik. Ndër operat e tij më të njohura janë: *Norma* dhe *Puritanët*.

### Kuriozitet

Operat e Verdit, veçanërisht *Nabuko*, *Rigoletto*, *Traviata* dhe *Aida*, konsiderohen simbole të nacionalizmit italian. Kori *Va, pensiero* nga opera *Nabuko* u bë simbol i luftës për bashkimin e Italisë. Verdi vetë ishte aktiv edhe në politikë dhe në vitin 1861 u zgjodh deputet në parlamentin e parë italian.

## Kuriozitet

### Kostumografia në operat e Verdit



Skica kostumografike të operave të Verdit

Këto ilustrime paraqesin skica origjinale të kostumeve nga Teatri i operës *La Scala* në Milano, të lidhura me operat e Xhuzepe Verdit.

Në ilustrimin e parë paraqitet një skicë kostumi për personazhin Ernani, nga opera me të njëjtin titull. Skica tregon kostumin skenik të personazhit, me detaje të veshjes, ngjyrave dhe stilit që i përshtaten periudhës historike dhe karakterit dramatik të operës.

Në ilustrimin e dytë paraqitet një skicë kostumi për një personazh nga opera *Don Karlo*, gjithashtu e Verdit. Kostumi është i pasur me elemente dekorative dhe simbolizon një personazh fisnik ose oborrtar, tipik për përmbajtjen historike dhe dramatike të kësaj opere.

Këto skica janë pjesë e trashëgimisë teatrore dhe kulturore të teatrit *La Scala* dhe dëshmojnë rëndësinë e kostumografisë në operë, ku pamja vizuale e personazheve është e lidhur ngushtë me muzikën dhe dramën. Ato janë një shembull i shkëlqyer se opera italiane nuk është vetëm muzikë, por edhe një bashkim i disa arteve – muzikës, teatrit, pikturës dhe modës.

## Aktivitete

### 1. Pyetje për diskutim

- Si u zhvillua opera gjatë shekullit XIX?
- Çfarë paraqet stili *belkanto* dhe cilat janë karakteristikat e tij më të rëndësishme në interpretimin vokal?
- Bëni një hulumtim për të shpjeguar pse *Berberi i Seviljes* konsiderohet një vepër kult e operës komike.
- Cilat janë operat më të njohura të Xhuzepe Verdit dhe cilat janë karakteristikat kryesore të gjuhës së tij muzikore?

## 2. Dëgjoni muzikë nga Rosini, Donizeti dhe Belini

Në linkun e dhënë gjenden të gjithë shembujt muzikorë për dëgjim nga veprat e Rosinit, Donizetit dhe Belinit.

- *Vilijam Tel (Uvertura)* nga Xhoakino Rosini
- *Berberi i Seviljes (Uvertura)* nga Xhoakino Rosini
- *Berberi i Seviljes (Kavatina e Figaros)* nga Xhoakino Rosini
- *Berberi i Seviljes (Kavatina e Rosinës)* nga Xhoakino Rosini
- *Eliksiri i dashurisë* nga Gaetano Donizeti
- *Norma (Casta Diva)* nga Vinçenco Belini



Udhëzime për dëgjim dhe analizë krahasuese

- Çfarë atmosfere krijon muzika? (lirike, dramatike, komike, solemne)
- Kush interpreton? (orkestër/zë). Si janë tempoja dhe dinamika?
- Cilat janë karakteristikat e përbashkëta të kompozimeve dhe në çfarë ndryshon stili i secilit kompozitor?
- Në fund të aktivitetit, përgatitni një analizë të shkurtër me shkrim dhe një prezantim në PowerPoint.

## 3. Dëgjoni kompozimet e Xhuzep Verdit dhe hulumtoni

Në linkun e dhënë gjenden të gjithë shembujt muzikorë për dëgjim nga veprat e Verdit.

- *Aida (Lavdia dhe Marshi triumfal)*
- *Nabuko (Kori i hebrenjve)*
- *Rigoletto (La donna è mobile)*
- *Traviata (Kënga e verës)*
- *Trubaduri (Kori i ciganëve)*



Udhëzime për dëgjim

- ndahuni në grupe;
- secili grup zgjedh një fragment dhe
- hulumton shkurtime: nga cila operë është fragmenti, çfarë paraqet skena dhe kush e interpreton (solist apo kor).

Secili grup përgatit një analizë të shkurtër muzikore dhe përmbajtësore, duke u mbështetur në këto udhëzime:

- si janë tempoja dhe karakteri i kompozimit;
- a lidhet muzika me popullin, dashurinë, heroizmin apo solemnitetin dhe
- cili është roli i orkestrës.

Në fund, përgatitni një prezantim të shkurtër në PowerPoint.

## Opera në Gjermani

Në gjysmën e parë të shekullit XIX, opera në Gjermani u zhvillua në frymën e romantizmit dhe kishte një lidhje të ngushtë me kulturën kombëtare, letërsinë dhe mitologjinë. Ndryshe nga opera italiane, ku mbizotëronin melodia e bukur dhe virtuozyteti vokal, opera gjermane u orientua gjithnjë e më shumë drejt përmbajtjes dramatike, shprehjes orkestrale dhe thellësisë së rrëfimit.

Një rol të rëndësishëm pati tradita e singshpilit – një formë operistike që ndërthur këndimin me dialogët e folur dhe që ishte e afërt me popullin. Temat shpesh merreshin nga legendat popullore, përrallat dhe rrëfimet fantastike, me një karakter të theksuar emocional dhe simbolik. Muzika shërbente për të fuqizuar dramën dhe atmosferën, ndërsa orkestra fitonte gjithnjë e më shumë rëndësi.

Një nga përfaqësuesit më të rëndësishëm të operës romantike gjermane ishte Karl Maria von Weber, opera e të cilit *Gjahtari i lirë* konsiderohet themeli i operës nacionale gjermane. Pikërisht në këtë mjedis u formësuan gradualisht edhe idetë e Rikard Vagnerit, i cili më vonë do ta ndryshonte rrënjësisht artin operistik.

Opera në Gjermani gjatë kësaj periudhe përbënte një pjesë të rëndësishme të jetës kulturore dhe shpirtërore, duke shprehur aspiratën për identitet kombëtar dhe për rrugë të reja artistike.

### Zgjeroni njohuritë

**Karl Maria von Weber** (1786–1826) ishte kompozitor, dirigjent dhe pianist gjerman i periudhës së romantizmit. Ai njihet më së shumti për operën *Gjahtari i lirë* (Der Freischütz), e cila pati një rëndësi të madhe në zhvillimin e operës romantike gjermane. Muzika e tij karakterizohet nga dramatizmi, orkestracioni i pasur dhe shprehja e fuqishme emocionale.



Teatri i Operës në Frankfurt mbi Majn

## Rikard Vagner (1813 – 1883)

Rikard Vagner (gjerm.: *Richard Wagner*) lindi më 22 maj të vitit 1813 në Lajpcig, në Mbretërinë e atëhershme të Saksonisë. Që në rininë e hershme tregoi interes të madh për muzikën dhe teatrin. Shkollimin e tij muzikor e mori në Lajpcig, ku u njoh me veprat e Betovenit dhe me letërsinë gjermane, të cilat ndikuan fuqishëm në zhvillimin e tij artistik. Që herët filloi të merrej me kompozim dhe dirigjim, ndërsa punoi edhe si drejtor muzikor në disa qytete gjermane.

Jeta e tij u karakterizua nga vështirësi financiare, angazhim politik dhe zhvendosje të shpeshta, por edhe nga një vizion i fuqishëm artistik. Vagneri synonte krijimin e “veprës së plotë artistike” (*Gesamtkunstwerk*), në të cilën muzika, poezia dhe skena bashkohen në një tërësi të vetme dramatike. Në historinë e muzikës ai konsiderohet një nga reformatorët më të mëdhenj të operës, e cila, falë tij, mori formën e dramës muzikore. Vagneri vdiq më 13 shkurt të vitit 1883 në Venedik.

### Kuriozitet

#### Një letër që zbulon botën e brendshme të Rikard Vagnerit

Letrat e Vagnerit drejtuar Hajnrih Eserit, mik i tij dhe kritik muzikor, zbulojnë shumë më tepër sesa njoftime të zakonshme – ato janë një dritare e vërtetë drejt mendjes dhe botës së tij shpirtërore. Eser, si kritik me ndikim dhe njohës i muzikës, ishte një person të cilit Vagneri mund t’i drejtohej hapur për idetë, planet dhe sfidat e tij. Ai i shërbeu edhe si këshilltar i besuar dhe ndërmjetës, i aftë të kuptonte dhe të vlerësonte potencialin artistik të Vagnerit.

Kjo letër është një burim i rëndësishëm historik, që na mundëson të kuptojmë më mirë botën e brendshme, përpjekjet dhe vizionin artistik të kompozitorit.



*Richard Wagner*



Letër nga Rikard Vagner për Hajnrih Eser – Paris, 27 shtator të vitit 1859

Vendin qendror në krijimtarinë e Vagnerit e zënë trembëdhjetë operat e tij. Vepra e tij më e rëndësishme është cikli epiko-mitologjik prej katër operash, me titull *Unaza e Nibelungut*, i cili përbëhet nga operat *Ari i Rinit*, *Valkira*, *Siegfried* dhe *Muzgu i perëndive*, si edhe operat *Rienzi*, *Holandezi fluturues*, *Tanhozjer*, *Tristani dhe Izolda*, *Lohengrin* dhe *Parsifal*.

Vagneri ishte gjithashtu një teoricien dhe shkrimtar i shquar i muzikës. Ai shkroi një numër esesh dhe librash, ndër të cilat *Arti dhe revolucioni*, *Opera dhe drama* dhe *Vepra artistike e së ardhmes*, ku i paraqiti idetë e tij për reformimin e operës dhe konceptin e “veprës së plotë artistike”.



Teatri i operës së Vagnerit në Bajrot



Ilustrim nga opera *Unza e Nibelungut* të Rikard Vagner



Skenë nga *Parsifali*



Skenë nga *Tristani dhe Izolda*

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX, Rikard Vagner ndërmori një reformë rrënjësore të operës, me të cilën ndryshoi formën, përmbajtjen dhe funksionin e saj artistik. Elementet më të rëndësishme të kësaj reforme janë:

- Opera si dramë muzikore: opera shndërrohet në një dramë muzikore, ku muzika, teksti dhe veprimi skenik bashkohen në një tërësi të vetme.
- Vepër e plotë artistike (Gesamtkunstwerk): bashkimi i muzikës, poezisë, skenografisë, aktrimit dhe regjisë në një koncept të vetëm artistik.
- Heqja e ndarjes tradicionale: i zhduk kufijtë e qartë ndërmjet aries, recitativit dhe ansamblit, duke krijuar një rrjedhë muzikore të pandërprerë.
- Përdorimi i lajtmotivit: përdor lajtmotive – tema të shkurtra muzikore të lidhura me personazhe, ide ose situata të caktuara, të cilat thellojnë shprehjen dramatike dhe psikologjike.
- Roli i zgjeruar i orkestrës: orkestra nuk është vetëm shoqëruese, por bëhet bartëse aktive e dramës dhe e simbolikës.
- Tema mitologjike dhe filozofike: veprat e tij trajtojnë shpesh mitologjinë gjermane, legjendat dhe ide të thella filozofike.



Faksimil i dorëshkrimit – taktet e fundit të operës *Tristani dhe Izolda* nga Rikard Vagner

### Kuriozitet

#### Si e shndërroi Vagneri operën në një përjetim të plotë

Vagneri ishte aq i përkushtuar ndaj operave të tij, sa projekttoi vetë edhe skenën dhe teatrin ku do të viheshin në skenë veprat e tij. Shembulli më i njohur është Teatri i festivalit të Bajrojtit (Bayreuther Festspielhaus), të cilin e ndërtoi posaçërisht për interpretimin e operave të tij. Aty ai vendosi një gropë të fshehur të orkestrës, që do të thotë se orkestra ndodhet jashtë fushës së shikimit të publikut, në mënyrë që mos ta largojë vëmendjen nga drama që zhvillohet në skenë. Kjo ishte një risi revolucionare për kohën, sepse në teatrot e tjera të operës orkestra ishte gjithmonë e dukshme dhe shpesh mbizotëronte mbi veprimin skenik. Vagneri dëshironte që publiku të përfshihej plotësisht në rrëfimin, muzikën dhe skenën.

## Opera në Francë

Në shekullin XIX, opera franceze u zhvillua në drejtime të ndryshme – nga temat romantike deri te ato historike dhe komike. Skena operistike franceze tregoi një interes të veçantë për realizmin, i cili synonte të paraqiste jetën dhe emocionet e njeriut të zakonshëm.

Kompozitorë si Zhak Ofenbah, Charl Guno dhe Zhorzh Bize e ndoqën këtë prirje përmes operës komike dhe operave me tematikë realiste, duke synuar që muzika dhe libreti të pasqyronin të vërtetën emocionale dhe rrethanat shoqërore e politike. Personazhet ishin të gjallë, natyral dhe të afërt me jetën reale, në vend të heronjve të idealizuar ose figurave mitologjike.

### Zhorzh Bize (1838 – 1875)

Zhorzh Bize (frëngj.: *Georges Bizet*) lindi më 25 tetor të vitit 1838 në Paris, Francë. Që në moshë të re tregoi talent dhe interes të madh për muzikën. Shkollimin e tij muzikor e mori në Konservatorin e Parisit, ku u njoh me veprat e Hektor Berliozit, Charl Gunosë dhe Frederik Shopenit, të cilat ndikuan fuqishëm në zhvillimin e tij artistik.

Bizet filloi herët të merrej me kompozim dhe punoi edhe si pedagog i muzikës. Ai synonte të krijonte një muzikë që pasqyronte emocionet dhe dramën njerëzore. Jeta e tij ishte e shkurtër dhe u shoqërua me probleme shëndetësore dhe sfida profesionale. Ai vdiq më 3 qershor të vitit 1875 në Paris, pak kohë pas premierës së veprës së tij më të njohur, operës *Karmen*, duke lënë një kontribut të madh dhe të qëndrueshëm në operën franceze dhe evropiane.

Krijimtaria e Zhorzh Bize përfshin muzikë dhome, vepra orkestrale, këngë solo dhe baletin Arleziana. Arritja e tij më e madhe janë operat *Doktor Mirakuli*, *Don Prokopio*, *Peshkatarët e perlave*, *Vajza e bukur nga Perti* dhe *Karmen*.



### Kuriozitet

#### Habanera – një sensacion botëror

Kur opera *Karmen* u vu për herë të parë në skenë në Paris, në vitin 1875, ajo u prit me kritika dhe skepticizëm, sepse publiku nuk ishte mësuar të shihte në skenë njerëz të zakonshëm dhe situata reale të jetës, por kryesisht kalorës dhe drama të mëdha. Megjithatë, me kalimin e kohës, *Karmen* u bë një nga operat më të interpretuara dhe më të njohura në botë, ndërsa një nga ariet e saj më të famshme, *Habanera*, fitoi famë ndërkombëtare. (Habanera është një valle me origjinë nga Kuba, e karakterizuar nga ritëm i sinkopuar dhe karakter sensual.)

## Zgjeroni njohuritë



Kostum për Karmenin – dizajn nga Ivon Sasino de Nel

Opera *Karmen* (1875) e Zhorzh Bizës rrëfen historinë tragjike të dashurisë midis Karmenit dhe ushtarit të ri Don Hoze. Përmbajtja e operës paraqet dashurinë konfliktuozë, xhelozinë dhe fatin, duke trajtuar temat e lirisë, pasionit dhe pashmangshmërisë tragjike.

Karmen është një cigane e bukur, një personazh i fortë, një grua e pavarur dhe karizmatike, që nuk pranon të kufizohet nga rregullat e shoqërisë apo nga lidhjet dashurore. Ajo e tërheq dhe ia ndryshon rrjedhën e jetës Don Hozesë, ndërsa liria dhe pasioni i saj çojnë drejt një fundi tragjik.

Muzika e Bize e mbështet këtë dramë përmes:

- melodive të gjalla dhe risive ritmike, veçanërisht në skenat me ciganë dhe në skenat e vallëzimit;
- thellësisë emocionale, ku muzika pasqyron botën psikologjike të personazheve;
- motiveve kombëtare dhe etnike, si ritmet dhe meloditë spanjolle, që theksojnë atmosferën e Andaluzisë dhe
- momenteve lirike dhe dramatike, të cilat e plotësojnë rrëfimin tragjik.

## Aktivitete

### 1. Pyetje për diskutim

- Çfarë nënkupton koncepti Gesamtkunstwerk (vepër e plotë artistike) dhe si e reformoi Wagneri operën përmes këtij koncepti?
- Çfarë është lajtmotivi dhe cili është roli i tij në operat e Wagnerit?
- Pse Rikard Wagner konsiderohet reformator i operës romantike?
- Çfarë nënkupton realizmi në operën franceze të shekullit XIX dhe si pasqyrohet ai në operën *Karmen* të Zhorzh Bize?

### 2. Dëgjoni muzikë nga Karl Maria von Veber, Rikard Wagner dhe Zhorzh Bize

Hulumtoni dhe analizoni fragmentet operistike:

- *Gjahtari i lirë (Kori i gjahtarëve)* nga Karl Maria von Veber
- *Valkira (Fluturimi i valkirave)* nga Rikard Wagner
- *Lohengrin (Marshi i dasmës)* nga Rikard Wagner
- *Karmen (Uvertura)* nga Zhorzh Bize
- *Karmen (Habanera)* nga Zhorzh Bize
- *Karmen (Kënga e toreadorit)* nga Zhorzh Bize
- *Karmen (Vallja boheme nga akti i dytë)* nga Zhorzh Bize - vallja e plotë

Udhëzime për aktivitetin

- Ndahuni në grupe. Secili grup zgjedh një fragment muzikor dhe hulumton shkurtimisht: nga cila operë është fragmenti, çfarë paraqet skena dhe nëse interpretohet nga solist, kor apo vetëm nga instrumente (pa vokal).
- Secili grup përgatit gojarisht një analizë të shkurtër, duke u mbështetur në këto udhëzime: si janë tempot dhe karakteri i muzikës; a lidhet muzika me popullin, dashurinë, heroizmin apo solemnitetin; dhe cili është roli i orkestrës – shoqërues ose udhëheqës, apo ka rol kryesor (kur nuk ka vokal).
- Paraqitni përfundimet tuaja para klasës dhe zhvilloni një diskutim duke krahasuar veprat.



## ROMANTIZMI NË VENDET SLLAVE

Romantizmi në vendet sllave u zhvillua gjatë shekullit XIX, si pjesë e zgjimit më të gjerë kombëtar dhe e përpjekjeve për pavarësi kulturore dhe politike. Në atë periudhë, një pjesë e madhe e popujve sllavë ndodheshin nën sundimin e perandorive të mëdha. Për këtë arsye, u forcua synimi për ruajtjen e gjuhës, traditës dhe memories historike. U shfaqën lëvizje kulturore dhe arsimore që theksonin rolin e popullit si bartës të identitetit dhe të vazhdimësisë historike. Intelektualët, shkrimtarët dhe veprimtarët shoqërorë punuan në mënyrë aktive për kodifikimin e gjuhës, mbledhjen e krijimtarisë gojore popullore dhe afirmimin e vetëdijes kombëtare. Këto procese krijuan një bazë të fuqishme shpirtërore dhe kulturore, mbi të cilën më vonë u formuan edhe shkollat nacionale në fusha të ndryshme të artit.

### Shkollat nacionale

Shkollat nacionale janë drejtime muzikore që theksojnë me vetëdije identitetin kombëtar. Gjatë kësaj periudhe u zgjua interesi për historinë, traditat kulturore dhe artin popullor, ndërsa artistët shpesh morën pjesë edhe në afirmimin historik dhe politik të popullit të tyre.

Krijuesit muzikorë studiuin melosin popullor, vallet, poezinë, epikën dhe përrallat, duke ndërtuar mbi to gjuhën e tyre muzikore nacionale. Meloditë popullore, kërcimet e pazakonshme intervalore, harmonia modale dhe veçoritë ritmike u bënë baza e krijimtarisë së shkollave nacionale. Ngjyra tingëllimore, si element i folklorit, ndikoi në krijimin e strukturave të reja tingullore dhe efekteve orkestrale. Legjendat, e kaluara, zakonet popullore dhe jeta në fshat ishin motive të shpeshta, ndërsa zgjedhja e formave muzikore mundësonte shprehjen sa më të qartë të këtyre temave. Romantizmi muzikor me tipare të theksuara kombëtare arriti zhvillimin e tij më të plotë sidomos te popujt që deri atëherë kishin pasur një rol më të kufizuar në skenën muzikore evropiane.

Lëvizja nacionale e romantizmit muzikor nuk u kufizua vetëm në krijimtarinë kompozicionale. Ajo u shoqërua me një veprimtari të gjerë organizative dhe kulturore: themelimin e shkollave të muzikës, teatrove të operës, orkestrave dhe koreve, mbledhjen dhe përpunimin e melodive dhe valleve popullore, si edhe studimin dhe dokumentimin e historisë muzikore nacionale.

Arti muzikor nacional rus fillon me Mihail Glinkën dhe kompozitorët e “Pesëshes ruse”, të cilët hodhën themelet e stilit nacional rus. Shkolla nacionale çeke përfaqësohet nga Bedzhih Smetana dhe Antonin Dvorzhak, ndërsa ajo polake, mbi të gjitha, nga Frederik Shopen, i cili me krijimtarinë e tij bëri që e gjithë Evropa të njihej me meloditë, ritmet dhe format karakteristike të atdheut të tij.



*Chopin*

### Kuriozitete

Talenti i Shopenit u vlerësua edhe jashtë Polonisë. Kompozitori gjerman Robert Schuman shkroi në revistën e tij: "Hiqni kapelat, zotërinj, para jush qëndron një gjeni!"

Shopeni pati shëndet të brishtë gjatë gjithë jetës, por, megjithatë, krijoi një pasuri të jashtëzakonshme veprash për piano. Ai interpretonte më shpesh në sallone të vogla, sesa në skena të mëdha koncertesh, sepse paraqitjet publike i shkaktonte stres dhe shqetësim.

Shopeni ishte gjithashtu një novator i madh në përdorimin e pedaleve të pianos, duke krijuar efekte tingëllimore me një sonoritet të butë dhe delikat.



Frederik Shopen interpreton para familjes aristokrate polake Radzivil në vitin 1829 (Henryk Siemiradzki)

## Frederik Shopen (1810 – 1849)

Frederik Shopen (pol.: *Fryderyk Franciszek Chopin*, frëngj.: *Frédéric François Chopin*) ishte kompozitori i parë i madh polak, i cili, pa pasur paraardhës të drejtpërdrejtë, solli një frymë të re dhe formë të reja në muzikën pianistike polake dhe evropiane.

Ai lindi më 1 mars të vitit 1810 në fshatin Zhelezova Vola, pranë Varshavës, nga një baba francez dhe nënë polake. Që si fëmijë tregoi një talent të jashtëzakonshëm muzikor dhe që në moshën tetëvjeçare, u shfaq në koncerte publike duke interpretuar vepra të ndërlikuara pianistike. Në fshatin polak u njoh nga afër me jetën popullore, këngët dhe vallet tradicionale. Pikërisht aty dëgjoi polonezën, mazurkën dhe krakoviakun – valle popullore që më vonë i ngriti në një nivel të lartë artistik dhe i bëri simbol të muzikës nacionale polake.

Në moshën njëzetvjeçare u vendos në Paris. Atje u miqësua me artistë të shquar, ndër të cilët edhe me virtuosin Franc List, si dhe me shkrimtaren franceze Zhorzh Sand, me të cilën pati një lidhje të rëndësishme dashurie. Në Francë arriti sukses të madh si pianist dhe kompozitor dhe u bë një nga artistët më të vlerësuar në sallonet artistike evropiane.

Për shkak të punës së lodhshme dhe shëndetit të brishtë, Shopeni u sëmur që herët nga tuberkulozi dhe vdiq në Paris më 17 tetor, vitin 1849, në moshën vetëm 39-vjeçare. Sipas dëshirës së tij, zemra iu dërgua në Varshavë, si simbol i dashurisë së tij të thellë për atdheun.

Shopeni është një nga pianistët dhe kompozitorët më të mëdhenj në historinë e muzikës. Për bukurinë e jashtëzakonshme melodike, harmoninë e pasur e të hollë dhe shprehjen e thellë poetike, ai është quajtur "poeti i pianos". Ai ushtroi një ndikim të madh në zhvillimin e artit pianistik. Përmes muzikës së tij ai shprehu frymën kombëtare të popullit polak dhe e realizoi aspiratën për krijimin e një stili muzikor nacional. Krijimtaria e tij i kushtohet pothuajse tërësisht pianos dhe përfshin rreth dyqind e dyzet kompozime të botuara me numra opusi nga 1 deri në 65, ndërsa një numër i konsiderueshëm u botuan pas vdekjes së tij. Këto kompozime nuk kanë një program të caktuar. Shopeni nuk përdor citime të drejtpërdrejta nga folklori popullor, por krijon muzikë origjinale, e cila për nga fryma, ritmi dhe karakteri është e lidhur ngushtë me traditën popullore polake. Të tilla janë përmbledhjet e *Mazurkave*, *Polonezave*, *Baladave*, *Etydeve*, *Valseve*, *Skercove*, *Nokturneve*, *Impromptuve* dhe *Preludeve*. Shopeni shkroi gjithashtu dy koncerte për piano dhe orkestër, në e - mol dhe f - mol, si edhe sonata, fantazi, rondo dhe vepra të tjera.



Partiturë autographe e kompozitorit polak Frederik Shopen

## Zgjeroni njohuritë

**Etyda koncertale** – me Shopenin, etyda pushon së qeni vetëm një ushtrim teknik dhe ngrihet në një vepër të pavarur koncertale. Edhe pse secila etydë zhvillon një problem të caktuar pianistik (arpezhe, terca, oktava, pasazhe), kompozitori i pasuron ato me një melodikë të thellë, harmoni të pasur dhe shprehje dramatike, duke i shndërruar në miniatura poetike me përmbajtje të fuqishme emocionale dhe në pjesë të rregullta të repertorit të sallave koncertale.

**Mazurka** e ka prejardhjen nga vallja popullore polake, por te Shopeni fiton një dimension artistik dhe poetik. Në vend të një forme të thjeshtë vallëzimi, ajo shndërrohet në një miniaturë intime, të mbushur me thekse ritmike të holla, harmoni të pasur dhe frymë kombëtare. Metri karakteristik tripjesor, me theks në kohën e dytë ose të tretë, i jep tingëllimin e saj të veçantë. Përmes mazurkave, Shopeni shpreh dashurinë dhe nostalgjinë për atdheun.

**Nokturni** është një miniaturë lirike që pasqyron në mënyrë figurative peizazhin e mbrëmjes, me një melodi të këndueshme dhe një bazë të pasur harmonike. Në nokturnet e Shopenit mbizotëron melodia kantabile në dorën e djathtë, e shoqëruar nga një harmoni e butë me arpezhe në dorën e majtë. Këto vepra krijojnë një atmosferë intime dhe poetike dhe renditen ndër krijimet më të dashura të literaturës pianistike.

**Poloneza** është një valle solemne polake në metër tripjesor, e cila te Shopeni merr karakter heroik dhe monumental. Në vend të një muzike oborrtare për vallëzim, ajo shndërrohet në simbol të dinjitetit kombëtar dhe të shpirtit luftarak. Me formulat e fuqishme ritmike, fakturën e gjerë dhe virtuositetin e shkëlqyer, polonezat tingëllojnë si epope pianistike. Veçanërisht dallohen polonezat heroike të periudhës së mesme dhe të vonë të krijimtarisë së tij.

**Balada** është formë instrumentale me karakter narativ dhe dramatik. Edhe pse nuk ka një program konkret, muzika krijon përshtypjen e një historie të mbushur me kontraste dhe kulminacione dramatike. Baladat janë vepra të mëdha koncertale me formë të lirë, harmoni të pasur dhe teknikë virtuozë. Me to, Shopeni krijoi një zhanër të ri në literaturën pianistike romantike.

## Aktivitete

### 1. Pyetje për diskutim

- Si ndikuan ndryshimet politike dhe shoqërore të fundit të shekullit XVIII dhe të gjysmës së parë të shekullit XIX në zhvillimin e shkollave muzikore nacionale?
- Në ç'mënyrë Frederik Shopen e integroi melosin popullor polak në muzikën e tij pianistike dhe pse krijimtaria e tij konsiderohet përfaqësuese e muzikës nacionale polake?

### 2. Aktivitet hulumtues përmes dëgjimit të kompozimeve të Frederik Shopen

*Vals op. 64, nr. 1, Vals op. 64, nr. 2, Nokturni op. 9, nr. 2, Poloneza në As - dur, op. 53, Sonata nr. 2 Marshi funeral, Fantazi-Impromptu në cis - mol, op. 66, Etydi revolucionar*

Udhëzime për aktivitetin:

- Përmes linkut të dhënë dëgjoni kompozimet e përmendura të Frederik Shopen dhe përcaktoni me kujdes karakterin, tempin dhe dinamikën e tyre.
- Gjatë dëgjimit, përpikuni të dalloni formën muzikore (vals, nokturn, polonezë, sonatë, fantazi-impromptu ose etydë) dhe mendoni se në çfarë dallon secila prej tyre.
- Për secilën vepër shkruani disa fjali, në të cilat do të përshkruani tempin, dinamikën dhe karakterin e saj (i butë, dramatik, heroik, lirik).
- Përgatitni gojarisht një prezantim të shkurtër, duke shpjeguar se cili kompozim ju la më shumë përshtypje gjatë dëgjimit.





*M. Glinka*

## Mihail Ivanoviç Glinka (1804 – 1857)

Mihail Ivanoviç Glinka (rus.: *Михаи́л Ива́нович Гли́нка*) lindi më 1 qershor të vitit 1804 në Novospask, Rusi dhe vdiq më 15 shkurt të vitit 1857 në Berlin, Gjermani. Ai mban epitetin “babai i muzikës klasike ruse” dhe ishte kompozitori i parë rus që synoi me vetëdije të krijonte një muzikë artistike autentike ruse. Me operat *Ivan Susanjin* dhe *Rusllani dhe Ludmilla*, ai hodhi themelet e dy drejtimeve në të cilat u zhvillua opera ruse gjatë shekullit XIX: opera heroiko-historike me karakter epik dhe opera-përrallë, e pasur me elemente legjendare dhe fantastike të folklorit.

Opera *Ivan Susanin* (me titullin fillestar *Jeta për Carin*, 1836) është një operë heroiko-historike, e bazuar në një ngjarje të vërtetë historike për fshatarin Ivan Susanin, i cili sakrifikoji jetën e tij për të shpëtuar carin rus. Muzika ndërthur format operistike të Evropës Perëndimore me meloditë popullore ruse, koralet dhe motivet patriotike. Në këtë vepër dallohen skenat madhështore korale dhe kulmet dramatike, të cilat krijojnë një atmosferë solemne dhe monumentale. Edhe pse aristokracia e quajti “muzikë qerrexhinjsh”, opera u bë model i operës historike ruse dhe ndikoi në krijimtarinë e kompozitorëve rusë.

Opera *Rusllani dhe Ludmilla* (1842) është frymëzuar nga poema me të njëjtin titull e A. S. Pushkinin dhe paraqet një rrëfim fantastik me heronj, keqbërës dhe ngjarje magjike. Vepra karakterizohet nga orkestracioni shumëngjyrësh, linjat virtuoze pianistike dhe vokale, si edhe nga skenat spektakolare të baletit. Motivet popullore dhe figurat ritmike i japin muzikës frymën ruse, ndërsa dinamika dramatike dhe elementet fantastike e bënë këtë vepër themel për zhvillimin e operave fantastike dhe përrallore në Rusi.



Glinka gjatë kohës së kompozimit të operës *Rusllani dhe Ludmilla*

### Pesëshja ruse

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX, kultura muzikore ruse përjetoi një zhvillim të fuqishëm. U themeluan konservatorët e muzikës në Shën Petersburg dhe Moskë, duke krijuar kushte për një arsimim muzikor sistematik. Krahas drejtimit akademik, u shfaq edhe një lëvizje që synonte krijimin e një muzike autentike nacionale ruse.

Në mesin e shekullit, rreth kompozitorit Mili Balakirev u mbledh një grup krijuesish të rinj: Cezar Kyi, Modest Musorgski, Nikolai Rimski-Korsakov dhe Aleksandër Borodin. Jashtë kufijve të Rusisë, ata u bënë të njohur si “Pesëshja ruse”. Qëllimi i tyre kryesor ishte krijimi i një kulture muzikore origjinale ruse, të mbështetur në krijimtarinë popullore, historinë dhe jetën shpirtërore të popullit rus. Ata e vazhduan traditën e Mihail Glinkës, por synuan të sillnin më shumë origjinalitet, liri krijuese dhe ngjyrim kombëtar në shprehjen muzikore. Është interesante se shumica e anëtarëve të Pesëshes ruse, në fillimet e tyre, nuk kishin shkollim formal muzikor.



Skicë nga skenografia e Ivan Bilibin për operën *Rusllani dhe Ludmilla*

Megjithëse jo të gjithë ishin muzikantë të shkolluar profesionalisht, ata u dalluan për individualitetin e tyre të fuqishëm krijues dhe përkushtimin ndaj artit kombëtar dhe identitetit kulturor. Pesëshja ruse hodhi themelet e shkollës nacionale muzikore ruse dhe kontribuoi në krijimin e një stili të ri e të dallueshëm muzikor rus.

### Zgjeroni njohuritë



#### Mili Balakirev (1837–1910)

Mili Balakirev (rus.: Милий Алексеевич Балакирев) ishte kompozitor dhe pianist autodidakt, por më vonë fitoi përvojë të konsiderueshme muzikore dhe u bë udhëheqësi shpirtëror i grupit. Ai është autor i poemës simfonike *Tamara* dhe i fantazisë pianistike me ngjyime orientale *Islamej*.

#### Cezar Kyi (1835–1918)

Cezar Kyi (rus.: Цезарь Антонович Кюи) ishte me profesion inxhinier ushtarak dhe profesor i fortifikimit, ndërsa muzikën e studioi paralelisht me karrierën e tij ushtarake. Ai kompozoi opera, këngë solo dhe muzikë dhome. Ndër veprat e tij më të rëndësishme janë opera *Viliam Ratklif* dhe një numër i madh romansash.



#### Modest Musorgski (1839–1881)

Modest Musorgski (rus.: Модест Петрович Мусоргский) u shkollua në një akademi ushtarake dhe për një periudhë shërbeu në ushtri. Muzikën e zhvilloi në mënyrë autodidakte, duke u dalluar për talentin e tij të jashtëzakonshëm krijues dhe shprehjen e thellë artistike. Meloditë e tij tërheqin me thjeshtësinë, natyrshmërinë dhe bukurinë e tyre të fuqishme emocionale. Ai është autor i operës *Boris Godunov*, i skicës simfonike *Natë në malin e zhveshur* dhe i ciklit pianistik *Tablo nga ekspozita*.

#### Nikolai Rimski-Korsakov (1844–1908)

Nikolai Rimski-Korsakov (rus.: Николай Андреевич Римский-Корсаков) ishte oficer i marinës; më vonë iu përkushtua muzikës dhe u bë profesor në Konservatorin e Shën Petersburgut. Ai njihet për mjeshtërinë e jashtëzakonshme në orkestracion dhe për veprat *Sheherazada*, *Kapriço spanjolle*, si dhe për operat *Sneguročka* dhe *Gjeli i artë*. Si një mjeshtër i shquar i përpunimeve instrumentale, ai përfundoi dhe orkestroi edhe kompozime të disa anëtarëve të tjerë të Pesëshes ruse.



#### Aleksandër Borodin (1833–1887)

Aleksandër Borodin (rus.: Александр Порфирьевич Бородин), kimist i shquar dhe profesor universitar, është autor i operës *Princi Igor* (me Vallet poloveciane të njohura) dhe i dy simfonive me karakter të theksuar nacional.

**Simfonia nacionale** është një vepër simfonike në të cilën kompozitorët përfshijnë me vetëdije melodi folklorike sllave, ritme, tema historike dhe motive kombëtare, me qëllim që të shprehin identitetin kulturor dhe kombëtar.

## Aktivitete

### 1. Pyetje për diskutim

- Pse Mihail Ivanoviç Glinka konsiderohet babai i muzikës klasike ruse?
- Cilat janë karakteristikat kryesore të operave *Ivan Susanjin* dhe *Rusllani dhe Ludmilla* dhe në ç'drejtim e orientuan ato zhvillimin e operës ruse?
- Cilët kompozitorë përbënin grupin e njohur si *Pesëshja ruse*?
- Cili ishte qëllimi kryesor i *Pesëshes ruse* dhe si e vazhduan ata traditën e Mihail Glinkës?

### 2. Dëgjoni kompozime nga kompozitorët e shkollës nacionale ruse



Përmes linkut të dhënë dëgjoni kompozimet e përzgjedhura të përfaqësuesve të Shkollës nacionale ruse.

Udhëzime për aktivitetin

Gjatë dëgjimit, kushtoni vëmendje këtyre elementeve:

- a është vepra orkestrale apo e muzikës së dhomës;
- a ka karakter vallëzues;
- a është pjesë e një opere, e një suite simfonike apo një kompozim i pavarur;
- çfarë karakteri ka (heroik, oriental, dramatik, solemn);
- si është dinamika (kontraste të forta, zhvillim gradual) dhe
- a dallohen elemente të muzikës popullore.

Detyrë

- Shprehni mendimin tuaj se cila nga kompozimet e dëgjuara ju la përshtypjen më të madhe dhe shpjegoni arsyen.

## Petar Iliç Çajkovski (1840 – 1893)

Petar Iliç Çajkovski (rus.: *Пётр Ильич Чайковский*) është një nga kompozitorët më të njohur rusë të epokës së romantizmit. Lindi më 7 maj të vitit 1840 në Votkinsk. Ai u shfaq në skenën muzikore ruse në të njëjtën kohë me kompozitorët e Pesëseshes ruse, por nuk ishte anëtar i këtij grupi. Stili i tij pasqyron ndarjen e inteligjencës ruse mes “perëndimorëve” dhe “sllavofilëve”, pasi ai synonte të krijonte një muzikë autentike ruse mbi standardet e muzikës evropiane. Edhe pse talentin muzikor e shfaqti që në fëmijëri, si bir i nëpunësve shtetërorë, fillimisht ndoqi të njëjtën rrugë profesionale. Megjithatë, në vitin 1862, me hapjen e Konservatorit të parë në Shën Petersburg, Çajkovski mori vendimin përfundimtar t’ia kushtonte jetën muzikës dhe u bë një nga studentët e parë të Konservatorit. Më vonë ai u emërua profesor në Konservatorin e Moskës. Jeta e tij u zhvillua shpesh midis Rusisë dhe Evropës. Ai gëzonte vlerësim dhe popullaritet kudo, ndërsa turnetë e tij triumfuese i siguruan statusin e një ylli me famë botërore (pati edhe nderin të dirigjonte në ceremoninë e hapjes së Karnegi holl, në Nju Jork, SHBA). Çajkovski vdiq më 6 nëntor të vitit 1893 në Shën Petersburg, nga kolera, vetëm pak ditë pasi kishte dirigjuar premierën e *Simfonisë patetike*.

Çajkovski kompozoi në gjini të ndryshme muzikore: simfoni, opera, baletë, muzikë dhomë, vepra fetare dhe koncerte për piano e violinë. Ai është veçanërisht i njohur për baletet e tij, të cilat fituan famë botërore: *Liqeni i Mjellmave*, *Bukuroshja e Fjetur* dhe *Arrëthyesi*. Ndër operat e tij, një vend të veçantë zënë *Eugen Onjegin* dhe *Dama pik*. Ai është autor i gjashtë simfonive, ndërsa Simfonitë nr. 4, 5 dhe 6 (*Patetike*) renditen ndër veprat e tij më të njohura dhe shprehin gamën e pasur emocionale të ndjenjave njerëzore. Një vend të rëndësishëm në krijimtarinë e tij zënë edhe Koncerti nr. 1 për piano dhe orkestër në b - mol, Koncerti për violinë dhe orkestër në D - dur, si edhe uvertura-fantazi *Romeo dhe Zhulieta* dhe uvertura solemne *Viti 1812*.

Petar Iliç Çajkovski është një kompozitor që i tejkaloi kufijtë e muzikës nacionale dhe la një gjurmë të përhershme në artin muzikor botëror.



*P. Tchaikovsky*

### Kuriozitet

#### Nga historia e Liqenit të mjellmave

Edhe pse sot *Liqeni i mjellmave* është një nga baletet më të njohura në botë, premiera e tij në vitin 1877 nuk pati sukses. Publiku dhe kritika, fillimisht, nuk u entuziazmuan nga muzika dhe koreografia. Vetëm pas vdekjes së Çajkovskit, me vënien e re në skenë në vitin 1895, vepra u shndërrua në një sukses botëror. Kjo tregon se ndonjëherë vlera e vërtetë e një veprë arti njihet me vonë.



Skenë nga baleti *Liqeni i mjellmave*

## Kuriozitet

### 1200 letra pa u takuar kurrë

Nga krijimtaria e Çajkovskit ishte e mahnitur Nadezhda von Mek, një grua e pasur dhe adhuruese e madhe e artit muzikor. Ajo i vinte në dispozicion kompozitorit një mbështetje vjetore prej gjashtë mijë rublash, megjithëse ata nuk u takuan kurrë personalisht. Lidhja e vetme mes tyre ishte korrespondenca, ndërsa miqësia e tyre shpirtërore i ofronte kompozitorit mbështetje morale. Ata shkëmbyen rreth një mijë e dyqind letra, të cilat janë ruajtur deri më sot. Çajkovski ia kushtoi asaj Simfoninë e pestë, baletin *Bukuroshja e fjetur* dhe operën *Eugen Onjegin*.



Nadezhda von Mek

## Aktivitete

### 1. Hulumtoni dhe diskutoni

- Në ç'mënyrë stili i Çajkovskit e ndërthur traditën kombëtare ruse me standardet e muzikës evropiane?
- Pse baletet e Çajkovskit konsiderohen kryevepra të literaturës muzikore botërore?
- Si e shprehin Simfonitë nr. 4, 5 dhe 6 (*Patetike*) të Çajkovskit gamën e pasur emocionale dhe dramatikën e brendshme të njeriut?

### 2. Dëgjoni kompozime nga Petar Iliç Çajkovski



Përmes linkut të dhënë dëgjoni kompozimet e Petar Iliç Çajkovskit dhe ndiqni me kujdes zhvillimin e tyre muzikor, karakterin dhe orkestracionin. Pas dëgjimit, përgjigjuni me shkrim ose diskutoni për pyetjet e mëposhtme që lidhen me muzikën e tij:

- Cilat emocione i shpreh më së shumti muzika e Petar Iliç Çajkovskit?
- Me çfarë dallohet muzika e baletit nga simfonia ose koncerti?
- A vërehen në veprat e tij dramatizëm dhe kontraste të forta dinamike?
- Cili është roli i orkestrës – a krijon ajo përshkrim figurativ dhe përmbajtje programatike?
- Ku ndihet lirizmi, e ku tragjikja?
- Përcaktoni nëse muzika ka përmbajtje programatike.

## Bedzhih Smetana (1824 – 1884)

Bedzhih Smetana (çek.: *Bedřich Smetana*) lindi më 2 mars të vitit 1824 në Litomishl, Çeki dhe vdiq më 12 maj të vitit 1884 në Pragë. Që në fëmijëri tregoi talent të madh muzikor dhe filloi herët të mësonte piano dhe kompozicion. Në rininë e tij u ndikua nga krijimtaria e Franc List. Për një periudhë jetoi dhe punoi në Suedi, ku fitoi përvojë të rëndësishme si pianist, dirigjent dhe pedagog. Pas kthimit në Pragë, u angazhua aktivisht në jetën kulturore dhe iu përkushtua zhvillimit të muzikës nacionale çeke. Në vitin 1874 e humbi plotësisht dëgjimin, por, megjithatë, vazhdoi të kompozonte.

Smetana konsiderohet “babai i muzikës nacionale çeke”. Ai ishte i pari që arriti të krijojë një muzikë artistike që shpreh qartë frymën kombëtare të popullit çek. E gjithë krijimtaria e Bedzhih Smetanës përfaqëson një sintezë të elementeve kombëtare dhe të elementeve muzikore evropiane të kohës, duke bashkuar shprehjen popullore me atë artistike. Smetana krijoi në disa gjini muzikore, por ai është krijuesi dhe përfaqësuesi më i rëndësishëm i poemës simfonike nacionale çeke dhe themeluesi i operës nacionale çeke.

Në ciklin *Atdheu im*, të përbërë nga gjashtë poema simfonike, ai lidhi muzikën programatike me historinë kombëtare dhe natyrën, duke paraqitur muzikalisht lumin Vltava, kështjellat e lashta, heronjtë mitikë dhe të kaluarën e lavdishme të atdheut të tij.

Vepra e tij më e njohur operistike, opera komike *Nusja e shitur*, konsiderohet themeli i operës nacionale çeke dhe dallohet për elementet e pasura popullore dhe motivet folklorike çeke.





Bedzhih Smetana në mesin e miqëve të tij  
në vitin 1865  
(pikturuar nga Frantishek Dvorzhak)

### Kuriozitet

#### Bedzhih Smetana dhe poema simfonike Vltava nga cikli Atdheu im

Melodia e *Vltavës*, në të vërtetë, ndjek rrjedhën e lumit: fillon me rrjedhën e qetë të dy burimeve, më pas lumi bashkohet dhe përshkon peizazhe pyjore, kalon pranë skenave të gjuetisë dhe fshatrave, për të mbërritur në fund në qytetin madhështor të Pragës. Smetana arriti ta “pikturojë” muzikalisht udhëtimin e lumit, nga burimi deri në derdhjen e tij. Ky kompozim është simbol i natyrës dhe kulturës çeke, ndërsa Smetana e kompozoi atë edhe pse në atë kohë e kishte humbur plotësisht dëgjimin.



Faqja e parë e partiturës autografe të  
Kuartetit të dytë harkor të Smetanës

# Vltava

## Analizë me hartë figurative

Sa ka arritur Smetana që përmes muzikës të na e paraqesë Vltavën dhe peizazhet nëpër të cilat rrjedh ajo, do ta shohim.

Më poshtë vijon përshkrimi i kompozimit sipas pjesëve. Lexoni me kujdes. Pastaj kaloni në dëgjimin e shembujve muzikorë. Përpikuni që, me ndihmën e përshkrimit dhe të vetë muzikës, të dalloni se cilit përshkrim i përket secili nga shembujt muzikorë.



### Burimet

Një përrua i vogël buron përmes pyllit, i paraqitur me tingujt e butë të flautit. Nga ana tjetër shfaqet një burim i ftohtë dhe i errët, i përshkruar përmes tingullit të klarinetës. Të dy rrjedhat depërtojnë gradualisht nëpër peizazhin pyjor, derisa më në fund bashkohen në një lumë të vetëm. Muzika lëviz me vlera të vogla notash dhe me tempo të shpejtë. Motivet janë të ngjashme dhe përmes përsëritjes së tyre, krijohet ndjesia se të dy burimet po afrohen gjithnjë e më shumë me njëri-tjetrin.



### Lumi

Lumi Vltava rrjedh gjallërisht, i mbushur me valë, duke u zgjeruar ndërsa kalon nëpër fusha dhe livadhe të gjelbra. Linja melodike krijon ndjesinë sikur dëgjuesi po lundron mbi rrjedhën e tij – e gjerë, e këndueshme dhe madhështore. Orkestra tingëllon e plotë dhe e pasur, me një theksim subtil të violinave, të cilave më pas u bashkohen oboa dhe fagoti, duke pasuruar më tej tablonë tingullimore.

### Gjuetia

Rrjedha e Vltavës kalon nëpër peizazhe pyjore, ku jehojnë tingujt e kornos, duke paralajmëruar fillimin e një gjuetie solemne. Ky instrument frymor prej tunxhi thekson ritmin karakteristik të thirrjes së gjuetisë, i shoqëruar nga timpanët. Atmosfera e gjuetisë përshkruhet përmes përsëritjes së të njëjtave lartësi tingujsh në një skemë ritmike që të kujton ritmin e marshimit.



### Dasma

Nga livadhet e lulëzuara dhe të gjelbra jehojnë tingujt të gjallë dhe plot hare. Ndihet një atmosferë festive – po zhvillohet një dasmë. Nën tingujt e polkës, valle tradicionale çeke, të pranishmit vallëzojnë me gëzim dhe gjallëri. Melodia është shkruar në metrin 2/4, me karakter të lehtë, të gjallë dhe lozonjar.



### Praga

Në rrugën e saj drejt Pragës, Vltava kalon pranë Vishegradit, si një përshëndetje muzikore drejtuar qytetit të lashtë. Tema merr karakter solemn dhe të madhërishtë, me motive fanfaresh të interpretuara nga trombat, si një nderim për sundimtarët e vjetër çekë. Plotësia tingullore përforcohet nga çinelat, të cilat sjellin shkëlqim dhe forcë. Më pas energjinë e marrin violinat me tingullin e tyre të ndritshëm, ndërsa lumi i gjerë dhe dinjitoz gradualisht humbet në largësi.

### Ujëvarat

Lumi zbret përgjatë shpateve të pjerrëta malore, ku valët përplasen pas shkëmbinjve, duke krijuar rrëqe të vullshme dhe ujëvara. Muzika merr një karakter dramatik dhe të tensionuar. Përshtypja e fuqishme ndërtohet përmes përdorimit të theksuar të instrumenteve frymore prej tunxhi dhe instrumenteve me goditje. Në fund, lumi depërton me forcë përmes masiveve malore dhe vazhdon rrugën e tij.

### Zanat e ujit

Në qetësinë e natës, përgjatë brigjeve të Vltavës, zanat e ujit vallëzojnë qetësisht nën dritën e hënës. Dëgjohet një melodi e butë dhe qetësuese, e ngjashme me një ninullë, e interpretuar nga violinat. Ndjehet fladi i lehtë i erës që krijon valë të qeta, shkëlqimi i dritës së hënës mbi sipërfaqen e ujit dhe siluetat e zanave.



*Antonín Dvořák*

## Antonín Dvořák (1841 – 1904)


Antonín Dvořák (çek.: *Antonín Dvořák*) lindi më 8 shtator të vitit 1841, në afërsi të Pragës. Ai është një nga kompozitorët më të shquar çekë të shekullit XIX, i cili vazhdoi rrugën e muzikës nacionale çeke të nisur nga Bedžih Smetana, duke sjellë në veprat e tij një pasuri elementesh folklorike dhe një frymëzim të fuqishëm melodik. Talenti i tij u vlerësua nga kompozitori gjerman Johanes Brams, i cili e ndihmoi të fitonte famë ndërkombëtare. Nga viti 1892 deri në vitin 1895 qëndroi në SHBA, ku ishte drejtor i Konservatorit Kombëtar në Nju Jork. Gjatë kësaj periudhe e kompozoi simfoninë e njohur *Nga bota e re*. Vdiq më 1 maj, në vitin 1904 në Pragë.

Me krijimtarinë e tij, Dvořaku kontriboi në afirmimin e kulturës dhe muzikës sllave në skenën evropiane. Ai krijoi në disa gjini muzikore, ndërsa veprat e tij më të njohura janë: simfonia nr. 9 *Nga bota e re*, op. 46 dhe op. 72 – dy përmbledhje me nga tetë *Valle sllave* për piano me katër duar dhe orkestër (të frymëzuara nga folklori sllav), Koncerti për violonçel dhe orkestër në h - mol dhe kryevepra e tij – opera *Rusalka*.



Temë nga opera *Rusalka*

### Kuriozitete



Faqja hyrëse e partiturës autografe të Simfonisë së nëntë *Nga bota e re*

Dvořaku ishte një adhurues i madh i muzikës popullore çeke dhe shpesh përdorte motive e ritme të këngëve popullore në simfonitë dhe veprat e tij të muzikës së dhomës. Megjithatë, pak njerëz e dinë se ai ishte aq i frymëzuar nga muzika popullore, sa që në kohën e tij u quajt "kompozitori i frymës popullore".

Kur ishte drejtor i Konservatorit Kombëtar në Nju Jork (1892–1895), ai i inkurajonte kompozitorët amerikanë të përdornin motive afroamerikane dhe të popujve autoktonë amerikanë (indianëve). Ky qëndrim u pasqyrua edhe në simfoninë *Nga bota e re*.

## Aktivitetet

### 1. Hulumtoni dhe diskutoni

- Pse Bedzhih Smetana konsiderohet “babai” i muzikës nacionale çeke dhe cila është rëndësia e ciklit *Atdheu im*?
- Cila është rëndësia e operës *Nusja e shitur* në zhvillimin e operës nacionale çeke?
- Cila vepër e Antonín Dvorzhakut u krijua gjatë qëndrimit të tij në SHBA dhe si ndikoi ajo në famën e tij botërore?

### 2. Dëgjoni kompozime nga kompozitorët e shkollës nacionale çeke



Në linkun e dhënë dëgjoni kompozimet e Bedzhih Smetanës dhe Antonin Dvorzhakut.

Pas dëgjimit të kompozimeve, përgjigjuni në pyetjet e mëposhtme:

- Përcaktoni se cilit zhanër i përket secila vepër: poemë simfonike, operë, valle, simfoni ose miniaturë për piano solo.
- Mendoni se si muzika në *Vltava* paraqet rrjedhën e lumit dhe skenat natyrore. Cilat instrumente krijojnë ndjesinë e lëvizjes?
- Te *Furiant* dhe *Vallja sllave*, kushtoni vëmendje ritmit dhe karakterit popullor. A ndihet energjia e valles dhe fryma nacionale?
- Në kohën e IV të Simfonisë nr. 9, analizoni dramatizmin dhe fuqinë orkestrale. Si ndërtohet kulminacioni?
- Në *Këngën e hënës*, përshkruani lirizmin dhe shprehjen vokale. Çfarë atmosfere krijon orkestra?
- Në *Humoreska* nr. 7, vëreni melodikën dhe karakterin e lehtë, të këndueshëm.

Plotësoni përgjigjet me elemente konkrete muzikore: tempo, dinamikë, ritëm, orkestracion dhe shprehje emocionale.



## MUZIKA NË SHEKULLIN XX

Muzika e shekullit XX karakterizohet nga një larmi e paparë, ndryshime të mëdha, eksperimentim dhe zhvillim i teknologjisë, me theks të veçantë në individualizmin dhe hulumtimin e tingujve dhe formave të reja. Ajo i kapërcen kufijtë tradicionalë të epokave të mëparshme, ndërsa kompozitorët eksplorojnë mënyra të reja shprehjeje përmes melodisë, ritmit, harmonisë, instrumentacionit dhe formave muzikore. Simfonia, poema simfonike, uvertura, koncerti dhe sonata vazhdojnë të kompozohen, por në mënyrë më fleksibile dhe më novatore. Muzika instrumentale merr një rol më të theksuar se muzika vokale, ndërsa përdoren më shpesh ansamble më të vogla dhe instrumente frymore. Harmonia pëson ndryshime të rëndësishme, të nxitura nga atonaliteti, politonaliteti dhe dodekafonia. Edhe ritmi dhe metrika fitojnë liri të reja, me ndryshime të shpeshta të metrit dhe me zhvillimin e poliritmisë. Në vend të një stili të vetëm dominues, gjatë kësaj periudhe zhvillohen drejtime të ndryshme artistike, si impresionizmi, ekspresionizmi, neofolklorizmi, neoklasicismi, neoromantizmi dhe muzika elektronike. Në muzikën e shekullit XX shfaqet gjithashtu avangarda (nga frëngjishtja *avant-garde*, që do të thotë “pararojë”). Ky term u referohet krijuesve ose veprave novatore, që eksperimentojnë dhe sjellin qasje të reja në fushën e tyre të veprimit. Avangarda sfidon normat mbizotëruese dhe thyen kufijtë tradicionalë të kulturës dhe artit. Në muzikë, ajo përfshin vepra që dalin jashtë strukturave klasike ose kompozitorë që dallohen rrënjësisht nga tradita e mëparshme.

Muzika bashkëkohore e shekullit XX shfaq dy prirje kryesore: njëra vë theksin te përmbajtja e ideve muzikore, duke pasqyruar marrëdhëniet ndërmjet individit dhe popujve, ndërsa tjetra e shndërron muzikën në një fushë kërkimi të pastër tingullor dhe ritmik. Në të dyja rastet, krijimtaria e kompozitorëve dëshmon rrugët dhe liritë e reja të shprehjes muzikore. Ndryshojnë instrumentariumi, format muzikore dhe mënyra e trajtimit të temës, ndërsa mendimi muzikor bëhet më fleksibël dhe më novator se kurrë më parë.



*Impression, lindja e diellit*  
nga Klod Mone

### Impresionizmi

Impresionizmi muzikor shfaqet nga fundi i shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, fillimisht në Francë. Termi vjen nga piktura, veçanërisht nga vepra *Impression, lindja e diellit* (*Impression, soleil levant*) e Klod Mone.

Në muzikë, ky drejtim paraqet një reagim kundër dramatismi të fuqishëm dhe peshës së romantizmit. Në vend të emocionit të theksuar dhe tingullit masiv, kompozitorët synojnë të krijojnë përshtypje, atmosferë dhe ngjyrë tingëllimore. Në impresionizëm, orkestracioni është i butë, transparent dhe koloristik. Instrumentet krijojnë

pamje tingëllimore, si p.sh. uji, mjegulla, era dhe natyra. Në planin harmonik përdoren shkallë me tone të plota, shkallë ekzotike, shkallë pentatonike, shkallë modale, akorde paralele dhe disonanca pa zgjidhje klasike. Meloditë janë të fragmentizuara dhe ndonjëherë të renditura si “mozaik”. Format janë të shkurtra, si miniaturat pianistike dhe këngët solo, ndërsa programatizmi është i shpeshtë – muzika pikturon skena ose momente të jashtme. Impresionizmi sjell subjektivizëm, individualitet dhe një stil tipik francez. Kompozitorët më të rëndësishëm të këtij stili janë Klod Debysi dhe Moris Ravel.

## Klod Debysi (1862 – 1918)

Klod Debysi (frëngj.: *Claude Debussy*) është kompozitor francez dhe një nga përfaqësuesit kryesorë të impresionizmit muzikor. Ai lindi më 22 gusht të vitit 1862 në San Zhermen an Le dhe vdiq më 25 mars të vitit 1918 në Paris.

Studioi në Konservatorin e Parisit, ku u dallua si pianist dhe kompozitor. Ishte pjesë e rrethit muzikor francez të fundit të shekullit XIX dhe u ndikua fuqimisht nga arti impresionist, megjithëse vetë shpesh e refuzonte këtë emërtim. Familja e tij nuk ishte e pasur dhe ai kaloi një jetë të mbushur me sfida profesionale, udhëtime dhe lidhje dashurie, duke iu përkushtuar vazhdimisht zhvillimit të gjuhës së tij unike muzikore.

Krijimtaria e Klod Debysi karakterizohet nga risi të mëdha në harmoni, ritëm dhe teksturë. Ai përdorte shpesh shkallët pentatonike dhe shkallët me tone të plota, të cilat krijojnë një tingull të pazakontë dhe “ekzotik”, në krahasim me harmoninë klasike tonale. Debysi shmangte format klasike, si sonata dhe simfonia, në kuptimin e tyre tradicional, duke parapëlqyer vepra të shkurtra poetike dhe programatike.

Krijimtaria e Debysi përfshin fusha të ndryshme, si kompozime instrumentale dhe vokalo-instrumentale. Në grupin e parë bëjnë pjesë veprat për piano: *Dy arabeska*, *Suita bergameze*, *Impresione*, *Imazhe*, *Këndi i fëmijëve*, *Preludet*, *Suita e vogël për piano me katër duar* (e interpretuar më së shpeshti në transkriptim për orkestër), *E bardha dhe e zeza* për dy piano etj. Nga veprat orkestrale, vend të rëndësishëm zënë *Pasditja e një fauni*, *Deti*, *Tre nocturne* etj., ndërsa nga kompozimet për zë dhe piano, më të njohurat janë ciklet *Arie të harruara*, *Pjesë lirike* etj. Ai ka shkruar gjithashtu një kantatë, dy balete dhe operën *Peleasi dhe Melisanda*.




### Kuriozitete

Debysi e donte shumë vajzën e tij, Klod - Ema, të cilën e thërrisnin Shushu. Për të ai shkroi suitën pianistike *Këndi i fëmijëve* (Children's Corner), të mbushur me tablo muzikore nga bota e fëmijëve.

Kompozimi i famshëm për piano *Drita e hënës* (Clair de Lune) e Debysi është një nga veprat pianistike më të interpretuara në botë dhe përdoret shpesh në filma dhe seriale televizive.

Dorëshkrim autograf i veprës së Klod Debysi



## Moris Ravel (1875 – 1937)

Moris Ravel (frëngj.: *Maurice Ravel*) lindi më 7 mars të vitit 1875 në Sibur (Francë) dhe vdiq më 28 dhjetor të vitit 1937 në Paris. Ai ishte i lidhur ngushtë me muzikën që në fëmijërinë e hershme. Studioi në Konservatorin e Parisit, ku u dallua si pianist dhe kompozitor. Shpesh është lidhur me impresionizmin, por stili i tij karakterizohet nga një ndërtim më i qartë formal, forma të mirëpërcaktuara dhe një orkestracion të jashtëzakonshëm. Pas Luftës së Parë Botërore vazhdoi të krijonte dhe të udhëtonte, duke fituar famë ndërkombëtare.

Krijimtaria e Moris Ravelit karakterizohet për formën e qartë, orkestracionin e rafinuar dhe koloritin e pasur tingëllimor. Ai ndërthurte strukturën klasike me zgjidhje moderne harmonike, duke përdorur shpesh shkallë modale, ritme spanjolle dhe elemente të xhazit. Muzika e tij është teknikisht e saktë, me linja melodike të modeluara me kujdes dhe qartësi ritmike. Ndryshe nga atmosfera e lirë tingullore e Debysi, Raveli mbështetej më shumë te ekuilibri formal dhe arkitektura e qartë e veprës.

Krijimtaria e tij përfshin vepra për piano, muzikë dhome, muzikë orkestrale, muzikë vokale dhe muzikë skenike. Vepra e tij më e njohur është kompozimi orkestral *Bolero*. Kjo vepër përbëhet nga një melodi dypjesëshe jashtëzakonisht e gjatë, e shoqëruar nga një figurë ritmike karakteristike dhe e pandërprerë, e cila përsëritet vazhdimisht. Ndër veprat për piano më të njohura janë: *Pavana për një infante të vdekur*, *Lojëra në ujë*, cikli *Pasqyrat*, cikli *Gaspardi i natës*, *Valset fisnike dhe sentimentale*, dy koncerte për piano dhe orkestër, përfshirë Koncertin për piano për dorën e majtë, si dhe suita *Varri i Kuprenit*. Ai shkroi gjithashtu dy opera, *Fëmija dhe magjitet* dhe *Ora spanjolle*, baletin *Dafne dhe Kloe*, si dhe kompozimin *Nëna ime pata për piano me katër duar*, i cili interpretohet edhe në version orkestral. Të njohura janë edhe kompozimet orkestrale *Sheherazada* dhe *Rapsodia spanjolle*, këngët solo, sonatat dhe rapsodia tejet virtuozë *Ciganja* për violinë dhe piano.

### Kuriozitet

Raveli njihej për përpikshmërinë e tij të jashtëzakonshme dhe për vëmendjen e madhe ndaj detajeve. Ai e rishikonte çdo notë të kompozimeve të tij shumë herë, madje edhe pasi e kishte përfunduar të gjithë veprën, për t'u siguruar që çdo tingull ishte pikërisht ashtu siç e kishte përfytyruar.

Kjo përpikshmëri i mundësoi të krijonte orkestracione me qartësi dhe kolorit të jashtëzakonshëm, të cilat konsiderohen si një nga tiparet më dalluese të stilit të tij.

## Aktivitetet

### 1. Pyetje për diskutim

- Cilat janë karakteristikat kryesore të muzikës së shekullit XX?
- Cilat mjete muzikore (harmonia, shkallët, orkestracioni dhe forma) janë më karakteristike për impresionizmin?
- Në ç'mënyrë Debysi, përmes veprave të tij, krijoi një gjuhë të re harmonike dhe një qasje të ndryshme ndaj formës muzikore?
- Si ndërthuren forma klasike dhe koloriti modern tingëllimor në krijimtarinë e Ravelit dhe në çfarë dallohet stili i tij nga qasja impresioniste e Debysi?

### 2. Dëgjoni kompozime nga Klod Debysi dhe Moris Ravel

*Pasditja e një fauni* nga Klod Debysi

*Arabeska nr. 1* nga Klod Debysi

*Bolero* nga Moris Ravel



Udhëzime për dëgjimin:

- Kushtoni vëmendje karakterit të muzikës: a është ëndërrimtare, e qetë, hipnotizuese apo energjike.
- Dëgjoni se si melodia, harmonia dhe ritmi krijojnë atmosferë dhe ndjesi.
- Vëreni ndryshimet dinamike dhe orkestracionin – cilat instrumente dëgjohen dhe si ndryshojnë tingulli dhe koloriti.
- Mendoni se si ndiheni nën ndikimin e muzikës dhe çfarë pamjesh apo përfytyrimesh ju krijojnë ajo.
- Përgatitni përshtypjet dhe mendimet tuaja për t'i paraqitur dhe diskutuar në klasë.

## Ekspresionizmi

Ekspresionizmi shfaqet në fillim të shekullit XX, kryesisht në Gjermani dhe Austri. Ndryshe nga impresionizmi, i cili synon të krijojë atmosferë dhe kolorit tingëllimor, ekspresionizmi orientohet drejt një shprehjeje të fuqishme, shpesh dramatike dhe tronditëse të botës së brendshme.

Ky drejtim lidhet me shqetësimet e kohës moderne, tensionin psikologjik dhe rivlerësimin e vlerave tradicionale.

Ekspresionizmi e braktis tonalitetin klasik (dur dhe mol) dhe eksploron shprehjen emocionale në format e saj më të skajshme. Pikërisht nga këto eksperimente u zhvilluan teknika radikale avangardiste, si sistemi dymbëdhjetëtingullsh (dodekafonia), serializmi, këndimi i folur (Sprechgesang), ritmet e ndërlikuara dhe disonancat. Përfaqësuesi më i rëndësishëm i ekspresionizmit është Arnold Shenberg.



### Arnold Shenberg (1874 – 1951)

Arnold Shenberg (gjerm.: *Arnold Schönberg*) lindi më 13 shtator të vitit 1874 në Vjenë, ndërsa vdiq më 13 korrik të vitit 1951 në Los Anxhelos, SHBA. Ai ishte përfaqësues i shkollës moderne muzikore austriake, i udhëhequr nga fryma e inovacionit dhe eksperimentimit. Gjatë jetës së tij u shpërngul në SHBA, ku vazhdoi të krijonte dhe të jepte mësim, duke ushtruar ndikim të madh në jetën muzikore amerikane.

Krijimtaria e Arnold Shenbergut karakterizohet nga risi radikale në harmoni, formë dhe ritëm. Ai njihet mbi të gjitha si themelues i atonalitetit dhe krijues i teknikës dymbëdhjetëtingullshe (dodekafonisë), një sistem që zëvendësoi harmoninë tradicionale me një metodë të re organizimi të të dymbëdhjetë tingujve të shkallës kromatike si bazë e kompozimit. Fillimisht krijoi vepra ekspresioniste me shprehje të fuqishme emocionale, shpesh me dinamikë dramatike dhe kontrastuese. Më vonë, stili i tij u bë teknikisht më i përpiktë, me kompozime të ndërtuara në mënyrë strikte dhe me kontroll të kujdesshëm të çdo tingulli.

Shenberg kompozoi vepra për orkestër dhe për instrumente solo, muzikë dhome, muzikë vokale, si edhe opera dhe këngë. Ndër veprat e tij më të njohura janë ciklet për vokal dhe orkestër, kompozimet: *Pieri Lunar* – një shembull i melodramës me formë ekspresioniste që përdor këndimin e folur (Sprechstimme); *Të mbijetuarit nga Varshava* – kantatë; *Nata e ndritshme* – sekstet harkor; dhe *Moisiu dhe Aroni* – një operë monumentale, e mbetur e papërfunduar, e shkruar me teknikën dymbëdhjetëtingullshe. Muzika e tij ushtroi një ndikim të thellë në zhvillimin e muzikës moderne dhe avangarde të shekullit XX.



Skenë nga opera *Moisiu dhe Aroni*

## Zgjeroni njohuritë

**Sistemi dymbëdhjetëtingullsh** (dodekafonia) është një teknikë e zhvilluar nga Arnold Shenberg. Çdo notë e 12 gjysmëtoneve të oktavës përdoren në mënyrë të barabartë, pa theksuar një qendër tonale. Qëllimi është të shmanget tonaliteti tradicional dhe të krijohen struktura e harmoni të reja muzikore.

**Serializmi** është një zhvillim i mëtejshëm i parimeve të sistemit dymbëdhjetëtingullsh, duke e aplikuar në seri edhe ritmin, dinamikën dhe timbrin. Çdo element i muzikës (jo vetëm tingujt) mund të organizohet në mënyrë strikte në renditje të përsëritura, gjë që krijon rregull, por edhe efekte të reja tingëllimore.

**Sprechgesang** (këndimi i folur) është një kombinim i të folurit dhe të kënduarit. Notat nuk interpretohen me lartësi plotësisht të përcaktuara, si në këndimin tradicional, por ndiqen në mënyrë të përafërt, derisa ruhen ritmi dhe shprehja. Kjo teknikë përdoret më së shumti në muzikën ekspresioniste për të krijuar efekte dramatike.

Shembull: *Pieri Lunar* nga Arnold Shenberg.

**Atonaliteti** është një drejtim muzikor i fillimit të shekullit XX, në të cilin muzika krijohet pa një qendër të përcaktuar tonale.

**Shkolla e Dytë Vienneze** – Arnold Shenberg ishte një nga kompozitorët më të rëndësishëm të shekullit XX dhe themelues i Shkollës së Dytë Vienneze. Nxënësit e tij, Alban Berg dhe Anton Webern, e vazhduan veprimtarinë e tij dhe zhvilluan më tej muzikën ekspresioniste dhe dodekafonike. Në këtë mënyrë, Shkolla e Dytë Vienneze u bë qendra e eksperimentimit muzikor në Vjenë dhe pati një rëndësi të madhe për zhvillimin e muzikës moderne të shekullit XX.

## Aktivitete

### 1. Pyetje për diskutim

- Cilat teknika të reja kompozicionale i solli Arnold Shenberg dhe si e ndryshuan ato kuptimin tradicional të harmonisë?
- Pse veprat si *Pieri Lunar* konsiderohen shembull për ekspresionizmin?
- Si ndikoi shpërngulja e Shenbergut në SHBA në zhvillimin e skenës muzikore amerikane?

### 2. Dëgjoni kompozim të Arnold Shenbergut

*Të mbijetuarit nga Varshava* nga Arnold Shenberg



Udhëzime për dëgjim:

- Kushtoni vëmendje këndimit të folur (Sprechstimme) – një ndërthurje e të folurit dhe të kënduarit, e karakterizuar nga kontraste dramatike.
- Dëgjoni se si orkestra krijon tension dhe dinamikë përmes disonancave, tempeve kontrastuese dhe ritmeve të papritura.
- Dëgjoni momente nga kori, i cili krijon një shtresë shtesë të teksturës dhe kontrastit në muzikë.
- Vëreni përdorimin e atonalitetit dhe të teknikës dymbëdhjetëtingullshe, si dhe mënyrën se si organizohen tingujt për të krijuar një gjuhë muzikore të veçantë.

## Kuriozitet

Përveçse ishte një kompozitor revolucionar, Arnold Shenberg ishte edhe piktor. Shumë prej pikturave të tij, të realizuara në stilin ekspresionist, dëshmojnë se imagjinata e tij artistike nuk kufizohej vetëm te muzika. Madje, ai shpesh thoshte se piktura e ndihmonte të çlironte emocionet dhe idetë, të cilat më pas i shndërronte në kompozimet e tij muzikore.



Alban Berg nga Arnold Shenberg, 1910

## Neofolklorizmi

Neofolklorizmi është një drejtim muzikor i shekullit XX, në të cilin kompozitorët frymëzohen nga muzika popullore, por e përpunojnë atë me teknika bashkëkohore kompozicionale. Në vend që elementet folklorike të merren në mënyrë të drejtpërdrejtë, ato përpunohen stilistikisht dhe integrohen në një gjuhë të re muzikore. Karakteristikë e këtij drejtimi është përdorimi i ritmeve asimetrike (5/8, 7/8, 9/8) dhe i shkallëve modale. Megjithatë mbështetet në traditën popullore, neofolklorizmi përdor një gjuhë harmonike dhe tingëllimore bashkëkohore. Përfaqësuesi më i rëndësishëm i këtij stili muzikor është kompozitori Bela Bartok.



*Bela Bartok*

### Bela Bartok (1881–1945)

Bela Bartok (hung.: *Béla Bartók*) është kompozitor, pianist dhe etnomuzikolog hungarez. Lindi më 25 mars të vitit 1881 në Nagyszentmiklós, ndërsa vdiq më 26 shtator të vitit 1945 në Nju Jork, SHBA. Që në fëmijërinë e hershme shfaq talent të jashtëzakonshëm muzikor. Studioi në Budapest, ku u dallua si kompozitor, interpretues dhe profesor. Ai konsiderohet një nga përfaqësuesit më të rëndësishëm të neofolklorizmit.

Krijimtaria e Bartokut karakterizohet nga ndërthurja e muzikës popullore me teknikat bashkëkohore kompozicionale. Ai mbledhi dhe studioi këngë popullore nga Hungaria, Rumania, Sllovakia, Kroacia, Serbia, Bullgaria dhe vende të tjera të rajonit të Danubit. Ritmet, shkallët dhe meloditë popullore i përdori si bazë për krijimin e strukturave harmonike të ndërlikuara dhe të formave moderne muzikore.

Krijimtaria e tij përfshin muzikë dhome, muzikë orkestrale, muzikë për piano dhe muzikë vokale. Ndër veprat e tij më të njohura bëjnë pjesë: Muzikë për harqe, perkusion dhe çelëstë; Koncerti nr. 3 për piano; përmbledhja pianistike *Mikrokosmos*; gjashtë kuartetet harkorë; Sonata për dy piano dhe instrumente perkusivë; opera *Kështjella e mjekërkaltrit*; baleti *Mandarini i magjishëm* etj.

### Kuriozitet

#### Në kërkim të këngës popullore

Bela Bartok udhëtoi nëpër fshatrat e Hungarisë, Rumanisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit, duke mbledhur këngë popullore drejtpërdrejt nga fshatarët. Ai jo vetëm që i transkriptonte këngët, por shpesh i regjistronte edhe me fonograf, për të ruajtur meloditë e tyre në formën sa më autentike. Veprimtaria e tij etnomuzikologjike dha një kontribut të jashtëzakonshëm në zhvillimin e etnomuzikologjisë si disiplinë shkencore dhe e ndihmoi të krijonte një stil kompozicional krejtësisht origjinal.

### Aktivitetet

#### 1. Pyetje për diskutim

- Çfarë nënkupton termi neofolklorizëm dhe si pasqyrohet ai në muzikën e Bela Bartokut?
- Hulumtoni se si Bartoku e ndërthuri muzikën tradicionale popullore me teknikat bashkëkohore kompozicionale.

#### 2. Nga tingulli te fjala: Ese e frymëzuar nga Bartoku

*Allegro barbaro*

*Vallet popullore rumune*

*Koncert për orkestër (fragmente)*

Zgjidhni një nga këto tri kompozime dhe, përmes një eseje të shkurtër, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

- Cila është përshtypja juaj e parë nga muzika?
- Cilat emocione ose pamje ju krijohen gjatë dëgjimit?
- Cilat elemente muzikore (ritmi, melodia, instrumentet) ju tërhoqën më shumë vëmendjen?

## Neoklasicismi

Neoklasicismi është një drejtim muzikor i gjysmës së parë të shekullit XX, i cili u shfaq si reagim ndaj romantizmit dhe ekspresionizmit. Pas një periudhe të karakterizuar nga emocionaliteti i theksuar dhe eksperimentimi me tonalitetin, kompozitorët iu rikthyen qartësisë, ekuilibrit dhe disiplinës formale të muzikës së shekullit XVIII. Frymëzimin e gjetën në veprat e Hajdnit, Mocartit dhe Bahut, si edhe në muzikën e barokut. U rikthyen format klasike, si forma e sonatës, simfonia, koncerti, suita dhe fuga, por ato u pasuruan me një gjuhë harmonike bashkëkohore. Muzika karakterizohet nga një strukturë e qartë, formë e rregullt dhe shprehje e përmbajtur. Në vend të dramatizmit subjektiv, vihet në pah objektiviteti dhe maturia stilistike. Megjithatë i rikthehet traditës, neoklasicismi nuk e imiton muzikën e së kaluarës, por i rishqyrton dhe i risjell elementet e saj stilistike dhe formale në frymën e shekullit XX. Ndër përfaqësuesit më të rëndësishëm të këtij drejtimi janë kompozitorët Igor Stravinski, Sergej Prokofjev dhe Pol Hindemith.

### Igor Stravinski (1882–1971)

Igor Fjodoroviç Stravinski (rus.: *Игорь Фёдорович Стравинский*) lindi më 17 qershor të vitit 1882 në Oranienbaum, pranë Shën Petersburgut, Rusi dhe vdiq më 6 prill të vitet 1971 në Nju Jork, SHBA. Sipas dëshirës së tij, u varros në Venedik. Pas Revolucionit të Tetorit u largua nga Rusia dhe jetoi e krijoi në Zvicër, Francë dhe SHBA.

Gjatë krijimtarisë së tij kaloi nëpër disa periudha stilistike. Fillimisht u ndikua nga tradita muzikore ruse dhe nga impresionizmi, ndërsa më vonë u bë një nga përfaqësuesit kryesorë të neoklasicismit. Ai mbështeste formën e qartë, disiplinën dhe “muzikën e pastër”, duke iu kundërvënë ndjeshmërisë romantike dhe programatizmit. Në periudhën e fundit të jetës e pranoi teknikën dodekafonike dhe serializmin.

Është autor i baleteve *Zogu i zjarrtë*, *Petrushka*, *Shenjtërimi i pranverës*, *Pulçinela*, *Orfeu* dhe *Agon*, në të cilat solli një gjuhë të re muzikore, të karakterizuar nga ritme të ndërlikuara, metre asimetrike dhe zgjidhje moderne harmonike. Stravinski shkroi gjithashtu edhe operën *Përparimi i llastarit*, tri simfoni, koncerte, kantata (*Canticum Sacrum*), muzikë dhome etj. Përveçse si kompozitor, ai ishte aktiv edhe si dirigjent, pianist dhe autor i librave mbi estetikën muzikore, ndër të cilat edhe *Autobiografia* e tij.



## Zgjeroni njohuritë



*Sergei Prokofiev*

**Sergej Prokofjev** (1891–1953) ishte kompozitor, pianist dhe dirigjent rus. Ai kompozoi simfoni, koncerte për piano, baletë, opera dhe muzikë dhomë. Ndër veprat e tij më të njohura janë baletet *Hirushja* dhe *Romeo dhe Zhulieta*, Koncertet për piano nr. 1–5 dhe Simfonia nr. 1 *Klasike*. Ai ndërthuri elemente të folklorit rus me teknika moderniste, duke krijuar një stil të qartë dhe novator. Prokofjev punoi në Rusi, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Evropë, ndërsa pas kthimit në BRSS në vitin 1936, iu desh t'u përshtatej kërkesave të rrepta të politikës kulturore sovjetike. Është interesante se Prokofjev e quante shpesh muzikën e tij “muzikë për veshin dhe për trurin”, duke iu referuar ndërthurjes së melodive lehtësisht të mbajtshme mend me struktura muzikore të ndërlikuara.

## Aktivitetet

### 1. Pyetje për diskutim përmes hulumtimit

Duke përdorur internetin, enciklopedi, libra ose burime të tjera të besueshme, hulumtoni dhe diskutoni pyetjet e mëposhtme:

- Pse Stravinski dhe kompozitorë të tjerë iu kthyen neoklasicizmit pas Luftës së Parë Botërore?
- Me cilat karakteristika dallohet gjuha muzikore e Stravinskit në baletet *Petrushka* dhe *Shenjtërimi i pranverës*?
- Në ç'mënyrë Stravinski ndërthuri traditën e muzikës ruse me teknikat dhe idetë bashkëkohore kompozicionale?

### 2. Dëgjoni muzikë nga Igor Stravinski dhe Sergei Prokofjev

*Baleti Petrushka* (fragmente)

*Shenjtërimi i pranverës* (fragmente)

*Romeo dhe Zhulieta* (fragmente)

*Koncerti nr. 1* për piano dhe orkestër

Dëgjoni me kujdes fragmente nga kompozimet e mëposhtme:

- vëreni llojin e kompozimit – a është balet apo koncert;
- kushtoni vëmendje karakterit të muzikës;
- dëgjoni cilat instrumente dalin në pah dhe si përdoren ato në vepër; dhe
- gjatë dëgjimit, vëreni ndryshimin në funksionin e muzikës: muzika për balet ndjek lëvizjen dhe dramën, ndërsa koncerti thekson interpretimin e solistit.



## Karl Orf (1895 – 1982)

Karl Orf (gjerm.: *Carl Orff*) ishte kompozitor, dirigjent dhe pedagog muzikor gjerman, i njohur për stilin e tij origjinal dhe për ndikimin e madh në edukimin muzikor bashkëkohor. Ai lindi më 10 korrik të vitit 1895 në Mynih, Gjermani, ku edhe vdiq më 29 mars të vitit 1982.

Që në rininë e hershme shfaqti interes të veçantë për teatrin, poezinë dhe letërsinë mesjetare. Së bashku me Dorotea Gunter themeloi shkollën *Gunter* (Günther-Schule), ku zhvilloi sistemin e tij të njohur muzikor – pedagogjik *Instrumentariumi i Orfit* (*Orff-Schulwerk*).

Në krijimtarinë e tij, Orf synonte thjeshtësinë, formën e qartë dhe ritmikën e theksuar. Muzika e tij shpesh ka një karakter arkaik dhe një shprehje të fuqishme dramatike, duke u frymëzuar edhe nga këngët dhe vallet popullore. Ai nuk i përkiste plotësisht asnjërit prej drejtimeve muzikore të kohës, por krijoi një stil origjinal, të ndërtuar mbi ritmin e theksuar, strukturën e qartë dhe lidhjen e ngushtë midis muzikës, fjalës dhe lëvizjes. Për shkak të prirjes drejt qartësisë dhe ekuilibrit formal, ai shpesh renditet ndër përfaqësuesit e neoklasicizmit.

Famën më të madhe ia solli vepra skenike-kantatë *Karina Burana* (Carmina Burana), e kompozuar në vitin 1936. Kjo vepër është pjesa e parë dhe më e njohur e trilogjisë *Triumfët*. Pjesa e dytë është *Këngët e Katulit*, ndërsa pjesa e tretë është *Triumfi i Afërditës*. Kjo vepër skenike-kantatë është shkruar mbi tekste mesjetare latine dhe gjermane dhe karakterizohet nga ritmi i fuqishëm, harmonia e thjeshtë, por mbresëlënëse, si edhe nga shprehja e fuqishme korale. Orf kompozoi gjithashtu edhe vepra skenike, si operat *Hëna* dhe *Gruaja e mençur*, si edhe muzikë për teatër, kor dhe formacione të ndryshme instrumentale.



*Carl Orff*

### Zgjeroni njohuritë

**Instrumentariumi i Orfit** është një grup instrumentesh të thjeshta melodike dhe me goditje, të destinuara për mësimin e muzikës, të cilat nxisin muzikimin aktiv dhe krijues te nxënësit. Ky sistem bazohet në ndërthurjen e muzikës me lëvizjen, të folurin dhe ritmin dhe sot zbatohet gjerësisht në edukimin muzikor në mbarë botën.

### Aktivitete

#### 1. Dëgjoni muzikë nga Karl Orf dhe hulumtoni

*Karina Burana* (O, Fortuna)

Dëgjoni me kujdes kompozimin dhe kushtoni vëmendje elementeve të mëposhtme:

- vëreni karakterin e muzikës – ritmin, dinamikën, pjesët korale ose solistike;
- hulumtoni tekstin dhe kuptimin e kompozimit në internet ose në enciklopedi; dhe
- përgatitni një prezantim të shkurtër, ku do të shënoni vërejtjet tuaja për karakterin e muzikës, tekstin dhe përshtypjen tuaj personale nga kompozimi.



## Muzika elektronike

Muzika elektronike është një lloj muzike bashkëkohore, në të cilën tingulli krijohet, përpunohet dhe riprodhohet me ndihmën e paisjeve elektronike, në vend që të prodhohet vetëm nga instrumentet tradicionale muzikore. Ajo filloi të zhvillohej në mesin e shekullit XX, fillimisht në studio eksperimentale në Evropë dhe në SHBA, si pjesë e avangardës muzikore.

Në muzikën elektronike tingulli mund të krijohet me sintetizatorë, oscilatorë elektronikë, shirit magnetik, kompjuterë dhe samplerë. Përveç krijimit të tingujve të rinj, rol të rëndësishëm ka edhe përpunimi i tingujve ekzistues përmes efekteve të ndryshme, si ekoja, reverberacioni, përshpejtimi, ngadalësimi dhe transformimi i zërit ose i instrumenteve.

Kjo muzikë shpesh nuk ka një formë tradicionale, por mbështetet në koloritin tingëllimor, teksturat dhe atmosferat. Karakteristikë e saj është qasja eksperimentale dhe synimi për të zbuluar mundësi të reja tingullore.

Ndër përfaqësuesit më të rëndësishëm të këtij drejtimi janë Karlhajnc Shtokhauzen dhe Edgar Varez, të cilët dhanë një kontribut të madh në zhvillimin e muzikës elektronike dhe eksperimentale.

### Zgjeroni njohuritë



Karlhajnc Shtokhauzen duke krijuar muzikë elektronike në vitet 1950

**Karlhajnc Shtokhauzen** është një kompozitor avangardist, i cili krijonte muzikë elektronike që në vitet 1950. Ai ishte ndër kompozitorët e parë që eksperimentuan me vendosjen hapësinore të tingullit, duke krijuar kompozime në të cilat tingulli “lëviz” nëpër hapësirën përreth publikut. Për shembull, në veprën *Kënga e të rinjve*, ai ndërthur zërin njerëzor me tinguj elektronikë dhe përdor hapësirën tredimensionale për t’i “hedhur” tingujt nëpër sallën e koncertit, gjë që ishte revolucionare për kohën kur vepra u interpretua.

### Aktivitete

#### 1. Hulumtoni mbi muzikën elektronike

- Hulumtoni në internet, në libra ose në enciklopedi se çfarë është muzika elektronike dhe cilat janë karakteristikat e saj kryesore.
- Gjeni të paktën dy shembuj të muzikës elektronike. Shënoni autorin, vitin e krijimit dhe karakterin e veprës.
- Përshkruani çfarë e bën të veçantë muzikën: tingullin, formën, efektet e përdorura dhe atmosferën e krijuar.
- Përgatitni një prezantim të shkurtër ose një poster mbi atë që keni mësuar dhe prezantojeni para klasës.

## SHKOLLA KOMPOZICIONALE MAQEDONASE

Shkolla kompozicionale maqedonase u formua gjatë shekullit XX, në kushtet e zgjimit të vetëdijes kombëtare dhe zhvillimit të kulturës muzikore bashkëkohore. Rrënjët e saj gjenden në trashëgiminë e pasur të muzikës popullore, e cila shërbeu si themel mbi të cilin u ndërtua krijimtaria profesionale. Folklori maqedonas, me ritmet e tij karakteristike jo të rregullta, shkallët modale dhe melodikën e ornamentuar, u bë burimi kryesor i frymëzimit për kompozitorët e parë.

Në fillim të shekullit XX u shfaqën muzikantët e parë të arsimuar, të cilët hodhën themelet e traditës kombëtare kompozicionale. Një rol veçanërisht të rëndësishëm patën veprimtarët që u morën me mbledhjen dhe përpunimin e këngëve popullore, si edhe autorët e këngëve të para korale dhe solo me karakter artistik. Pas Luftës së Dytë Botërore filloi zhvillimi më sistematik i jetës muzikore në Maqedoni.

Me themelimin e institucioneve, si Filharmonia e Maqedonisë, Opera dhe Baleti i Maqedonisë dhe Akademia e Muzikës në Shkup, u krijuan kushtet për zhvillimin e krijimtarisë profesionale kompozicionale. Gjatë kësaj periudhe u shfaqën brezat e parë të kompozitorëve me formim akademik, të cilët përcaktuan drejtimet stilistike dhe estetike të muzikës bashkëkohore maqedonase. Ndër ta dallohen veçanërisht Trajko Prokopiev, Todor Skalovski, Stefan Gajdov dhe Kiril Makedonski, të cilët me krijimtarinë e tyre hodhën themelet e shkollës nacionale maqedonase.



Filharmonia e RMV



Opera dhe baleti nacional, Shkup

Veprat e këtyre autorëve përfshijnë zhanre të ndryshme – muzikë korale, këngë solo, kompozime orkestrale, muzikë dhome dhe opera. Në krijimtarinë e tyre vërehet prirja për të ndërthurur traditën popullore me teknikat bashkëkohore kompozicionale. Brezat e mëvonshëm të kompozitorëve e vazhduan zhvillimin e kësaj tradite, duke sjellë drejtime të reja stilistike, si neoklasicizmin, modernizmin dhe avangardën.

Shkolla kompozicionale maqedonase karakterizohet nga një ndjenjë e theksuar melodike, larmi ritmike dhe emocionalitet të spikatur. Ajo përfaqëson një pjesë të rëndësishme të identitetit kulturor të popullit maqedonas dhe një segment të rëndësishëm të kulturës muzikore bashkëkohore evropiane. Gjatë zhvillimit të saj historik, muzika maqedonase ka arritur të ruajë frymën kombëtare, duke u përfshirë njëkohësisht në rrjedhat e muzikës artistike botërore.

## Kompozitorët maqedonas – themeluesit (periudha pas vitit 1945)

Pas vitit 1945 u shfaq brezi i parë i kompozitorëve maqedonas, i cili i hodhi themelet e muzikës artistike bashkëkohore maqedonase. Këta krijues formësuan shprehjen muzikore nacionale, duke u mbështetur në trashëgiminë e pasur folklorike, të cilën e integruan në kompozimet e tyre.

Krijimtaria e tyre përbën bazën mbi të cilën u zhvillua më tej shkolla kompozicionale maqedonase. Përfaqësuesit më të rëndësishëm të këtij brezi janë: Stefan Gajdov, Trajko Prokopiev, Todor Skalovski, Zhivko Firfov, Gligor Smokvarski, Blagoja Ivanovski, Vlastimir Nikolovski dhe Kiril Makedonski, të cilët me krijimtarinë e tyre hodhën themelet e traditës nacionale kompozicionale.



**Stefan Gajdov (1905–1992)** është i lindur në Veles dhe është një nga pionierët e muzikës artistike maqedonase, veçanërisht i rëndësishëm për zhvillimin e krijimtarisë korale. Krijimtaria e tij mbështetet në këngën popullore maqedonase, me një linjë melodike të qartë, ndërsa veprat e tij karakterizohen nga forma e thjeshtë dhe komunikimi i drejtpërdrejtë. Ndër veprat e tij më të rëndësishme janë: përpunimet korale të këngëve popullore (*Ajde slushaj Angjo, Milkano mome*), *Kuarteti harkorë, Fantazia për flaut dhe orkestër*, etj.

**Trajko Prokopiev (1909–1979)**, kompozitor dhe dirigjent, lindi në Kumanovë. Në krijimtarinë e tij vend qendror zënë muzika korale dhe muzika skenike. Veprat e tij karakterizohen nga lidhja e thellë me folklorin maqedonas, melodika e pasur dhe karakteri i qartë kombëtar. Ndër veprat më të rëndësishme të Prokopievit janë: cikli koral *Kumanovaret*, baleti i parë maqedonas *Labin dhe Dojrana* dhe operat *Ndarja* dhe *Kuzman Kapidan*.

**Todor Skalovski (1909–2004)**, kompozitor dhe dirigjent, lindi në Tetovë. Ai ishte anëtar i Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe Arteve dhe një nga krijuesit dhe organizatorët më të rëndësishëm të jetës muzikore në Maqedoni pas Luftës së Dytë Botërore. Renditet ndër themeluesit e shkollës kompozicionale maqedonase dhe pati një rol të rëndësishëm në themelimin dhe zhvillimin e Filharmonisë së Maqedonisë, Operës dhe Baletit Nacional të Maqedonisë dhe Akademisë së Muzikës në Shkup (sot Fakulteti i Artit Muzikor pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”). Ndër veprat e tij më të rëndësishme janë kompozimet korale *Valle maqedonase, Lavde për Kirilin dhe Metodin* dhe suita *Baltepe*.

**Zhivko Firfov (1906–1984)** ishte kompozitor dhe etnomuzikolog, i lindur në Veles. Ai është një nga mbledhësit dhe studiuesit më të rëndësishëm të folklorit muzikor maqedonas dhe një pjesëmarrës aktiv në zhvillimin e shkollës kompozicionale maqedonase. Në krijimtarinë e tij mbizotërojnë mbështetja në folklorin maqedonas, modaliteti dhe strukturat ritmike karakteristike. Veprat e tij përfaqësojnë një ndërthurje të njohurive shkencore mbi folklorin me përpunimin artistik në frymën e muzikës bashkëkohore. Ndër veprat e tij më të rëndësishme janë cikli koral *Humoreska*, kompozimi koral *Drotar* dhe *Suita orkestrale*.

**Gligor Smokvarski (1914–1974)**, kompozitor, lindi në fshatin Budimirci, rajoni i Berovës. Ai është një nga kompozitorët që hodhën themelet e muzikës simfonike dhe skenike maqedonase. Krijimtaria e tij karakterizohet nga përdorimi i motiveve folklorike në formën simfonike dhe nga prirja për krijimin e veprave të mëdha muzikore-skenike. Veçanërisht i rëndësishëm është kontributi i tij në zhvillimin e baletit maqedonas dhe të muzikës orkestrale. Ndër kompozimet e tij më të njohura janë baletet *Histori maqedonase*, *Dojçini i sëmurë* dhe poema simfonike *11 Tetori*.

**Blagoja Ivanovski (1921–1994)** ishte kompozitor dhe redaktor muzikor, i lindur në Shkup. Pjesën më të madhe të jetës së tij profesionale ia kushtoi veprimtarisë në Radio Shkupi dhe zhvillimit të muzikës simfonike në Maqedoninë e Veriut. Opusi i tij karakterizohet nga tematika historike, shprehja dramatike dhe lidhja e fortë me folklorin maqedonas. Në krijimtarinë e tij mbizotërojnë veprat simfonike, me një gjuhë muzikore mesatarisht moderne dhe një karakter të qartë kombëtar. Pjesë e opusit të tij janë poemat simfonike *Meditim*, *Afreske*, *Vardari* dhe *Nerezi*, si edhe trilogjia *Epopeja e Samuil*.

**Vlastimir Nikolovski (1925–2001)** është kompozitor, pedagog dhe akademik, i lindur në Prilep. Studioi në Shën Petersburg dhe Beograd, ndërsa gjithë jetën ia kushtoi arsimit muzikor dhe zhvillimit të muzikës artistike maqedonase. Ai ishte dekani i parë i Fakultetit të Artit Muzikor në Shkup dhe anëtar i Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe Arteve. Krijimtaria e Nikolovskit karakterizohet nga një orientim i theksuar vokal, melodikë modale dhe metroritmikë e pasur. Frymëzimi nga folklori maqedonas dhe tradita shpirtërore është i qëndrueshëm dhe thelbësor, i përpunuar përmes një gjuhe muzikore bashkëkohore, të matur dhe ekspresive. Ndër veprat e tij më të rëndësishme janë oratoriumet *Klimenti dhe Kirili*, simfonitë *Brevis*, *Barbara* dhe *Rustika*, si edhe një opus i gjerë koral i frymëzuar nga folklori.

**Kiril Makedonski (1925–1984)** ishte kompozitor dhe dirigjent, i lindur në Manastir. Studioi kompozicion dhe dirigjim në Zagreb, Sarajevë dhe Lubjanë, ndërsa u specializua edhe në Poloni dhe Gjermani. Krahas kompozimit, ai u mor edhe me kërkime në fushën e psikologjisë së muzikës dhe muzikoterapisë. Në krijimtarinë e tij mbizotëron folklori muzikor maqedonas, i shndërruar në forma simfonike dhe skenike. Muzika e tij karakterizohet nga energji e fuqishme ritmike, dramatizëm dhe një orientim i qartë kombëtar, duke dhënë kështu një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e operës dhe simfonisë maqedonase. Ndër veprat e tij bëjnë pjesë poema simfonike *Valltarja*, opera e parë maqedonase *Goce* dhe opera *Car Samuil*.

## Aktivitete

### 1. Pyetje për diskutim dhe hulumtim

- Shpjegoni rolin e folklorit maqedonas në krijimtarinë e kompozitorëve themelues të muzikës maqedonase.
- Cilat janë kontributet kryesore të kompozitorëve themelues të këtij brezi në zhvillimin e muzikës artistike maqedonase?
- Krahasoni prirjet krijuese të kompozitorëve të brezit të parë në Maqedoni. Në çfarë ngjajnë shprehjet e tyre muzikore dhe në çfarë dallohen?

## Grupi i dytë i kompozitorëve maqedonas – afirmimi dhe modernizmi (1960–1980)

Gjatë viteve 1960 dhe 1970, muzika artistike maqedonase hyri në një fazë të re të zhvillimit të saj. Duke u mbështetur mbi themelet e vendosura nga brezi i parë, u shfaq një grup kompozitorësh që zhvilluan stilin e tyre individual, duke përdorur teknika moderniste dhe duke u frymëzuar nga folklori, por jo përmes citimeve të drejtpërdrejta. Ata krijuan simfoni, koncerte, vepra të muzikës së dhomës dhe vepra vokalo-instrumentale, duke e pasuruar kështu repertorin koncertor. Gjuha muzikore u bë më e sofistikuar dhe më e thelluar, ndërsa secili autor zhvilloi një stil personal dhe të dallueshëm.

**Toma Proshev (1931–1996)** është kompozitor dhe muzikolog, i lindur në Shkup. Studioi në Zagreb, Lubjanë dhe Paris dhe konsiderohet një nga përfaqësuesit më të shquar të muzikës bashkëkohore maqedonase dhe i të ashtuquajturës moderna muzikore maqedonase. Krijimtaria e Proshevit karakterizohet nga një gjuhë muzikore bashkëkohore dhe avangarde, eksperimentimi me formën dhe tingullin, si edhe nga një qasje e lirë ndaj folklorit. Ai është një nga kompozitorët më të rëndësishëm që e orientuan muzikën maqedonase drejt rrjedhave bashkëkohore evropiane. Në krijimtarinë e tij bëjnë pjesë operat *Rrjeta e merimangës*, *Princi i vogël* dhe *Areteu*; baletet *Korniza dhe jehona* dhe *Kënga e këngëve*; simfonitë (ndër to *Simfonia e shpresës*) si edhe oratoriumet *Shkupi* dhe *Terra Macedonia*.

**Tomislav Zografski (1934–2000)** është kompozitor, i lindur në Veles. Studioi kompozicion në Beograd dhe pjesën më të madhe të jetës së tij punoi si profesor në Fakultetin e Artit Muzikor në Shkup. Krijimtaria e tij lidhet kryesisht me neoklasicizmin, formën e qartë dhe shprehjen e ekuilibruar. Në shumë prej veprave të tij janë të pranishme elemente folklorike dhe shpirtërore, të përpunuara me një gjuhë muzikore të matur dhe stilistikisht të pastruar. Ndër kompozimet e tij më të rëndësishme janë veprat simfonike *Fantasia corale* dhe *Sinfonietta in Si*, kantata *Karaorman*, kompozimet korale *Vardari* dhe *Lutja*, si edhe vepra të frymëzuara nga tradita kishtare maqedonase.

**Mihajlo Nikolovski (1934–1994)** lindi në Manastir dhe vinte nga një mjedis i pasur me traditë qytetare dhe folklorike, e cila ndikoi fuqishëm në formimin e tij muzikor. Krijimtaria e tij karakterizohet nga një strukturë e qartë formale, një gjuhë modalo-tonale dhe një përpunim subtil të folklorit maqedonas. Në veprat e tij ndihet një shprehje bashkëkohore e matur, pa eksperimente radikale, e shoqëruar me lirikë të theksuar dhe orkestracion të kultivuar. Ndër veprat e tij më të rëndësishme dallohen oratoriumi *Ilinden*, kantata *Maqedonia*, Koncerti për korno, piano dhe orkestër, Sonata për violinë dhe piano etj.



**Risto Avramovski (1943–2007)** ishte kompozitor, i lindur në Sellce, afër Strugës, i cili që në moshë të re tregoi interes për muzikën dhe u formua si një nga autorët më prodhimtarë të muzikës bashkëkohore maqedonase. Avramovski krijoi vepra me një gjuhë muzikore bashkëkohore dhe me një qasje neoklasiciste, në të cilat folklori maqedonas dhe tradita kishtare marrin një shprehje të re tingëllimore. Muzika e tij karakterizohet nga dramatizmi, forma e qartë dhe orkestracioni i pasur. Ndër veprat e tij bëjnë pjesë: *Simfonia nr. 1 Drejt dritës*, *Psikofonia 1 dhe 2*, oratoriumet *Maqedonia* dhe *Kirili dhe Metodi*, baleti *Dojçini i sëmurë* etj.

**Stojan Stojkov (1941)** është kompozitor dhe pedagog, i lindur në Podarësh, rajoni i Radovishit. Studioi piano dhe kompozicion në Shkup dhe Beograd, ndërsa pjesën më të madhe të jetës ia kushtoi veprimtarisë pedagogjike dhe krijuese në Maqedoni. Krijimtaria e tij karakterizohet nga një lidhje e thellë me folklorin muzikor maqedonas, veçanërisht me shtresën e tij rustike dhe diafonike. Elementet folklorike ai i shndërroi në një shprehje bashkëkohore harmonike dhe polifonike, me një vullë origjinale autoriale dhe me një dimension të fuqishëm shpirtëror e kombëtar. Ai është autor i veprave: kompozimi koral *Suita fshatare*, baleti *Robëresha e Ohrit – Tashula*, opera *Nusja e dragoit*, kantata vokale *Psalmes* etj.

## Aktivitetet

### 1. Pyetje për diskutim

- Si e përpunon traditën folklorike brezi i dytë i kompozitorëve maqedonas, në krahasim me kompozitorët themelues? Mendoni për shkallën e citimit të drejtpërdrejtë të folklorit në raport me frymëzimin stilistik.
- Si shfaqet individualizimi i stilit te secili autor? (Shqyrtoni se cili autor eksperimenton më shumë me formën, tingullin ose dramatizmin.)

### 2. Aktivitet hulumtues

Në kodin QR të paraqitur më poshtë gjendet një listë e veprave të kompozitorëve maqedonas. Gjeni veprat e kompozitorëve të grupit të dytë dhe zgjidhni dy ose tri kompozime.

Udhëzime për aktivitetin:

- dëgjoni kompozimet e përzgjedhura;
- përcaktoni cilët elemente tregojnë një qasje moderniste (harmonia, forma, ritmi);
- vëreni praninë e frymëzimit nga folklori; dhe
- mendoni se si ndryshojnë veprat nga njëra-tjetra për nga stili dhe shprehja.

Përgatitni një prezantim të shkurtër, në të cilin do t'u përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme:

- Cilët elemente moderniste janë më të theksuara?
- A ndihet frymëzimi nga folklori?
- Si e pasqyrojnë veprat individualitetin e secilit kompozitor?



## Grupi i tretë i kompozitorëve maqedonas – shprehja bashkëkohore (nga vitet 1980)

Që nga vitet 1980, muzika artistike maqedonase hyri në një fazë të ndërkombëtarizimit intensiv dhe të larmisë stilistike. Kompozitorët e këtij brezi u arsimuan dhe vepruan në qendra të ndryshme evropiane dhe botërore, gjë që ndikoi në zgjerimin e gjuhës muzikore dhe të koncepteve estetike. Ndryshe nga brezat e mëparshëm, ky grup nuk karakterizohet nga një stil i vetëm dominues, por nga një individualizëm i theksuar dhe një qasje ndaj teknologjive të reja, formave eksperimentale dhe projekteve ndërdisiplinore. Në veprat e tyre përdoren mjete elektronike, përpunimi kompjuterik i tingullit dhe teknologjitë e reja, shpesh në kombinim me video, elemente skenike ose koncepte multimediale. Si rrjedhojë, gjuha muzikore bëhet më e lirë dhe pluraliste. Kompozitorët marrin pjesë aktivisht në festivale ndërkombëtare, bashkëpunojnë me ansamble dhe institucione të huaja dhe zhvillojnë veprimtarinë e tyre edhe jashtë kufijve kombëtarë, duke integruar muzikën maqedonase në hapësirën globale të muzikës bashkëkohore. Njëkohësisht, ata eksplorojnë ngjyra të reja tingëllimore, teknika të zgjeruara instrumentale, forma jotradicionale dhe ide konceptuale, duke vënë në pah natyrën eksperimentale dhe novatore të krijimtarisë së tyre.

**Tome Mançev (1950–2020)** është kompozitor dhe muzikolog, i lindur në Gjevgjeli. Studioi kompozicion në Shkup, Pragë dhe Sofje, ndërsa për shumë vite ishte profesor në Fakultetin e Artit Muzikor në Shkup. Krijimtaria e Mançevit karakterizohet nga një dramatizëm i theksuar, një gjuhë simfonike bashkëkohore dhe një shprehje e fuqishme emocionale. Ai frymëzohej shpesh nga folklori, historia dhe temat bashkëkohore shoqërore, të cilat i trajtonte me orkestracion të pasur dhe formë të qartë. Pjesë e krijimtarisë së tij janë kompozimet: simfonia *Paganofonia*, vepra orkestrale *Ekzodus 2001*, cikli vokal *Balada e sanatoriumit*, simfonia *Requiem* etj.

**Dimitrije Buzharovski (1952)** është kompozitor, pianist dhe muzikolog, i lindur në Shkup. Për shumë vite ishte profesor dhe dekan i Fakultetit të Artit Muzikor në Shkup dhe një nga teoricienët dhe organizatorët më të rëndësishëm të jetës muzikore në Maqedoni. Krijimtaria e Buzharovskit karakterizohet nga një qasje polistilistike, duke ndërthurur mjete shprehëse tradicionale dhe bashkëkohore, si edhe nga përdorimi aktiv i teknologjive elektronike dhe digjitale. Në veprat e tij janë të pranishme shpesh elemente folklorike dhe të xhazit, të përpunuara me një formë të qartë dhe një gjuhë muzikore komunikative. Ai është autor i veprave: Simfonia nr. 2 *Lindja e lirisë*, oratoriumi *Psaltiri i Radomirit*, opera *Despina* dhe *Mister Doks*, Koncerti për piano dhe orkestër simfonike, baleti *Borëbardha* etj.

**Goce Kolarovski (1959–2006)** është kompozitor, dirigjent dhe publicist, i lindur në Shkup. Studioi kompozicion dhe dirigjim në Fakultetin e Artit Muzikor në Shkup, ndërsa u specializua në Shën Petersburg. Ai ishte për shumë vite profesor dhe dekan i Fakultetit të Artit Muzikor dhe një personalitet i rëndësishëm i jetës muzikore maqedonase. Muzika e Kolarovskit karakterizohet nga një gjuhë bashkëkohore, logjikë e qartë formale dhe energji e fuqishme ritmike. Në veprat e tij ndërthuren elemente folklorike, teknika moderne dhe orkestracion i pasur, ndërsa gjithmonë është e pranishme një linjë e qartë dramaturgjike dhe një shprehje e fuqishme tingëllimore. Ndër veprat e tij bëjnë pjesë: Simfonia në tri kohë, Koncerti për piano dhe orkestër, kompozimi *Këmbanat*, *Këndime* – vepër orkestrale në versione për formacione të ndryshme (mbi një temë të Jan Kukuzelit), kantata *Zërat* etj.

**Jana Andreevska (1967)** është kompozitore maqedonase, e lindur në Shkup. Studimet i kreu në Fakultetin e Artit Muzikor në Shkup, ndërsa vepron edhe si pedagoge dhe autore në fushën e muzikës bashkëkohore. Krijimtaria e saj karakterizohet nga një gjuhë muzikore bashkëkohore, një shprehje tingëllimore subtile dhe hulumtimi i timbrit dhe teksturës. Shpesh frymëzohet nga poezia dhe gjendjet e brendshme psikologjike, duke përdorur elemente minimaliste dhe ambientale. Ndër veprat e saj më të rëndësishme janë: *Skifter jam, stuhi apo këngë e pafund?* – vepër për ansambël dhome, *Scattered Blues* për piano, *Elective Affinities (Afinetete zgjedhore)* për ansambël dhome, *Diada* nr. 1 dhe nr. 2 për orkestër simfonike etj.

**Pande Shahov (1973)** është kompozitor, i lindur në Shkup. Studioi kompozicion në Shkup dhe Londër, ndërsa vepron si kompozitor, pedagog dhe dirigjent me një karrierë aktive ndërkombëtare. Krijimtaria e Shahovit karakterizohet nga një sintezë e teknikave bashkëkohore kompozicionale, elementeve të xhazit dhe folklorit maqedonas. Muzika e tij dallohet për energjinë ritmike, koloritin e pasur dhe një stil autorial qartësisht të dallueshëm. Ndër veprat e tij më të rëndësishme janë: *Ishuj* për violonçel dhe ansambël dhome, *Suita e vogël* për piano, *Koncerti për piano dhe orkestër*, *Dridhje* (për ansambël dhome) etj.

**Vullnet Tairi (1982)** ka lindur në Gostivar. Studioi kompozicion në Fakultetin e Artit Muzikor në Shkup dhe vepron aktivisht si kompozitor dhe pedagog në Maqedoni. Krijimtaria e tij karakterizohet nga një strukturë e qartë formale, një shprehje bashkëkohore dhe një orkestracion i kujdesshëm. Veprat e tij shpesh ndërthurin elemente tradicionale me teknika bashkëkohore. Ai është autor i veprave: *Trio* për oboe, klarinetë dhe fagot, *Cikli i këngëve* nr. 2, *Simfonia* nr. 1, etj.

**Fatos Lumani (1983)** është kompozitor dhe muzikolog, i lindur në Strugë. Studioi dhe doktoroi në Tiranë dhe është profesor në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. Krijimtaria e tij karakterizohet nga një gjuhë polistilistike, që ndërthur teknikën seriale, aleatorikën, format klasike dhe frymëzimet folklorike. Veprat e tij dallohen për kontrastet, strukturat ritmike të ndërlikuara dhe përdorimin e teknikave të larmishme kompozicionale. Ndër kompozimet e tij më të rëndësishme janë: *Suita* për orkestër, *Koncert-Rapsodia* për violinë, piano dhe orkestër, *Simfonia*, *Metamorfoza in D* për orkestër harqesh, *Oratoriumi* për solistë, kor dhe orkestër, *Kantata për Kongresin e Manastirit*, opera *Skënderbeu* etj.

## Aktivitete

### 1. Pyetje për diskutim

- Si ndikuan studimet dhe bashkëpunimet jashtë vendit në larminë stilistike të muzikës maqedonase pas viteve 1980?
- Në çfarë mënyrash kompozitorët bashkëkohorë e ndërthurin folklorin maqedonas me teknikat e reja kompozicionale dhe mjetet elektronike?
- Cilat veçori e bëjnë të dallueshëm stilin individual të kompozitorëve të brezit të tretë?

### 2. Vlerësim estetik i një kompozimi

Në kodin QR ose në listën e veprave gjeni një kompozim të njërit prej kompozitorëve të grupit të tretë.

Shkruani një vlerësim të shkurtër estetik, duke iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:

- Çfarë karakteri ka muzika?
- Cilët elemente ju lanë më shumë përshtypje (melodia, orkestra, ritmi, elementet folklorike, elektronika etj.) dhe pse mendoni kështu?



## Kompozitorët e muzikës së popullarizuar dhe të xhazit – linjë paralele

Paralelisht me zhvillimin e muzikës artistike bashkëkohore, në gjysmën e dytë të shekullit XX u zhvilluan edhe skena maqedonase e muzikës argëtuese dhe e xhazit. Këta autorë nuk bëjnë pjesë drejtpërdrejt në shkollën akademike kompozicionale, por krijimtaria e tyre luajti një rol të rëndësishëm në formësimin e shprehjes muzikore bashkëkohore. Ata krijuan këngë për festivale dhe media, bashkëpunuan me radion dhe televizionin, si edhe realizuan aranzhime për ansamble *big bend*. Në muzikën e tyre dallohen harmoni të xhazit, ritme të sinkopuara, improvizimi dhe një melodikë e qartë me linjë vokale të theksuar. Shpesh përdorin elemente të folklorit maqedonas, të përshtatura në një shprehje moderne pop. Shumë prej këtyre kompozitorëve u shquan edhe si aranzhues të aftë, duke krijuar një lidhje të vazhdueshme ndërmjet traditës, modernes dhe komunikimit muzikor masiv.

**Dragan Gjakonovski – Shpato (1931–1987)** ishte kompozitor dhe aranzhues, i lindur në Shkup. Ai ishte themelues dhe dirigjent i Orkestrës së Vallëzimit të Radio Televizionit të Maqedonisë dhe i kuartetit vokal Impulse. Krijimtaria e tij lidhet ngushtë me muzikën argëtuese dhe xhazin dhe dallohet për aftësitë e jashtëzakonshme në aranzhim, qasjen inventive dhe transformimin origjinal të materialit muzikor. Ndër kompozimet e tij më të njohura janë: *Në mbrëmje vallëzimi, Një puthje, Ballo në ujë, Elegji për trombon* etj.

**Ljubomir Brangjolica (1932–2023)** ishte kompozitor dhe pianist, i lindur në Herceg Novi. Studioi në Zagreb dhe Rijekë, ndërsa punoi si korrepetitor në Teatrin Popullor të Maqedonisë së Veriut dhe në Radio Televizionin e Maqedonisë. Gjuha e tij krijuese është neoromantike, tonale, me melodikë dhe orkestracion të pasur. Ai integron shpesh elemente të folklorit maqedonas dhe të folkloreve të tjera në një shprehje klasike dhe të baletit. Është autor i baleteve *Variacionet e Velegradit* dhe *Pasqyrim*, i disa operave, ndër të cilat *Marini dhe Judita*, i *Koncertit* për piano dhe orkestër simfonike, si dhe i veprave të tjera.

**Aleksandar Xhambazov (1936–2022)** është kompozitor dhe dirigjent, i lindur në Stapar (Vojvodinë). Ai punoi në Radio Televizionin e Maqedonisë, si dirigjent i Orkestrës së Vallëzimit dhe organizator i Festivalit të Shkupit dhe i festivalit të këngës për fëmijë *Bilbili i artë*. Krijimtaria e tij përfshin muzikë të popullarizuar, muzikë për fëmijë dhe muzikë klasike, si edhe muzikë për film dhe teatër. Ndër veprat e tij bëjnë pjesë: *Rapsodia për Shkupin* (për piano dhe orkestër simfonike), *Shtatë variacione vallesh, Eja, Baladë për Shpaton*, si edhe më shumë se njëqind e pesëdhjetë melodi argëtuese dhe shumë këngë për fëmijë, ndër të cilat *Zilja e parë* dhe *Ej, pëllumba, pëllumba të bardhë*.

**Kire Kostov (1949–2023)** ishte kompozitor, dirigjent dhe pedagog, i lindur në Manastir. Ai ishte trumpetisti i parë dhe dirigjent i Orkestrës së Vallëzimit të RTM-së, si edhe ka qenë pjesëmarrës në Big Bendin e Radiodifuzionit Evropian. Krijimtaria e tij përfshin një numër të madh kompozimesh, aranzhimesh dhe këngësh, si: *Fluturo, pulëbardhë, Kur ti mungon, Sytë e tu bir, Biri i Zotit, Sekretet im*, si



edhe rreth pesëdhjetë kompozime orkestrale në fushën e muzikës së popullarizuar dhe të xhazit. Ai dha një kontribut të rëndësishëm në edukimin muzikor dhe në zhvillimin e skenës së festivaleve për fëmijë dhe të rinj (*Si-Do, Interfest Manastir*).

**Ilija Pejovski (1947)** është kompozitor dhe aranzhues, i lindur në Veles. Ai punoi në RTM si dirigjent dhe redaktor muzikor, ndërsa më vonë si profesor në Fakultetin e Muzikës në Universitetin “Goce Dellçev” në Shtip. Është autor i më shumë se tetëdhjetë kompozimeve origjinale, ndër të cilat *Bërsjakët, Vagus, Tema e fëmijës, Iluzion* etj., si edhe i më shumë se katërqind aranzhimeve, me një theks të veçantë në ndërthurjen e folklorit maqedonas me xhazin. Gjithashtu, ka kompozuar muzikë për më shumë se dyzet filma dokumentarë dhe për disa filma artistikë.

**Zhivojin Glisliq (1954)** është kompozitor dhe aranzhues i xhazit, i lindur në Shkup. Ai punoi si kitarist dhe aranzhues në RTM, ishte anëtar i grupit të xhazit *Jazbina* dhe profesor në Fakultetin e Artit Muzikor në Shkup. Krijimtaria e tij përfshin muzikë klasike, muzikë të popullarizuar dhe xhaz, me një interes të veçantë për folklorin muzikor maqedonas. Veprat e tij dallohen për larminë stilistike, melodikën e qartë dhe orkestracionin e kujdesshëm, të përshtatur si për interpretimin tradicional, ashtu edhe për atë bashkëkohor. Ndër veprat e tij bëjnë pjesë: *Simfonieta, Koncertino* për kitarë elektrike dhe orkestër simfonike, *Në Ohrin e bukur e të kaltër, Prelud dhe Pajdushka* (për piano), *Jehonë e Pashkës*, si edhe më shumë se 250 aranzhime për big bend.

## Aktivitete

### 1. Pyetje për diskutim dhe hulumtim

- Si e ndërthurin kompozitorët e muzikës së popullarizuar dhe të xhazit folklorin maqedonas me elementet e muzikës popullore dhe të xhazit?
- Çfarë roli kanë festivalet, radioja dhe televizioni në zhvillimin e krijimtarisë së tyre?
- Çfarë dallimesh vëreni midis stilit të tyre dhe stilit të shkollës akademike kompozicionale?

### 2. Analizë dëgjimore

Në kodin QR ose në listën e veprave gjeni kompozimet e kompozitorëve maqedonas të muzikës së popullarizuar dhe të xhazit dhe kërkoni versionet e tyre audio duke përdorur TIK

Shkruani një vlerësim të shkurtër estetik për secilën vepër:

- Çfarë ndjenjash ju zgjon vepra?
- Cilët elemente e përcaktojnë më shumë stilin e saj?
- A mendoni se vepra është më afër muzikës klasike, muzikës së xhazit apo muzikës së popullarizuar?



## ZHANRET E MUZIKËS SË POPULLARIZUAR

Muzika e popullarizuar është muzikë e pranuar nga një publik i gjerë, e lehtë për t'u dëgjuar dhe për t'u njohur. Ajo e pasqyron kulturën bashkëkohore dhe shijet e njerëzve, ndërsa synon të argëtojë, të frymëzojë dhe të shprehë ndjenja.

Muzika e popullarizuar u zhvillua në fillim të shekullit XX, falë përparimit teknologjik, shfaqja e radios dhe pllakave të gramafonit, por edhe urbanizimit dhe lëvizjeve të reja kulturore. Karakteristikat kryesore të saj janë lehtësia për ta mbajtur në mend, linjat melodike dhe motivet ritmike, si edhe aftësia për të përcjellë emocione dhe disponime. Ajo përfshin zhanre të ndryshme muzikore, të cilat krijojnë laramani dhe eksperimentim. Ndër zhanret më të njohura të muzikës së popullarizuar janë: xhaz, pop, rok, teknoja dhe rap. Këto zhanre muzikore luajnë një rol të rëndësishëm në kulturën bashkëkohore: ato i lidhin njerëzit, përcjellin emocione dhe vlera kulturore, ndikojnë në modë dhe në stilin e jetesës, si edhe shpesh pasqyrojnë realitetin shoqëror dhe politik. Megjithatë, muzika e popullarizuar mund të ketë edhe disa anë negative. Ndonjëherë tekstet e këngëve kanë përmbajtje të papërshtatshme ose të dhunshme, të cilat mund të ndikojnë në qëndrimet dhe sjelljen e të rinjve. Disa këngë krijojnë një pamje jorealiste për jetën, dashurinë ose suksesin, duke nxitur pritshmëri që janë të vështira për t'u përmbushur, kurse dëgjimi i shpeshtë i ritmeve shumë të shpejta dhe monotone mund të ndikojë negativisht në përqendrimin dhe vëmendjen e dëgjuesit.

**Muzika xhaz** është një stil muzikor që e ka origjinën në SHBA në fillim të shekullit XX, veçanërisht në Nju Orleans, ku u ndërthurën ritmet afroamerikane, bluzi dhe harmonia evropiane. Ajo karakterizohet nga improvizimi, ritmi i sinkopuar dhe kontrastet dinamike.

Një nga kompozitorët më të njohur të xhazit është Luis Armstrong (Louis Armstrong). Ai, gjithashtu ishte trumpetist dhe këngëtar. Një nga këngët e tij më të njohura është *What a Wonderful World*, e cila shpalos melodiozitetin, emocionalitetin dhe karakteristikat tipike të stilit të xhazit.

Muzika e xhazit ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e muzikës së popullarizuar, ka ndikuar në zhanre të tjera, si pop dhe rok dhe e shpreh lirinë dhe kreativitetin e interpretuesit.

### Kuriozitet

#### Duelet muzikore në rrugë

Në fillimet e tij, xhaz ishte aq i gjallë dhe eksperimental, sa që muzikantët shpesh garonin se kush do të krijonte improvizimin më interesant në rrugë ose në klub. Këto duele muzikore ishin një argëtim i vërtetë për publikun dhe pikërisht kështu xhaz u bë sinonim i lirisë dhe krijimtarisë.



Luis Armstrong

**Muzika pop** është një zhanër që filloi të zhvillohet gjatë viteve 1950 dhe 1960 si pjesë e muzikës së destinuar për një publik të gjerë. Ajo karakterizohet nga melodi lehtësisht të dallueshme, refrane të përsëritshme dhe një shprehje e drejtpërdrejtë emocionale, me synimin për të tërhequr sa më shumë dëgjues. Muzika pop është e orientuar drejt argëtimit, por njëkohësisht mund të përcjellë mesazhe, ndjenja dhe vlera kulturore. Ajo i drejtohet kryesisht publikut të ri, shpesh ndjek trendet e modës dhe ndikon në stilin e jetesës dhe në zakonet e konsumit. Interpretohet në forma të ndryshme – nga solistë, grupe muzikore ose grupe vokale – dhe shpërndahet përmes radios, televizionit, platformave të transmetimit (streaming) dhe koncerteve.

Një shembull i një autori dhe interpretuesi të njohur të muzikës pop është Majkëll Xhekson, me albumin *Thriller* (1982). Kënga me të njëjtin titull dhe i gjithë albumi përcaktuan tingullin e muzikës pop të viteve 1980, me linja të fuqishme ritmike, melodikë tërheqëse dhe popullaritet të jashtëzakonshëm në mbarë botën.



Majkëll Xhekson

**Muzika rok** është një zhanër i muzikës së popullarizuar që u shfaq në vitet 1950 në SHBA dhe në Britaninë e Madhe. Karakteristikat kryesore të këtij zhanri janë përdorimi i kitarës elektrike, bas kitarës, baterive, ritmi i fuqishëm dhe, shpesh, vokalet energjike e ekspresive. Roku lidhet shpesh me frymën e rebelimit, lirinë dhe energjinë rinore.

Ndër përfaqësuesit më të njohur të kësaj muzike janë grupet Bitëlls (The Beatles) dhe Rolling Stouns (The Rolling Stones). Krahas tyre, ekzistojnë edhe shumë grupe të tjera të njohura që kanë ndikuar në zhvillimin e muzikës rok.

Bitëlls (The Beatles) konsiderohen një nga grupet më me ndikim në historinë e rokut, të njohur për këngët e tyre melodike dhe produksionin novator. Ndër këngët e tyre më të njohura janë *Hey Jude*, *Yesterday*, *Let It Be*.

Rolling Stouns (The Rolling Stones) janë një shembull i rokut klasik. Një nga këngët e tyre më të njohura është *Satisfaction*.

Roku ka ushtruar një ndikim të madh në kulturë, modë dhe në qëndrimet e të rinjve, duke luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e skenës muzikore bashkëkohore.



Bitëlls



Rolling Stouns

**Muzika tekno** është një zhanër i muzikës së popullarizuar elektronike, që u shfaq në vitet 1980 në shtetin e Miçiganit, SHBA, veçanërisht në qytetin e Detroitit. Ajo karakterizohet nga ritme të përsëritura, tinguj sintetikë dhe përdorimi i instrumenteve elektronike. Shpesh është krijuar për vallëzim në klube dhe diskoteka. Tiparet kryesore të muzikës tekno janë përqendrimi te ritmi dhe atmosfera dhe jo aq te melodia, si edhe përdorimi i linjave të përsëritura të basit dhe efekteve elektronike.

Ndër autorët dhe producentët më të njohur të muzikës tekno janë Juan Atkins, Derrick May dhe Kevin Saunderson. Këta artistë njihen si tre pionierët e tekno-së së Detroitit. Një nga veprat më përfaqësuese të këtij zhanri është *Strings of Life* (1987) nga Derrick May.



**Muzika rap** është një zhanër muzikor që u zhvillua si pjesë e kulturës hip-hop dhe bazohet në recitimin ritmik të tekstit (rap) mbi një bazë muzikore (beat). Ajo u shfaq në vitet 1970 në Nju Jork, veçanërisht në komunitetet afroamerikane dhe latino-amerikane, si një mënyrë që të rinjtë të shprehnin përvojat e tyre të përditshme, problemet, qëndrimet dhe identitetin.

Karakteristika më e rëndësishme e muzikës rap është teksti, i cili shpesh trajton tema reale të jetës, si padrejtësia shoqërore, varfëria, diskriminimi, por edhe miqësia, suksesi, vetëbesimi dhe përvojat personale. Muzika zakonisht ka një ritëm të qartë dhe të përsëritur, të krijuar me bateri, sample dhe tinguj elektronikë. Muzika rap ka një ndikim të madh te të rinjtë, sepse u jep mundësi të shprehen lirshëm dhe u krijon ndjesinë se zëri i tyre dëgjohet. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme që tekstet të vlerësohen në mënyrë kritike, pasi disa këngë përmbajnë mesazhe të papërshtatshme, si dhuna ose gjuha vulgare.

Ndër interpretuesit më të njohur të rapit janë Kendrick Lamar, Tupac Shakur dhe Eminem. Sot, muzika rap është një nga zhanret më me ndikim në muzikën e popullarizuar botërore.



Eminem

Muzika e popullarizuar më shpesh përdor forma të thjeshta dhe që përsëriten, të cilat janë të lehta për t'u mbajtur mend dhe për t'u kënduar. Forma më e zakonshme është kënga standarde me strofë dhe refren. Ajo interpretohet në mënyra të ndryshme: nga solistë ose bende, grupe vokale, DJ, producentë të muzikës elektronike etj. Funkcioni i saj është të argëtojë, të përcjellë emocione dhe ndjenja, të pasqyrojë kulturën dhe prirjet bashkëkohore, ndonjëherë të transmetojë mesazhe ose informacione dhe të arrijë te një publik i gjerë. Ajo ka gjithashtu rol komercial dhe motivues. Muzika e popullarizuar është e dedikuar për një publik të gjerë, zakonisht për të rinjtë, por edhe për të gjithë ata që pëlqejnë argëtimin dhe muzikën lehtësisht të dallueshme.

### Aktivitete

#### 1. Pyetje për diskutim dhe hulumtim

- Cilët faktorë ndikuan në zhvillimin e muzikës së popullarizuar në fillim të shekullit XX dhe cilat janë karakteristikat e saj kryesore?
- Përmendni tri role pozitive të zhanreve të muzikës së popullarizuar në kulturën bashkëkohore.
- Cilat karakteristika të muzikës së popullarizuar ndikojnë negativisht te të rinjtë?
- Kur dhe ku u shfaqën xhazit, muzika pop, muzika rok, muzika tekno dhe muzika rap dhe cilat janë karakteristikat e tyre kryesore?
- Sipas zgjedhjes suaj, hulumtoni dhe përgatitni një listë të solistëve dhe bendeve të njohura nga zhanret e muzikës së popullarizuar.

#### 2. Krahasoni i muzikës së popullarizuar dhe muzikës klasike

- Hulumtoni në internet dhe krahasoni muzikën e popullarizuar me muzikën klasike.
- Zgjidhni një vepër të muzikës klasike dhe një këngë ose kompozim nga muzika e popullarizuar.
- Kushtoni vëmendje formës së veprave, interpretimit, funksionit të muzikës dhe qëllimit të saj.
- Në fund, shkruani vërejtjet dhe përfundimet tuaja dhe përgatitni një prezantim në PowerPoint, ku do të paraqisni se si kriteret e ndryshme ndikojnë në mënyrën se si e përjetoni muzikën.

#### 3. Dëgjoni dhe analizoni kompozime muzikore të autorëve vendas

Gjeni në internet shembujt e mëposhtëm muzikorë dhe dëgjoni me kujdes:

- *Rapsodi për Shkupin* (Рапсодија за Скопје) – Aleksandar Xhambazov
- *Natën e mirë* – Elita 5
- *Mbretëresha e natës* (Нокна кралица) – Erzana Berisha
- *Caress* – Ilija Pejovski

Mendoni dhe përgjigjuni:

- A përmban vepra elemente të xhazit, rokut, pop-it, folklorit ose muzikës klasike?
- A është melodia lirike, dramatike apo improvizuese?
- Cilat instrumente ose vokali kanë rolin udhëheqës?
- Cilit zhanër të muzikës së popullarizuar i përket secila vepër?
- Ndani përfundimet tuaja me shokët e klasës dhe shpjegoni pse mendoni kështu.

## Muzika e filmit, muzika për filmat e animuar, videolojërat dhe reklamave

Muzika e filmit, muzika për filmat e animuar, videolojërat dhe reklamave bëjnë pjesë në të ashtuquajturën muzikë në media. Kjo është muzikë që nuk ekziston si vepër e pavarur, por krijohet për të mbështetur figurën, rrëfimin ose mesazhin që përcillet përmes mediave të ndryshme (filmit, televizionit, internetit, videolojërave dhe reklamave).

### Kuriozitete

#### Magjia muzikore e filmit

Muzika e filmit mund të bëhet e njohur edhe pa filmin. Disa tema muzikore, si tema e *James Bond* ose muzika e *Star Wars*, njihen menjëherë, edhe nga njerëz që nuk i kanë parë këta filma, sepse krijojnë emocione të forta dhe mbeten gjatë në kujtesë.



**Enio Morikone** ishte kompozitor dhe dirigjent italian, një nga autorët më të njohur të muzikës së filmit në botë. Muzika e filmit *The Good, the Bad and the Ugly* fillon me një tingull të pazakontë që i ngjan ulërimës së një kojoti. Ky motiv karakteristik është bërë një nga hyrjet më të njohura në historinë e muzikës së filmit.



*Rapsodia hungareze nr. 2* e Franc List mund të dëgjohet edhe në një nga filmat e animuar *Tom and Jerry*, ku personazhet e interpretojnë në piano në mënyrë humoristike. Falë këtij filmi të animuar, shumë fëmijë njihen për herë të parë me këtë vepër të famshme të muzikës klasike.

**Muzika e filmit** ka për detyrë të përforcojë emocionin, të shoqërojë zhvillimin dramatik dhe të ndihmojë në rrëfimin e historisë. Ajo mund të krijojë tension, gëzim, trishtim ose heroizëm dhe shpesh lidhet me një personazh, skenë ose ngjarje të caktuar. Disa melodi bëhen të njohura edhe jashtë filmit, por funksioni i tyre kryesor mbetet mbështetja e përmbajtjes vizuale.

**Muzika për filmat e animuar** është zakonisht e gëzueshme, lozonjare dhe e qartë, e përshtatur për fëmijët. Ajo thekson lëvizjet e personazheve, humurin dhe karakterin e skenave. Me ndihmën e muzikës, fëmijët i dallojnë më lehtë emocionet dhe mesazhet e filmit të animuar.

**Muzika në videolojëra** ka një rol interaktiv. Ajo ndryshon në varësi të veprimeve të lojtarit dhe e krijon atmosferën e lojës – avanturiste, misterioze, të rrezikshme ose të qetë. Kjo muzikë e ndihmon lojtarin të përfshihet më thellë në botën virtuale.

**Muzika në reklama** është e shkurtër, por ka një funksion shumë të rëndësishëm. Ajo duhet të tërheqë shpejt vëmendjen, të mbahet mend lehtë dhe të përforcojë mesazhin e reklamës. Për këtë arsye përdoren shpesh melodi ose ritme të thjeshta, të cilat mbeten lehtësisht në kujtesë.

### Aktivitete

#### 1. Pyetje për diskutim dhe hulumtim

- Çfarë nënkupton termi muzikë në media dhe si ndryshon ajo nga llojet e tjera të muzikës?
- Cili është roli kryesor i muzikës së filmit? Jepni shembuj emocioneve ose skenash që ajo i përforcon.
- Si karakterizohet muzika për filmat e animuar dhe në çfarë përqendrohet më së shumti?
- Si e krijon muzika atmosferën e lojës në videolojëra?
- Cila është sfida kryesore e muzikës në reklama dhe si e arrin ajo këtë?
- Sipas mendimit tuaj, cili nga këto katër lloje të muzikës është më i rëndësishëm për krijimin e emocioneve të publiku dhe pse?

#### 2. Dëgjoni dhe analizoni

Hulumtoni dhe gjeni shembuj të muzikës për filma, filma të animuar, videolojëra dhe reklama.

Dëgjoni shembujt dhe mendoni për pyetjet e mëposhtme:

- Si e mbështet muzika rrëfimin, personazhet ose skenën?
- Çfarë emocioneve zgjon muzika?
- Cilat instrumente ose tinguj përdoren dhe çfarë atmosfere krijojnë?

Shkruani shënime të shkurtra për secilin kompozim dhe më pas ndani me klasën vëzhgimet tuaja.

## Produksioni muzikor dhe studioja për inçizim të tingullit

**Produksioni muzikor** përfshin gjithçka që lidhet me krijimin, inçizimin, përpunimin dhe realizimin përfundimtar të një vepre muzikore. Ai fillon me idenë fillestare të autorit, vazhdon me aranzhimin dhe interpretimin, ndërsa përfundon me regjistrimin audio të gatshëm për t'u publikuar dhe dëgjuar nga publiku.

Në muzikën bashkëkohore, produksioni muzikor ka një rëndësi të madhe, sepse mënyra se si muzika inçizohet dhe përpunohet ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e saj dhe në përshtypjen që lë te dëgjuesi.



Studio muzikore

**Studioja për inçizim të tingullit** është një hapësirë e pajisur, ku inçizohet dhe përpunohet muzika. Në studio përdoren mikrofona, miksetë, kompjuterë dhe programe të ndryshme audio për regjistrimin e vokaleve dhe instrumenteve. Aty realizohen procese si inçizimi, montazhi, miksimi dhe masterizimi, përmes të cilave muzika fiton një tingull të pastër, të balancuar dhe profesional.

Në produksionin muzikor marrin pjesë profesionistë me role të ndryshme: kompozitori, interpretuesit, producenti dhe inxhinieri i zërit. Producenti udhëheq të gjithë procesin e punës dhe vendos për pamjen përfundimtare tingullore të veprës, ndërsa inxhinieri i zërit kujdeset për aspektin teknik të inçizimit dhe përpunimit të zërit.

Sot, falë teknologjisë digjitale, produksioni muzikor mund të realizohet edhe në studio të vogla shtëpiake. Megjithatë, studiot profesionale të inçizimit vazhdojnë të kenë një rol të rëndësishëm, sidomos në regjistrimin e koncerteve, albumeve, muzikës së filmit dhe muzikës së popullarizuar.

Produksioni muzikor dhe studioja e inçizimit janë thelbësore për krijimin e muzikës bashkëkohore, sepse bëjnë të mundur që një ide muzikore të shndërrohet në një produkt tingullor cilësor dhe të përfunduar, të gatshëm për publikun.

### Kuriozitet

#### Studiot e para të inçizimit

Studiot e para profesionale të inçizimit u shfaqën në fillim të shekullit XX, kur teknologjia e regjistrimit të zërit u bë e disponueshme. Një nga studiot e para komerciale u themelua nga kompania Victor Talking Machine Company në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, rreth vitit 1901. Aty muzika regjistrohej në pllaka gramafoni dhe i gjithë procesi ishte plotësisht mekanik. Mikrofonët ishin të thjeshtë, ndërsa muzikantët duhej të qëndronin në vende të përcaktuara saktë, në mënyrë që zëri të regjistrohej siç duhet.

Është interesante se në atë kohë nuk ekzistonte mundësia e montazhit ose e miksimit. Gjithçka duhej të interpretohej në mënyrë të përsosur që të regjistrohej në një inçizim të vetëm. Kjo tregon se sa shumë kanë përparuar studiot moderne të inçizimit falë teknologjisë digjitale, në krahasim me përpjekjet e para për regjistrimin e muzikës.

### Aktivitete

#### 1. Pyetje për diskutim

- Çfarë përfshin produksioni muzikor?
- Cilat janë fazat kryesore në krijimin e një vepre muzikore?
- Pse produksioni muzikor është i rëndësishëm për muzikën bashkëkohore?
- Shpjegoni çfarë është studioja e inçizimit, cili është funksioni i saj dhe cilat janë pajisjet teknike dhe programet kompjuterike që përdoren në të.
- Cilët profesionistë marrin pjesë në produksionin muzikor dhe cilat janë rolet e tyre?
- Pse studiot profesionale të inçizimit vazhdojnë të kenë një rol të rëndësishëm edhe sot?
- Sipas mendimit tuaj, si e ka ndryshuar teknologjia digjitale mënyrën e krijimit të muzikës?

## Festivalet dhe koncertet e muzikës së popullarizuar

### Kuriozitet

#### Hipitë dhe muzika si formë proteste

Në vitet 1960, hipitë përdorën muzikën rok dhe psikodelike për të shprehur idealet e paqes, dashurisë dhe protestës kundër Luftës së Vietnamit. Koncertet dhe festivalet, si *Woodstock*, nuk ishin vetëm ngjarje argëtuese, por edhe vende ku të rinjtë ndanin energjinë, idealet dhe mesazhet e tyre për liri, paqe dhe barazi. Në këtë mënyrë, muzika u bë simbol i një lëvizjeje të tërë shoqërore.



Festivalet dhe koncertet e muzikës së popullarizuar janë një pjesë e rëndësishme e jetës dhe kulturës muzikore bashkëkohore. Ato janë ngjarje publike muzikore, në të cilat interpretuesit e prezantojnë muzikën e tyre drejtpërdrejt para publikut. Koncertet zakonisht janë paraqitje të një interpretuesi ose grupi muzikor, ndërsa festivalet përfshijnë më shumë interpretues dhe zgjasin një ose disa ditë. Këto ngjarje luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e muzikës, sepse krijojnë një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet muzikantëve dhe publikut. Përmes interpretimeve live, muzika fiton një energji të veçantë, ndërsa publiku përjeton emocione të forta dhe një përvojë të përbashkët.

Festivalet dhe koncertet kontribojnë në zhvillimin kulturor dhe ekonomik, tërheqin të rinj, turistë dhe vëmendjen e mediave. Ato shpesh shërbejnë si platformë për promovimin e stileve të reja muzikore, interpretuesve të rinj dhe trendeve në muzikën e popullarizuar. Në shoqërinë bashkëkohore, festivalet dhe koncertet nuk janë vetëm një formë argëtimi, por edhe një mjet komunikimi kulturor, ku muzika i bashkon njerëzit pa marrë parasysh moshën, gjuhën ose përkatësinë kulturore.

Disa nga festivalet më të njohura të muzikës popullore në botë janë:

- *Glastonbury Festival* (Britania e Madhe) – një nga festivalet më të mëdha dhe më të njohura në botë, ku përfaqësohen zhanre të ndryshme muzikore;
- *Coachella Valley Music and Arts Festival* (SHBA) – një festival shumë me ndikim, i njohur për muzikën bashkëkohore pop, rok dhe elektronike;
- *Tomorrowland* (Belgjikë) – një nga festivalet më të njohura të muzikës elektronike dhe tekno;
- *Rock in Rio* (Brazil dhe Portugali) – një festival i madh ndërkombëtar me interpretues të muzikës rok dhe pop;
- *Montreux Jazz Festival* (Zvicër) – një festival i famshëm botëror i xhazit, i cili përfshin edhe zhanre të tjera bashkëkohore;
- *Eurovision Song Contest* (Evropë) – një konkurs ndërkombëtar muzikor me pjesëmarrjen e shumë vendeve evropiane.



Festivali muzikor – artistik  
*Coachella* (SHBA)

Disa nga festivalet më të rëndësishme muzikore në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë:

- *MakFest (Shtip)* – festivali më i njohur i muzikës zbavitëse dhe popullore në vend;
- *Festivali i Xhazit në Shkup* – festival me reputacion ndërkombëtar, i cili prej dekadash mirëpret artistë të shquar të xhazit;
- *Jazz Fest Tetova* – festival ndërkombëtar i xhazit që promovon muzikën bashkëkohore të xhazit;
- *Notafest* – festival i kushtuar muzikës së re dhe krijimtarisë autoriale, me rol të rëndësishëm edukativ dhe artistik; aktualisht nuk është aktiv;
- *Vera e Ohrit* – festivali më i rëndësishëm ndërkombëtar i muzikës klasike dhe arteve skenike në vend, i cili, përveç muzikës klasike, përfshin edhe koncerte të zhanreve të tjera muzikore;
- *Jazz Factory Festival (Manastir)* – festival ndërkombëtar i njohur në skenën evropiane dhe botërore të xhazit;
- *Astibo Jazz Festival (Shtip)* – festival i njohur për komponentin e tij edukativ.



Jazz Fest Tetova

## Aktivitete

### 1. Pyetje për diskutim

- Çfarë janë festivalet dhe koncertet e muzikës së popullarizuar dhe si dallohen ato nga njëri-tjetri?
- Pse këto ngjarje janë të rëndësishme për popullarizimin e muzikës?
- Si ndihmojnë këto ngjarje në promovimin e stileve të reja muzikore dhe interpretuesve të rinj?
- Pse festivalet dhe koncertet konsiderohen forma të komunikimit kulturor?
- Cilin festival, nga festivalet vendore ose ndërkombëtare, do të doje ta vizitoje dhe pse?
- Si i bashkon muzika njerëzit në festivale, pavarësisht moshës, gjuhës apo përkatësisë kulturore?

## Kuriozitet

### Muzika dhe truri

Muzika ka një ndikim të madh në trurin dhe trupin tonë. Ajo mund të përmirësojë humorin, të ulë stresin dhe të stimulojë memorjen. Muzika aktivizon sistemin limbik dhe hipokampusin, të cilët lidhen me emocionet dhe kujtimet. Gjithashtu, ajo stimulon korteksin motorik, duke na nxitur të lëvizim sipas ritmit.

Muzika e zhvillon kreativitetin, përqendrimin dhe të menduarit hapësinor, ndërsa mësimi i një instrumenti muzikor përmirëson koordinimin dhe aftësitë kognitive. Muzika e përzgjedhur në mënyrë të përshtatshme mund të ndihmojë edhe personat me ADHD ose ata që kanë pësuar dëmtime të trurit. Megjithatë, përzgjedhja e papërshtatshme ose dëgjimi i muzikës me volum shumë të lartë mund të shkaktojë stres ose të rikthejë kujtime të pakëndshme. Muzika i afron njerëzit me njëri-tjetrin dhe sjell gëzim, frymëzim dhe mirëqenie në jetën e përditshme.



Ndikimi i muzikës në tru

## DËGJIMI I UDHËZUAR

Dëgjimi i udhëzuar është një mënyrë e dëgjimit të muzikës, në të cilën vepra muzikore përjetohet me vëmendje dhe në mënyrë analitike, duke përfshirë në mënyrë aktive proceset e të menduarit. Ai nënkupton ndjekjen me kujdes të rrjedhës së muzikës, strukturës së saj dhe mjeteve shprehëse muzikore, si dhe kuptimin e idesë ose mesazhit që kompozitori e përcjell përmes veprës.

Gjatë dëgjimit të muzikës duhet t'u kushtohet vëmendje disa elementeve të rëndësishme: periudhës stilistike, kompozitorit dhe titullit të veprës. Më pas duhet të vëzhgohen mjetet e ndryshme shprehëse muzikore, si dinamika, tempoja, karakteri i veprës, melodia dhe ritmi. Gjithashtu, duhet të ndiqen forma muzikore dhe zhvillimi i kompozicionit. Dëgjimi aktiv nuk nënkupton vetëm "ta dëgjosh" muzikën, por ta dëgjosh atë me qëllim. Kjo do të thotë të dallohen ritmi, melodia, dinamika dhe forma, t'u përgjigjesh pyetjeve që lidhen me veprën dhe ta përshkruash muzikën me fjalë para dhe pas dëgjimit.

Këto teknika janë pjesë e qasjeve bashkëkohore të pedagogjisë muzikore, të cilat synojnë zhvillimin e ndërgjegjësimit muzikor dhe të aftësisë për dëgjim kritik.

### Udhëzime për dëgjimin e muzikës

| Kategoria               | Çfarë duhet të vërehet                                                       |
|-------------------------|------------------------------------------------------------------------------|
| stili                   | baroku, klasicizmi, romantizmi, muzika bashkëkohore                          |
| kompozitori / titulli   | emri i kompozitorit, titulli i veprës                                        |
| formacioni interpretues | solist, kor, orkestër, ansambël dhome, opera, balet                          |
| dinamika                | e qetë ose e fortë, kontraste dinamike                                       |
| tempoja                 | e shpejtë ose e ngadaltë, ndryshimet e tempos                                |
| karakteri               | i gëzueshëm, i trishtuar, dramatik, solemn                                   |
| melodia / ritmi         | motive, përsëritje, fraza                                                    |
| përmbajtja programore   | ngjarje, personazh, histori, ndjenjë                                         |
| forma / zhvillimi       | përsëritje, variacione, kontrast, formë dypjesëshe/tripjesëshe, formë sonate |
| terma muzikore          | lajtmotiv, uverturë, akt dhe skenë, duet, ari                                |
| aktivitete              | shënim i elementeve, përgjigje në pyetje, përshkrim, analizë                 |



**TEORIA E**  
**MUZI<sup>ë</sup>KËS**  
**NËPËRMJET**  
**PRAKTI<sup>ë</sup>KËS**



## TEORIA E MUZIKËS NËPËRMJET PRAKTIKËS

Teoria e muzikës bëhet më e qartë dhe më interesante kur lidhet me praktikën. Në këtë pjesë do të trajtohen shkallët muzikore, intervalet dhe akordet, ritmi, metri dhe takti, si edhe elementet e formave muzikore.

Përmes punës aktive në aplikacione për shkrimin e notave ose duke luajtur në një instrument, mund të krijojmë dhe të dëgjojmë muzikë, të eksperimentojmë me ritmin dhe melodinë, si dhe t'i zbatojmë njohuritë teorike në situata reale muzikore. Në këtë mënyrë, teoria e muzikës nuk mbetet abstrakte, por merr jetë përmes interpretimit dhe shprehjes krijuese, duke ndihmuar në kuptimin më të mirë të saj dhe në zhvillimin e talentit muzikor.

### SHKALLËT, INTERVALET DHE AKORDET

#### Të rikujtojmë!

Shkalla muzikore përbëhet nga shtatë tinguj të renditur sipas alfabetit muzikor, ku tingulli i parë përsëritet si tingulli i tetë.

Grada është vendi i një toni në një shkallë muzikore. Gradët shënohen me numra romakë (I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII).

Gjysmëtoni (Semitoni) është distanca më e vogël ndërmjet dy gradëve fqinje. Shënohet me  $1/2$ .

Toni është i përbërë nga dy gjysmëtone. Shënohet me  $1/1$ .

Tetrakordi paraqet ndarjen e një shkalle muzikore në dy pjesë të barabarta. Çdo shkallë muzikore ka një tetrakord të parë ose të poshtëm, i cili përfshin gradët I, II, III dhe IV, dhe një tetrakord të dytë ose të sipërm, që përfshin gradët V, VI, VII dhe VIII.

#### PARAQITJE GRAFIKE E SHKALLËVE MUZIKORE – SHKALLËT DUR DHE MOL

##### SHKALLA DUR

|   |     |     |     |     |     |     |      |
|---|-----|-----|-----|-----|-----|-----|------|
|   | 1/1 | 1/1 | 1/2 | 1/1 | 1/1 | 1/1 | 1/2  |
| I | II  | III | IV  | V   | VI  | VII | VIII |

##### SHKALLA MOL NATYRALE

|   |     |     |     |     |     |     |      |
|---|-----|-----|-----|-----|-----|-----|------|
|   | 1/1 | 1/2 | 1/1 | 1/1 | 1/2 | 1/1 | 1/1  |
| I | II  | III | IV  | V   | VI  | VII | VIII |

##### SHKALLA MOL HARMONIKE

|     |     |     |     |     |       |     |      |
|-----|-----|-----|-----|-----|-------|-----|------|
| 1/1 | 1/2 | 1/1 | 1/1 | 1/2 | 1 1/2 | 1/2 |      |
| I   | II  | III | IV  | V   | VI    | VII | VIII |

##### SHKALLA MOL MELODIKE (Gjatë zbritjes përdoret moli natyral)

|     |     |     |     |     |     |      |
|-----|-----|-----|-----|-----|-----|------|
| 1/1 | 1/2 | 1/1 | 1/1 | 1/1 | 1/1 | 1/2  |
| I   | II  | III | IV  | V   | VII | VIII |


## D-dur

D - dur është shkallë dur që fillon dhe mbaron me tingullin **d**. Ajo ndërtohet nga kjo renditje tingujsh: **d, e, fis, g, a, h, cis, d**. Ka dy parashenja – tingullin e ngritur **f (fis)**, dhe tingullin e ngritur **c (cis)**.


### Tetrakordi i parë (i poshtëm)

 $\frac{1}{2}$ 

### Tetrakordi i dytë (i sipërm)

 $\frac{1}{2}$ 


|           |    |    |     |     |    |    |     |      |
|-----------|----|----|-----|-----|----|----|-----|------|
| Solmizim: | re | mi | fa# | sol | la | si | do# | re   |
| Alfabet:  | d  | e  | fis | g   | a  | h  | cis | d    |
| Gradët:   | I  | II | III | IV  | V  | VI | VII | VIII |



## Aktivitete

### 1. Përgjigjuni pyetjeve

- Sa parashenja ka shkalla D – dur, cilat janë ato dhe për cilët tinguj përdoren?
- Cila është renditja e toneve dhe e gjysmëtoneve në shkallën D - dur?
- Cilat janë elementet përbërëse të shkallës D - dur?

### 2. Detyra për punë në aplikacion për shkrimin e notave

- Shkruani në çelësin e violinës shkallën D - dur me të gjitha elementet e saj.
- Shkruani të paktën nga tre intervale melodike (nga prima deri te oktava) duke u nisur nga gradi i I, IV dhe V.
- Shkruani të paktën nga tre intervale harmonike (nga prima deri te oktava) duke u nisur nga gradi i II, III, VI dhe VII.

### 3. Përdorimi i shkallës D - dur përmes këndimit dhe interpretimit

Këndoni shkallën D - dur me lëvizje ngjitëse dhe zbritëse, duke i kushtuar vëmendje intonacionit të pastër, ndërkohë që një nxënës e luan të njëjtën shkallë në tastierë, sipas shkrimit të dhënë muzikor. Pas përfundimit, nxënësi që luan zëvendësohet nga një nxënës tjetër dhe aktiviteti përsëritet.



## h – mol

## Të rikujtojmë!

Çdo shkallë dur e ka shkallën e saj paralele mol. Shkalla mol fitohet duke u nxjerrë nga shkalla dur. Grada e gjashtë e shkallës dur bëhet grada e parë e shkallës mol, ndërsa më pas renditen tonet e shkallës mol.


Shkalla h - mol është shkalla paralele mol e D - durit dhe i ka të njëjtat parshenja: **fis** dhe **cis** (ashtu si shkalla paralele).

Lloji natyral i shkallës h - mol ndërtohet sipas modelit natyral të shkallës mol, pa ngritje ose zbritje shtesë të tingujve.

Tingujt e shkallës h - mol natyrale janë: **h, cis, d, e, fis, g, a, h**.

## Tetrakordi i parë (i poshtëm)

## Tetrakordi i dytë (i sipërm)




Solmizim:

Alfabet:

Gradët:

|     |     |     |     |     |     |     |      |
|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|------|
| 1/1 |     | 1/1 | 1/1 |     | 1/1 | 1/1 |      |
| si  | do# | re  | mi  | fa# | sol | la  | si   |
| h   | cis | d   | e   | fis | g   | a   | h    |
| I   | II  | III | IV  | V   | VI  | VII | VIII |



|     |     |     |     |     |     |     |      |
|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|------|
| 1/1 | 1/2 | 1/1 | 1/1 | 1/2 | 1/1 | 1/1 |      |
| I   | II  | III | IV  | V   | VI  | VII | VIII |

Shkalla h – mol harmonike ndërtohet sipas modelit harmonik të shkallës mol, me ngritje të gradit të VII.

Tingujt e shkallës h – mol harmonike janë: **h, cis, d, e, fis, g, ais, h**.

## Tetrakordi i parë (i poshtëm)

## Tetrakordi i dytë (i sipërm)




Solmizim:

Alfabet:

Gradët:

|     |     |     |     |     |     |       |      |
|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-------|------|
| 1/1 |     | 1/1 | 1/1 |     | 1/2 | 1 1/2 | 1/2  |
| si  | do# | re  | mi  | fa# | sol | la#   | si   |
| h   | cis | d   | e   | fis | g   | ais   | h    |
| I   | II  | III | IV  | V   | VI  | VII   | VIII |



|     |     |     |     |     |       |     |      |
|-----|-----|-----|-----|-----|-------|-----|------|
| 1/1 | 1/2 | 1/1 | 1/1 | 1/2 | 1 1/2 | 1/2 |      |
| I   | II  | III | IV  | V   | VI    | VII | VIII |

Shkalla h – mol melodike ndërtohet sipas modelit melodik të shkallës mol, me ngritje të gradit të **VI** dhe **VII** gjatë ngjitjes. Gjatë zbritjes, shkalla interpretohet në formën e saj natyrale.

Tingujt e shkallës h – mol melodik janë: **h, cis, d, e, fis, gis, ais, h↑, h, a, g, fis, e, d, cis, h↓**.

**Tetrakordi i parë (i poshtëm)**      **Tetrakordi i dytë (i sipërm)**

$\frac{1}{2}$        $\frac{1}{2}$

1/1      1/1      1/1      1/1      1/1

|                  |    |     |     |    |     |      |     |      |
|------------------|----|-----|-----|----|-----|------|-----|------|
| <b>Solmizim:</b> | si | do# | re  | mi | fa# | sol# | la# | si   |
| <b>Alfabet:</b>  | h  | cis | d   | e  | fis | gis  | ais | h    |
| <b>Gradët:</b>   | I  | II  | III | IV | V   | VI   | VII | VIII |

$\frac{1}{2}$        $\frac{1}{2}$

1/1      1/1      1/1      1/1      1/1

|                  |      |     |     |     |    |     |     |    |
|------------------|------|-----|-----|-----|----|-----|-----|----|
| <b>Solmizim:</b> | si   | la  | sol | fa# | mi | re  | do# | si |
| <b>Alfabet:</b>  | h    | a   | g   | fis | e  | d   | cis | h  |
| <b>Gradët:</b>   | VIII | VII | VI  | V   | IV | III | II  | I  |

1/1       $\frac{1}{2}$       1/1      1/1      1/1      1/1       $\frac{1}{2}$

I      II      III      IV      V      VI      VII      VIII

## Aktivitetet

### 1. Përgjigjuni pyetjeve

- Cila është shkalla paralele e D - durit dhe si formohet ajo?
- Cila gradë ngrihet te shkalla h - mol harmonike?
- Çfarë ndodh me tingujt e ngritur gjatë zbritjes te shkalla h - mol melodike?

### 2. Detyra për punë në aplikacionin për shkrimin e notave

- Shkruani në çelësin e violinës shkallën h - mol në të gjitha format e saj.

### 3. Këndojmë ushtrim dyzanor në h - mol natyral

- Me ndihmën e mësimehdhënësit këndoni ushtrimin melodik dyzanor të paraqitur më poshtë. Punoni në dy grupe: grupi i parë këndon melodinë e zërit të sipërm, ndërsa grupi i dytë këndon melodinë e zërit të poshtëm. Më pas, të dy grupet e këndojnë së bashku ushtrimin e dhënë.



### 4. Këndojmë ushtrim melodik në h - mol harmonik

- Me ndihmën e mësimehdhënësit këndoni ushtrimin e mëposhtëm melodik




### 5. Interpretim praktik

- Me ndihmën e mësimehdhënësit luani në tastierë melodinë e paraqitur më poshtë.




## B-dur

B – dur është shkallë dur që fillon dhe mbaron me tingullin **b**. Përbëhet nga rradhitja e këtyre tingujve: **b, c, d, es, f, g, a, b**. Ka dy parashenja – tingullin e zbritur **h (b)**, dhe tingullin e zbritur **e (es)**.



|           |                 |    |     |                 |    |     |     |                 |
|-----------|-----------------|----|-----|-----------------|----|-----|-----|-----------------|
| Solmizim: | si <sup>b</sup> | do | re  | mi <sup>b</sup> | fa | sol | la  | si <sup>b</sup> |
| Alfabet:  | b               | c  | d   | es              | f  | g   | a   | b               |
| Gradët:   | I               | II | III | IV              | V  | VI  | VII | VIII            |



### Aktivitete

#### 1. Përgjigjuni pyetjeve

- Sa parashenja ka shkalla B – dur, cilat janë ato dhe për cilët tinguj përdoren?
- Cila është rradhitja e toneve dhe e gjysmëtoneve në shkallën B - dur?
- Cilat janë elementet përbërëse të shkallës B - dur?

#### 2. Këndoni shkallën e mëposhtme B – dur



#### 3. Detyra për punë në aplikacionin për shkrimin e notave

- Shkruani në çelësin e violiës shkallën B - dur me të gjitha elementet e saj.
- Krijoni një melodi prej tetë taktesh në shkallën B - dur, në masën 2/4, duke përdorur nota tetëshe, katërshe, gjysëm dhe pushime përkatëse, e më pas këndojeni.

## g – mol

Shkalla g – mol është paralele e B – durit dhe i ka parashenjat **b** dhe **es** (ashtu si shkalla paralele).


Lloji natyral i shkallës g - mol ndërtohet sipas modelit natyral të shkallës mol, pa ngritje ose zbritje shtesë të tingujve.

Tingujt e shkallës g – mol natyral janë: **g, a, b, c, d, es, f, g.**

### Tetrakordi i parë (i poshtëm)

 $\frac{1}{2}$ 

### Tetrakordi i dytë (i sipërm)


 $\frac{1}{2}$ 


Solmizim:

Alfabet:

Gradët:

|     |     |            |     |     |            |     |      |
|-----|-----|------------|-----|-----|------------|-----|------|
| 1/1 | 1/1 | 1/1        | 1/1 | 1/1 | 1/1        | 1/1 | 1/1  |
| sol | la  | si $\flat$ | do  | re  | mi $\flat$ | fa  | sol  |
| g   | a   | b          | c   | d   | es         | f   | g    |
| I   | II  | III        | IV  | V   | VI         | VII | VIII |



1/1  $\frac{1}{2}$  1/1 1/1  $\frac{1}{2}$  1/1 1/1  
I II III IV V VI VII VIII


Shkalla g – mol harmonike ndërtohet sipas modelit harmonik të shkallës mol, me ngritje të gradit të VII.

Tingujt e shkallës g – mol harmonike janë: **g, a, b, c, d, es, fis, g.**

### Tetrakordi i parë (i poshtëm)

 $\frac{1}{2}$ 

### Tetrakordi i dytë (i sipërm)


 $\frac{1}{2}$ 


Solmizim:

Alfabet:

Gradët:


|     |     |            |     |     |            |     |      |
|-----|-----|------------|-----|-----|------------|-----|------|
| 1/1 | 1/1 | 1/1        | 1/1 | 1/1 | 1/1        | 1/1 | 1/1  |
| sol | la  | si $\flat$ | do  | re  | mi $\flat$ | fa# | sol  |
| g   | a   | b          | c   | d   | es         | fis | g    |
| I   | II  | III        | IV  | V   | VI         | VII | VIII |




1/1  $\frac{1}{2}$  1/1 1/1  $\frac{1}{2}$  1/1  $\frac{1}{2}$   
I II III IV V VI VII VIII

Shkalla g – mol melodike ndërtohet sipas modelit melodik të shkallës mol, me ngritje të gradit të **VI** dhe **VII** gjatë ngjitjes. Gjatë zbritjes, shkalla interpretohet në formën e saj natyrale.


Tingujt e shkallës g – mol melodik janë: **g, a, b, c, d, e, fis, g↑, g, f, es, d, c, b, a, g↓.**



|                  |     |    |            |    |    |            |             |      |
|------------------|-----|----|------------|----|----|------------|-------------|------|
| <b>Solmizim:</b> | sol | la | si $\flat$ | do | re | mi $\flat$ | fa $\sharp$ | sol  |
| <b>Alfabet:</b>  | g   | a  | b          | c  | d  | e          | fis         | g    |
| <b>Gradët:</b>   | I   | II | III        | IV | V  | VI         | VII         | VIII |



|                  |      |     |            |    |    |            |    |     |
|------------------|------|-----|------------|----|----|------------|----|-----|
| <b>Solmizim:</b> | sol  | fa  | mi $\flat$ | re | do | si $\flat$ | la | sol |
| <b>Alfabet:</b>  | g    | f   | es         | d  | c  | b          | a  | g   |
| <b>Gradët:</b>   | VIII | VII | VI         | V  | IV | III        | II | I   |



## Aktivitetet

### 1. Përgjigjuni pyetjeve

- Cila është shkalla paralele e shkallës B-dur dhe si interpretohet ajo?
- Cila gradë ngrihet në shkallën g-mol harmonik?
- Çfarë ndodh me tingujt e ngritur gjatë zbritjes në shkallën g-mol melodik?

### 2. Detyra për punë në aplikacionin për shkrimin e notave

- Shkruani në çelësin e basit shkallën g-mol natyral.
- Shkruani në çelësin e violinës intervalet harmonike tercë, kuintë dhe oktavë nga gradët: I, IV dhe V të shkallës g-mol (lloji natyral).

### 3. Vizualisht dhe përmes këndimit njohim shkallët dur dhe mol deri në dy parashenja

- Analizoni këto shkrime muzikore, pastaj, përmes vëzhgimit dhe këndimit, përcaktoni se në cilën shkallë muzikore janë ndërtuar.



## Akordi

Akordi është bashkëtingëllimi i tre ose më shumë toneve me lartësi të ndryshme.

Lloji më themelor i akordit është kuintakordi ose trezërëshi, i cili përbëhet nga toni bazë, terca dhe kuinta e tij.

Kuintakordi ose trezërëshi mund të jetë dur ose mol (varësisht nga madhësia e tercës).

**Kuintakordi dur** përbëhet nga terca e madhe dhe kuinta e pastër.


### Të rikujtojmë!

Intervali është largësia ndërmjet dy tingujve në muzikë. Intervalet kryesore janë: prima, sekonda, terca, kuarta, kuinta, seksta, septima dhe oktava.

### Zgjeroni njohuritë

Dy intervale me të njëjtin emër mund të dallohen për nga lloji. Për shembull, terca mund të jetë e vogël, e madhe, e zvogëluar ose e zmadhuar. Sipas llojit, intervallet ndahen në: të pastra, të mëdhaja, të vogla, të zvogëluara dhe të zmadhuara.

Shembuj të kuintakordevë (trezërëshit) dur:



c – e – g

f – a – c

g – h – d

c – e tercë e madhe




f – a tercë e madhe

g – h tercë e madhe

c – g kuintë e pastër


f – c kuintë e pastër

g – d kuintë e pastër



**Kuintakordi mol** përbëhet nga terca e vogël dhe kuinta e pastër.

Shembuj të kuintakordevë (trezërëshit) mol:



d – f – a

e – g – h

a – c – e

d – f tercë e vogël




e – g tercë e vogël

a – c tercë e vogël

d – a kuintë e pastër

e – h kuintë e pastër

a – e kuintë e pastër



## Aktivitete

### 1. Detyra për punë në aplikacionin për shkrimin e notave

- Në aplikacionin për shkrimin e notave shkruani kuintakordet:
  - kuintakordet dur nga notat c, f dhe g;
  - kuintakordet mol nga notat d, e dhe a.

### 2. Formimi i kuintakordit dur dhe mol në tastierë

- Në tastierë ndërtoni kuintakord dur nga notat c, f dhe g.
- Në tastierë ndërtoni kuintakord mol nga notat d, e dhe a.
- Luani të dy kuintakordet dhe vëreni ndryshimin në tingëllim ndërmjet tyre.

### 3. Analizo dhe hulumto

- Me ndihmën e mësimdhënësit analizoni këto ushtrime melodike, pastaj identifikoni intervalet, akordet dhe mjetet e tjera shprehëse të përdorura (metrin - taktin, tempon dhe dinamikën).

Temë në D-dur – pjesë nga Koncerti për violinë dhe orkestër në D-dur i Ludvig van Betoven.


*Allegro ma non troppo*

Temë në B-dur – pjesë nga Koncerti për piano dhe orkestër në b-mol i Petar Iliç Çajkovskit.

*Allegro con fuoco*

## RITMI, METRI DHE TAKTI

### Sinkopa



Sinkopa krijohet kur dy tinguj të njëjtë, prej të cilëve i pari ndodhet në pjesën e patheksuar, ndërsa i dyti në pjesën e theksuar të taktit, bashkohen në një tingull të vetëm të pandërprerë. Bashkimi i këtyre dy toneve të njëjta bëhet me legaturë.

Legatura (ital.: ligare – të lidhësh) është një shenjë në formë harku, me të cilën lidhen tone (nota) me të njëjtën lartësi, në mënyrë që gjatësia e tyre të interpretohet si një ton i vetëm i pandërprerë. Legatura shënohet gjithmonë nga koka e një note deri te koka e notës së njëjtë që vjen menjëherë pas saj.

#### Të rikujtojmë!

Ritmi është radhitja dhe kombinimi i tingujve me gjatësi të ndryshme.

Metri është alternimi i vazhdueshëm i tingujve të theksuar dhe të patheksuar. Takti është njësi themelore ndërtuese dhe pjesa më e vogël e një kompozimi muzikor që është e përcaktuar metrikisht.

Pjesët e theksuara në çdo takt quhen tezë (–), ndërsa ato të patheksuara quhen arzë (˘).



Shembull:



Mund të shënohet edhe kështu:



#### Kuriozitet


Sinkopa shpesh quhet befasi ritmike, sepse e zhvendos theksin nga pjesa e theksuar e taktit drejt pjesës së patheksuar. Në këtë mënyrë, muzika tingëllon më e gjallë, më lozonjare dhe më dinamike. Është interesante se sinkopa ka rol kyç në xhaz, muzikën pop dhe muzikën popullore, duke përfaqësuar një nga tiparet e tyre ritmike dalluese.



Mund të shënohet edhe kështu:



## Paratakti



Paratakti është takt jo i plotë, i cili zakonisht plotësohet me taktin e fundit, që gjithashtu është jo i plotë. Paratakti nuk llogaritet si takti i parë.

Shembull:



## Ritmi i punktuar




Ritmi i punktuar është një dukuri ritmike, në të cilën vlera themelore e notës zgjatet me një pikë (lat.: puncta – pikë). Pika e rrit vlerën e notës për gjysmën e kohëzgjatjes së saj.

Shembull:

- Ndërtimi i notës së punktuar – nota katërshe me pikë

Pika e zgjat notën katërshe për gjysmën e gjatësisë së saj. Prandaj, në metret 2/4, 3/4 dhe 4/4, nota katërshe me pikë zgjat një rrahje e gjysmë (sa një notë katërshe dhe një notë tetëshe:  $1 + \frac{1}{2} = 1\frac{1}{2}$ )




- Ndërtimi i notës së punktuar – nota tetëshe me pikë

Pika e zgjat notën tetëshe për gjysmën e gjatësisë së saj. Prandaj, në metret 2/4, 3/4 dhe 4/4, nota tetëshe me pikë zgjat tri të katërtat e një rrahjeje (sa një notë tetëshe dhe një notë gjashtëmbëdhjetëshe:  $\frac{1}{2} + \frac{1}{4} = \frac{3}{4}$ ).




## Triola



Triola krijohet kur një vlerë e notës, në vend që të ndahet në dy pjesë, ndahet në tri pjesë të barabarta.

Triola bën pjesë në grupet ritmike (tingullore) të parregullta. Ajo shënohet me numrin 3, i cili zakonisht vendoset brenda një harku mbi ose nën notat që e përbëjnë triolën.

Shembull:




### Aktivitete

#### 1. Pyetje kuizi me përgjigje të shkurtër

- Çfarë është sinkopa?
- Me cilën shenjë zakonisht bashkohen dy tone me të njëjtën lartësi për të krijuar sinkopën?
- Çfarë është legatura?
- Çfarë është paratakti?
- A llogaritet paratakti si takti i parë? Pse?
- Çfarë është ritmi i punktuar?
- Çfarë i bën pika vlerës së notës?
- Sa zgjat nota katërshe me pikë në metret 2/4, 3/4 dhe 4/4?
- Nga cilat vlera të notës përbëhet nota katërshe me pikë?
- Sa zgjat nota tetëshe me pikë në të njëjtat metre?
- Nga cilat vlera të notës përbëhet nota tetëshe me pikë?
- Çfarë është triola?
- Si ndahet vlera e notës te triola?
- Si shënohen në shkrimin muzikor notat që e përbëjnë triolën?


## Aktivitetet


1. Taktioni ushtrime ritmike në masat 2/4, 3/4 dhe 4/4 me sinkopë, paratakt, ritëm të punktuar dhe triolë.

1. 

2. 

3. 





2. Në aplikacionin për shkrimin e notave krijoni ushtrime të shkurtra ritmike në masat 2/4, 3/4 dhe 4/4, të cilat përmbajnë sinkopa, ritëm të punktuar, triola dhe paratakt.

3. Aktivitet dëgjimor: Njohja e dukurive ritmike

*Sonata patetike* e Ludvig van Betoven (të dëgjohet hyrja – pjesa fillestare e kompozimit).

*Sonata në G – dur, koha I*, nga Ludvig van Betoven

*The Entertainer* nga Skot Xhoplin



Dëgjoni me vëmendje të tre shembujt muzikorë

Detyra juaj është që, në mënyrë të pavarur dhe përmes dëgjimit, të përcaktoni:

- në cilin shembull mbizotëron sinkopa;
- në cilin shembull dëgjohen triola;
- në cilin shembull ka ritëm të punktuar.

## ELEMENTET E FORMËS MUZIKORE DHE ZHVILLIMIT MUZIKOR

**Forma muzikore** është arkitektura e veprës muzikore. Ashtu si në arkitekturë çdo ndërtesë ka formën dhe strukturën e saj të qartë, edhe në muzikë çdo vepër muzikore ka formën e vet muzikore.

Forma muzikore është mënyra se si pjesët muzikore – motivet, frazat, fjalitë dhe tërësitë më të mëdha – renditen dhe lidhen ndërmjet tyre për të ndërtuar një tërësi muzikore të qartë dhe të përmbyllur.

**Zhvillimi muzikor** tregon se si lëviz dhe si ndryshon mendimi muzikor gjatë rrjedhës së veprës. Ai realizohet përmes:

1. Njëjtësi (përsëritjes) – nënkupton përsëritjen e të njëjtit material muzikor pa ndryshime.
2. Ngjashmërisë (variacionit) – paraqitet kur materiali muzikor përsëritet, por me ndryshime të vogla, për shembull në ritëm, në lartësinë e tingujve ose në dinamikë.
3. Kontrastit (temës së re) – paraqitet kur shfaqet një material muzikor krejtësisht i ri ose një temë e re (plotësisht e ndryshme nga materiali i mëparshëm).

Elementet ndërtuese të formës muzikore janë: motivi, fraza, fjalia dhe periudha.

- Motivi është mendimi më i vogël muzikor ritmiko-melodik.
- Faza (dytaktëshi) është tërësia më e vogël metriko-formale – grup prej dy taktesh.
- Fjalia është një mendim muzikor i përmbyllur me një përfundim harmonik – kadencë.
- Periudha është një tërësi e përmbyllur, e përbërë nga dy fjali me përmbajtje të afërt dhe të varura harmonikisht nga njëra-tjetra.

Këto elemente përbëjnë bazën për krijimin e formave më të mëdha muzikore, siç janë:

- forma dypjesëshe;
- forma tripjesëshe;
- tema me variacione;
- rondoja dhe
- forma e sonatës.

Secila prej këtyre formave ka mënyrën e vet të zhvillimit dhe organizimit muzikor.

## Kuriozitete

### Forma muzikore dhe arkitektura



Hyrja në Galerinë e Milanos

Forma muzikore dhe arkitektura shpesh mbështeten në simetri dhe përsëritje për të krijuar ndjenjën e rendit, ekuilibrit dhe harmonisë. Në muzikë, për shembull, forma tripjesëshe (ABA) ka një strukturë të qartë, në të cilën pjesa e parë përsëritet në fund, duke i dhënë dëgjuesit ndjenjën e plotësisë dhe të përmbylljes. Në mënyrë të ngjashme, në arkitekturë shumë ndërtesa klasike janë ndërtuar me një renditje simetrike të shtyllave dhe elementeve arkitekturore, gjë që i krijon vëzhguesit përshtypjen e qëndrueshmërisë dhe të një organizimi të qartë. Përsëritja dhe simetria e ndihmojnë mendjen e njeriut ta perceptojë më lehtë bukurinë dhe logjikën, si në tingull, ashtu edhe në formën vizuale.

### Forma muzikore dhe piktura



*Darka e fundit* nga Leonardo da Vinci

Në pikturë, veçanërisht në veprat klasike të artit, artistët kanë përdorur parime të ngjashme me ato të formës muzikore. Për shembull, Leonardo da Vinci, në veprën *Darka e fundit*, e ka organizuar me kujdes kompozicionin, duke i vendosur figurat në grupe të rregulluara qartë dhe me një pikë qendrore të theksuar, çka krijon ndjenjën e ritmit vizual, ekuilibrit dhe harmonisë. Në mënyrë të ngjashme, forma muzikore i organizon tingujt në një tërësi logjike, duke mundësuar zhvillimin, ndërlidhjen dhe një ndjenjë të qartë përmbylljeje. Struktura dhe përsëritja janë elemente kyçe si në muzikë, ashtu edhe në artet vizuale, sepse e ndihmojnë dëgjuesin ose vëzhguesin ta ndjekë më lehtë përmbajtjen dhe ta përjetojë atë si një tërësi të përmbyllur.



### Forma muzikore dhe poezia

Muzika dhe poezia ndërtohen mbi parime shumë të ngjashme, pasi të dyja mbështeten në ritëm, përsëritje dhe një strukturë të qartë. Motivi në muzikë mund të krahasohet me fjalën ose me një shprehje të shkurtër në poezi, si elementi më i vogël, por i dallueshëm ndërtues. Fraza i përgjigjet një vargu, në të cilin disa elemente së bashku krijojnë kuptim, ndërsa fjalia muzikore është e ngjashme me një dyvargjesh ose me një mendim të përmbyllur në poezi. Periudha, nga ana tjetër, mund të krahasohet me strofën, si një tërësi që ka logjikën, zhvillimin dhe ndjenjën e vet të përmbylljes, ku shpesh shfaqet marrëdhënia pyetje–përgjigje ose tension–qetësim.

### Forma muzikore dhe filmi



Ashtu si një film nuk përbëhet nga skena të rastësishme, por nga pjesë të lidhura logjikisht, edhe një vepër muzikore ndërtohet nga tërësi muzikore të organizuara qartë. Motivi i shkurtër muzikor mund të krahasohet me një kuadër mbresëlënës ose me një skenë të shkurtër që tërheq vëmendjen; fraza me një skenë të vogël që ka kuptimin e vet; ndërsa fjalia muzikore me një skenë të plotë, me fillim dhe fund të qartë. Periudha muzikore, nga ana tjetër, i përgjigjet një sekuence të plotë filmike, në të cilën ngjarjet janë të lidhura logjikisht dhe së bashku krijojnë ndjenjën e një tërësie të përmbyllur.

## Motivi

Në letërsi, në artet pamore dhe në fusha të tjera artistike, nocioni motiv nënkupton idenë themelore mbi të cilën ndërtohet vepra artistike.

Në muzikë, motivi është tërësia më e vogël ritmiko-melodike e formuar qartë, e cila mund të veçohet dhe të njihet me përmbajtjen muzikore. Ai mund të krahasohet me fjalën në të folur, pasi edhe fjala është njësi më e vogël kuptimore, nga e cila ndërtohen fjalitë.

Motivi zakonisht përsëritet gjatë veprës muzikore, herë në formën e tij të pandryshuar, e herë në formë të ndryshuar. Përmes këtyre përsëritjeve dhe ndryshimeve, motivi shërben si bazë për krijimin dhe zhvillimin e tërësive më të mëdha muzikore-formale.

Shembuj të motiveve

Petar Iliç Çajkovski – *Këngë pa fjalë*



Dimitri Shostakoviç – *Fugë*



Ludvig van Betoven – *Simfonia nr. 5*



Wolfgang Amadeus Mocart – *Sonata për piano në A – dur*



## Fraza (dytaktëshi)

Kur disa motive lidhen ndërmjet tyre dhe renditen brenda dy takteve, ato formojnë një frazë (dytaktësh). Dytaktëshi duhet patjetër të përmbajë dy kohë kryesore të theksuara. Nga pikëpamja melodike, tek dytaktëshi mund të zhvillohet vetëm një motiv (dytaktësh i pandashëm), ose ai mund të përmbajë përsëritjen ose variacionin e të njëjtit motiv, si edhe dy motive të ndryshme (dytaktësh i ndashëm).

### Analizoni frazën muzikore përmes dëgjimit të muzikës

Pjesë nga *Sonata për piano në A-dur*, koha I (temë me variacione), nga Wolfgang Amadeus Mocart.

- Dëgjoni fillimin e kompozimit dhe dalloni frazën muzikore dhe dy motivet.

**Frazë**

Motiv                      Motiv

Andante grazioso

Piano



## Fjalia

Fjalia është mendim muzikor i përmbyllur me një përfundim harmonik – kadencë.

Në ndërtimin e saj të rregullt, fjalia zakonisht ka katër takte (fjali e vogël) ose tetë takte (fjali e madhe).

### Analizoni fjali muzikore përmes dëgjimit të muzikës

Pjesë nga *Sonata për piano në A-dur*, koha I (temë me variacione), nga Wolfgang Amadeus Mozart.

Dëgjoni fillimin e kompozimit dhe dalloni fjalinë muzikore, frazat dhe motivet.

### Mëso më shumë

**Kadencia** është një përfundim harmonik dhe melodik në muzikë, me të cilin përmbyllet një frazë muzikore, një fjali ose një formë më e madhe muzikore, duke krijuar ndjesinë e një përfundimi të përkohshëm ose të plotë.

**Fjali**

Frazë      Frazë

Motiv      Motiv      Motiv      Motiv



## Periudha (a)

Periudha është një tërësi muzikore e formuar nga dy fjali që janë të afërta për nga përmbajtja dhe të varura harmonikisht nga njëra-tjetra. Fjalia e parë përfundon me një kadencë më pak të bindshme, ndërsa fjalia e dytë përfundon me një kadencë të plotë në tonikë.

### Analizoni periudhën muzikore përmes dëgjimit të muzikës

Pjesë nga *Sonata për piano në A-dur*, koha I (temë me variacione), nga Wolfgang Amadeus Mozart

- Dëgjoni këtë pjesë të kompozimit dhe dalloni periudhën muzikore, fjalitë, frazat dhe motivet.




a

## Periudhë

**Fjali**      **Fjali**

Frazë      Frazë      Frazë      Frazë

Motiv      Motiv      Motiv      Motiv      Motiv      Motiv      Motiv      Motiv



Analogji midis formës së periudhës muzikore dhe strukturës arkitekturore të Partenonit

Kjo fotografi e Partenonit në Athinë mund të na ndihmojë ta kuptojmë më mirë formën muzikore, veçanërisht nocionet motiv, frazë, fjali dhe periudhë.

- Çdo shtyllë mund ta përfytyrojmë si një motiv – njësia më e vogël ndërtuese, e qartë dhe e dallueshme.
- Dy shtylla së bashku formojnë një frazë, njësoj si disa motive në muzikë krijojnë një tërësi të shkurtër të përmbyllur.
- Katër shtylla formojnë një fjali – një mendim muzikor të përmbyllur.
- Tetë shtylla së bashku formojnë tërësinë arkitekturore, e cila në muzikë i përgjigjet një periudhe të përbërë nga dy fjali.


Ashtu si Partenoni është i qëndrueshëm, i ekuilibruar dhe simetrik falë organizimit të qartë të shtyllave, edhe muzika tingëllon logjike dhe e përmbyllur kur motivet, frazat dhe fjalitë organizohen në mënyrë të rregullt brenda një periudhe.

## Aktivitetet

### 1. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme

- Çfarë është motivi në muzikë?
- Sa motive ka zakonisht një frazë (dytaktësh)?
- Çfarë është fraza dhe si mund ta dallojmë gjatë dëgjimit?
- Çfarë është fjalia në muzikë?
- Sa takte kanë zakonisht fjalia e vogël dhe fjalia e madhe?
- Çfarë është periudha në muzikë dhe nga se përbëhet?
- Si mund ta dallojmë marrëdhënien pyetje–përgjigje brenda një tërësie muzikore?

### 2. Analizë e një pjese nga *Simfonia nr. 9 – Oda e gëzimit*, nga Ludwig van Beethoven



Dëgjoni me vëmendje pjesën prej 8 takteve

- Ku fillon motivi i parë dhe sa takte zgjat?
- Ku shfaqet motivi i dytë dhe a është i njëjtë me të parin apo ka ndryshime të vogla?
- Cilat takte e formojnë dytaktëshin e parë (frazën)?
- Cilat takte e formojnë dytaktëshin e dytë (frazën)?
- Ku fillon dhe ku përfundon fjalia e parë? Sa takte ka?
- Ku fillon dhe ku përfundon fjalia e dytë? Sa takte ka?
- Cila pjesë tingëllon si pyetje dhe cila si përgjigje?
- Cilat motive përsëriten gjatë kompozimit?
- Me ndihmën e tastierës, përcaktoni me cilat akorde fillojnë dhe me cilat akorde përfundojnë fjalia e parë dhe fjalia e dytë.

## Forma dypjesore (ab)

Forma dypjesore përbëhet nga dy periudha, pra nga dy pjesë që për nga gjatësia u përgjigjen periudhave. Në varësi të faktit nëse periudhat janë të vogla apo të mëdha, dallojmë: formën dypjesore të vogël, me  $2 \times 8$  takte dhe formën dypjesore të madhe, me  $2 \times 16$  takte.

Forma dypjesore shënohet si **ab**, ku shkronjat përfaqësojnë periudhat (temat).

- **a** – pjesa e parë është tema kryesore muzikore (periudha); dhe
- **b** – pjesa e dytë është një temë e re muzikore, e cila krijon një kontrast të moderuar me pjesën e parë, por për nga ndërtimi dhe gjatësia mbetet analoge me të.



a

b

### Analizoni formën dypjesore (ab) përmes dëgjimit të muzikës

*Menuet nga Jozef Hajdn*



Udhëzime për analizën përmes dëgjimit të kompozimit

- Dëgjoni kompozimin me vëmendje dhe ndiqeni në partiturë.
- Ndiqni zhvillimin e melodisë.
- Ky kompozim është një shembull i formës së vogël dypjesore, e cila përbëhet nga dy periudha (ab).
- Secila periudhë përbëhet nga dy fjali; fjalitë ndërtohen nga dy fraza, ndërsa frazat përbëhen nga motive.
- Në shembullin me nota, për ta ndjekur më lehtë, janë shënuar pjesët a dhe b, si edhe fjalitë, frazat dhe motivet.
- Edhe pse pjesët a dhe b janë të ndryshme, kontrasti ndërmjet tyre është i vogël, sepse forma është e shkurtër dhe e thjeshtë.
- Përpikuni të dalloni fillimin e pjesëve a dhe b, si edhe motivet dhe frazat që i formojnë fjalitë dhe periudhat.

### Forma dypjesore ab

#### Periudhë (a)

Fjali

Fjali



#### Periudhë (b)

Fjali

Fjali



## Forma tripjesore (aba)

Forma tripjesore përbëhet nga tri periudha, ku pjesa e parë dhe pjesa e tretë janë të njëjta ose shumë të ngjashme, ndërsa pjesa e dytë paraqet një temë muzikore kontrastuese.



Forma shënohet si **aba**, ku:

**a** – pjesa e parë është tema kryesore muzikore (periudha);

**b** – pjesa e dytë është një temë e re muzikore, e cila kontraston me pjesën e parë, por është relativisht e shkurtër dhe ndryshon për nga melodia, harmonia ose ritmi dhe

**a** – pjesa e tretë e përsërit ose e varijon temën e parë, duke krijuar ndjenjën e përmbylljes dhe të ekuilibrit.

Gjatësia e periudhave (në varësi të madhësisë së fjalive – të vogla ose të mëdha) mund të jetë e njëjtë ose e ngjashme. Në këtë mënyrë, forma tripjesore krijon një strukturë të qartë: tema kryesore – kontrasti – përsëritja e temës kryesore.

### Analizoni formën tripjesore (aba) përmes dëgjimit të muzikës

*Ekosezë nga Ludvig van Betoven*

Udhëzime për analizën përmes dëgjimit të kompozimit



- Dëgjoni kompozimin me vëmendje dhe ndiqeni në partiturë.
- Pjesa a përfaqëson një periudhë prej 8 taktesh, të përbërë nga dy fjali prej 4 taktesh secila. Fjalitë ndërtohen nga fraza muzikore (dytaktështa), ndërsa frazat përbëhen nga motive. Në këtë pjesë paraqitet ideja kryesore muzikore dhe vendoset karakteri i kompozimit.
- Pjesa b, gjithashtu, përfaqëson një periudhë prej 8 taktesh, të përbërë nga dy fjali prej 4 taktesh secila. Ashtu si në pjesën a, fjalitë ndërtohen nga fraza muzikore (dytaktështa), ndërsa frazat nga motive. Kjo pjesë sjell material të ri tematik (kontrast të lehtë) dhe për nga karakteri dhe tingëllimi dallohet qartë nga pjesa a. Kontrasti në pjesën b mund të vërehet përmes dinamikës, lëvizjes së melodisë dhe karakterit të përgjithshëm të muzikës.
- Pjesa e përsëritur a (repriza) – Pas përfundimit të pjesës b, muzika rikthehet te pjesa a, duke e përmbyllur formën. Kjo pjesë e përsëritur është e njëjtë me pjesën fillestare a.

# Forma tripjesore aba

**Fjali** Piano

## Periudhë (a)

**Fjali** Pno.

**Fjali** Pno.

## Periudhë (b)

**Fjali** Pno.

**Fjali** Pno.

## Periudhë (a)

**Fjali** Pno.

## Forma tripjesore e përbërë (ABA)



A  
a b a
B  
a b a
A  
a b a

Forma tripjesore e përbërë ndërtohet nga tri pjesë të mëdha, ku secila pjesë përfaqëson një formë të pavarur – tripjesore (aba) ose dypjesore (ab).

Skema e formës tripjesore të përbërë shënohet me shkronja të mëdha **ABA** dhe ka këtë strukturë:

- **A** është pjesa e parë (mund të ketë formë dypjesëshe ab ose tripjesëshe aba).
- **B** është pjesa e mesme, kontrastuese (gjithashtu mund të ketë formë ab ose aba), e cila harmonikisht zhvillohet në një tonalitet tjetër, të ndryshëm nga tonaliteti i pjesës A. Përveç harmonisë, kontrasti mund të realizohet edhe përmes mjeteve të tjera shprehëse muzikore, si forma, dinamika, tempoja dhe metri.
- **A** është përsëritja e pjesës së parë, e quajtur reprizë. Kjo përsëritje mund të jetë e njëjtë me temën fillestare A ose mund të varijojë (me ndryshime të vogla).

### Zgjeroni njohuritë

Forma tripjesore e përbërë ABA mund të përbëhet nga pjesë që kanë strukturë të brendshme tripjesore ose dypjesore, nga kombinime të këtyre formave ose nga një varg fjalish muzikore, ku secila pjesë ndërton tërësinë e vet muzikore.

|     |     |     |
|-----|-----|-----|
| A   | B   | A   |
| aba | aba | aba |
| ab  | ab  | ab  |
| aba | ab  | aba |
| ab  | aba | ab  |

**Menueti** (Menuetto) është një kompozim muzikor me prejardhje nga një vallëzim elegant francez, i cili më vonë u zhvillua në një formë artistike instrumentale, e përdorur në veprat instrumentale të muzikës klasike. Fillimisht, gjatë periudhës së barokut dhe të klasicizmit të hershëm, menueti paraqitej shpesh si një formë dypjesore e thjeshtë (ab), ku secila pjesë përsëritej.

Gjatë periudhës së klasicizmit, menueti u bë një pjesë e rëndësishme e ciklit të sonatës, veçanërisht si kohë e tretë në simfoni, sonata dhe vepra të muzikës së dhomës, duke u zhvilluar në formën tripjesore të përbërë ABA.

Pjesa e mesme (B) zakonisht quhet Trio.

Përsëritja e pjesës së parë A, pas përfundimit të trios (pjesës B), në partitura shënohet me Da Capo (D.C.), që do të thotë nga fillimi, deri te shenja Fine (fund).

## Analizoni formën tripjesore të përbërë (ABA) përmes dëgjimit të muzikës

*Menuet nga Sonata për piano në Es-dur, koha II, nga Jozef Hajdn*



Udhëzime për analizën përmes dëgjimit të kompozimit

- Dëgjoni kompozimin me vëmendje dhe ndiqeni në partiturë.
- Skema e kësaj forme është:

A    B    A  
aba   ab   aba

- Pjesa A – në pjesën e parë paraqitet tema kryesore muzikore, e cila e përcakton karakterin e kompozimit. Kjo pjesë ka formë tripjesore aba.
- Pjesa B – paraqitet një temë e re muzikore, e cila për nga karakteri, lëvizja, dinamika dhe harmonia ndryshon nga pjesa A, duke krijuar kontrast. Kjo pjesë ka formë dypjesore ab.
- Pjesa e përsëritur A ose repriza – pas përfundimit të pjesës B, muzika rikthehet te pjesa A. Kjo pjesë zakonisht nuk shkruhet përsëri në partiturë, por në fund të kompozimit vendoset shënimi *Menuetto da capo*, që do të thotë se kompozimi luhet përsëri nga fillimi dhe përfundon me pjesën e parë A.

**A**

**a**  
Menuetto.

**b**

**a**

**a** **B**

### Aktivitetet

#### 1. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme

- Çfarë paraqet forma muzikore dypjesore dhe si shënohet?
- Çfarë paraqet secila prej pjesëve a dhe b në formën dypjesëshe?
- Çfarë është karakteristike për formën tripjesore (aba)?
- Cila është struktura e formës tripjesore të përbërë?
- Në çfarë mënyrash mund të krijojë kontrast pjesa B me pjesën A në formën tripjesore të përbërë?
- A është gjithmonë e njëjtë përsëritja e pjesës A në formën tripjesore të përbërë apo mund të paraqitet me variacione?

#### 2. Analizë e kompozimit përmes dëgjimit të muzikës dhe ndjekjes së tekstit muzikor (partiturës)

*Valle gjermane*, nga Ludvig van Betoven

Udhëzime për dëgjim

- Dëgjoni kompozimin me vëmendje dhe ndiqeni melodinë në tekstin muzikor.
- Përpikuni të dalloni fillimet dhe përfundimet e pjesëve, si edhe përsëritjet.



## Pyetje për analizë

- Cila është tempoja e kompozimit?
- Si janë dinamika dhe karakteri i muzikës?
- Cila është forma e këtij kompozimi (dypjesëshe, tripjesëshe apo tripjesore e përbërë)?
- Ku ndodhen periudhat, fjalitë dhe motivet?
- A ka kontrast ndërmjet pjesëve?

Allegro

Valle gjermane

Ludvig van Betoven



## 3. Analizë përmes dëgjimit të muzikës

Menuet nga *Muzikë e vogël e natës*, nga Wolfgang Amadeus Mozart

## Udhëzime për analizë

- Gjatë dëgjimit, përqëndroni vëmendjen në ndjekjen e melodisë në tekstin muzikor dhe në vëzhgimin e strukturës së kompozimit.
- Përpikuni të zbuloni vetë se nga sa pjesë përbëhet kompozimi.
- Dalloni motivet, frazat, fjalitë dhe periudhat që ndërtojnë secilën tërësi.
- Vëreni nëse ndonjë pjesë përsëritet dhe nëse përsëritja është e njëjtë apo paraqitet me ndryshime të vogla.
- Kushtoni vëmendje kontrastit të veprës: si ndryshon ai për nga karakteri, lëvizja ose dinamika.



## Menuet nga Muzikë e vogël e natës

Tempo di Minuetto

Wolfgang Amadeus Mozart

**Allegretto**

**Trio**

**Menuetto da capo**

- Në fund të analizës, përgatitni një paraqitje vizuale (hartë mendore) të formës së kompozimit, duke përdorur një bllok për vizatim ose një aplikacion kompjuterik.


## Tema me variacione

Tema me variacione është një formë muzikore në të cilën tema kryesore përsëritet disa herë e ndryshuar.

Tema kryesore ka një strukturë të qartë, të thjeshtë dhe të kuptueshme, në mënyrë që karakteristikat e saj të mund të ndiqen gjatë të gjitha variacioneve. Variacionet mund ta ndryshojnë temën për sa i përket ritmit, harmonisë, tempos, dinamikës dhe elementeve të tjera muzikore.

Qëllimi është të tregohen mënyra të ndryshme të shprehjes së të njëjtës ide muzikore.

Numri i variacioneve është relativ dhe mund të jetë nga 2–3 ose më shumë, veçanërisht kur variacionet paraqiten brenda një forme ciklike. Nëse tema me variacione është një kompozim i pavarur, numri i variacioneve shpesh mund ta tejkalojë 32-shin.



Paraqitje grafike e formës Temë me variacione

### Analizoni temën me variacione përmes dëgjimit të muzikës

*Sonata për piano në A-dur, koha I (temë me variacione), nga Wolfgang Amadeus Mozart*



Udhëzime për analizën përmes dëgjimit të kompozimit

- Dëgjoni kompozimin me vëmendje dhe ndiqeni në partiturë.
- Tema paraqitet në fillim dhe ka karakter elegant.
- Më pas shfaqen variacionet, të cilat e ndryshojnë temën përmes mjeteve të ndryshme muzikore – në ritëm, dinamikë, melodi ose harmoni – ndërsa ideja kryesore muzikore mbetet e dallueshme.
- Përpikuni t'i dalloni këto ndryshime dhe mënyrat e variacionit të temës përmes dëgjimit të muzikës.

## Tema

Andante grazioso

Measures 1-14 of the Theme. The score is in 8/8 time with a key signature of two sharps (F# and C#). It features a melody in the right hand and a bass line in the left hand. Dynamics include *p* (piano), *sf* (sforzando), and *f* (forte). The tempo is marked *Andante grazioso*.

## Variacioni I

Measures 15-18 of Variation I. The score is in 8/8 time with a key signature of two sharps. It features a melody in the right hand and a bass line in the left hand. Dynamics include *p* (piano).

## Variacioni II

Measures 19-22 of Variation II. The score is in 8/8 time with a key signature of two sharps. It features a melody in the right hand and a bass line in the left hand. Dynamics include *p* (piano). The word *tr* (trill) is written above the right hand in measures 19 and 21. The word *(simile)* is written below the bass line in measure 22.

## Variacioni III

Measures 23-26 of Variation III. The score is in 8/8 time with a key signature of two sharps. It features a melody in the right hand and a bass line in the left hand. Dynamics include *p* (piano).

## Variacioni IV

Measures 27-30 of Variation IV. The score is in 8/8 time with a key signature of two sharps. It features a melody in the right hand and a bass line in the left hand. Dynamics include *p* (piano). The word *m.s.* (mezzo-soprano) is written above the right hand in measure 27.

## Variacioni V

Measures 31-34 of Variation V. The score is in 8/8 time with a key signature of two sharps. It features a melody in the right hand and a bass line in the left hand. Dynamics include *p* (piano).

## Variacioni VI

Measures 35-38 of Variation VI. The score is in 8/8 time with a key signature of two sharps. It features a melody in the right hand and a bass line in the left hand. Dynamics include *p* (piano).

## Rondoja

Rondoja është një formë muzikore e ndërtuar nga një ose më shumë tema, ku tema e parë ose tema kryesore shfaqet gjatë formës të paktën tri herë, gjithmonë në tonalitetin kryesor.


Dallohen tri lloje të rondos:

- rondoja e Kuprenit (**R K<sub>1</sub> R K<sub>2</sub> ... R**);
- rondoja klasike me një ose më shumë tema-rondo klasike me një temë - rondo me episode (**A E<sub>1</sub> A E<sub>2</sub> ... A + Kodë**); rondo klasike me dy tema (**A B A B A + Kodë**); rondo klasike me tri ose më shumë tema (**A B A C A + Kodë**);
- rondo-sonata (**A B A C A B A**).

Rondoja është përdorur më së shpeshti në kohët përmbyllëse të simfonive, koncerteve, sonatave dhe veprave të tjera të muzikës së dhomës. Meqenëse ka karakter të gëzueshëm, të gjallë, virtuozy dhe brilant, rondoja është bërë veçanërisht e përshtatshme për një finale efektive dhe brilante.

Tema kryesore, për nga forma, mund të jetë periudhë, formë e vogël dypjesore ose formë tripjesore. Ajo paraqitet gjithmonë në tonalitetin kryesor, ndërsa në paraqitjet e mëvonshme mund të jetë e variuar ose e shkurtuar.

Në fund të formës së rondos (me përjashtim të Rondos së Kuprenit) paraqitet Koda.



Paraqitje grafike e formës së rondos me tre tema ABACA + Koda

## Zgjeroni njohuritë

Rondoja, si formë muzikore, ka kaluar një zhvillim të gjatë historik. Ajo u shfaq që në shekullin XIII si një valle francez me këndim, i quajtur “këngë në valle”. Në shekullin XVI, rondoja u zhvillua si formë instrumentale. Materiali tematik quhej refren, pas të cilit pasonin pjesë me përmbajtje kontrastuese. Në shekujt XVII dhe XVIII, përfaqësuesi më tipik ishte Fransoa Kupren, i cili kompozoi rondo me kuplete. Klasikët vjenezë e zhvilluan rondon paraklasike me një temë, ndërsa gjatë periudhës së klasicizmit rondoja mori formën e saj përfundimtare, e cila vazhdon të kompozohet edhe në ditët e sotme.

Rondoja mund të paraqitet në forma të ndryshme, varësisht nga numri i temave dhe episodeve që vendosen ndërmjet tyre.

- Rondo me një temë  
Bazohet në një temë kryesore (A), e cila rikthehet vazhdimisht në formë të variuar (A<sup>1</sup>, A<sup>2</sup>, A<sup>3</sup>...), ndërsa ndërmjet paraqitjeve të saj vendosen pjesë episodike (E).  
Skema tipike është:  
A E A<sup>1</sup> E A<sup>2</sup> E A<sup>3</sup> + Kodë
- Rondo me dy tema  
Përbëhet nga dy tema të ndryshme (A dhe B), të cilat përsëriten në mënyrë të alternuar. Në fund zakonisht pason Koda.  
Skema tipike është:  
A B A B A + Kodë
- Rondo me tri tema  
Bazohet në tri tema të ndryshme (A, B dhe C), ku tema kryesore A rikthehet ndërmjet temave të tjera, ndërsa forma zakonisht përfundon me Kodë.  
Skema tipike është:  
A B A C A + Kodë

Pavarësisht llojit të rondos, tema kryesore A mbetet gjithmonë e dallueshme dhe e qëndrueshme, ndërsa episodet dhe temat e tjera sjellin kontrast dhe larmi në karakter, dinamikë dhe harmoni.

**Koda** është pjesa përmbyllëse e një vepre muzikore, e cila shtohet pas formës kryesore dhe shërben për ta përmbyllur kompozimin në mënyrë të qartë dhe të sigurt.

- Fjala kodë vjen nga italishtja coda, që do të thotë bisht.
- Ajo zakonisht paraqitet në fund të veprës.
- Në kodë mund të rikthehen elemente të temës kryesore ose të zhvillohet një material i ri, i shkurtër.
- Koda nuk sjell një formë të re, por e përforcon përfundimin dhe krijon ndjenjën e plotësisë dhe të qëndrueshmërisë.
- Në formën e rondos, koda zakonisht vjen pas rikthimit të fundit të temës A dhe e thekson kadencën përmbyllëse.

## Analizoni rondon përmes dëgjimit të muzikës

Rondo nga Sonata për piano në C-dur (koha III) nga Jozef Hajdn

Forma e kompozimit është Rondo, me skemë: A B A C A + Kodë

Udhëzime për analizën përmes dëgjimit të kompozimit



**A**  
Allegro

**B**

**A**

**C**

Dëgjoni kompozimin me vëmendje dhe ndiqeni në partiturë.

- Tema kryesore A paraqitet në fillim të kompozimit dhe ka karakter të qartë dhe lehtësisht të dallueshëm.
- Pas saj vijon pjesa B, e cila sjell material të ri tematik dhe krijon kontrast në raport me temën A.
- Më pas rikthehet tema kryesore A, kësaj here në formë të shkurtuar.
- Pas rikthimit të temës A, vijon pjesa C, e cila sjell përsëri kontrast të ri, me karakter tjetër muzikor dhe me ide të reja në krahasim me pjesët e mëparshme. Kontrasti ndërtohet përmes lëvizjes së melodisë, harmonisë dhe dinamikës.
- Në fund, tema kryesore A rikthehet përsëri, gjë që është karakteristike për formën e rondon dhe e bën atë lehtësisht të dallueshme gjatë dëgjimit.
- Koda është pjesa përmbyllëse e kompozimit, e cila shfaqet pas paraqitjes së fundit të temës kryesore A. Ajo shërben për ta përmbyllur tërësinë muzikore në mënyrë të qartë dhe bindëse.

**A**

**Koda**

## Forma e sonatës

Forma e sonatës është një nga format muzikore më të rëndësishme dhe më të përdorura në periudhën e klasicizmit, por haset edhe në veprat e barokut të vonë dhe të romantizmit. Ajo përdoret më së shpeshti në kohën e parë të sonatave, simfonive, koncerteve dhe veprave të muzikës së dhomës.

Forma e sonatës përbëhet nga tri pjesë kryesore: ekspozicioni, pjesa zhvilluese dhe repriza.

### 1. Ekspozicioni

Në ekspozicion paraqitet materiali kryesor muzikor.

- Tema e parë – paraqitet në tonalitetin kryesor dhe ka karakter të qartë dhe stabil.
- Ura (modulimi – ndryshimi i tonalitetit gjatë rrjedhës së veprës muzikore) – është pjesa moduluese që i lidh temat.
- Tema e dytë – paraqitet në një tonalitet tjetër (më së shpeshti në tonalitetin dominant ose paralel) dhe ka karakter kontrastues në raport me temën e parë.
- Pjesa përmbyllëse – e përmbyll ekspozicionin.

### 2. Pjesa zhvilluese

Në pjesën zhvilluese, kompozitori i zhvillon dhe i përpunon temat e ekspozicionit.

- Temat transformohen përmes sekuencave, modulimeve, variacioneve ritmike dhe melodike.
- Krijohet tension dhe dramatizëm.
- Tonaliteti ndryshon shpesh.

Pjesa zhvilluese është pjesa më e lirë dhe më dinamike e formës së sonatës.

### 3. Repriza

Në reprizë rikthehen temat e ekspozicionit, por tani:

- si tema e parë, ashtu edhe tema e dytë paraqiten në tonalitetin kryesor; dhe
- në këtë mënyrë vendosen ekuilibri dhe qëndrueshmëria.

### 4. Hyrja dhe Koda – sipas dëshirës së kompozitorit.



Paraqitje grafike e formës së sonatës

## Analizoni formën e sonatës përmes dëgjimit të muzikës

### Sonata për piano në G-dur (koha I) nga Ludvig van Beethoven

Forma e këtij kompozimi është formë sonate (ekspozicion + pjesë zhvilluese + reprizë).



Udhëzime për analizën përmes dëgjimit të kompozimit

- Dëgjoni kompozimin dhe njëkohësisht ndiqeni partiturën, në të cilën janë shënuar pjesët e formës së sonatës.
- Ekspozicioni: tema I + ura + tema II + pjesa përmbyllëse
- Në fillim të kompozimit paraqitet tema e parë (G-dur), e cila ka karakter dramatik.
- Në fund të temës së parë vijon pjesa kalimtare (ura), e cila çon drejt temës së dytë.

Tema e dytë (D-dur) ka karakter lirik dhe krijon kontrast me temën e parë.

- Ekspozicioni përfundon me materialin muzikor të pjesës përmbyllëse, e cila e përmbyll këtë pjesë të formës së sonatës.

Pjesa zhvilluese

- Përpunohet materiali tematik i ekspozicionit.
- Krijohet tension dhe dramatizëm.
- Në këtë shembull, pjesa zhvilluese është e shkurtër, por e ruan dinamikën muzikore.

Repriza

- Tema e parë dhe tema e dytë rikthehen në tonalitetin kryesor (G-dur).
- Në këtë mënyrë vendosen qëndrueshmëria dhe ekuilibri i formës, ndërsa kompozimi fiton një strukturë të plotë.
- Në fund paraqitet edhe një kodë e shkurtër.

Ekspozicioni  
Allegro ma non troppo  $\text{♩} = 104$

## Repriza

Musical score for the Repriza section, measures 1-12. The score is written for piano in G major, 2/4 time. It features a melody in the right hand and a bass line in the left hand. Dynamics include *f* (forte) and *p* (piano). The melody starts with a half note G, followed by a quarter note A, and then a half note B. The bass line starts with a half note G, followed by a quarter note A, and then a half note B. The melody continues with a half note C, followed by a quarter note D, and then a half note E. The bass line continues with a half note C, followed by a quarter note D, and then a half note E. The melody ends with a half note F, followed by a quarter note G, and then a half note A. The bass line ends with a half note F, followed by a quarter note G, and then a half note A.

Musical score for the Repriza section, measures 13-24. The score is written for piano in G major, 2/4 time. It features a melody in the right hand and a bass line in the left hand. Dynamics include *f* (forte) and *p* (piano). The melody starts with a half note G, followed by a quarter note A, and then a half note B. The bass line starts with a half note G, followed by a quarter note A, and then a half note B. The melody continues with a half note C, followed by a quarter note D, and then a half note E. The bass line continues with a half note C, followed by a quarter note D, and then a half note E. The melody ends with a half note F, followed by a quarter note G, and then a half note A. The bass line ends with a half note F, followed by a quarter note G, and then a half note A.

## Koda

## Aktivitete

## 1. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

- Çfarë është tema me variacione?
- Cila pjesë e muzikës ndryshon tek variacionet dhe çfarë mbetet e dallueshme?
- Cilat elemente muzikore mund të ndryshohen në variacione?
- Sa variacione kanë zakonisht veprat e periudhës së klasicizmit?
- Çfarë është rondoja dhe cila është karakteristika themelore e kësaj forme muzikore?
- Cilat janë tri pjesët kryesore të formës së sonatës?
- Çfarë ndodh në ekspozicionin e formës së sonatës?
- Në cilin tonalitet paraqitet zakonisht tema e dytë dhe si ndryshon ajo nga tema e parë?
- Çfarë është karakteristike për reprizën dhe cili është qëllimi i saj?

## 2. Analizë e formës muzikore përmes dëgjimit të muzikës

Këtë detyrë duhet ta punoni në shtëpi dhe ta prezantoni në orën mësimore.

*Gjashtë variacione të lehta për piano* nga Ludvig van Betoven

*Marshi turk* (Rondo alla Turca) nga *Sonata për piano në A-dur*, koha III, nga Wolfgang Amadeus Mozart



Mënyra e punës

- Ndahuni në dy grupe:

Grupi 1 – analizë e veprës *Gjashtë variacione të lehta për piano* nga Ludvig van Betoven

Grupi 2 – analizë e veprës *Marshi turk* (Rondo alla Turca) nga *Sonata për piano në A-dur*, koha III, nga Wolfgang Amadeus Mozart

Udhëzime për dëgjim

- Dëgjoni me vëmendje kompozimet dhe përpiquni ta ndiqni strukturën e tyre.
- Sipas nevojës, mund t'i gjeni në internet dhe t'i përdorni partiturat e kompozimeve të përmendura.
- Te tema me variacione, dalloni se ku fillon tema dhe ku paraqiten variacionet. Çfarë ndryshon në variacione: ritmi, tempoja, dinamika apo harmonia?
- Te forma e rondos, dalloni se ku fillon tema kryesore A dhe ku përsëritet ajo. Ku paraqiten temat e tjera kontrastuese?
- Kushtoni vëmendje kontrastit ndërmjet pjesëve të ndryshme, si në dinamikë, ritëm dhe karakter.
- Pasi ta përfundoni dëgjimin, përgatitni një paraqitje vizuale të formës, për ta dalluar më lehtë strukturën e kompozimit.
- Një përfaqësues nga secili grup e prezanton analizën para klasës.

## 3. Hulumtimi i formës së sonatës


- Së bashku zgjidhni një kompozim muzikor të shkruar në formë sonate. Ai mund të jetë sonatë, simfoni ose koncert.
- Dëgjoni kompozimin me vëmendje dhe përpiquni ta ndiqni strukturën e tij.
- Në kompozim shënoni:  
ekspozicionin – ku paraqiten temat kryesore: tema I, ura, tema II dhe pjesa përmbyllëse;  
pjesën zhvilluese – ku përpunohen temat;  
reprizën – ku temat rikthehen në tonalitetin kryesor.
- Përgatitni një paraqitje të shkurtër vizuale (në formën e një skeme ose harte) të strukturës së kompozimit.
- Përgatituni ta prezantoni analizën tuaj para klasës, duke i shpjeguar pjesët e shënuara dhe dallimet ndërmjet tyre.

## APLIKACIONE PËR SHKRIMIN E NOTAVE

Aplikacionet për shkrimin e notave janë mjete digjitale të krijuara për t'i ndihmuar muzikantët të shkruajnë, të redaktojnë, të dëgjojnë, të shtypin dhe të ndajnë partitura muzikore. Në vend të shkrimit tradicional me laps dhe letër, këto aplikacione u mundësojnë kompozitorëve, aranzhuesve, mësuesve dhe interpretuesve të krijojnë materiale muzikore me cilësi profesionale, duke përdorur kompjuterë ose tableta.

Aplikacionet bashkëkohore për notacion muzikor ofrojnë riprodhim realist të tingullit, integrim me MIDI, mundësi bashkëpunimi dhe mbështetje për struktura muzikore të ndërlikuara.

Rëndësia e aplikacioneve për notacion muzikor është rritur ndjeshëm me zhvillimin e prodhimit digjital të muzikës, arsimimit online dhe bashkëpunimit në distancë. Nga muzika filmike dhe orkestrimi, deri te mësimdhënia në klasë, këto mjete kanë një rol qendror në shndërrimin e ideve muzikore në kompozime të strukturuar qartë dhe lehtësisht të ndashme.



Shkrimi digjital i notave muzikore

Përdorimi i zakonshëm në praktikë:

- kompozimi dhe aranzhimi i muzikës për bende, orkestra, filma dhe videolojëra;
- përgatitja e materialeve muzikore (partiturave) për nxënës, kore dhe ansamble;
- transkriptimi i muzikës nga regjistrime audio ose MIDI;
- përgatitja e partiturave dhe e partëve individuale për interpretime live dhe publikimi dhe shpërndarja digjitale e muzikës.

Aplikacionet për shkrimin e notave janë veçanërisht të dobishme edhe për nxënësit, sepse u ndihmojnë të përgatisin më lehtë detyrat muzikore, ta dëgjojnë atë që kanë shkruar, të bëjnë korrigjime dhe t'i dorëzojnë detyrat në formë të shtypur ose digjitale.

Këto aplikacione përdoren për:

- shkrimin e melodive, ritmeve dhe akordeve;
- përgatitjen e ushtrimeve dhe detyrave muzikore;
- krijimin e kompozimeve individuale dhe
- notimin e qartë dhe të saktë të ideve muzikore.

Aplikacionet për shkrimin e notave na mundësojnë:

- ta dëgjojmë atë që kemi shkruar, gjë që na ndihmon t'i vërejmë më lehtë gabimet;
- të ndryshojmë dhe të korrigjojmë notat pa pasur nevojë për fshirje dhe rishkrim dhe
- të punojmë në mënyrë të pavarur dhe krijuese.

Në këtë mënyrë, të mësuarit bëhet më interesant dhe më aktiv.

Disa nga aplikacionet më të njohura për shkrimin e notave janë:

- *Sibelius* është një aplikacion profesional për notacion muzikor, i përdorur gjerësisht nga kompozitorë, aranzhues, mësimdhënës dhe botues për krijimin e partiturave të ndërlikuara dhe me cilësi të lartë.
- *Finale* është një aplikacion i fuqishëm dhe fleksibël për notacion muzikor, i njohur për mundësitë e shumta të personalizimit dhe kontrollin e saktë mbi shkrimin e notave.
- *Dorico* është një aplikacion bashkëkohor për notacion muzikor, i zhvilluar me fokus në një rrjedhë pune efikase, saktësi teorike dhe cilësi të lartë të notografisë.
- *MuseScore* është një aplikacion i njohur për notacion muzikor me kod të hapur, i përdorur gjerësisht nga nxënës, mësues dhe dashamirës të muzikës.
- *Notion* kombinon notacionin muzikor me riprodhim realist të tingullit dhe funksione të orientuara drejt interpretimit, prandaj është i popullarizuar ndër kompozitorët dhe interpretuesit.
- *ScoreCloud* është një aplikacion që fokusohet në shndërrimin automatik të një interpretimi live ose të hyrjeve MIDI në partiturë të shkruar.
- *LilyPond* është një sistem tekstual për notacion muzikor, i krijuar për përgatitjen e partiturave me cilësi të lartë, të gatshme për botim.
- *Capella* është një aplikacion për notacion muzikor, i përdorur gjerësisht në sistemet arsimore evropiane dhe në praktikën e muzikës korale.
- *Guitar Pro* është një aplikacion i specializuar për notacion muzikor, i dedikuar për kitaristë, basistë dhe muzikantë që përdorin tabulaturë.
- *Flat* është një aplikacion për notacion muzikor, i krijuar për bashkëpunim, arsimim dhe redaktim të partiturave në kohë reale.



# Si punon nxënësi në aplikacionin për shkrimin e notave



1

## Shkrimi i notave

- Vendosje e tingujve, ritmeve dhe akordeve
- Tastiera / MIDI tastierë



2

## Dëgjimi i asaj që kemi shkruar

- Kontrolli i saktësisë



3

## Korrigjime dhe ndryshime

- Përmirësimi i gabimeve



4

## Ruajtja e detyrës

- Ruajtja dhe shpërndarja



5

## Printimi/Dorëzimi

- Printimi i partiturave ose dorëzimi online



6

Detyra është gati!





INTERPRETIMI  
MUZIKOR DHE  
SHPREHJA  
**KREATIVE**



## INTERPRETIMI MUZIKOR DHE SHPREHJA KREATIVE



Nxënësit krijojnë muzikë

Interpretimi muzikor paraqet një proces aktiv të gjallërimit të veprave muzikore përmes këndimit, interpretimit në instrumente, vallëzimit dhe mjeteve të tjera të shprehjes muzikore. Ai nuk është vetëm një realizim teknik i notave, por edhe një mënyrë për të shprehur emocione, për të përcjellë ide dhe për të krijuar një përshtypje artistike.

Shprehja krijuese në muzikë manifestohet përmes krijimit të muzikës, aranzhimit dhe përpunimit të saj dhe është e lidhur ngushtë me stilin individual të artistit.

Interpretimi muzikor dhe shprehja kreative janë të pandashme, sepse muzika fillimisht krijohet si një akt krijues i kompozitorit, ndërsa më pas, përmes interpretimit të këngëtarit ose instrumentistit, ajo gjallërohet dhe fiton kuptimin e saj të plotë artistik.

## INTERPRETIMI VOKAL DHE LUAJTJA NË INSTRUMENTE



Nxënësit në aktivitete muzikore

Interpretimi vokal dhe luajtja në instrumente janë format themelore të interpretimit muzikor, përmes të cilave idetë dhe ndjenjat muzikore përcillen te dëgjuesi në mënyrë të qartë dhe shprehëse.

Në interpretimin vokal dhe instrumental, kompozitorët dhe muzikantët shpesh krijojnë aranzhime dhe përpunime të ndryshme të një kompozimi instrumental ose kënge. Përmes tyre përcaktohet mënyra e interpretimit, përzgjedhja dhe shpërndarja e zërave dhe instrumenteve, si dhe karakteri i përgjithshëm tingullor, duke shprehur qartë stilin dhe zhanrin e kompozimit ose të këngës.

**Aranzhimi** është mënyra se si organizohet dhe përshtatet një kompozim muzikor për interpretim, pra si shpërndahen instrumentet, zërat dhe elementet e tjera muzikore për të krijuar tingullin përfundimtar që e dëgjon publiku.

**Përpunimi** (ose aranzhimi/përpunimi) është procesi i riformulimit ose i përshtatjes së një kompozimi muzikor ekzistues, me qëllim që ai të interpretohet në një mënyrë tjetër, me një përbërje tjetër instrumentesh ose në një stil tjetër.

Përmes interpretimit muzikor dhe shprehjes krijuese mund të krijohen aranzhime ose përpunime të këngëve dhe kompozimeve instrumentale. Muzika mund të përshtatet për një mënyrë tjetër interpretimi, sipas stilit individual, idesë dhe kreativitetit të kompozitorit ose krijuesit, duke ruajtur njëkohësisht karakterin e saj themelor muzikor.

## Aktivitete

### 1. *Let It Be* nga The Beatles (karaoke)



(Versioni original)



(Versioni karaoke)



Grupi The Beatles

*Let It Be* është një nga këngët më të njohura të grupit The Beatles dhe përfaqëson një vepër të rëndësishme në zhvillimin e muzikës pop-rok. Kënga dallohet për vijën e saj të qartë melodike dhe shprehjen e fuqishme emocionale, prandaj edhe sot vazhdon të dëgjohej dhe të interpretohet gjerësisht.

#### Udhëzime për aktivitetin

- Dëgjoni këngën me vëmendje, fillimisht në versionin original, e më pas në versionin karaoke, me qëllim që ta përjetoni më mirë melodinë, ritmin dhe karakterin e këngës.
- Fillimisht mësohet teksti i këngës, ndërsa më pas teksti lidhet me melodinë, duke kënduar me dëgjim dhe me ndihmën e shoqërimit të karaokes.
- Bëhet ndarja e roleve:

Një nxënës e interpreton strofën solo

*When I find myself in times of trouble*

*Mother Mary comes to me*

*Speaking words of wisdom*

*Let it be*

Refreni interpretohet në grup (në kor, në unison), me shoqërim karaoke

*Let it be, let it be*

*Let it be, let it be*

*Whisper words of wisdom*

*Let it be*

- Gjatë këndimit, me ndihmën e mësimeve, kushtoni vëmendje elementeve themelore të teknikës vokale, si: frymëmarrjes së saktë, diksionit të qartë, intonacionit të saktë dhe përshtatjes me tempon dhe dinamikën e shoqërimit karaoke.
- Përpikuni ta shprehni karakterin dhe atmosferën e këngës (qetësinë, butësinë dhe emocionalitetin) përmes mënyrës së interpretimit.
- Ndërroni rolin e solistit, në mënyrë që më shumë nxënës të kenë mundësi të provojnë interpretimin solo.
- Në fund, interpretoni këngën në formën e saj të plotë, duke harmonizuar qartë pjesët solo dhe ato grupore, me shoqërim karaoke.

2. Interpretim kolektiv i një kënge sipas partiturës – *Dona nobis pacem* me shoqërim të akordeve të thieshta në tastierë

Më poshtë është paraqitur partitura e këngës. Kushtoni vëmendje tekstit dhe melodisë së këngës, shoqërimit me akorde të thjeshta në tastierë, si dhe tempos, dinamikës dhe formës së kompozimit.

*Dona nobis pacem* është një këngë e shkurtër dhe e thjeshtë vokale, me karakter të qetë dhe paqësor. Teksti është në gjuhën latine dhe do të thotë *Na jep paqe*, duke i dhënë këngës një mesazh universal për paqen dhe harmoninë.

Kënga është me prejardhje evropiane dhe më së shpeshti lidhet me traditën muzikore gjermane. Autori i saj është i panjohur, prandaj konsiderohet një melodi anonime dhe tradicionale. Me kalimin e kohës ajo është përcjellë gojarisht dhe është interpretuar në kontekste të ndryshme, më së shumti si një melodi e butë njëzërëshe.

Për shkak të thjeshtësisë së saj, vijës së qartë melodike dhe mesazhit të fuqishëm për paqen, *Dona nobis pacem* edhe sot përdoret si këngë për këndim, për interpretim vokal dhe për edukim muzikor.

*Dona nobis pacem*  
(Na jep page)

Andantino

Anonim

Do-na no-bis pa-cem. Do-na no-bis pa-cem.

cem. Do-na no-bis pa-cem. Do-na no-bis pa-cem.

Do-na no-bis pa-cem. Do-na no-bis pa-cem.

## Rrjedha e aktivitetit

- Dëgjoni me vëmendje melodinë e këngës *Dona nobis pacem*. Përpiquni të dalloni karakterin dhe atmosferën e këngës.
- Mësojeni tekstin gradualisht, duke i kushtuar vëmendje shqiptimit të saktë dhe diksionit të qartë. Njihuni me kuptimin e tekstit, në mënyrë që ta lidhni më lehtë përmbajtjen me muzikën.
- Duke ndjekur partiturën, mësojeni kompozimin nga fillimi deri në fund. Kushtoni vëmendje toneve të larta, kërcimeve melodike dhe vlerave ritmike.

- Interpretimi melodinë me tekst, fillimisht pjesë-pjesë, e më pas si një tërësi. Kushtoni vëmendje rrjedhës së frazës muzikore.
- Zbatoni tempon dhe dinamikën e përshtatshme, në përputhje me karakterin e këngës. Kushtoni vëmendje frazimit dhe frymëmarrjes së saktë.
- Këndojeni këngën së bashku, duke synuar një tingull të harmonizuar koral. Dëgjoheni njëri-tjetrin dhe ruani ekuilibrin ndërmjet zërave.
- Njëri nga nxënësit interpreton në tastierë akordet e thjeshta të shënuara në partiturë, si shoqërim të këndimit. Nxënësit mund të ndërrohen në këtë rol.
- Kushtoni vëmendje qëndrimit të drejtë të trupit, frymëmarrjes së kontrolluar, tingullit të pastër, si dhe shprehjes që pasqyron karakterin e qetë dhe paqësor të këngës.
- Në fund, jepni një vlerësim të argumentuar për interpretimin, duke përdorur terminologjinë përkatëse muzikore (ritmi, dinamika, tempoja etj.).

### 3. Të formojmë një rok-bend në orën e mësimi

#### Interpretim solo dhe në grup i një kënge rok me dëgjim, me shoqërim instrumental



Si shembull për punë mund të përdoret kënga *You Give Love a Bad Name* nga Bon Xhovi (Bon Jovi).

Sipas dëshirës, mund të zgjidhni edhe një këngë nga grupe rok të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si Superhiks, Elita 5, Leb i Sol e të tjera.



Grupi Bon Jovi

Bon Xhovi është një grup rok amerikan nga Nju Xhersi, i themeluar në vitin 1983. Vokalisti kryesor është Xhon Bon Xhovi, ndërsa grupi përbëhet edhe nga Riçi Sambora (kitarë), Dejvid Brajan (tastierë), Tiko Tores (bateri) dhe Hju MkDonald (bas-kitarë). Ata interpretojnë hard rok dhe pop-rok, të karakterizuar nga melodi të fuqishme dhe refrene lehtësisht të mbajtura në mend.

Ndër këngët e tyre më të njohura janë *Livin' on a Prayer*, *You Give Love a Bad Name*, *Wanted Dead or Alive* dhe *It's My Life*. Grupi u bë i famshëm në mbarë botën gjatë viteve '80, ndërsa muzika e tyre njihet për ndërthurjen e energjisë së rokut me melodiozitetin, gjë që i bën këngët të lehta për t'u kënduar edhe me dëgjim.

#### Rrjedha e aktivitetit

- Dëgjoni me vëmendje këngën rok të përzgjedhur. Kushtoni vëmendje ritmit, karakterit, formës dhe mënyrës së interpretimit.

- Përpikuni ta dalloni dhe ta këndonit melodinë kryesore me dëgjim, fillimisht së bashku, e më pas edhe solo, sipas dëshirës.
- Me ndihmën e mësimitdhënësit krijoni një shoqërim të thjeshtë ritmik, duke përdorur instrumente ritmike (daulle e vogël, shejker etj.). Kujdesuni që ritmi të jetë i qëndrueshëm dhe i harmonizuar me këngën.
- Me ndihmën e mësimitdhënësit, në tastierë ose në kitarë, krijoni një shoqërim të thjeshtë tonal dhe harmonik, duke përdorur intervale dhe akorde bazë. Shoqërimi duhet ta mbështesë melodinë dhe ritmin e këngës.
- Një ose disa nxënës mund ta këndojnë këngën solo, ndërsa të tjerët marrin pjesë në këndimin në grup, duke krijuar një tingull kolektiv.
- Gjatë interpretimit, përpikuni të përcillni karakterin energjik dhe dinamik të muzikës rok, përmes një shprehjeje të përshtatshme vokale dhe pranisë skenike.



Këngëtare me etnostil modern

#### 4. Aranzhimi dhe përpunimi i një kënge popullore për interpretim bashkëkohor

Shumë muzikantë dhe grupe në mbarë botën punojnë me melodi tradicionale dhe i përshtatin ato në aranzhime bashkëkohore. Për shembull, Lorena Mekkenit (Loreena McKennitt) kombinon motive popullore kelte dhe motive të muzikës botërore me stile bashkëkohore, ndërsa Dip Forest (Deep Forest) përdor këngë etno nga kultura të ndryshme dhe i ndërthur ato me muzikën elektronike. Jo Jo Ma (Yo-Yo Ma) dhe Silk Road Ensemble (Silk Road Ensemble) kombinojnë melodi tradicionale nga kultura të ndryshme në interpretime bashkëkohore.

Në rajon, grupe maqedonase si Sintezis, Next Time dhe Ljubojna krijojnë përpunime bashkëkohore të këngëve popullore maqedonase.

Këngëtarët shqiptarë Eda Zari dhe Elina Duni kombinojnë meloditë popullore shqiptare me stile muzikore bashkëkohore. Muzikantë turq, si Merxhan Dede dhe Taksim Trio, përpunojnë këngë popullore turke me aranzhime elektronike dhe bashkëkohore. Ansamble rome, si Taraf de Hajdoks (Taraf de Haïdouks), përshtatin meloditë tradicionale rome në interpretime ndërkombëtare.

Këta shembuj tregojnë se si muzika tradicionale mund të gjallërohet dhe të marrë një tingull bashkëkohor përmes aranzhimeve dhe përpunimeve të reja, duke ruajtur njëkohësisht melodinë e saj origjinale dhe frymën kulturore.

- Zgjidhni një këngë popullore sipas dëshirës suaj. Ajo mund të jetë maqedonase, shqiptare, turke, rome, serbe, vllehe ose boshnjake.
- Krijoni planin tuaj (me ndihmën e mësimitdhënësit) se si kënga mund të tingëllojë në një version bashkëkohor, duke ruajtur të njëjtën melodi, por me një aranzhim dhe përpunim të ri. Mendoni se si mund ta përshtatni këngën me stilin e sotëm muzikor. Mund të përdorni: instrumente të ndryshme (tastierë, kitarë, bateri etj.); ndryshime ritmike; figura ritmike moderne ose sinkopa; shoqërim harmonik me akorde bazë; përpunim vokal (solo ose në grup); dhe ndryshime të tempos ose të dinamikës për të krijuar një ndjesi të re.

Qëllimi është të ruani melodinë burimore, por ta shndërroni atë në një version bashkëkohor dhe interesant, duke përdorur kreativitetin tuaj.

- Prezantoni para klasës përpunimin dhe aranzhimin tuaj, duke shpjeguar elementet muzikore që keni përdorur.



Loreena McKennitt

## SINKRETIZMI – MUZIKA DHE ARTET TJERA

Sinkretizmi, si mënyrë e ndërthurjes së arteve, paraqet një formë të përshtatshme dhe të adaptuar përmes së cilës mund të shprehet kreativiteti artistik. Përmes kësaj forme zhvillohen aftësitë artistike dhe nxitet imagjinata krijuese, sepse nxënësit kanë mundësi të eksperimentojnë me muzikën, lëvizjen, fjalën dhe shprehjen vizuale, duke krijuar zgjidhjet e tyre kreative.



Fotografi nga formë sinkretike  
– mjuzikëll

### Aktivitete



#### 1. Interpretim muzikor-skenik (mjuzikëll)

*You're the One That I Want* është një këngë e interpretuar nga aktori dhe këngëtari amerikan Xhon Travolta dhe këngëtarja dhe aktorja anglo-australiane Olivia Njutn-Xhon për versionin filmik të mjuzikllit *Grease* të vitit 1978. Autor dhe producent i këngës është Xhon Farar dhe është publikuar si singli i dytë nga *Grease: The Original Soundtrack from the Motion Picture*.

Kjo këngë dhe interpretimi i saj përfaqësojnë një formë sinkretike artistike, sepse ndërthurin këndimin, interpretimin skenik, shoqërimin muzikor dhe koreografinë (vallëzimin). Në këtë mënyrë krijohet një tërësi artistike komplekse, ku muzika, lëvizja dhe drama bashkohen për të përcjellë emocione dhe për të rrëfyer një histori. Duke u bazuar në mjuzikllin *Grease* (ose në një muzikël tjetër sipas përzgjedhjes suaj), përgatitni një interpretim të ngjashëm muzikor-skenik dhe paraqiteni atë para klasës. Të njëjtin interpretim mund ta prezantoni edhe në një program shkollor ose në një manifestim publik.

Në kodin QR të bashkëngjitur gjendet një shembull i një interpretimi skenik shkollor, nga i cili mund të frymëzoheni gjatë përgatitjes.

Plan për përgatitjen e një interpretimi muzikor-skenik

Përzgjedhja e materialit

- zgjidhni një këngë nga një mjuzikëll (*Grease, High School Musical* etj.); dhe
- vendosni nëse interpretimi do të jetë një skenë e shkurtër, një këngë me koreografi ose një miniperformancë (3–5 minuta).

Formimi i grupeve dhe ndarja e roleve

Ndahuni në grupe dhe secili grup të ketë një detyrë konkrete:

- Solistët – këngëtarët kryesorë;
- Grupi i këndimit në grup (kori) – vokalet shoqëruese;
- Instrumentistët – shoqërim instrumental live ose mbështetje ritmike;
- Grupi i vallëzimit / koreografisë – lëvizja dhe shprehja skenike;
- Aktorët – shprehja, lëvizja dhe komunikimi skenik;
- Kostumet dhe skenografia – veshja, rekuizitat dhe hapësira skenike;
- Ndriçimi dhe efektet vizuale – sipas mundësive teknike.

Përgatitja muzikore

- ushtrimi i melodisë, tekstit dhe ritmit;
- puna me dinamikën, artikulimin dhe interpretimin e përbashkët dhe
- harmonizimi i këngëtarëve me shoqërimin instrumental.

Koreografia dhe lëvizja skenike

- krijimi i një koreografie të thjeshtë dhe të përshtatshme;
- harmonizimi i lëvizjes me muzikën dhe tekstin dhe
- ushtrimi i hyrjeve, daljeve dhe pozicioneve në skenë.

Skenografia dhe kostumet

- përzgjedhja e kostumeve të thjeshta që mbështesin karakterin dhe atmosferën;
- përgatitja e një skenografie bazë (karrige, rekuizita, sfond) dhe
- harmonizimi i ngjyrave dhe stilit.

Bashkimi i të gjithë elementeve

- provë e përbashkët me:
- këndim;
- shoqërim instrumental;
- lëvizje dhe interpretim skenik dhe
- kontrolli i kohëzgjatjes dhe koordinimi i plotë.

Prova gjenerale

- interpretimi pa ndërprerje, sikur të ishte në një skenë të vërtetë;
- kontrolli i ndriçimit, hapësirës dhe sjelljes skenike dhe
- korrigjimet përfundimtare.

Interpretimi publik

Paraqitja e performancës:

- para klasës ose në një program shkollor.

Respektimi i kulturës skenike dhe i punës në ekip.



## 2. Përzgjedhja dhe redaktimi i muzikës për një program shkollor

Ky aktivitet e paraqet muzikën si një element artistik sinkretik, i cili, së bashku me të folurin, lëvizjen dhe interpretimin skenik, krijon një vepër të plotë dramatike-skenike.

Përshkrimi i aktivitetit

Përgatitni një program shkollor (shfaqje dramatike me muzikë), në të cilin muzika nuk do të jetë vetëm shoqërim, por do të bëhet pjesë përbërëse e veprimit dramatik. Muzika duhet ta ndjekë dhe ta formësojë në mënyrë aktive skenën, duke theksuar atmosferën, lëvizjen dhe emocionet e personazheve.

Rezultati përfundimtar është një interpretim i plotë skenik – një dramë me muzikë, e paraqitur para publikut.

Organizimi dhe rolet

- aktorët;
- solistët dhe grupi i këndimit;
- instrumentistët;
- TIK – redaktimi i muzikës;
- koreografia;
- skenografia, kostumet dhe ndriçimi.

Procesi i punës

- Përzgjedhja e përmbajtjes dramatike

Zgjidhni

- një dramë të shkurtër, një tregim skenik ose një dramatizim; dhe
- një temë (jeta shkollore, miqësia, familja, tradita etj.).
- përcaktoni skenat në të cilat muzika do të jetë pjesë e veprimit dramatik.
- krijoni muzikë për skenat

Për secilën skenë

Krijoni:

- fraza të shkurtra muzikore (hyrje, kalim, kulminacion dhe përfundim).

Përdorni:

- aplikacione për shkrimin e notave;
- programe muzikore për krijim dhe redaktim dhe
- instrumente muzikore.



Fotografi nga shfaqje shkollore



Redaktim muzikor



Redaktim muzikor nga nxënësit

### Redaktimi muzikor në funksion të dramës

Formësoni muzikën duke përdorur:

- ndryshimin e ritmit (tension, lëvizje, qetësi);
- ndryshimin e melodisë (atmosferë, drejtim) dhe
- ndryshimin e dinamikës (intensitet emocional).

Çdo ndryshim bëhet me qëllim që ta përforcojë veprimin dramatik.

- Lidhni muzikën, të folurën dhe lëvizjet

Harmonizohen:

- teksti;
- lëvizja skenike dhe
- frazat muzikore.

Prova gjenerale dhe interpretimi

- prova e plotë e shfaqjes;
- programi përfundimtar shkollor / shfaqja dramatike me muzikë dhe
- paraqitja para publikut (nxënësve, mësime dhënëse dhe prindërve).



Prova skenike



Interpretimi i muzikës përmes mjeteve digjitale



Prova gjenerale



Përfundimi i shfaqjes

## PUNË ME FRAGMENTE TË SHKURTRA MUZIKORE PËRMES APLIKACIONEVE PËR SHKRIMIN E NOTAVE

Punë me aplikacion për shkrimin e notave



Mësimdhënia bashkëkohore e muzikës e përdor gjithnjë e më shumë teknologjinë digjitale si mjet për shprehje kreative dhe për krijimin aktiv të muzikës. Aplikacionet për shkrimin e notave mundësojnë krijimin, dëgjimin, redaktimin dhe analizimin e muzikës në mënyrë të thjeshtë, edhe pa njohuri të avancuara instrumentale.

Puna me fragmente të shkurtra muzikore (motive dhe fraza) ndihmon në zhvillimin e mendimit muzikor, dëgjimit muzikor dhe krijimtarisë.

Me ndihmën e aplikacioneve për shkrimin e notave mundësohet:

- vendosja e notave dhe e ritmit;
- dëgjimi i muzikës së shkruar;
- ndryshimi i lartësisë së tingujve, ritmit dhe dinamikës dhe
- eksperimentimi me ide të ndryshme muzikore.

Kjo krijon një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet teorisë dhe tingullit, si dhe mundëson krijimin e muzikës përmes praktikës.

Gjatë punës me fragmente të shkurtra muzikore në aplikacionet për shkrimin e notave mund të zbatohen transponimi, sekuenca, ndarja e motivit dhe imitacioni.

**Transponimi** është bartja e një tërësie muzikore (motivi, fraze ose melodie) në një tonalitet tjetër ose në një lartësi tjetër tonale, duke ruajtur të njëjtat marrëdhënie intervalore.

**Sekuenca** është përsëritja e një motivi ose fraze muzikore në një lartësi tjetër tonale, zakonisht në ngjitje ose në zbritje graduale, duke ruajtur ritmin dhe strukturën intervalore.

**Ndarja e motivit** është një procedurë në të cilën nga një melodi ose temë veçohet një motiv i shkurtër, i cili më pas zhvillohet, përsëritet ose variohet në mënyrë të pavarur.

**Imitacioni** është një teknikë në të cilën një vijë melodike ose një motiv përsëritet në një zë tjetër ose instrument tjetër, pas një intervali të caktuar kohor ose në një lartësi tjetër tonale.

## Aktivitete

## 1. Krijimi i frazave muzikore

## Rrjedha e aktivitetit

- Në një aplikacion për shkrimin e notave krijoni një frazë të thjeshtë muzikore prej 4 deri në 8 takte.
- Zgjidhni një shkallë sipas dëshirës suaj (dur ose mol, me deri në dy parashenja).
- Shkruani frazën në masën 2/4, 3/4 ose 4/4.
- Përdorni ritëm të punktuar, sinkopë dhe triolë.
- Dëgjoni frazën e krijuar dhe kontrolloni nëse është e nevojshme të bëni ndryshime për një interpretim më të mirë.

## 2. Transponimi i një melodie nga C-dur në D-dur

- Duke përdorur një aplikacion digjital për shkrimin e notave, transpononi këtë melodi në tonalitetin D-dur.



### 3. Transponimi i një melodie nga C-dur në B-dur

- Duke përdorur një aplikacion digjital për shkrimin e notave, transpononi këtë melodi në tonalitetin B-dur.



#### 4. Modifikimi i frazave muzikore

## Andante



Duke përdorur një aplikacion për shkrimin e notave, modifikoni frazat e melodisë së mësipërme duke ndryshuar:


- ritmin (ritëm i punktuar, triola, sinkopa etj.);
- lëvizjen e melodisë (lëvizje ngjithëse ose zbritëse);
- dinamikën (piano, forte, cresc., decresc.) dhe
- tempon (Adagio, Allegro).

Dëgjoni frazën e modifikuar dhe shpjegoni se si këto ndryshime ndikojnë në shprehjen dhe karakterin e muzikës.



# V

TRASHËGIMIA  
KULTURORE  
MUZIKORE



## TRASHËGIMIA KULTURORE MUZIKORE

Muzika është një nga shprehjet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, e cila pasqyron historinë, zakonet dhe traditat e popujve. Në këtë temë do të njihemi me muzikën në zakonet e Maqedonisë së Veriut, si dhe me trashëgiminë kulturore muzikore në rajon, në Evropë dhe në botë, për të kuptuar vlerën universale të muzikës dhe rolin e saj në formësimin e traditës kulturore dhe artistike.

### MUZIKA NË ZAKONET DHE TRADITAT E POPULLIT MAQEDONAS DHE TË POPUJVE QË JETOJNË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Muzika ka pasur gjithmonë një rol të rëndësishëm në jetën e popullit. Ajo është e pranishme në festat, kremtimet fetare dhe familjare, dasmat, korrjet dhe gëzimet popullore. Përmes këngëve dhe muzikës instrumentale përcillen historia, traditat dhe vlerat kulturore nga një brez te tjetri. Në këtë mënyrë, muzika nuk është vetëm argëtim, por edhe pjesë e identitetit dhe e jetës së përditshme të njerëzve

#### Tradita përmes zakoneve dhe riteve

Tradita muzikore-folklorike e një shoqërie përfaqëson një tërësi njohurish muzikore, praktikash dhe repertoresh, të cilat janë karakteristike për një komunitet të caktuar. Ajo është e lidhur ngushtë me zakonet dhe ritualet popullore. Zakoni është një mënyrë tradicionale e sjelljes, e cila përsëritet në raste të caktuara, ndërsa rituali është një akt solemn me kuptim simbolik ose fetar, që zhvillohet sipas rregullave të përcaktuara. Tradita lidhet ngushtë me mjedisin ku është krijuar, me zhvillimin historik dhe me ndikimet që kanë formësuar rrjedhën e saj. Tradita muzikore-folklorike është zhvilluar kryesisht në mjedise fshatare dhe patriarkale. Ajo ka karakter lokal, përcillet gojarisht, karakterizohet nga variantet dhe kolektiviteti, si dhe është e lidhur ngushtë me jetën e komunitetit.



## Këngët dhe vallet e lidhura me ritet dhe traditat

Këngët dhe vallet që shoqërojnë ritualet dhe traditat kanë një rol të veçantë në jetën e komunitetit. Ato interpretohen në dasma, pagëzime, festa fetare dhe zakone sezonale dhe shërbejnë si mjet për shprehjen e gëzimit, pikëllimit, mirënjohjes ose respektit. Përmes tyre ruhen zakonet e vjetra, përcillen vlerat morale dhe kulturore dhe nxitet fryma e bashkësisë ndërmjet anëtarëve të komunitetit. Krahas shprehjes muzikore, këto këngë dhe valle shpesh përfshijnë lëvizje dhe rituale të veçanta, të cilat theksojnë simbolikën e ritit.

Disa rite shoqërohen vetëm me këngë, të tjera vetëm me valle, ndërsa disa të tjera me kombinimin e valleve dhe këngëve, siç janë këngët e valleve. Këto këngë përbëjnë një ndërthurje të poezisë, muzikës dhe lëvizjes. Ato interpretohen më së shpeshti në hapësira të hapura, gjatë tubimeve të njerëzve, si pjesë e procesioneve pranverore dhe e zakoneve të *Pashkëve*, ditës së *Shëngjergjit*, verës, syneve dhe dasmave. Në të kaluarën ato kishin edhe domethënie magjike, ndërsa sot shërbejnë si shprehje vizuale dhe muzikore e traditës kolektive. Këngët dhe vallet rituale ndahen në rituale kalendarike dhe rituale të lidhura me ciklin jetësor.

Në traditën maqedonase, ritualet kalendarike lidhen me festa dhe zakone të ndryshme gjatë vitit. Ato përfshijnë këngët rituale të *Varvarës*, *Krishtlindjes*, *Ujit të Bekuar* (Vodici), *Lazarit*, *Pashkëve*, ditës së *Shëngjergjit* dhe këngë të tjera rituale, si edhe zakone që lidhen me magjinë e pjellorisë, punës dhe veprimtarisë së përditshme, ndër të cilat bëjnë pjesë edhe *ritualet e Dodollës*.

Në traditën shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, këngët dhe vallet rituale janë pjesë e formave më të hershme sinkretike të ciklit vjetor, të lidhura me festat e kalendarit popullor, si *Buzmit*, *ritualet me maska*, kremtimi i *Letnikut*, zakonet e ditës së *Shëngjergjit* të lidhura me ditën e *Luleve*, ritualet e *Dodollës*, *ritualet e punës* dhe festat e *Bajramit*.

Edhe komuniteti turk në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka një traditë të pasur të këngëve dhe valleve rituale, të cilat interpretohen gjatë riteve fetare, familjare dhe sezonale.

Tradita rome përfshin ritualet festive dhe familjare, ndërsa veçanërisht të njohura janë këngët dhe vallet që lidhen me festën e *Ederlezit* (ditës së *Shëngjergjit*).

Edhe në traditën boshnjake, serbe dhe vllehe, këngët dhe vallet rituale kanë një rol të rëndësishëm në shënimin e festave fetare, zakoneve familjare dhe ngjarjeve të ciklit jetësor.

Këto tradita përbëjnë një segment të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore të Maqedonisë së Veriut dhe kontribuojnë në ruajtjen e identitetit të tyre kombëtar dhe shpirtëror.

### Zgjeroni njohuritë

**Këngët rituale të Varvarës** – lidhen me kremtimin e festës së Shën Varvarës dhe me ritualet për shërimin e bagëtive; kremtohen në fshatrat e maleve të Osogovës.

**Këngët e Krishtlindjes** – këndohen gjatë agjërimit të Krishtlindjes dhe në vetë festën e Krishtlindjes.

**Buzmi** – festa dimërore në traditën shqiptare, të lidhura me Natën e Buzmit, Kolendrat dhe Krishtlindjen.

**Këngët gjatë ritualeve me maska** – interpretohen për pjellori dhe mbarësi të të korrave bujqësore.

**Këngët e Ujit të bekuar** – lidhen me festën e Ujit të bekuar.

**Këngët e Lazarit** – u kushtohen personave ose dukurive të ndryshme dhe përmbajnë urime për një jetë më të mirë.

**Këngët e Pashkëve** – me elemente mitologjike, të lidhura me qenie të mbinatyrshme si murtaja, llamjat dhe zanat.

**Letniku** – festë e shoqëruar me këngë magjiko-fetare për të fituar dashamirësinë e forcave të natyrës (tradita shqiptare).

**Këngët e ditës së Shëngjergjit** – lidhen me mbledhjen e bimëve mjekësore dhe me ritualet për pjellori dhe shëndet.

**Këngët e punës** – këngë të korrjes, të kultivimit të orizit dhe të bletarisë.

**Këngët e Bajramit** – këndohen për Fitër Bajram dhe Kurban Bajram (tradita shqiptare, turke, boshnjake dhe rome).

**Ritualet dhe këngët e Dodollës** – ritualet më të hershme, të lidhura me ujin dhe lutjet për shi.

**Ninullat** – këngë për qetësimin dhe vënien në gjumë të fëmijës.

**Këngët e lojërave për fëmijë** – këndohen me rastin e hapave të parë, prerjes së thonjve ose flokëve dhe në momente të tjera të rëndësishme.

**Lozonjare** – këngë të shkurtra melopoetike me përmbajtje humoristike, që përdoren gjatë lojës.

**Numëroret** – vargje me rimë që përdoren për ndarjen e roleve në lojë.

**Këngët e synetisë** – këngë myslimane shqiptare, turke dhe boshnjake që interpretohen me rastin e synetisë së djemve.

**Këngët e dasmës** – këngë që shoqërojnë ritualet dhe ceremonitë martesore.

**Vajtimet** – këngë rituale që lidhen me vdekjen dhe zakonet mortore.

## Aktivitete

### 1. Pyetje për diskutim

- Si kontribuojnë muzika dhe vallet në ruajtjen e traditës dhe të identitetit kulturor të komunitetit?
- Përse këngët dhe vallet rituale lidhen me festa, rite ose cikle të caktuara jetësore të njerëzve?
- Cilat janë dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet këngëve dhe valleve rituale të bashkësitë e ndryshme etnike në Maqedoninë e Veriut?

### 2. Hulumtimi i këngëve dhe valleve rituale

Ndahuni në grupe dhe zgjidhni një zakon ose traditë nga kultura maqedonase, shqiptare, turke ose rome, apo nga kulturat e bashkësive të tjera etnike.

- Mblidhni të dhëna për kuptimin e zakonit, mënyrat e realizimit të tij dhe rolin e muzikës në ritual.
- Zgjidhni nga një shembull të një kënge ose valleje dhe analizoni ritmin, melodinë, strukturën dhe instrumentariumin.
- Diskutoni në grup se si muzika e thekson kuptimin e ritualit dhe si i lidh pjesëmarrësit me traditën.
- Përgatitni një prezantim të shkurtër me slajde ose poster, në të cilin do t'i paraqitni rezultatet e hulumtimit tuaj.

## Këngët dhe vallet e dasmave në Maqedoninë e Veriut

Këngët dhe vallet e dasmës janë pjesë e zakoneve dhe ritualeve të ciklit jetësor. Dasma është një nga momentet më të rëndësishme në jetën e njeriut dhe përfaqëson një model të rëndësishëm sociokulturor në kuadër të ritualeve familjare.

Në traditën maqedonase të dasmës, figurat qendrore të ritualit janë nusja dhe dhëndri. Krahas tyre, rol të rëndësishëm kanë kumbari, kryekrushku, vëllai i nuses, vëllai i dhëndrit (kunati) dhe krushqit e tjerë që marrin pjesë në ceremoni. Rituali i dasmës shoqërohet me këngë, të cilat interpretohen në momente të caktuara rituale dhe sipas një rendi të përcaktuar. Kështu, këngët këndohen gjatë përgatitjes së pogaçes, thurjes së rrogozinës, rruajtjes së dhëndrit, zbukurimit të flamurit të dasmës gjatë marrjes së nuses dhe në çastin e përshëndetjes së saj me familjarët më të afërt, si edhe në momente të tjera solemne.



Përcjellja e nuses



Dasma e Galiçnikut

Ritet martesore maqedonase përfshijnë valle dhe vallëzime të ndryshme tradicionale, të cilat interpretohen gjatë kremtimit të dasmës. Për shembull, *Svadbarsko* është një nga vallet më të njohura të dasmës, që kërcëhet me lëvizje të qeta në gjysmërreth, ku valltarët mbahen për supë. *Teshkoto* është një valle burrash, ndërsa *Nevestinsko oro*, *Svekrvino oro* dhe *Pajdushka* janë shembuj të tjerë të njohur.

Në ruajtjen e trashëgimisë muzikore dhe rituale maqedonase, një vend të veçantë zë festivali *Dasma e Galiçnikut*, i cili zhvillohet në fshatin Galiçnik. Në këtë festival paraqiten ritualet tradicionale të dasmës, këngët, vallet dhe veshjet popullore.



Dasëm maqedonase dibrane



Valle maqedonase



Ritual dasmor maqedonas

Në traditën shqiptare, dasma është një ceremoni e gjatë, e shoqëruar me shumë këngë dhe zakone. Figurat kryesore të ritualit janë dhëndri dhe nusja, ndërsa rol të rëndësishëm kanë edhe ndërmjetësi, bajraktari dhe mushtullxhiu (lajmëtari), i cili kumton lajmin e gëzueshëm. Këngët ndahen sipas momenteve të ceremonisë: këngë parafejese, këngë të fejesës, këngë gjatë bartjes së pajës, këngë që këndohen te dhëndri dhe për nusen kur mbërrin në shtëpinë e bashkëshortit, si edhe këngë pas dasmës. Vallet shqiptare të dasmës kërcehen më së shumti nga gratë dhe shoqërohen me dajre. Ndër vallet më të njohura janë *Vallja e nuses*, *Vallja e kapjes së kulaçit* dhe *Vallja e thërrmimit të grurit*.



Lyerja e nuses me këna



Vallja e nuses



Copëtimi i kulaçit



Rregullimi i nuses



Përcjellja e nuses

Në traditën turke, dasma është një ceremoni e gjatë, e shoqëruar me këngë dhe zakone që ndjekin rrjedhën e ngjarjeve. Çdo pjesë e ceremonisë ka këngët e veta. Një nga më të njohurat është kënga *Jyksek jyksek tepelere* (Yüksek Yüksek Tepelere), e cila këndohet kur nusja përshëndetet me familjen e saj. Vallet tradicionale turke të dasmës përfshijnë vallen *Hallaç* (Halaj), vallen që interpretohet gjatë marrjes së nuses nga shtëpia e saj, *Këna gexhesi* (Kına Gecesi) dhe *Çifteteli* (Çiftetelli), një valle orientale festive për çifte.



Valle turke të dasmave



## Kuriozitet

### Çoçeku

Një valle e veçantë në traditën e romëve është çoçeku, i cili karakterizohet nga lëvizje energjike dhe të improvizuara.

Edhe në traditat rome, boshnjake, serbe dhe vllehe, dasma paraqet një ngjarje të rëndësishme familjare dhe shoqërore, e cila zgjat disa ditë dhe është e mbushur me rituale dhe zakone të shumta. Festimet e dasmës shoqërohen me këngë, valle dhe muzikë instrumentale, të cilat përcjellin përgatitjen e nuses, largimin e saj nga shtëpia e prindërve, mbërritjen në shtëpinë e dhëndrit, si edhe të gjitha momentet e rëndësishme të ritualit. Muzika ka një rol të veçantë: ajo shpreh gëzimin, emocionet dhe urimet për një martesë të lumtur e të frytshme, ndërsa njëkohësisht bashkon familjet dhe komunitetin në kremtimin e përbashkët.



Valle nga dasëm rome



Valle boshnjake



Valle serbe



Valle vllehe

## Aktivitete

### 1. Pyetje për diskutim

- Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet zakoneve të dasmës të maqedonasit, shqiptarët, turqit, romët dhe grupet e tjera etnike?
- Pse disa këngë ose valle lidhen me momente të caktuara të dasmës, si për shembull: përgatitja e pogaçes, përshëndetja e nuses me familjen dhe bartja e pajës?
- Si kontribuojnë këngët dhe ritualet e dasmës në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe të identitetit të komunitetit?

### 2. Këngë dhe valle të dasmës

- Nga kodi QR i dhënë, zgjidhni një shembull nga tradita popullore e komuniteteve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Ndahuni në grupe dhe përgatitni një interpretim, duke pasur kujdes për: saktësinë e ritmit dhe të melodisë, harmonizimin me grupin dhe paraqitjen skenike.
- Prezantoheni interpretimin para klasës.
- Vlerësoni interpretimet e njëri-tjetrit.



## TRASHËGIMIA KULTURORE MUZIKORE NË RAJON, EVROPË DHE BOTË

Trashëgimia kulturore muzikore pasqyron traditat, zakonet dhe identitetin e popujve të ndryshëm. Ajo ruan historinë dhe veçoritë lokale të muzikës, si dhe shërben si frymëzim për brezat e rinj. Në mbarë botën, çdo rajon ka forma të veçanta të shprehjes muzikore, të cilat e pasurojnë skenën kulturore globale.

### Trashëgimia kulturore muzikore në rajon

Trashëgimia kulturore muzikore në rajon përfaqëson një traditë të pasur dhe të larmishme të hapësirës ballkanike, ku muzika është rezultat i ndërthurjes shekullore të kulturave të ndryshme, ndikimeve dhe proceseve historike. Kjo ka krijuar një identitet muzikor të dallueshëm dhe autentik.

Muzika tradicionale dhe ritualet ballkanike përbëjnë një sintezë unike të ritmeve asimetrike (si 7/8, 9/8, 11/8 etj.) dhe ndikimeve të thella orientale, duke krijuar një peizazh tingullor kompleks, i cili është shenjë dalluese e rajonit. Kjo traditë e fuqishme vokalo-instrumentale shërben si bazë për rituale të shumta që kremtojnë ndërkulturalitetin, ku rrënjët pagane dhe ndikimet e ndryshme fetare ndërthuren përmes këngëve, valleve dhe ritualeve.

**Bullgaria** njihet për kompleksitetin ritmik dhe stilin unik të këndimit vokal femëror, ku këngët interpretohen me teknikën karakteristike të “fytit të hapur” dhe me këndim diafonik, ndërsa temat shpesh lidhen me korrrjet dhe jetën fshatare. Instrumentet kryesore janë gajda kaba, gadulka dhe kavalli, ndërsa vallet karakteristike janë *Raçenica* (me ritëm 7/16) dhe *Pajdushko*. Të veçantë janë edhe *kukerët* – burra të maskuar që kërcëjnë me kambana të rënda për të larguar të keqen.



*Raçenica* – Pikturë nga Ivan Mrkvička



Gadulka



Valle greke

**Folklori grek** shtrihet nga krahinat malore të Epirit deri te ishujt e Detit Egje. Këngët *Kleftiko* rrëfejnë për luftën kundër Perandorisë Osmane, ndërsa në zonat bregdetare mbizotërojnë linja melodike më të lehta dhe tipike mesdhetare. Simbol i instrumentariumit grek është buzuku, ndërsa përdoren edhe lira e Kretës dhe lira pontike. Vallet karakteristike janë *Sirtaki*, *Zeibekiko* (valle solo për burra) dhe *Pentozali* (valle e shpejtë luftarake nga Kreta).



Lira e Kretës



Buzuku



Çiftelia

Folklori në **Shqipëri** ndahet në dy dialekte kryesore stilistike – gegë në veri dhe tosk në jug. Në veri mbizotërojnë këngët epike dhe *cikli i kreshnikëve*, të cilat rrëfejnë bëmat e heronjve, ndërsa në jug është i përhapur këndimi iso-polifonik, i mbrojtur nga UNESCO, ku zërat ndërthuren mbi një ton të ulët e të vazhdueshëm (iso). Instrumentet karakteristike janë çiftelia (instrument me dy tela) dhe lahuta (instrument me një tel), ndërsa vallet dallohen për lëvizjet krenare, lëvizjet e sakta të këmbëve dhe simbolikën e shqiponjës. Një nga vallet më të njohura është *Vallja e Tropojës*.



Veshje nga Skrapari

Në folklorin e **Kosovës** janë shumë të përhapura këngët epike, të cilat ruajnë traditën e rrëfimeve fisnore dhe heroike. Instrumentet karakteristike janë çiftelia, lahuta dhe tupani, ndërsa vallet janë dinamike. Një nga më të njohurat është *Vallja e Shotës*.

Folklori në **Sërb**i dallohet për energjinë dhe dinamikën karakteristike të kolos, këndimin tradicional “me zë” dhe këngët epike të shoqëruara me gusle. Ndër instrumentet më të njohura janë frula në Serbinë Qendrore, tamburat në Vojvodinë dhe trumpeta, e cila konsiderohet simbol kombëtar i rajonit të Dragaçevës (Guça). Ndër vallet tradicionale serbe, një nga më të njohurat është *Vallja e Uzhiçës*, e cila karakterizohet nga dridhje të shpejta e të vogla të trupit dhe hapa që kërkojnë qëndrueshmëri të madhe fizike.



Lahuta



Gusla



Frula



Tamburica

**Folklori malazez** është sinonim i dinjitetit dhe krenarisë, duke pasqyruar historinë e luftërave dhe jetën në malet e ashpra. Në këngë mbizotëron poezia epike, ndërsa gusla është instrumenti më i rëndësishëm dhe nuk përdoret për argëtim, por për recitimin e ngjarjeve historike dhe bëmave heroike. Më karakteristikja është *Vallja malazeze*, e cila dallohet për faktin se valltarët ngjiten mbi supet e njëri-tjetrit, duke formuar një “kullë” dykatëshe, që simbolizon forcën dhe unitetin.

Për shkak të pozitës së saj gjeografike, **folklori kroat** është shumë i larmishëm, me ndikime të ndryshme – nga ato mesdhetare në bregdetin e Adriatikut deri te ato panonike në veri. Për këngët e zonave bregdetare është karakteristik këndimi “klapa” (këndim shumëzërësh a cappella), i cili është nën mbrojtjen e UNESCO-s. Në Sllavoni janë të njohura beqaracët – këngë të shkurtra humoristike dhe shpesh provokuese. Tamburica është simbol i instrumentariumit kroat, ndërsa në Istri përdoret edhe rozhenica, një instrument frymor karakteristik. Ndër vallet, më e njohura është *Linxho* nga Dubrovniku, e cila kërcehet në çifte me shoqërimin e gjallë dhe dinamik të lijericës, një instrument harkor me tre tela, i ngjashëm me violinën. Kjo valle dallohet për lëvizjet energjike të valltarit mashkull dhe hapat elegantë të partneres femër, duke përfaqësuar një shprehje të energjisë rinore, lojës së dashurisë dhe gëzimit të përbashkët.



Rozhenica



Valle kroate

Në **Bosnje dhe Hercegovinë**, folklori është një ndërthurje e ndikimeve sllave, orientale dhe të Evropës Qendrore. Kurora e folklorit boshnjak është *Sevdalinka* – një këngë dashurie melankolike me melizma të pasura orientale, e cila përshkruan sevdanë (mallin dhe etjen për dashuri). Ndër instrumentet tradicionale përdoren shargia, sazi dhe zurla, ndërsa vallet grupohen sipas rajoneve dhe ndikimeve të ndryshme folklorike.



Vajzë boshnjake e cila vallëzon



Saz

### Aktivitetet



#### 1. Ese me temë: Udhëtim nëpër botën muzikore ballkanike

Përmes dëgjimit të shembujve nga kodi QR, TIK-u dhe literatura e ndryshme, hulumtoni trashëgiminë kulturore muzikore të Ballkanit.

Përpikuni të dalloni:

- ritmet karakteristike dhe strukturat metrike (ritmet asimetrike, polifoninë dhe ndikimet orientale);
- instrumentet tipike dhe rolin e tyre;
- stilet vokale, këngët dhe vallet;
- lidhjen me ritualet, festat ose ciklet jetësore.

Shkruani një ese të shkurtër dhe shpjegoni:

- se në ç'mënyrë kulturat e ndryshme krijojnë një identitet muzikor të dallueshëm dhe unik;
- ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet folklorit të popujve të rajonit;
- rëndësinë e muzikës dhe të valleve në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Përgatitni një prezantim të shkurtër, në të cilin do të paraqitni analizën tuaj dhe zbulimet më interesante.

## TRASHËGIMIA KULTURORE MUZIKORE NË EVROPË

Çdo rajon evropian – Evropa Perëndimore, Qendrore, Lindore, Veriore ose Jugore – ka zhvilluar veçoritë, stilet, instrumentet dhe traditat e veta muzikore, të formuara nga proceset historike, shoqërore dhe kulturore. Kjo qasje mundëson një kuptim më të lehtë të ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet kulturave muzikore evropiane, si dhe vlerësimin e kontributit të tyre në zhvillimin e trashëgimisë muzikore evropiane.

Folklori në **Evropën Perëndimore** (Francë, Belgjikë, Holandë dhe Ishujt Britanikë – Angli, Skoci, Irlandë dhe Uells) karakterizohet nga një traditë e pasur vokale, tonalitet i qartë dhe metrikë e rregullt. Në Francë mbizotërojnë këngët dhe vallet popullore rajonale, veçanërisht në Bretanjë dhe Oksitani, të shoqëruara nga gajdja dhe violina. Në Ishujt Britanikë janë të përhapura baladat tradicionale, rilet dhe xhiget, ndërsa në Skoci është i njohur interpretimi tradicional me gajden skoceze. Në Belgjikë dhe Holandë, folklori përfaqësohet nga këngë dhe valle me melodikë të thjeshtë dhe formë strofike.



Gedenët – vallet tradicionale në Plentel, Francë



Piano accordion – Francë



Bodrani irlandez (bodhrán) dhe gajdja



Veshje angleze

**Evropa Qendrore** (Gjermania, Austria, Zvicra, Polonia, Çekia, Sllovakia, Hungaria dhe Sllovenia) ka një folklor të pasur, me tonalitet të qartë, melodi diatonike dhe ritme të larmishme (2/4, 3/4 dhe 4/4). Në Gjermani dhe Austri janë të përhapura këngët popullore (Lied), *jodlimi* dhe vallet si *ländleri* dhe *vals*. Folklori slloven ka ndikime të fuqishme alpine dhe austriake, me prani të theksuar të këndimit polifonik. Ndër vallet mbizotërojnë *polka* dhe *vals*, ndërsa këngët shpesh shoqërohen me harmonikë dhe flaut druri. Çekia dhe Sllovakia njihen për vallet, *polkat* dhe *vallet në grup*. Në Poloni dhe Hungari janë të njohura këngët popullore dhe vallet me ritme të ndërlikuara, si edhe *çardashi*, ndërsa në Zvicër tradicionalisht dëgjohet *jodlimi*.



Veshje popullore nga Sllovenia



Veshje popullore gjermane



Vallja polka



Valle popullore hungareze – çardash



Flauti rumun i Panit

**Evropa Lindore** (Rumania, Rusia, Ukraina, Bjellorusia dhe Moldavia) ka një folklor me melodi të pasur, ritme të ndërlikuara dhe një larmi të madhe instrumentesh. Në Rumani është i njohur *çallushari*, një *valle rituale burrash*, e cila dallohet për shpejtësinë e jashtëzakonshme dhe elementet akrobatike, si edhe *vallja hora*. Flauti i Panit është instrumenti tradicional rumun më i njohur në botë, krahas violinës dhe instrumentit karakteristik cimbalomit.



Instrumenti moldav Cobza



Vallja ukrainase gopak



Çallushari – valle rituale rumune – pikturë nga Amedeo Preziosi


Në **Rusi** janë të njohura këngët shumëzërëshe dhe vallet, si *barinia* dhe *trojka*, të shoqëruara me balalaikë, garmoshkë dhe domra. Në Ukrainë mbizotërojnë linjat melodike energjike dhe variacionet ritmike. Vallet më të njohura janë *hopaku* dhe *arkani*, ndërsa ndër instrumentet dallohen bandura, sopilka dhe cimbalet. Bellorusia karakterizohet nga këngë shumëzërëshe me karakter melankolik, vallet *polka* dhe *kadril*, si edhe instrumentet: cimbalet (pjatat), duda dhe gudoku. Në Moldavi muzika është e gjallë dhe e përshtatshme për vallëzim, me valle si *hora* dhe *sarba*, kurse ndër instrumentet tradicionale dallohen fluieri, kobza dhe taragui.



Vajzë ruse me balalajkë



Veshje dhe valle popullore e grave ruse



Instrumenti gudok

**Evropa Veriore** (Suedia, Norvegjia, Danimarka, Finlanda, Islanda dhe Ishujt Faroe) ka një folklor me tradita të pasura vokale, melodi plot emocion dhe ritme vallëzimi (2/4, 3/4, 6/8). Në Suedi dhe Norvegji janë të njohura këngët popullore shumëzërëshe dhe vallet tradicionale *polska* dhe *haling*, të cilat shpesh interpretohen të shoqëruara me violinën tradicionale norvegjeze (Hardanger fiddle). Në Finlandë mbizotërojnë këngët epike (Kalevala) dhe vallet me ritme të gjalla, ndërsa instrumenti kantele përdoret gjerësisht. Në Danimarkë dhe Islandë muzika është kryesisht vokale, e shoqëruar me instrumente tradicionale si hardingfele dhe fajerflejta.



Violinë norvegjeze



Valle nga Norvegjia — pikturë nga Gustav Wentzel



Këngëtarë tradicionale runikë të Finlandës



Instrumentisti i kanteles,  
pikturë nga Peka Halonen



Vajzë italiane me veshje popullore

**Evropa Jugore** (Italia, Spanja, Portugalia dhe Malta) ka një folklor me ritme të gjalla, melodi vallëzimi dhe instrumente tradicionale. Në Itali janë të njohura këngët dhe vallet, si *tarantella*, të shoqëruara me violinë, mandolinë dhe harmonikë. Në Spanjë mbizotëron *flamenkoja* (një këngë dhe valle tradicionale nga Andaluzia), e shoqëruar me kitarë, kastanjeta dhe perkusion (cajón). Në Portugali është e njohur *fadoja*, një këngë tradicionale me karakter melankolik, e cila interpretohet kryesisht me kitarën portugeze dhe violinën.



Kitara



Valle spanjolle flamenco



Mandolina



Veshje popullore nga Portugalia

## Aktivitete

### 1. Hulumtim mbi folklorin evropian

Ndahuni në grupe.

Hulumtoni folklorin e një ose më shumë rajoneve të Evropës, duke përdorur arkiva digjitale, burime në internet dhe video.

Përmes kodit QR të dhënë, evidentoni veçoritë e këngëve, valleve dhe instrumenteve popullore:

- ritmin;
- melodinë dhe stilin vokal;
- instrumentet karakteristike;
- stilet e vallëzimit dhe zakonet.

Krahasoni rezultatet ndërmjet rajoneve të ndryshme evropiane dhe veçoni:

- ngjashmëritë dhe dallimet;
- veçoritë unike të secilit rajon.

Përgatitni një material të shkurtër audiovizual (video, inçizim audio ose prezantim), duke përdorur TIK, në të cilin do t'i paraqitni zbulimet tuaja.

Prezantoni materialin para klasës dhe shpjegoni karakteristikat më interesante të rajonit të zgjedhur, si dhe ngjashmëritë dhe dallimet e tij në krahasim me rajonet e tjera.



## Trashëgimia kulturore muzikore në botë

**Afrika** ka një traditë të pasur muzikore me këngë, valle dhe instrumente karakteristike. Në Afrikën Perëndimore (Gana, Nigeria, Mali) përdoren instrumente ritmike si xhembja dhe ksilofoni, të cilat shoqërojnë valle të shpejta dhe plot energji. Në Afrikën Lindore (Kenia, Tanzania, Sudani), muzika përfshin korën (instrument me tela) dhe instrumente të ndryshme frymore, ndërsa këngët rrëfejnë histori. Në Afrikën Veriore (Maroku, Algjeria, Egjipti) mbizotërojnë udi, dafi dhe instrumente tradicionale me tela, ndërsa muzika është pjesë e ritualeve dhe festivaleve popullore. Në Afrikën Jugore (Republika e Afrikës së Jugut, Zimbabve) janë të përhapura interpretimet vokale në grup dhe vallet dinamike, të shoqëruara me instrumente tradicionale me goditje.



Orkestër tradicionale në Afrikë



Muzikant nga Marokoja

**Azia** ka një traditë të larmishme muzikore me këngë, valle dhe instrumente unike. Në Azinë Lindore (Kina, Japonia dhe Koreja) përdoren instrumente me tela, si erhu dhe koto, instrumente frymore, si fyelli, si dhe instrumente të ndërlikuara ritmike me goditje. Në Azinë Jugore (India, Pakistani, Sri Lanka dhe Bangladeshi) mbizotërojnë sitari, tabla dhe instrumente të tjera me goditje, ndërsa muzika është pjesë e ritualeve dhe rrëfimeve popullore. Në Azinë Juglindore (Tajlanda, Indonezia, Filipinet dhe Malajzia) përdoren instrumente me goditje prej metali dhe druri, ndërsa vallet janë pjesë e festivaleve dhe zakoneve tradicionale. Në Lindjen e Mesme dhe Azinë e Vogël (Turqia, Arabia Saudite, Siria, Iraku dhe Irani) janë të përhapura udi, neji, dafi (daf), kanuni dhe interpretimet tradicionale vokale.



Muzikant tradicional kinez



Vajzë nga India e veshur me kostum tradicional – sari



Muzikant popullor nga Alepo – Siri

Në **Amerikë** muzika është e larmishme dhe dallohet për ritmet e pasura dhe instrumentet e ndryshme. Në Amerikën Veriore dhe Qendrore, muzika e popujve indigjenë përfshin këngë vokale, instrumente me goditje dhe valle ritmike. Muzika afroamerikane karakterizohet nga ritme dinamike dhe përdorimi i instrumenteve si daullet, marakat dhe tromboni, duke krijuar bazat e zhanreve si xhazi dhe bluzi. Në Amerikën Jugore muzika është e gjallë dhe ritmike, me ndikime nga popujt autoktonë dhe kultura koloniale. Në rajonin e Andeve përdoren fyelli i Panit dhe çarangoja, ndërsa muzika është pjesë e ritualeve dhe festivaleve popullore. Në Karaibe dhe në Brazil janë zhvilluar stile si *salsa* dhe *samba*, të shoqëruara me orkestra daullesh, instrumente me goditje dhe valle plot gjallëri. Muzika në Amerikë karakterizohet nga lidhja e ngushtë me zakonet kulturore dhe traditat e ndryshme etnike.



Veshje popullore nga kultura indiane



Çarangoja



Vallëzimi salsa

**Australia** është e njohur për muzikën tradicionale të aborigjenëve, e cila është shumë e lashtë dhe përfshin didzheridun (instrument frymor), instrumente me goditje dhe rituale vokale, që rrëfejnë legjenda dhe zakone. Në Oqeani dhe Polinezi, muzika popullore e Havait, Samoas dhe Fixhit karakterizohet nga përdorimi i instrumenteve me goditje, instrumenteve me tela dhe formave vokale, ndërsa është e lidhur ngushtë me vallet dhe festivalet tradicionale.



Aborigjen me  
instrumentin tradicional  
aborigjen – didzheridu



### Aktivitete

1. Përmes kodeve QR të dhëna, evidentoni veçoritë e këngëve, valleve dhe instrumenteve popullore në botë:

- ritmin;
- melodinë dhe stilin vokal;
- instrumentet karakteristike;
- stilet e vallëzimit dhe zakonet.

Krahasoni rezultatet ndërmjet rajoneve të ndryshme të botës dhe veçoni:

- karakteristikat unike të secilit rajon.

Prezantoni materialin para klasës dhe shpjegoni karakteristikat e tyre.

## 2. Diskutim mbi temën Ruajtja e trashëgimisë kulturore muzikore në rajon, në Evropë dhe në botë

Diskutoni për atë që vijon:

- pse është e rëndësishme të ruhet trashëgimia kulturore muzikore;
- cilat mënyra dhe teknologji bashkëkohore mund të ndihmojnë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore muzikore (TIK, arkiva digjitale, festivale, projekte edukative);
- si mund të kontribuojë secili prej nesh në ruajtjen dhe promovimin e muzikës tradicionale.

Argumentoni qëndrimet tuaja, dëgjoni mendimet e të tjerëve dhe nxitni një diskutim konstruktiv.

Së bashku formuloni një përfundim, i cili do t'i përfshijë pikat dhe idetë më të rëndësishme të diskutimit.



## Literatura e shfrytëzuar

1. Abrashev, B., Gadjev, V. (2012). *The world atlas of musical instruments*. Potsdam: H. F. Ullmann Publishing.
2. Aliu, R. (2006). *Folklori dhe traditat në malësinë e Sharrit*. Tetovë: Jehona e re.
3. Andreis, J. (1989). *Povijest glazbe* (Knjiga 2). Zagreb: SNL.
4. Andreis, J. (1989). *Povijest glazbe* (Knjiga 3). Zagreb: SNL.
5. Andreis, J. (1989). *Povijest glazbe* (Knjiga 4). Zagreb: SNL.
6. Antoni, L. (1977). *Folklori muzikor shqiptar*. Prishtinë: Redaksia e botimeve Rilindja
7. Berisha, Ē. (1975). *Historia e muzikës II*. Prishtinë: (Dispensë).
8. Bose, F. (Ramadani, B). (2019). *Etnomuzikologjia*. Tetovë: BIR
9. Carl, S. E. (1938). *Psychology of music*. New York: Dover Publications.
10. Cvetko, D. *Juzni sloveni u istoriji evropske muzike*. Beograd: Nolit.
11. Džorž, Š. B. (1991). *O muzici*. Beograd: Nolit.
12. Ewen, D. (1973). *Enciklopedija glasbenih umetnin (Druga knjiga)*. Ljubljana: Državna založba.
13. Ewen, D. (1973). *Enciklopedija glasbenih umetnin (Prva knjiga)*. Ljubljana: Državna založba.
14. Filimon, R. C. (2023, July). *Syncretism and synaesthesia in music – unification of arts and perceptions*. *Artes Journal of Musicology*, 27(27–28), 167–184.  
[https://www.researchgate.net/publication/372539260\\_Syncretism\\_and\\_synaesthesia\\_in\\_music\\_-\\_unification\\_of\\_arts\\_and\\_perceptions](https://www.researchgate.net/publication/372539260_Syncretism_and_synaesthesia_in_music_-_unification_of_arts_and_perceptions)
15. Grujonjič, Z. (1990). *Pismo besmrtnoj dragoj*. Banja Luka: Novi glas.
16. Hanslik, E. (1977). *O muzički ljepom*. Beograd: Beogradski izdavačko-grafički zavod.
17. Heveler, K. (1988). *Muzički leksikon*. Novi Sad: Budućnost.  
[https://www.devopsschool.com/blog/top-10-music-notation-software-features-pros-cons-comparison\(JosephK.\)](https://www.devopsschool.com/blog/top-10-music-notation-software-features-pros-cons-comparison(JosephK.))
18. Ilić, D. (2002). *Sredstva izražavanja u muzici*. Niš: Permanego.
19. Ksenija, M. R. (1996). *Psihologija muzike*. Beograd: Zavod za udžbenike i nastavna sredstva.
20. Kuk, D. (1982). *Jezik muzike*. Beograd: Nolit.
21. Lara, K. (1999). *Ndërtimi i formave muzikore*. Tiranë: Drier.
22. Michael, M. (1971). *Larousse encyclopedia of music*. London: Hamlyn.
23. Muçollari, G. (2023). *Bishat e rock'n'rollit*. Tiranë: Albas.
24. *Musical (musical comedy, musical theatre)*. (2025, August 5). In *Encyclopedia Britannica*.  
<https://www.britannica.com/art/musical>
25. Pejović, P. (1987). *Историја музике за музичке школе*. Први део. Beograd: Zavod za udžbenike i nastavna sredstva.
26. Pejović, P. (1987). *Историја музике за музичке школе*. Други део. Beograd: Zavod za udžbenike i nastavna sredstva.
27. Polena, I., & Tole, V. S. (2015). *Fjalor i muzikës klasike dhe popullore*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
28. Rojko, P. (1982). *Psihološke osnove intonacije i ritma*. Zagreb: Muzikološki zavod Muzičke akademije.
29. Rojko, P. (2014). *Metodika e mësimet të muzikës (B. Ramadani, Përkth.)*. Tetovë: Universiteti Shtetëror i Tetovës.
30. Salazar, F. *Ideologije u operi*. Beograd: Nolit.
31. Skovran, D. & Perićić, V. (1991). *Nauka o muzičkim oblicima*. Beograd: Fakultet muzičke umetnosti.

32. Stringa, H. (2000). *Historia e muzikës botërore (Pjesa e dytë)*. Tiranë: Shtëpia botuese e librit universitar.
33. Vasilević, Z. M. (2000). *Metodika muzičke pismenosti*. Beograd.
34. Величковска, Р. (2008). *Музичкиџе дијалекџи во џтрадиционалноџо народно џеење – обредно џеење*. Скопје: Институт за фолклор „Марко Цепенков“.
35. Величковска, Р. (2008). *Македонскоџо џтрадиционално народно џеење – хресџомаџија со мелодоеџска анализа*. Скопје: Маска
36. Величковски, Б. (2011). *Македонски деџски фоклор*. Скопје: Институт за фолклор „Марко Цепенков“.
37. Група автори, (1999) *Музикаџа на џочваџа на Македонија, книга 7, дел I-II*. Скопје: Македонска Академија на Науките и Уметностите
38. Коловски, М. (1993). *Македонски комџозиџори и музиколози*. Скопје: Сојуз на композиторите на Македонија (Универзитетска печатница).
39. Линин, А. (1986). *Народниџе музички инсџруменџи во Македонија*. Скопје: Македонска книга.
40. Маринковиќ, С. (1997). *Исџорија музике за средње музичке школе*. Београд: Завод за уџбенике и наставна средства.
41. Нестневои, М. (1990). *С. С. Прокофјев*. Москва: Музика.
42. Пеев, И. (1964). *Очерци џо методика на обучениеџо џо солфеж*. Софиа: Държавно издателство Наука и изкуство.
43. Пенушлиски, К. (1999). *Македонски фолклор*. Скопје: Матица Македонија.
44. Институт за македонски јазик "Крсте Мисирков". (2017). *Правойис на македонскиоџ јазик*. Скопје: Култура.
45. Рамадани, Б. (2019). *Традиционална музичка кулџура на албанциџе од долни Полоџ*. Тетово: БИР.
46. Светозаревиќ, Б. П. (2017). *Кулџурно џулсирање низ времеџо*. Тетово: Иљо Антески Смок.
47. Симс, М; Стивенс. М. (2010). *Жив фолклор*. Скопје: Академски печат.
48. Тајчевиќ, М. (2000). *Основна џеорија на музикаџа*. Скопје: Просветно дело.
49. Тајчевиќ, М. *Умеџносџиџе и нивниџе каракџерисџики*. Скрипта.
50. Филиповски, Ј. (1972). *Македонски народни ора*. Скопје: Македонска книга.
51. Чадиковска С. А. (2006). *Моцарџ*. Скопје: Музичка младина на МК.
52. Ширинян, Р. (1989). *П. М. Мусорџский*. Москва: Музика.

**Burime të fotografive të përdorura**



**Linqe të përdorura nga kanale të YouTube**



